

URDHËR
Nr. 57, datë 13.3.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
ZBATUESE TË VLEFSHMËRISË AJRORE DHE TË CERTIFIKIMIT MJEDISOR OSE
DEKLARATËN E PËRPUTHSHMËRISË SË AVIONIT DHE PRODUKTEVE TË
LIDHURA ME TO, PJESËVE DHE PAJISJEVE, SI DHE PËR KËRKESAT E AFTËSISË
SË ORGANIZATAVE TË PROJEKTIMIT DHE PRODHIMIT¹**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 37, 38, 39, 42 dhe 43, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Certifikatat e lëshuara me urdhrin e ministrit nr. 326, datë 29.8.2019, do të vazhdojnë të mbeten të vlefshme.

3. Urdhri i ministrit nr. 326, datë 29.8.2019, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Autoritetit i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

¹ Ky urdhër përafrohet plotësisht rregulloren e Komisionit (BE) nr. **748/2012** e datës 3 gusht 2012, për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 224, 21.8.2012, L1, e **ndryshuar** me rregulloret e Komisionit (BE) nr. **7/2013** e 8 janarit 2013, nr. **69/2014** e 27 janarit 2014, nr. **2015/1039** e 30 qershorit 2015, nr. **2016/5** e 5 janarit 2016, nr. **2019/897** e 12 marsit 2019, nr. **2020/570** e 28 janarit 2020, nr. **2021/699** e 21 dhjetorit 2020, nr. **2021/1088** e 7 prillit 2021, nr. **2022/201** e 10 dhjetorit 2021, nr. **2022/203** e 14 shkurtit 2022, nr. **2022/1358** e 2 korrikut 2022, nr. **2022/1645** e 14 korrikut 2022, nr. **2022/1253** e 19 korrikut 2022, nr. **2022/1361** e 28 korrikut 2022, nr. **2023/203** e 27 tetorit 2022, nr. **2023/1028** e 20 marsit 2023, botuar në fletoret zyrtare të BE-së, L4, 9.1.2013, L23, 28.1.2014, L167, 1.7.2015, L3, 6.1.2016, L144 3.6.2019, L132 27.4.2020, L145 28.4.2021, L236 5.7.2021, L33 15.2.2022, L33 15.2.2022, L205 5.8.2022, L248 26.9.2022, L191 20.7.2022, L205 5.8.2022, L31 2.2.2023, L139 26.5.2023.

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE ZBATUESE TË VLEFSHMËRISË AJRORE DHE TË CERTIFIKIMIT MJEDISOR OSE DEKLARATËN E PËRPUTHSHMËRISË SË AVIONIT DHE PRODUKTEVE TË LIDHURA ME TO, PJESËVE DHE PAJISJEVE, SI DHE PËR KËRKESAT E AFTËSISË SË ORGANIZATAVE TË PROJEKTIMIT DHE PRODHIMIT

Neni 1

Qëllimi dhe përkufizimet

1. Kjo rregullore përcakton, në përputhje me nenet 19 dhe 62, të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, kërkesat e përbashkëta teknike dhe procedurat administrative për vlefshmërinë ajrore dhe certifikimin mjedisor të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve duke specifikuar:

a) lëshimin e certifikatave tip, certifikatave të kufizuara të tipit, certifikatave plotësuese të tipit dhe ndryshimet në ato certifikata;

b) lëshimin e certifikatave të vlefshmërisë ajrore, certifikatave të kufizuara të vlefshmërisë ajrore, lejeve për fluturim dhe certifikatave për përdorim të autorizuar;

c) lëshimin e miratimeve të projektimit të riparimit;

d) dëshminë e përputhshmërisë me kërkesat e mbrojtjes së mjedisit;

e) lëshimin e certifikatave të zhurmës dhe certifikatave të kufizuara të zhurmës;

f) identifikimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve;

g) certifikimin e pjesëve dhe pajisjeve të caktuara;

h) certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit;

i) lëshimin e direktivave të vlefshmërisë ajrore;

j) hartimin e deklaratave të përputhshmërisë së projektimit dhe ndryshimet në ato deklarata;

k) hartimin e deklaratave të aftësisë së projektimit dhe prodhimit.

2. Për qëllim të kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “JAA” nënkupton “Autoritetet e përbashkëta të Aviacionit”;

b) “JAR” nënkupton “Kërkesat e përbashkëta të aviacionit”;

c) “Pjesa 21” nënkupton kërkesat dhe procedurat për certifikimin e avionëve dhe produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe të organizatave të projektimit dhe prodhimit të përcaktuara në aneksin I (Pjesa 21) të kësaj rregulloreje;

d) “Pjesa 21 Light” nënkupton kërkesat dhe procedurat për certifikimin ose deklaratën e përputhshmërisë së projektimit të avionëve të destinuara kryesisht për përdorim sportiv dhe rekreativ dhe produkteve dhe pjesëve që kanë lidhje me to, dhe deklaratën e aftësisë së projektimit dhe prodhimit të organizatave të përcaktuara në aneksin Ib (Pjesa 21 Light) të kësaj rregulloreje;

e) “vendi kryesor i biznesit” nënkupton selinë qendrore ose selinë e regjistruar të ndërmarrjes brenda së cilës ushtrohen funksionet kryesore financiare dhe kontrolli operacional i veprimtarive të përmendura në këtë rregullore;

f) “artikull” nënkupton çdo pjesë dhe pajisje që do të përdoret në avionët civilë;

g) “ETSO-European Technical Standard Order” nënkupton Urdhrin e Standardit Teknik Evropian. Urdhri i Standardit Teknik Evropian është një specifikim i detajuar i vlefshmërisë ajrore, i lëshuar nga Agjencia e Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian (“Agjencia”) për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e kësaj Rregulloreje si një standard minimal i performancës për nenet e specifikuar;

h) “EPA- European Part Approval” nënkupton Miratimin Evropian të Pjesës. Miratimi evropian i pjesës së një artikulli nënkupton që një artikull është prodhuar në përputhje me të dhënat e miratuara të projektimit që nuk i përkasin mbajtësit të certifikatës së tipit të produktit përkatës, me përjashtim të artikujve të ETSO-s;

“(ha) “avion kompleks me motor”, do të thotë:

i) një aeroplan

- me një masë maksimale të certifikuar të ngritjes që tejkalon 5 700 kg, ose

- i certifikuar për një konfigurim maksimal të ndenjësive të pasagjerëve më shumë se nëntëmbëdhjetë, ose

- i certifikuar për operim me një ekuipazh minimal prej të paktën dy pilotësh, ose

- i pajisur me motor(ë) turbojet ose më shumë se një motor turboprop, ose

ii) një helikopter i certifikuar:

- për një masë maksimale ngritjeje që tejkalon 3 175 kg, ose

- për një konfigurim maksimal të ndenjësive të pasagjerëve prej më shumë se nëntë, ose

- për operim me një ekuipazh minimal prej të paktën dy pilotësh, ose

iii) një avion me rotor me anim.

i) “Avionët ELA1” nënkupton avionët e lehtë të pilotuar evropianë si më poshtë:

i) një aeroplan me një masë maksimale ngritjeje (MTOM) prej 1 200 kg ose më pak që nuk klasifikohet si avion kompleks me fuqi motorike;

ii) një planer (glajder) ose planer me motor me masë 1 200 kg MTOM ose më pak;

iii) një balonë me një vëllim maksimal të projektimit të gazit ngritës ose të ajrit të nxehtë jo më shumë se 3 400 m³ për balonat me ajër të nxehtë, 1 050 m³ për balonat me gaz, 300 m³ për balonat me gaz të lidhur;

iv) një aerostat i projektuar për jo më shumë se katër pasagjerë dhe një vëllim maksimal projektimi të gazit ngritës ose ajrit të nxehtë prej jo më shumë se 3 400 m³ për aerostatet me ajër të nxehtë dhe 1 000 m³ për aerostatet me gaz;

j) “Avionët ELA2” nënkupton avionët e lehtë të pilotuar evropianë si më poshtë:

i) një aeroplan me një masë maksimale ngritjeje (MTOM) prej 2 000 kg ose më pak që nuk klasifikohet si avion kompleks me fuqi motorike;

ii) një planer (glajder) ose avion me motor me masë 2 000 kg MTOM ose më pak;

iii) një balonë;

iv) një aerostat me ajër të nxehtë;

v) një aerostat me gaz në përputhje me të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

- 3% peshë maksimale statike

- forcë shtytëse jo vektoriale (përveç forcës shtytëse të kundërt),

- projektim konvencional dhe të thjeshtë të strukturës, sistemit të kontrollit dhe sistemit të balonetit,

- kontrole pa fuqi motorike ndihmëse;

vi) një helikopter me një MTOM jo më shumë se 600 kg, i cili është i një projektimi të thjeshtë, i projektuar për të transportuar jo më shumë se dy pasagjerë, që nuk mundësohet nga motorë turbinash dhe/ose raketash; i kufizuar në operacionet e ditës VFR;

k) “Të dhënat e përshtatshmërisë operacionale (OSD)” nënkupton të dhënat, të cilat janë pjesë e një certifikate të tipit të avionit, certifikatës së kufizuar të tipit ose certifikatës plotësuese të tipit, e përbërë si në vijim:

i) planprogrami minimal i trajnimit të pilotit për kategorinë e tipit, duke përfshirë përcaktimin e kategorisë së tipit;

ii) përcaktimi i fushës së të dhënave burimore të vlefshmërisë së avionit për të mbështetur kualifikimin objektiv të simulatorëve ose të dhënat e përkohshme për të mbështetur kualifikimin e tyre të përkohshëm;

iii) planprogrami minimal i trajnimit të personelit që certifikon mirëmbajtjen për trajnimin e kategorisë së tipit, duke përfshirë përcaktimin e kategorisë së tipit;

iv) përcaktimi i tipit ose variantit për ekuipazhin e kabinës dhe të dhënat specifike të tipit për ekuipazhin e kabinës;

v) lista kryesore e pajisjeve minimale.

Neni 2

Certifikimi i produkteve, pjesëve dhe pajisjeve

1. Produkteve, pjesëve dhe pajisjeve do t'u lëshohen certifikata siç specifikohet në aneksin I (Pjesa 21).

2. Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, certifikatat mund të lëshohen në mënyrë alternative siç specifikohet në aneksin Ib (Pjesa 21 Light) për produktet e mëposhtme:

a) një aeroplan me një masë maksimale ngritjeje (MTOM) prej 2 000 kg ose më pak dhe një konfigurim maksimal operativ të ndenjësve për katër persona;

b) një planer (*glajder*) ose avion me motor me masë 2 000 kg MTOM ose më pak;

c) një balonë;

d) një aerostat me ajër të nxehtë;

e) një aerostat pasagjerësh me gaz i projektuar për jo më shumë se katër persona;

f) një helikopter prej 1 200 kg MTOM ose më pak dhe një konfigurim maksimal i ndenjësve operacionale për katër persona;

g) një motor pistoni ose një helikë me krah rrotullimi të fiksuar që synohet të instalohet në një avion siç përmendet në pikat (a) deri (f); ose

h) një xhiroplan.

3. Me përjashtim të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, në mënyrë alternative mund të hartohet një deklaratë e përputhshmërisë së projektimit, siç specifikohet në aneksin Ib (Pjesa 21 Light), për produktet e mëposhtme:

a) një aeroplan prej 1 200 kg MTOM ose më pak që nuk është me fuqi reaktive dhe me një konfigurim maksimal të ndenjësve operacionale për dy persona;

b) një planer (*glajder*) ose një planer me motor prej 1 200 kg MTOM ose më pak;

c) një balonë e projektuar për jo më shumë se katër persona;

d) një aerostat me ajër të nxehtë i projektuar për jo më shumë se katër persona.

4. Me përjashtim nga paragrafët 1 deri në 3 të këtij neni, avionët, duke përfshirë çdo produkt, pjesë dhe pajisje të instaluar, të cilët nuk janë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, përjashtohen nga dispozitat e nënpjesëve H dhe I të seksionit A të aneksit I (Pjesa 21) dhe nënpjesët H dhe I të seksionit A të aneksit Ib (Pjesa 21 Light). Ata gjithashtu do të përjashtohen nga dispozitat e nënpjesës P të seksionit A të aneksit I (Pjesa 21) dhe nënpjesës P të seksionit A të aneksit Ib (Pjesa 21 Light), përveç rasteve kur shenjat identifikuese të avionit janë të përshkuara nga Republika e Shqipërisë.

Neni 2a

Rregullime kalimtare për certifikatat e lëshuara më parë sipas aneksit I (Pjesa 21)

1. Mbajtësi i një certifikate tipi të vlefshme ose një certifikate plotësuese tipi të lëshuar, ose që konsiderohet se është lëshuar, nga AAC-ja sipas aneksit I (Pjesa 21), mundet, deri më 25 gusht 2025,

t'i kërkojë AAC-së të mbajë, nga një datë e caktuar, projektin e tipit të miratuar sipas asaj certifikate në përputhje me aneksin Ib (Pjesa 21 Light), me kusht që produkti i mbuluar nga ajo certifikatë të jetë brenda objektit të nenit 2(2).

2. Kur bëhet një kërkesë në përputhje me paragrafin 1, ajo certifikatë tipi ose certifikatë plotësuese të tipit, rregullohet, që nga data e dhënë e përmendur në paragrafin 1, nga dispozitat e aneksit Ib (Pjesa 21 Light) në lidhje me certifikatat e tipit ose certifikatë plotësuese të tipit, sipas rastit. AAC-ja ndryshon fletën e të dhënave të certifikatës së tipit ose fletën e të dhënave të certifikatës plotësuese të tipit sipas rrethanave.

Neni 3

Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së certifikatave të tipit dhe certifikatave përkatëse të vlefshmërisë ajrore

1. Për sa u përket produkteve të cilët kanë pasur një certifikate tipi apo një dokument që lejon lëshimin e një certifikatë të vlefshmërisë ajrore, të lëshuar para 28 shtatorit 2003, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) produkti konsiderohet të ketë një certifikate tip të lëshuar në përputhje me këtë rregullore kur:

i) baza e tij e certifikimit të tipit ka qenë:

- baza e certifikimit të tipit sipas JAA-së, për produktet që janë certifikuar sipas procedurave të JAA, siç përcaktohet në fletën e tyre të të dhënave sipas JAA-së, ose

- për produktet e tjera, baza e certifikimit të tipit siç përcaktohet në fletën e të dhënave të certifikatës së tipit të Shtetit të projektimit, nëse ai shtet projektimi ka qenë:

- Republika e Shqipërisë, një Shtet Anëtar i BE-së ose i ZPEA-së, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, përveç nëse përkatësisht AAC ose Agjencia përcakton, duke marrë parasysh në veçanti specifikimet e certifikimit të përdorura dhe përvojën e shërbimit, që një bazë e tillë e certifikimit të tipit nuk siguron një nivel sigurie të barabartë me atë të kërkuar në VKM- në nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe nga kjo rregullore, ose

- një shtet me të cilin Shqipëria ka lidhur një marrëveshje dypalëshe të vlefshmërisë ajrore ose një marrëveshje të ngjashme sipas të cilit produktet e tilla janë certifikuar në bazë të specifikimeve të certifikimit të atij Shteti të Projektimit, përveçse nëse AAC-ja përcakton se këto specifikime certifikimi ose përvoja e shërbimit ose sistemi i sigurisë i atij Shteti të projektimit nuk siguron një nivel sigurie të barabartë me atë të kërkuar në VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”.

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (AAC) bën një vlerësim të parë të implikimit të dispozitave të paragrafit të dytë, në mënyrë që të japë një opinion për ministrin, duke përfshirë ndryshimet e mundshme të kësaj rregulloreje;

ii) kërkesat për mbrojtjen e mjedisit janë ato të përcaktuara në aneksin 16 të Konventës së Çikagos, siç aplikohen te produkti;

iii) direktivat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore kanë qenë ato të shtetit të projektimit.

b) projektimi individual i një avioni, që është regjistruar në regjistër para 28 shtatorit 2003, miratohet sipas kësaj rregulloreje kur:

i) projekti bazë i tipit të tij të ketë qenë pjesë e certifikatës së tipit referuar pikës (a);

ii) të gjitha ndryshimet e këtij projekti bazë tip, të cilat nuk kanë qenë nën përgjegjësinë e mbajtësit të certifikatës tip, kanë qenë miratuar.

iii) direktivat e vlefshmërisë ajrore të lëshuara ose adaptuara nga AAC-ja kur Shqipëria ka qenë shtet i regjistrit para 28 shtatorit 2003 kanë qenë në përputhje, duke përfshirë çdo ndryshim, me

direktivat e vlefshmërisë ajrore të shtetit të projektimit të pranuar nga AAC-ja kur Shqipëria ka qenë shteti i regjistrit.

2. Referuar produkteve për të cilat procesi i certifikimit tip është kryer më 28 shtator 2003, aplikohen sa më poshtë:

- a) nëse një produkt është nën certifikim nga disa shtete, si referencë përdoret projekti më i avancuar;
- b) pikat 21.A.15(a), (b) dhe (c) të aneksit I (pjesa 21) nuk aplikohen;
- c) me përjashtim të pikës 21.B.80 të aneksit I (pjesa 21), baza e certifikimit të tipit është ajo e përcaktuar nga JAA-ja ose, aty ku është e zbatueshme, nga Shteti Anëtar i BE-së ose ZPEA-ja, ose Republika e Shqipërisë në datën e aplikimit për miratim;
- d) gjetjet e përputhshmërisë të bëra sipas procedurave të JAA ose të Shtetit Anëtar konsiderohen se janë bërë nga AAC-ja ose Agjencia sipas rastit me qëllim të përputhjes me pikat 21.A.20 (a) dhe (d) të aneksit I (pjesa 21).

3. Në lidhje me produktet që kanë një certifikatë tipi kombëtar ose ekuivalent, dhe për të cilat procesi i miratimit të një ndryshimi të kryer nga një Shtet Anëtar nuk ishte finalizuar në kohën kur certifikata e tipit duhej të miratohej në përputhje me këtë rregullore, do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

- a) nëse një produkt është nën certifikim nga disa Shtete Anëtare projekti më i avancuar përdoret si referencë;
- b) pika 21.A.93 e aneksit I (Pjesa 21) nuk zbatohet;
- c) baza e certifikimit të tipit do të jetë ajo e vendosur nga JAA-ja ose, kur është e zbatueshme, nga AAC-ja në datën e aplikimit për miratimin e ndryshimit;
- d) gjetjet e përputhshmërisë të bëra sipas procedurave të JAA-së ose të AAC-së konsiderohen se janë bërë nga AAC-ja për qëllime të përputhshmërisë me pikat 21.B.107 të aneksit I (Pjesa 21).

4. Në lidhje me produktet që kanë një certifikatë tipi kombëtare ose ekuivalente dhe për të cilat procesi i miratimit të një projekti riparimi madhor të kryer nga AAC-ja nuk është finalizuar në kohën kur certifikata e tipit duhej të përcaktohej në përputhje me këtë rregullore, gjetjet e përputhshmërisë të bëra sipas procedurave të JAA-së ose të AAC-së do të konsiderohen se janë bërë nga AAC-ja për qëllime të përputhshmërisë me pikën 21.A.433 (a) të aneksit I (Pjesa 21).

5. Certifikata e vlefshmërisë ajrore e lëshuar nga AAC-ja e cila vërteton përshtatshmërinë me certifikatën tip të përcaktuar në përputhje me pikën 1, duhet të konsiderohet në përputhje me këtë Rregullore.

Neni 4

Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së certifikatës tip plotësuese

1. Referuar certifikatës tip plotësuese të lëshuar nga Republika e Shqipërisë sipas procedurave të JAA ose procedurave të zbatueshme kombëtare, referuar ndryshimeve të produkteve të propozuara nga persona të tjerë nga mbajtësit e certifikatës tip të produktit, që kanë qenë të miratuara sipas procedurave të aplikueshme kombëtare, n.q.s. certifikata tip plotësuese ose ndryshimi ka qenë i vlefshëm deri në 2003, certifikata tip plotësuese ose ndryshimi konsiderohen si të lëshuara sipas kësaj rregulloreje.

2. Referuar certifikatave tip plotësuese, për të cilat procesi i certifikimit është ndërmarrë në vitin 2003 sipas procedurave të aplikueshme të JAA-së për certifikatën tip plotësuese dhe referuar ndryshimeve madhore të produkteve të propozuara nga persona të tjerë nga mbajtësit e certifikatës tip të produktit, për të cilën procesi i certifikimit është ndërmarrë në vitin 2003 sipas procedurave të aplikueshme kombëtare, veprohet si më poshtë:

a) n.q.s. procesi i certifikimit është ndërmarrë nga disa shtete, projekti më i avancuar përdoret si referencë;

b) pikat 21.A.113 (a) dhe (b) të aneksit I (pjesa 21) nuk zbatohen;

c) bazat e aplikueshme të certifikimit duhet të përcaktohen nga JAA-ja ose kur është e aplikueshme nga AAC-ja në datën e aplikimit për aprovimin e certifikatës tip plotësuese ose ndryshimeve madhore;

d) gjetjet e përputhshmërisë të kryera nga procedurat kombëtare konsiderohen si të kryera nga AAC-ja me qëllim përmbushjen e pikave 21.A.115(a) të aneksit I (pjesa 21).

Neni 5

Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së certifikatave të pjesëve dhe pajisjeve

1. Miratimet e pjesëve dhe pajisjeve të lëshuara dhe të vlefshme në 28 shtator 2003 konsiderohen si të jenë lëshuar në përputhje me këtë rregullore.

2. Referuar pjesëve dhe pajisjeve, për të cilat procesi i miratimit ose autorizimit ka qenë i ndërmarrë më datë 28 shtator 2003, veprohet si më poshtë:

a) nëse procesi i autorizimit është kryer nga disa shtete të ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, si referencë përdoret projekti më i avancuar;

b) pika 21.A.603 e aneksit I (pjesa 21) nuk aplikohet;

c) kërkesat e të dhënave të zbatueshme të përcaktuara në pikën 21.A.605 të aneksit I (pjesa 21) janë ato të përcaktuara nga AAC-ja, në datën e aplikimit për miratimin ose autorizimin.

d) gjetjet e përputhshmërisë të bëra nga AAC-ja konsiderohen si të bëra për përmbushjen e pikës 21.A.606(b) të aneksit I (pjesa 21).

Neni 6

Leja e fluturimit

Kushtet e përcaktuara për lejet e fluturimit ose certifikatat e tjera të vlefshmërisë ajrore të lëshuara për avionë të cilët nuk mbajnë një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore sipas kësaj rregulloreje, konsiderohen si në përputhje me këtë rregullore, përveç kur AAC-ja konstaton se këto kushte nuk provojnë një ekuivalent të nivelit të sigurisë të kërkuar nga VKM-ja nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” ose nga kjo rregullore.

Neni 6a

Të dhënat e përshtatshmërisë operacionale

1. Mbajtësi i një certifikatë tip të avionit të lëshuar para datës 17 shkurt 2014 që synon të dorëzojë një avion të ri te një operator i Shqipërisë ose BE-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe pas 17 shkurtit 2014, duhet të marrë miratimin në përputhje me pikën 21.A.21 (e) të aneksit I (pjesa 21) me përjashtim të programit minimal të trajnimit për kualifikimin e personelit të caktuar për certifikimin e mirëmbajtjes dhe me përjashtim të të dhënave të burimit të vlefshmërisë së avionit për të mbështetur kualifikimin objektiv të simulatorit(ëve). Miratimi do të merret përpara se avioni të përdoret nga një operator i Shqipërisë ose BE-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe cilado që është më e fundit. Të dhënat e përshtatshmërisë operacionale mund të kufizohen në modelin që është dorëzuar.

2. Aplikanti për një certifikatë tipi të avionit për të cilën është paraqitur kërkesa përpara 17 shkurtit 2014 dhe për të cilën nuk është lëshuar certifikata e tipit përpara 17 shkurtit 2014 duhet të marrë

miratimin në përputhje me pikën 21.A.21 (e) të shtojcës I (pjesa 21) me përjashtim të programit minimal të trajnimit për kualifikimin e personelit të caktuar për certifikimin e mirëmbajtjes dhe me përjashtim të të dhënave të burimit të vlefshmërisë së avionit për të mbështetur kualifikimin objektiv të simulatorit(ëve). Miratimi do të merret përpara se avioni të përdoret nga një operator i Shqipërisë ose BE-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, cilado që është më e fundit. Gjetjet e përputhshmërisë të bëra nga autoritetet në proceset e Bordit të Vlerësimit Operacional të kryera nën përgjegjësinë e JAA ose Agjencisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pranohen nga Agjencia pa verifikime të mëtejshme.

3. Raportet e Bordit të Vlerësimit Operacional dhe masterlistat e pajisjeve minimale të lëshuara në përputhje me procedurat e JAA ose Agjencisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të konsiderohen si të dhëna të përshtatshmërisë operationale të miratuara në përputhje me pikën 21.A.21 (e) të aneksit I (pjesa 21) dhe duhet të përfshihen në certifikatën përkatëse të tipit.

4. Mbajtësit e një certifikatë të tipit duke përfshirë të dhënat e përshtatshmërisë operationale duhet të marrin miratimin e një zgjatjeje të fushëveprimit të miratimit të organizatës së tyre të projektimit ose të procedurave alternative për miratimin e organizatës projektuese.

Neni 7

Organizatat e projektimit

1. Një organizatë përgjegjëse për projektimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve, ose për ndryshime ose riparimin e tyre duhet të vërtetojë aftësinë e saj në përputhje me aneksin 1 (pjesën 21).

2. Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, një person fizik ose juridik përgjegjës për projektimin e produkteve, vendi kryesor i biznesit të të cilit ndodhet në Republikën e Shqipërisë dhe që zbaton ose ka një certifikatë për projektimin e produkteve, ndryshimet ose riparimet, në përputhje me nenin 2(2), mundet, në mënyrë alternative, të dëshmojë aftësinë e tyre në përputhje me aneksin Ib (Pjesa 21 Light).

3. Personat fizikë ose juridikë që janë përfshirë në projektimin e avionëve që i nënshtrohen një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit të përmendur në nenin 2(3) nuk duhet të dëshmojnë aftësinë e tyre.

4. Me përjashtim të pikave 21.B.433(d)(1) dhe (2) të aneksit I (Pjesa 21), një organizatë projektuese që mban një certifikatë të vlefshme miratimi të lëshuar në përputhje me aneksin I (Pjesa 21) mund të korrigjojë, deri më 7 mars 2025, çdo gjetje mospërputhjeje në lidhje me kërkesat e aneksit I të paraqitura në këtë rregullore.

Nëse pas datës 7 mars 2025, organizata nuk i ka mbyllur këto gjetje, certifikata e miratimit do të revokohet, kufizohet ose pezullohet tërësisht ose pjesërisht.

Neni 8

Organizatat e prodhimit

1. Një organizatë përgjegjëse për prodhimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve duhet të demonstrojë aftësinë e saj në përputhje me dispozitat e aneksit I (Pjesa 21). Ky demonstrim i aftësisë nuk kërkohet për pjesët ose pajisjet që prodhon një organizatë, të cilat, në përputhje me dispozitat e aneksit I (Pjesa 21), janë të pranueshme për instalim në një produkt të certifikuar tipi pa pasur nevojë të shoqërohen nga një certifikatë e autorizuar e lejimit në shërbim.(d.m.th. forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s).

2. Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, një prodhues, vendi kryesor i biznesit të të cilit është në një shtet tjetër mund të demonstrojë aftësinë e tij duke mbajtur një certifikatë të lëshuar nga ai shtet për produktin, pjesën dhe pajisjen për të cilën ai aplikon, me kusht:

a) ai shtet është shteti i prodhimit; dhe

b) AAC-ja dhe/ose Agjencia ka përcaktuar se sistemi i atij shteti përfshin të njëjtin nivel të pavarur të kontrollit të përputhshmërisë siç parashikohet nga kjo rregullore, qoftë nëpërmjet një sistemi ekuivalent të miratimeve të organizatave ose nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të autoritetit kompetent të atij shteti.

3. Miratimet e organizatave prodhuese të lëshuara ose të njohura nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat dhe procedurat e JAA-së dhe të vlefshme përpara datës 28 shtator 2003 do të konsiderohen se janë në përputhje me këtë rregullore.

4. Me përjashtim të paragrafit 1, organizata prodhuese mund të aplikojë tek autoriteti kompetent për përjashtime nga kërkesat për mbrojtjen e mjedisit të përmendura në nënparagrafin e parë të nenit 9(2) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, që transpozon rregulloren e BE-së nr. 1139/2018.

5. Me përjashtim të pikave 21.B.225(d)(1) dhe (2) të aneksit I (Pjesa 21), një organizatë prodhuese që mban një certifikatë miratimi të vlefshme të lëshuar në përputhje me aneksin I (Pjesa 21) mund të korrigjojë, deri më 7 mars 2025, çdo gjetje mospërputhjeje në lidhje me kërkesat e Aneksit I të paraqitura nga në këtë rregullore.

Nëse pas datës 7 mars 2025 organizata nuk i ka mbyllur këto gjetje, certifikata e miratimit do të revokohet, kufizohet ose pezullohet tërësisht ose pjesërisht.

6. Me përjashtim të pikës 21.A.125C(a)(1) të aneksit I (Pjesa 21), një organizatë që prodhon produkte, pjesë ose pajisje pa një certifikatë miratimi dhe që mban një letër marrëveshjeje të vlefshme të lëshuar në ose para datës 7 mars 2023 në përputhje me aneksin I (Pjesa 21) nuk do t'i kërkohej të pajtohet me kërkesat përkatëse të aneksit I të paraqitura në këtë rregullore.

7. Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, një person fizik ose juridik, vendi kryesor i biznesit të cilit është në Shqipëri dhe i cili është përgjegjës për prodhimin e produkteve dhe pjesëve dhe pajisjeve të tyre në përputhje me nenin 2(2) mund të demonstrojë në mënyrë alternative aftësinë e tyre në përputhje me aneksin Ib (Pjesa 21 Light).

8. Demonstrimi i aftësisë në përputhje me paragrafët 1 ose 2 nuk kërkohet kur organizata prodhuese ose personi fizik ose juridik është i përfshirë në aktivitetet e mëposhtme prodhuese:

a) prodhimin e pjesëve ose pajisjeve që janë të pranueshme, në përputhje me aneksin I (Pjesa 21), për instalim në një produkt të certifikuar tipi pa pasur nevojë të shoqërohet nga një certifikatë e autorizuar e lejimit në shërbim (d.m.th. forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s);

b) prodhimin e pjesëve që janë të pranueshme, në përputhje me aneksin Ib (Pjesa 21 Light), për instalim në një avion që i është nënshtruar një deklaratë për pajtueshmërinë e projektimit pa pasur nevojë të shoqërohet me një certifikatë të autorizuar të lejimit në shërbim (që do të thotë forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s);

c) prodhimin e një avioni që i është nënshtruar një deklaratë për përputhjen e projektimit të përmendur në nenin 2(3), dhe të pjesëve që janë të pranueshme për instalim në një avion të tillë. Në këtë rast, aktivitetet e prodhimit do të kryhen në përputhje me nënpjesën R të seksionit A të aneksit Ib (Pjesa 21 Light) nga një organizatë prodhuese ose një person fizik ose juridik, vendi kryesor i biznesit të cilit është në një shtet anëtar.

Neni 9

Masat e AAC-së

1. AAC-ja zhvillon mjete të pranueshme përputhshmërie (“AMC”) të cilat vetë AAC, organizatat dhe personeli mund t'i përdorin për të dëshmuar përputhshmërinë me parashikimet e aneksit I (Pjesa

21) dhe aneksit Ib (Pjesa 21 Light). AAC-ja mund të pranojë dhe publikojë AMC-të e zhvilluara nga EASA.

2. AMC-të e lëshuara nga AAC-ja nuk paraqesin kërkesa të reja dhe nuk lehtësojnë kërkesat e aneksit I (Pjesa 21) dhe aneksit Ib (Pjesa 21 Light).

ANEKSI I

PJESA 21

CERTIFIKIMI I MJETEVE FLUTURUESE DHE PRODUKTEVE, PJESËVE DHE PAJISJEVE PËRKATËSE, DHE I ORGANIZATAVE TË PROJEKTIMIT DHE PRODHIMIT

Përmbajtja

21.1 Autoriteti kompetent

21.2 Fushëveprimi

SEKSIONI A – KËRKESAT TEKNIKE

NËNPJESA A – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

21.A.1 Fushëveprimi

21.A.2 Ndërmarrja e një certifikate nga një person tjetër përveç aplikantit, ose mbajtësit

21.A.3A Sistemi i raportimit

21.A.3B Direktivat e vlefshmërisë ajrore

21.A.4 Koordinimi midis projektimit dhe prodhimit

21.A.5 Mbajtja e të dhënave

21.A.6 Manualet

21.A.7 Udhëzime për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore

21.A.9 Aksesi dhe hetimi

NËNPJESA B – CERTIFIKATAT E TIPIT DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË TIPIT

21.A.11 Fushëveprimi

21.A.13 Përshtatshmëria

21.A.14 Demonstrimi i aftësisë

21.A.15 Aplikimi

21.A.19 Ndryshimet që kërkojnë një certifikatë të re tipi

21.A.20 Demonstrimi i përputhshmërisë me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit

21.A.21 Kërkesat për lëshimin e një certifikate tipi ose një certifikate tipi të kufizuar

21.A.31 Projektimi i tipit

21.A.33 Inspektimet dhe testet

21.A.35 Testet e fluturimit

21.A.41 Certifikata tip

21.A.44 Detyrimet e mbajtësit

21.A.47 Transferueshmëria

21.A.51 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria vlefshmërisë

21.A.62 Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operationale

21.A.65 Vazhdimi i integritetit strukturor për strukturat e avionëve

(NËNPJESA C – NUK ZBATOHEJ)
NËNPJESA D – NDRYSHIMET NË CERTIFIKATAT E TIPI TË DHE CERTIFIKATAT E
KUFIZUARA TË TIPI TË

- 21.A.90A Fushëveprimi
- 21.A.90B Ndryshimet standarde
- 21.A.90C Ndryshime të pavarura në udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore
- 21.A.91 Klasifikimi i ndryshimeve në një certifikate tipi
- 21.A.92 Përshtatshmëria
- 21.A.93 Aplikimi
- 21.A.95 Kërkesat për miratimin e një ndryshimi të vogël
- 21.A.97 Kërkesat për miratimin e një ndryshimi të madh
- 21.A.101 Baza e certifikimit tip, baza e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi
- 21.A.108 Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale
- 21.A.109 Detyrimet dhe shënimi EPA

NËNPJESA E – CERTIFIKATA PLOTËSUESE E TIPI TË

- 21.A.111 Fushëveprimi
- 21.A.112A Përshtatshmëria
- 21.A.112B Demonstrimi i aftësisë
- 21.A.113 Aplikimi për një certifikatë plotësuese tipi
- 21.A.115 Kërkesat për miratimin e ndryshimeve të mëdha në formën e një certifikate plotësuese tipi
- 21.A.116 Transferueshmëria
- 21.A.117 Ndryshimet në atë pjesë të një produkti të mbuluar nga një certifikatë tipi plotësuese
- 21.A.118A Detyrimet dhe shënimi EPA
- 21.A.118B Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë
- 21.A.120B Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale

NËNPJESA F – PRODHIMI PA CERTIFIKATË MIRATIMI TË ORGANIZATËS
PRODHUESE

- 21.A.121 Fushëveprimi
- 21.A.122 Përshtatshmëria
- 21.A.124 Aplikimi
- 21.A.124A Mjetet e përputhshmërisë
- 21.A.125A Lëshimi i një letre marrëveshjeje
- 21.A.125B Gjetjet dhe vëzhgimet
- 21.A.125C Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë
- 21.A.126 Sistemi i inspektimit të prodhimit
- 21.A.127 Testet: avion
- 21.A.128 Testet: motorët dhe helikat
- 21.A.129 Detyrimet e organizatës prodhuese

21.A.130 Deklarata e konformitetit

NËNPJESA G – MIRATIMI I ORGANIZATËS PRODHUESE

- 21.A.131 Fushëveprimi
- 21.A.133 Pranueshmëria
- 21.A.134 Aplikimi
- 21.A.134A Mjetet e përputhshmërisë
- 21.A.135 Lëshimi i miratimit të organizatës prodhuese
- 21.A.139 Sistemi i menaxhimit të prodhimit
- 21.A.139A Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit
- 21.A.143 Manuali i organizatës prodhuese
- 21.A.145 Burimet
- 21.A.147 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të prodhimit
- 21.A.148 Ndryshimet e vendndodhjes
- 21.A.149 Transferueshmëria
- 21.A.151 Kushtet e miratimit
- 21.A.153 Ndryshime në kushtet e miratimit
- 21.A.158 Gjetjet dhe vëzhgimet
- 21.A.159 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë
- 21.A.163 Privilegjet
- 21.A.165 Detyrimet e mbajtësit

NËNPJESA H – CERTIFIKATA TË VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATA TË KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

- 21.A.171 Fushëveprimi
- 21.A.172 Përshtatshmëria
- 21.A.173 Klasifikimi
- 21.A.174 Aplikimi
- 21.A.175 Gjuha
- 21.A.177 Ndryshimi ose modifikimi
- 21.A.179 Mundësia për t'u transferuar dhe rilëshimi në një vend anëtar të BE-së
- 21.A.181 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë
- 21.A.182 Identifikimi i avionit

NËNPJESA I – CERTIFIKATAT E ZHURMAVE

- 21.A.201 Fushëveprimi
- 21.A.203 Përshtatshmëria
- 21.A.204 Aplikimi
- 21.A.207 Ndryshimi ose modifikimi
- 21.A.209 Mundësia për t'u transferuar dhe rilëshimi në vend anëtar të BE-së
- 21.A.211 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

NËNPJESA J – MIRATIMI I ORGANIZATËS PROJEKTUESE

- 21.A.231 Fushëveprimi
- 21.A.233 Përshtatshmëria
- 21.A.234 Aplikimi
- 21.A.235 Lëshimi i miratimit të organizatës projektuese
- 21.A.239 Sistemi i menaxhimit të projektimit
- 21.A.239A Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit
- 21.A.243 Manuali
- 21.A.245 Burimet
- 21.A.247 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të projektimit
- 21.A.249 Transferueshmëria
- 21.A.251 Kushtet e miratimit
- 21.A.253 Ndryshime në kushtet e miratimit
- 21.A.258 Gjetjet dhe vëzhgimet
- 21.A.259 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë
- 21.A.263 Privilegjet
- 21.A.265 Detyrimet e mbajtësit

NËNPJESA K – PJESËT DHE PAJISJET

- 21.A.301 Fushëveprimi
- 21.A.303 Përputhshmëria me kërkesat e aplikueshme
- 21.A.305 Miratimi i pjesëve dhe pajisjeve
- 21.A.307 Përshtatshmëria e pjesëve dhe pajisjeve për instalim

(NËNPJESA L – NUK ZBATOHET) NËNPJESA M – RIPARIMET

- 21.A.431A Fushëveprimi
- 21.A.431B Riparime standarde
- 21.A.432A Përshtatshmëria
- 21.A.432B Demonstrimi i aftësisë
- 21.A.432C Aplikim për miratimin e projektit të riparimit
- 21.A.433 Kërkesat për miratimin e një projekti riparimi
- 21.A.435 Klasifikimi dhe miratimi i projekteve të riparimit
- 21.A.439 Prodhimi i pjesëve të riparimit
- 21.A.441 Riparimi
- 21.A.443 Kufizimet
- 21.A.445 Dëmtime të pa riparuar
- 21.A.451 Detyrimet dhe shënimi EPA

(NËNPJESA N – NUK ZBATOHET)

NËNPJESA O – AUTORIZIMET E URDRHAVE STANDARDE TEKNIKE EVROPIANE

- 21.A.601 Fushëveprimi
- 21.A.602A Përshtatshmëria
- 21.A.602B Demonstrimi i aftësisë
- 21.A.603 Aplikimi

- 21.A.604 Autorizimi ETSO për një njësi energjie ndihmëse (APU)
- 21.A.605 Kërkesat për të dhëna
- 21.A.606 Kërkesat për lëshimin e një autorizimi ETSO
- 21.A.607 Privilegjet e autorizimit ETSO
- 21.A.608 Deklarata e projektimit dhe performancës (DDP)
- 21.A.609 Detyrimet e mbajtësve të autorizimeve ETSO
- 21.A.610 Miratimi për devijimin
- 21.A.611 Ndryshimet e projektimit
- 21.A.61 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë
- 21.A.621 Transferueshmëria

NËNPJESA P – LEJA PËR FLUTURIM

- 21.A.701 Fushëveprimi
- 21.A.703 Përshtatshmëria
- 21.A.707 Aplikimi për leje fluturimi
- 21.A.708 Kushtet e fluturimit
- 21.A.709 Aplikim për miratimin e kushteve të fluturimit
- 21.A.710 Miratimi i kushteve të fluturimit
- 21.A.711 Lëshimi i lejes për fluturim
- 21.A.713 Ndryshimet
- 21.A.715 Gjuha
- 21.A.719 Transferueshmëria
- 21.A.723 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhdueshme
- 21.A.725 Rinovimi i lejes për fluturim
- 21.A.727 Detyrimet e mbajtësit të lejes për fluturim

NËNPJESA Q – IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE, PJESËVE DHE PAJISJEVE

- 21.A.801 Identifikimi i produkteve
- 21.A.803 Trajtimi i të dhënave të identifikimit
- 21.A.804 Identifikimi i pjesëve dhe pajisjeve
- 21.A.805 Identifikimi i pjesëve kritike
- 21.A.807 Identifikimi i artikujve ETSO

SEKSIONI B – PROCEDURAT PËR AUTORITETET KOMPETENTE NËNPJESA A – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- 21.B.10 Dokumentacioni i mbikëqyrjes
- 21.B.15 Informacion për Agjencinë
- 21.B.20 Reagim i menjëhershëm ndaj një problemi sigurie
- 21.B.20A Reagim i menjëhershëm ndaj një incidenti ose cenueshmërie të sigurisë së informacionit me ndikim në sigurinë e aviacionit;
- 21.B.25 Sistemi i menaxhimit
- 21.B.30 Ndarja e detyrave
- 21.B.35 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit
- 21.B.55 Mbajtja e të dhënave

21.B.65 Pezullimi, kufizimi dhe revokimi

NËNPJESA B – CERTIFIKATAT E TIPIT DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË TIPIT

21.B.70 Specifikimet e certifikimit

21.B.75 Kushtet e veçanta

21.B.80 Baza e certifikimit të tipit për një certifikatë tipi ose një certifikatë tipi të kufizuar

21.B.82 Baza e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale për një certifikatë tipi avioni ose një certifikatë e kufizuar tipi

21.B.85 Përcaktimi i kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe specifikimeve të certifikimit për një certifikatë tipi ose një certifikatë tipi të kufizuar

21.B.100 Niveli i përfshirjes

21.B.103 Lëshimi i një certifikate lloji ose certifikate lloji të kufizuar

(NËNPJESA C – NUK ZBATOHET)

NËNPJESA D – NDRYSHIMET NË CERTIFIKATAT E TIPIT DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË TIPIT

21.B.105 Baza e certifikimit të tipit, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe baza e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi

21.B.107 Lëshimi i një miratimi të një ndryshimi në një certifikatë tipi

NËNPJESA E – CERTIFIKATA TIP PLOTËSUESE

21.B.109 Baza e certifikimit të tipit, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe baza e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale për një certifikatë tip plotësuese

21.B.111 Lëshimi i një certifikate tipi plotësuese

NËNPJESA F – PRODHIMI PA MIRATIMIN E ORGANIZATËS PRODHUESE

21.B.115 Mjetet e përputhshmërisë

21.B.120 Procedura fillestare e certifikimit

21.B.125 Gjetjet dhe veprimet korigjuese; vëzhgimet

21.B.135 Ruajtja e letrës së marrëveshjes

21.B.140 Ndryshimi i një letre marrëveshjeje

NËNPJESA G – MIRATIMI I ORGANIZATËS PRODHUESE

21.B.215 Mjetet e përputhshmërisë

21.B.220 Procedura fillestare e certifikimit

21.B.221 Parimet e mbikëqyrjes

21.B.222 Programi i mbikëqyrjes

21.B.225 Gjetjet dhe veprimet korigjuese; vëzhgimet

21.B.240 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të prodhimit

21.B.240A Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

NËNPJESA H –CERTIFIKATA TË VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATA TË KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

- 21.B.320 Investigimi
- 21.B.325 Lëshimi i certifikatës së vlefshmërisë ajrore
- 21.B.326 Certifikata e vlefshmërisë ajrore
- 21.B.327 Certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore

NËNPJESA I – CERTIFIKATA E ZHURMAVE

- 21.B.420 Investigimi
- 21.B.425 Lëshimi i certifikatave të zhurmave

NËNPJESA J –MIRATIMI I ORGANIZATËS PROJEKTUESE

- 21.B.430 Procedura fillestare e certifikimit
- 21.B.431 Parimet e mbikëqyrjes
- 21.B.432 Programi i mbikëqyrjes
- 21.B.433 Gjetjet dhe veprimet korigjuese; vëzhgimet
- 21.B.435 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të projektimit
- 21.B.435A Ndryshime në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

NËNPJESA K – PJESËT DHE PAJISJET (NËNPJESA L – NUK ZBATOHET) NËNPJESA M – RIPARIMET

- 21.B.450 Baza e certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit për miratimin e një projekti riparimi të madh
- 21.B.453 Lëshimi i miratimit të projektit të riparimit

(NËNPJESA N – NUK ZBATOHET)

NËNPJESA O – AUTORIZIMET E URDRHAVE STANDARDE TEKNIKE EVROPIANE

- 21.B.480 Lëshimi i një autorizimi ETSO

NËNPJESA P – LEJA PËR FLUTURIM

- 21.B.520 Investigimi
- 21.B.525 Lëshimi i lejes për fluturim

NËNPJESA Q – IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE, PJESEVE DHE PAJISJEVE

Shtojcat

- Shtojca I – Forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s – Certifikata e autorizimit për lejim
- Shtojca II – Forma 15a dhe 15c e RSH-së sipas modelit të EASA-s – Certifikata e rishikimit të vlefshmërisë ajrore
- Shtojca III – Forma 20a e RSH-së sipas modelit të EASA-s – Leja për fluturim

Shtojca IV – Forma 20b e RSH-së sipas modelit të EASA-s – Leje për fluturim (lëshuar nga organizata të miratuara)

Shtojca V – Forma 24 e RSH-së sipas modelit të EASA-s – Certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore

Shtojca VI – Forma 25 e RSH-së sipas modelit të EASA-s – Certifikata e vlefshmërisë ajrore

Shtojca VII – Forma 45 e RSH-së sipas modelit të EASA-s – Certifikata e zhurmës

Shtojca VIII – Forma 52 e RSH-së sipas modelit të EASA-s – Deklarata e konformitetit të avionit

Shtojca IX – Forma 53 e RSH-së sipas modelit të EASA-s – Certifikata e lejimit në shërbim

Shtojca X – Forma 55 e RSH-së sipas modelit të EASA-s – Certifikata e miratimit të organizatës prodhuese

Shtojca XI – Forma 65 e RSH-së sipas modelit të EASA-s – Letër marrëveshjeje për prodhim pa miratimin e organizatës prodhuese

Shtojca XII – Kategoritë e testeve të fluturimit dhe kualifikimet përkatëse të ekuipazhit të testimit të fluturimit.

21.1 Autoriteti kompetent

Për qëllim të këtij aneksi, “autoriteti kompetent”, do të jetë:

a) për seksionin A, nënpjesa A,

1. për organizatat projektuese, Agjencia, kur Shqipëria të jetë anëtare e BE-së; Për organizatat projektuese të themeluara në Shqipëri, për sa kohë Shqipëria nuk është shtet anëtar i BE-së, Autoritet Kompetent është AAC-ja;

2. për organizatat prodhuese që kanë selinë e biznesit në një territor për të cilin Shqipëria është përgjegjëse sipas Konventës Ndërkombëtare për Aviacionin Civil, nënshkruar në Çikago më 7 dhjetor 1944 (“Konventa e Çikagos”), AAC-ja si autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë, ose kur është e zbatueshme si autoriteti i caktuar nga një Shtet tjetër Anëtar në përputhje me nenin 64 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, ose kur është e zbatueshme, Agjencia nëse përgjegjësia i është rialokuar Agjencisë në përputhje me nenin 64 ose 65 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”;

3. për sa kohë Shqipëria nuk është shtet anëtar i BE-së, për organizatat prodhuese që kanë selinë e biznesit jashtë një territori për të cilin Shqipëria është përgjegjëse sipas Konventës së Çikagos, AAC; AAC-ja mund të njohë certifikimet e kryera nga Agjencia si Autoritet Kompetent për këtë pikë, në Bashkimin Evropian, po ashtu edhe certifikimet e kryera nga një shtet anëtar i BE-së, si autoritete kompetente për organizatat prodhuese që kanë selinë e biznesit në atë shtet;

b) për seksionin A, nënpjesët B, D, E, J, K, M, O dhe Q, për sa kohë Shqipëria nuk është shtet anëtar i BE-së, AAC-së; AAC-ja mund të njohë certifikimet e kryera nga Agjencia si Autoritet Kompetent për këtë pikë, në Bashkimin Evropian;

c) për seksionin A, nënpjesët F dhe G:

1. për personat fizikë ose juridikë që kanë selinë e biznesit në një territor për të cilin Shqipëria është përgjegjëse sipas Konventës së Çikagos, AAC-ja si autoriteti i caktuar nga Shqipëria ose kur është e zbatueshme nga një Shtet tjetër Anëtar në përputhje me nenin 64 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1139/2018, ose Agjencisë nëse përgjegjësia i është rialokuar Agjencisë në përputhje me nenin 64 ose, sa i përket nënpjesës G, nenit 65 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”;

2. për personat fizikë ose juridikë që kanë selinë e biznesit jashtë një territori për të cilin një Shqipëria është përgjegjës sipas Konventës së Çikagos, AAC-së; AAC-ja mund të njohë certifikimet e kryera nga Agjencia si Autoritet Kompetent për këtë pikë, në Bashkimin Evropian, po ashtu edhe certifikimet e kryera nga një shtet anëtar i BE-së, si autoritete kompetente për organizatat prodhuese që kanë selinë e biznesit në atë shtet;

d) për seksionin A, nënjësia H dhe I, AAC, kur avioni është regjistruar ose do të regjistrohet në Shqipëri:

e) për seksionin A, nënjësia P:

1. për avionët e regjistruar në Shqipëri, AAC;
2. për avionët e paregjistruar, AAC, kur ai është autoriteti që ka përshkruar shenjat e identifikimit;
3. për miratimin e kushteve të fluturimit lidhur me sigurinë e projektimit, për sa kohë Shqipëria nuk është shtet anëtar i BE-së, AAC; AAC-ja mund të njohë miratimet e kryera nga Agjencia si Autoritet Kompetent për këtë pikë, në Bashkimin Evropian.

21.2 Fushëveprimi

Seksioni A i këtij aneksi përcakton dispozitat që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e aplikantit dhe mbajtësit të çdo certifikate të lëshuar ose që do të lëshohet në përputhje me këtë aneks.

Seksioni B i këtij aneksi përcakton kushtet për kryerjen e detyrave të mbikëqyrjes së certifikimit dhe detyrimit të zbatimit, si dhe kërkesat e sistemit administrativ dhe të menaxhimit që duhet të respektohen nga autoriteti kompetent që është përgjegjës për zbatimin e seksionit A të këtij aneksi.

PJESA A - KËRKESAT TEKNIKE NËNJËSIA A - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

21.A.1 Fushëveprimi

Kjo nënjësia përcakton të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme të aplikantit dhe mbajtësit të çdo certifikate që është lëshuar ose që do të lëshohet në përputhje me këtë aneks.

21.A.2 Nisma nga një person tjetër, përveç aplikantit ose mbajtësit të një certifikatë

Veprimet ose detyrimet e kërkuara që të ndërmerren nga një mbajtës ose aplikant për certifikatën e një produkti, pjese ose pajisjeje sipas kësaj pjese mund që të ndërmerren në emër të tij nga një person tjetër fizik ose juridik, me kusht që mbajtësi ose aplikanti për atë certifikate të mund të tregojë se ka bërë një marrëveshje me personin tjetër në mënyrë që të garantohet se detyrimet e mbajtësit janë dhe përmbushen siç duhet.

21.A.3A Sistemi i raportimit

a) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores ‘Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë’” që përafrohet rregulloren (BE) nr. 376/2014, të gjithë personat fizikë ose juridikë që kanë aplikuar ose mbajnë një certifikatë tipi, certifikatë tipi e kufizuar, certifikatë tipi plotësuese, autorizimi i urdhrin të Standardit Teknik Evropian (ETSO), miratimi i projektimit të riparimit të madh ose çdo miratim tjetër përkatës që konsiderohet se është lëshuar sipas kësaj rregulloreje, duhet:

1. të krijojë dhe të mirëmbajë një sistem për mbledhjen, investigimin dhe analizimin e raporteve të ngjarjeve me qëllim identifikimin e tendencave të pafavorshme ose adresimin e mangësive dhe nxjerrjen e ngjarjeve, raportimi i të cilave është i detyrueshëm në përputhje me pikën 3 dhe ato që raportohen vullnetarisht. Kur selia e biznesit ndodhet në Republikën e Shqipërisë, mund të krijohet një sistem i vetëm për të përmbushur kërkesat e urdhrin të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”. Sistemi i raportimit do të përfshijë:

i) raportet dhe informacionet në lidhje me dështimet, keqfunksionimet, defektet ose ngjarje të tjera që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë efekte negative në vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit, pjesës ose pajisjes që mbulohet nga certifikata e tipit, certifikata e tipit e kufizuar, certifikata tip plotësuese, autorizimi ETSO, miratimin e projektimit të riparimit të madh ose me ndonjë miratim tjetër përkatës që konsiderohet se është lëshuar sipas kësaj rregulloreje;

ii) gabimet, pasaktësitë dhe rreziqet që nuk përfshihen në pikën (i);

2. vënien në dispozicion operatorëve të njohur të produktit, pjesës ose pajisjes dhe, sipas kërkesës, çdo personi të autorizuar në bazë të akteve të tjera zbatuese ose të deleguara, informacionin në lidhje me sistemin e krijuar në përputhje me pikën 1, dhe mbi mënyrën e dhënies së raporteve dhe informacionit në lidhje me dështime, keqfunksionime, defekte ose ngjarje të tjera të përmendura në pikën 1 (i);

3. raportimin AAC-së të çdo dështimi, mosfunksionimi, defekti ose ngjarje tjetër për të cilën është në dijeni dhe ka të bëjë me një produkt, pjesë ose pajisje të mbuluar nga certifikata e tipit, certifikata e tipit e kufizuar, certifikata e tipit plotësuese, autorizimi ETSO, miratimi i projektimit të riparimit të madh ose nga ndonjë miratim tjetër përkatës që konsiderohet se është lëshuar sipas kësaj Rregulloreje dhe që ka rezultuar ose mund të rezultojë në një gjendje të pasigurt.

b) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, që përafuron rregulloren (BE) nr. 376/2014, çdo person fizik ose juridik që zotëron ose ka aplikuar për një certifikatë miratimi të organizatës prodhuese sipas nënpjesës G të këtij seksioni, ose që prodhon një produkt, pjesë ose pajisje sipas nënpjesës F të këtij seksioni, duhet:

1. të krijojë dhe të mirëmbajë një sistem për mbledhjen dhe vlerësimin e raporteve të ngjarjeve, duke përfshirë raportet për gabimet, pasaktësitë dhe rreziqet, me qëllim identifikimin e tendencave negative ose për të adresuar mangësitë dhe nxjerrjen e ngjarjeve, raportimi i të cilave është i detyrueshëm në përputhje me pikat 2 dhe 3 dhe ato që janë raportuar vullnetarisht. Për organizatat që kanë selinë e biznesit në një Shtet Anëtar, mund të krijohet një sistem i vetëm për të përmbushur kërkesat e urdhrin të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 Për miratimin e rregullores “Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë” që përafuron rregulloren (BE) nr. 376/2014 dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1139/2018 dhe aktet e deleguara dhe zbatuese;

2. raportimin të mbajtësi përgjegjës i certifikatës së miratimit të projektimit të gjitha rastet kur produktet, pjesët ose pajisjet janë lëshuar nga organizata prodhuese dhe janë identifikuar më pas devijimet e mundshme nga të dhënat e aplikueshme të projektimit dhe investigon me mbajtësin e miratimit të projektimit për të identifikuar ato devijime që mund të çojnë në një gjendje të pasigurt;

3. raportimin tek AAC-ja në përputhje me pikën 21.1 dhe Agjencisë devijimet që janë identifikuar në përputhje me pikën 21.A.3A(b)2 dhe që mund të çojnë në një gjendje të pasigurt;

4. nëse organizata prodhuese vepron si furnizues për një organizatë tjetër prodhuese, t’i raportojë gjithashtu asaj organizate tjetër të gjitha rastet kur ka lëshuar produkte, pjesë ose pajisje në atë organizatë dhe devijimet e mundshme nga të dhënat e projektimit të zbatueshëm që janë identifikuar më pas.

c) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores ‘Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë’” që përafuron rregulloren (BE) nr. 376/2014, çdo person fizik ose juridik, kur raporton në përputhje me pikat (a) (3), (b) (2), (b)(3) dhe (b)(4), do të mbrojnë rregullisht konfidencialitetin e personit që raporton dhe të personit(ave) të përmendur në raport.

d) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullore ‘Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë’”, çdo person fizik ose juridik do të bëjë raportet e përmendura në pikat (a) (3) dhe (b) (3) në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, dhe t’i dërgojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 72 orë pasi personi fizik ose juridik të ketë identifikuar ngjarje që mund të çojnë në një gjendje të pasigurt, përveç nëse rrethanat e jashtëzakonshme e pengojnë.

e) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullore ‘Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë’” që përaftron rregulloren (BE) nr. 376/2014, nëse një ngjarje e raportuar sipas pikës (a) (3) ose nën pikën (b) (3) rezulton nga një mangësi në projektim ose mangësi prodhimi, mbajtësi i certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar, certifikatës së tipit plotësues, miratimit të projektimit të riparimit të madh, autorizimit ETSO ose çdo miratimi tjetër përkatës që konsiderohet se është lëshuar sipas kësaj rregulloreje, ose organizata prodhuese, sipas rastit, do të investigojë arsyen e mungesës dhe do t’i raportojë AAC-së në përputhje me pikën 21.1 dhe Agjencisë rezultatet e këtij investigimi dhe çdo veprim që synon të ndërmerret ose propozon të ndërmerret për të korrigjuar atë mangësi.

f) Nëse AAC-ja konstaton se kërkohet veprim për të korrigjuar mangësitë, mbajtësi i certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar, certifikatës së tipit plotësues, miratimit të projektimit të riparimit të madh, autorizimit ETSO ose çdo miratimi tjetër përkatës që konsiderohet se është lëshuar sipas kësaj rregulloreje, ose organizata prodhuese sipas rastit, do t’i paraqesë të dhënat përkatëse AAC me kërkesën e tij.

21.A.3B Direktivat e vlefshmërisë ajrore

a) Një direktivë e vlefshmërisë ajrore nënkupton një dokument, të pranuar ose lëshuar përkatësisht nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, i cili urdhëron veprimet që do të kryhen në një avion, për të risjellë një nivel të pranueshëm të sigurisë në fluturim, ku në të kundërt të dhënat tregojnë se niveli i sigurisë i këtij avioni mund të komprometohet.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, lëshon një direktivë të vlefshmërisë ajrore, kur:

1. Nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 është përcaktuar se në avion ekziston një gjendje e pasigurt si rrjedhojë e një mangësie në avion, ose në një motor, helikë, pjesë ose pajisje të instaluar në këtë avion; dhe

2. Ajo gjendje ka të ngjarë të ekzistojë ose të zhvillohet në avionët e tjerë.

c) Kur nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 duhet të lëshohet një direktivë e vlefshmërisë ajrore për të korrigjuar gjendjen e pasigurt të cituar në paragrafin (b), ose për të kërkuar kryerjen e një inspektimi, mbajtësi i certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar, certifikatës së tipit plotësuese, miratimit të projektit të një riparimi madhor, autorizimit ETSO ose çdo miratimi tjetër përkatës të vlerësuar si të lëshuar sipas kësaj rregulloreje:

1. propozon veprimet korrigjuese të përshtatshme ose inspektimet e kërkuara, ose të dyja, si dhe paraqet për miratim detajet e këtyre propozimeve tek Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 sipas rastit.

2. pas miratimit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 të propozimeve të cituara sipas nënparagrafit 1, vendos në dispozicion të gjithë operatorëve të njohur ose pronarëve të produktit, pjesës ose pajisjes dhe, me kërkesë, të çdo personi nga i cili kërkohet që të pajtohet me direktivën e vlefshmërisë ajrore, të dhëna përshkruese të përshtatshme dhe udhëzime të përbushjes.

d) Një direktivë e vlefshmërisë ajrore përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. Një identifikim të gjendjes së pasigurt;
2. Një identifikim të avionit të prekur;
3. Veprimin (veprimet) e kërkuar;
4. Kohën e përputhjes me veprimin (veprimet) e kërkuar;
5. Datën e hyrjes në fuqi.

21.A.4 Koordinimi midis projektimit dhe prodhimit

Çdo mbajtës i certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar, certifikatës së tipit plotësuese, autorizimit ETSO, miratimit të një ndryshimi në projektin e tipit ose miratimit të një projekti riparimi, bashkëpunon me organizatën prodhuese sipas nevojës për të siguruar:

- a) Koordinimin e kënaqshëm të projektimit me prodhimin të kërkuar nga pika 21.A.122 ose pika 21.A.130(b)(3) dhe (4), si dhe nga pika 21.A.165(c) (2) dhe (3), sipas nevojës, dhe;
- b) Mbështetjen e duhur për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit, pjesës ose pajisjes.

21.A.5 Mbajtja e të dhënave

Të gjithë personat fizikë ose juridikë që zotërojnë ose kanë aplikuar për një certifikatë tipi, certifikatë tipi të kufizuar, certifikatë tipi plotësuese, autorizim ETSO, miratim projektimi ose riparimi, leje për fluturim, certifikatë miratimi e organizatës prodhuese ose letër marrëveshjeje sipas kësaj rregulloreje:

a) kur projektojnë një produkt, pjesë ose pajisje ose ndryshojnë ose riparojnë, krijojnë një sistem të mbajtjes së të dhënave dhe mbajnë informacionin/të dhënat përkatëse të projektimit; ai informacion/të dhëna do t'i vihen në dispozicion Agjencisë për të ofruar informacionin/të dhënat që janë të nevojshme për të garantuar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit, pjesës ose pajisjes, vazhdueshmërinë e vlefshmërisë të të dhënave të përshtatshme të operacionale dhe përputhshmërinë me kërkesat e aplikueshme të mbrojtjes së mjedisit;

b) kur prodhojnë një produkt, pjesë ose pajisje, regjistrojnë detajet e procesit të prodhimit në lidhje me përputhshmërinë e produktit, pjesës ose pajisjeve me të dhënat e aplikueshme të projektimit dhe kërkesat e vendosura ndaj partnerëve dhe furnitorëve të tyre, dhe i bëjnë këto të dhëna të disponueshme për autoritetin e tyre kompetent për të ofruar informacionin që është i nevojshëm për të siguruar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit, pjesës ose pajisjes;

c) në lidhje me lejet për fluturim:

1. të mirëmbajnë dokumentet që prodhohen për të përcaktuar dhe justifikuar kushtet e fluturimit, dhe t'i vënë në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, në mënyrë që të ofrojnë informacionin që është i nevojshëm për të siguruar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit;

2. kur lëshojnë leje për të fluturuar nën privilegjin e organizatave të miratuara, mirëmbajnë dokumentet që lidhen me të, duke përfshirë të dhënat e inspektimit dhe dokumentet që mbështesin miratimin e kushteve të fluturimit dhe lëshimin e vetë lejes për të fluturuar, dhe i vënë në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, për mbikëqyrjen e organizatës në mënyrë që të ofrojnë informacionin që është i nevojshëm për të siguruar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit;

d) të ruajnë të dhënat e aftësive dhe kualifikimeve, të përmendura në pikat 21.A.139(c), 21.A.145(b), 21.A.145(c), 21.A.239(c), 21. A.245(a) ose 21.A.245(e)(1), të personelit që është i përfshirë në funksionet e mëposhtme:

1. projektim ose prodhim;

2. monitorim të pavarur të përputhshmërisë së organizatës me kërkesat përkatëse;

3. menaxhim sigurie;

e) të ruajnë të dhënat e autorizimit të personelit, kur punësojnë personel që:

1. të ushtrojnë privilegjet e organizatës së miratuar në përputhje me pikat 21.A.163 dhe/ose 21.A.263, sipas rastit;

2. të kryejnë funksionin e pavarur për të monitoruar përputhjen e organizatës me kërkesat përkatëse në përputhje me pikat 21.A.139(e) dhe/ose 21.A.239(e), sipas rastit;

3. të kryejnë funksionin e pavarur të verifikimit të demonstrimit të përputhshmërisë sipas pikës 21.A.239(d)(2).

21.A.6 Manuallet

Mbajtësi i një certifikate tipi, një certifikate tipi të kufizuar ose një certifikate tipi plotësuese do të prodhojë, mirëmbajë dhe përditësojë kopjet kryesore të të gjitha manualeve ose ndryshimeve në manualet e kërkuara nga baza e aplikueshme e certifikimit të tipit, baza e aplikueshme e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit për produktin ose njësinë, dhe t'i sigurojë Agjencisë kopje, sipas kërkesës.

21.A.7 Udhëzime për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore

a) Mbajtësi i një certifikatë tipi, një certifikate tipi të kufizuar ose një certifikate tipi plotësuese, ndryshimi i projektimit ose miratimi i projektit të riparimit duhet të zhvillojë ose referojë udhëzimet që janë të nevojshme për të siguruar që standardi i vlefshmërisë ajrore në lidhje me llojin e avionit dhe çdo pjesë të lidhur është ruajtur gjatë gjithë vlefshmërisë operationale të avionit, kur demonstroi pajtueshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit të vendosur dhe njoftuar nga Agjencia në përputhje me pikën 21.B.80.

b) Të paktën një grup udhëzimesh të plota për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore duhet të sigurohet nga mbajtësi i:

1. një certifikate tipi ose një certifikatë tipi të kufizuar për çdo pronar të njohur të një ose më shumë produkteve me dorëzimin e saj ose me lëshimin e certifikatës së parë të vlefshmërisë ajrore ose certifikatës së kufizuar të vlefshmërisë ajrore për avionin e prekur, cilado që të ndodhë më vonë,

2. një certifikate tipi plotësuese ose miratim ndryshimi të projektimit për të gjithë operatorët e njohur të produktit të prekur nga ndryshimi pas lëshimit në shërbim të produktit të modifikuar,

3. një miratim projektimi riparimi për të gjithë operatorët e njohur të produktit të prekur nga riparimi pas lëshimit në shërbim të produktit në të cilin është përfshirë projektimi i riparimit. Produkti, pjesa ose pajisja e riparuar mund të lëshohet në shërbim përpara se të plotësohen udhëzimet përkatëse për vlefshmërinë ajrore të vazhdueshme, por kjo do të jetë për një periudhë të kufizuar shërbimi dhe në marrëveshje me Agjencinë.

Më pas, këta mbajtës të miratimit të projektimit do t'i vënë ato udhëzime të disponueshme sipas kërkesës për çdo person tjetër që kërkohet të bjerë dakord me udhëzimet.

c) Me përjashtim të pikës (b), mbajtësi i certifikatës tip ose mbajtësi certifikatës tip të kufizuar mund të vonojë disponueshmërinë e një pjesë të udhëzimeve për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore, që kanë të bëjnë me udhëzime për arritje të gjata të një natyre të planifikuar, deri pasi produkti ose produkti i modifikuar të ketë hyrë në shërbim, por duhet t'i vërë ato udhëzime të disponueshme përpara se përdorimi i këtyre të dhënave të kërkohet për produktin ose produktin e modifikuar.

d) Mbajtësi i miratimit të projektimit, të cilit i kërkohet të japë udhëzime për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore në përputhje me pikën (b), do të vërë gjithashtu në dispozicion ndryshimet në këto udhëzime për të gjithë operatorët e njohur të produktit të prekur nga ndryshimi dhe, sipas kërkesës, për çdo person tjetër kërkohet të pajtohen me këto ndryshime. Ky mbajtës i miratimit të projektimit do t'i demonstrojë Agjencisë, sipas kërkesës, përshtatshmërinë e procesit të bërjes së ndryshimeve në udhëzimet për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të disponueshme në përputhje me këtë pikë.

21.A.9 Akses dhe investigimi

Çdo person fizik ose juridik që zotëron ose ka aplikuar për një certifikatë tipi, një certifikatë tipi të kufizuar, një certifikatë tipi plotësuese, autorizim ETSO, ndryshim projektimi ose miratim riparimi, certifikatë të vlefshmërisë ajrore, certifikatë zhurme, leje fluturimi, miratim të organizatës projektuese, Certifikatë miratimi të organizatës prodhuese ose letra e marrëveshjes sipas kësaj rregulloreje, duhet:

a) t'i sigurojnë Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 akses në çdo objekt, produkt, pjesë dhe pajisje, dokument, regjistrim, të dhëna, proces, procedurë ose në çdo material tjetër me qëllim që të shqyrtojnë çdo raport, të bëjnë inspektime, ose të kryejnë ose të dëshmojnë çdo test fluturimi dhe test tokësor, sipas nevojës, për të verifikuar përputhshmërinë fillestare dhe të vazhdueshme të organizatës me

kërkesat e zbatueshme të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”.

b) të marrin masa për të siguruar që autoriteti kompetent të ketë akses, siç parashikohet në pikën (a), edhe në lidhje me partnerët, furnitorët dhe nënkontraktuesit e personit fizik ose juridik.

NËNPJESA B - CERTIFIKATAT E TIPIT DHE CERTIFIKATAT E TIPIT TË KUFIZUAR 21.A.11 Fushëveprimi

Kjo nënpjesë vendos procedurën për lëshimin e certifikatave tip për produktet dhe certifikatat e tipit të kufizuara për avionët, si dhe vendos të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre certifikatave.

21 A.13 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik, që ka demonstruar ose është në proces demonstrimi të aftësisë së tij në përputhje me pikën 21.A.14, do të ketë mundësi të pranohet si një aplikant për një certifikate tipi ose një certifikate tipi të kufizuar sipas kushteve të parashtruara në këtë nënpjesë.

21.A.14 Vërtetimi i kapacitetit

a) Një aplikant për një certifikatë tipi ose certifikatë tipi të kufizuar do të demonstrojë aftësinë e tij duke mbajtur një miratim të organizatës projektuese, të lëshuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, në përputhje me nënpjesën J;

b) Me përjashtim të paragrafit (a), si një procedurë alternative për të dëshmuar aftësinë e tij, një aplikant mund të kërkojë miratimin e Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, për përdorimin e procedurave që përcaktojnë praktikat specifike të projektimit, burimet dhe rendin e aktiviteteve të nevojshme për t’u pajtuar me këtë aneks I (pjesa 21), kur produkti është një prej sa më poshtë:

1. Një avion ELA 2;
2. Një motor ose helikë e instaluar në avionin ELA 2;
3. Një motor me piston;
4. Një helikë me krah rrotullimi aksial të fletës, fiks ose të ndryshueshëm.

c) Me përjashtim të paragrafit (a), një aplikant mund të demonstrojë aftësinë e tij duke marrë miratimin e Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, të programit të tij të certifikimit të përcaktuar në përputhje me pikën 21.A.15 (b), nëse produkti për t’u certifikuar është:

1. një avion ELA1; ose
2. një motor ose helikë e instaluar në avionin ELA1

21.A.15 Aplikimi

a) Një aplikim për një certifikate tipi ose një certifikate tipi të kufizuar bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

b) Një aplikim për një certifikatë tipi ose një certifikatë tipi të kufizuar duhet të përfshijë, minimalisht, të dhëna përshkuese paraprake të produktit, përdorimin e synuar të produktit dhe llojin e operimeve për të cilat kërkohet certifikimi. Përveç kësaj, do të përfshijë ose plotësohet pas aplikimit fillestar nga një program certifikimi për demonstrimin e përputhshmërisë në përputhje me pikën 21.A.20, i përbërë nga:

1. Një përshkrim i hollësishëm të projektit të tipit, duke përfshirë të gjitha konfigurimet që do të certifikohen;

2. Karakteristikat dhe kufizimet e propozuara të funksionimit;
3. Përdorimin e synuar të produktit dhe llojin e operimeve për të cilat kërkohet certifikimi;

4. Një propozim për bazën fillestare të certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshatshmërisë operationale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, të përgatitur në përputhje me kërkesat dhe opsionet e specifikuar në pikat 21.B.80, 21.B.82 dhe 21.B.85;

5. Një propozim për ndarjen e programit të certifikimit në grupe kuptimplota të aktiviteteve dhe të dhënave demonstruese të pajtueshmërisë, përfshirë një propozim për mjetet e pajtueshmërisë dhe dokumentet përkatëse të pajtueshmërisë;

6. Një propozim për vlerësimin e grupeve kuptimplota të aktiviteteve dhe të dhënave demonstruese të pajtueshmërisë, duke adresuar gjasat e një mos-pajtueshmërie të paidentifikuar me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale ose kërkesat e mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimin e mundshëm të kësaj mospërputhjeje mbi sigurinë e produktit ose mbrojtjen e mjedisit. Vlerësimi i propozuar do të marrë parasysh të paktën elementet e përcaktuara në nën-pikat (1) deri (4) të pikës 21.B.100 (a). Bazuar në këtë vlerësim, aplikimi do të përfshijë një propozim për përfshirjen e Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 në verifikimin e aktiviteteve dhe të dhënave demonstruese të pajtueshmërisë; dhe

7. Një program të projektit që përfshin fazat/hapat kryesorë.

c) Pas dorëzimit fillestar të tij në Autoritetin kompetent sipas pikës 21.1, programi i certifikimit do të përditësohet nga aplikanti kur ka ndryshime në projektin e certifikimit që prekin ndonjë nga pikat 1 deri në 7 të pikës (b).

d) Një aplikim për një certifikatë tipi ose një certifikatë tipi të kufizuar për një avion duhet të përfshijë ose të plotësohet pas aplikimit fillestar, nga një shtesë aplikimi për miratimin e të dhënave të përshtatshmërisë operationale.

e) Një aplikim për një certifikatë tipi ose certifikatë tipi të kufizuar për një avion të madh ose një rotorkraft me përmasa të mëdha do të jetë i vlefshëm për pesë vjet dhe një aplikim për çdo lloj certifikate tipi tjetër ose certifikate tipi të kufizuar do të jetë i vlefshëm për tre vjet, përveç nëse aplikanti demonstroi në kohën e aplikimit që produkti i tij kërkon një periudhë më të gjatë kohore për të demonstruar dhe deklaruar pajtueshmërinë dhe Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 bie dakord për atë periudhë më të gjatë kohore.

f) Në rastin kur një certifikatë tipi ose një certifikatë tipi e kufizuar nuk është lëshuar, ose është e qartë se nuk do të lëshohet, brenda afatit të parashikuar në pikën (e), aplikanti mund të:

1. paraqesë një kërkesë të re dhe të jetë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, siç përcaktohet dhe njoftohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikat 21.B.80, 21.B.82, dhe 21.B.85 për datën e aplikimit të ri; ose

2. aplikojë për një zgjatje të periudhës kohore të parashikuar në pikën (e) dhe të propozojë një datë të re për lëshimin e certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit të kufizuar. Në atë rast, aplikanti duhet të jetë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, siç përcaktohet dhe njoftohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikat 21.B.80, 21.B.82 dhe 21.B.85 për një datë që do të zgjidhet nga aplikanti. Sidoqoftë, kjo datë nuk do t'i paraprijë datës së re të propozuar nga aplikanti për lëshimin e certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit të kufizuar për më shumë se pesë vjet për një kërkesë për një certifikatë tipi ose certifikatë tipi të kufizuar për një avion të madh ose një rotorkraft me përmasa të mëdha, dhe me më shumë se tre vjet për një kërkesë për ndonjë certifikatë tipi tjetër ose certifikatë tipi të kufizuar.

21.A.19 Ndryshimet që kërkojnë një certifikatë tipi të re

Çdo person fizik ose juridik që propozon të ndryshojë një produkt, aplikon për një certifikatë tipi të re nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 zbulon se ndryshimi në projektim, fuqi, shtytje ose peshë është aq i madh sa që të kërkohej një investigim i plotë tërësor i pajtueshmërisë me bazën përkatëse të certifikimit të tipit.

21.A.20 Demonstrimi i pajtueshmërisë me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit

a) Pas pranimit të programit të certifikimit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, aplikanti do të demonstrojë pajtueshmërinë me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshme të operacionale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, siç përcaktohet dhe i njoftohet aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikat 21.B.80, 21.B.82, 21.B.85, dhe do t'i sigurojë Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 mjetet me të cilat është demonstruar një pajtueshmëri e tillë.

b) Aplikanti duhet të raportojë tek Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 çdo vështirësi ose ngjarje të hasur gjatë procesit të demonstrimit të pajtueshmërisë që mund të ketë një efekt të dukshëm në vlerësimin e rrezikut sipas pikës 21.A.15 (b) (6) ose në programin e certifikimit, ose përndryshe mund të kërkojë një ndryshim në nivelin e përfshirjes së Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 së njoftuar më parë aplikantit në përputhje me pikën 21.B.100 (c).

c) Aplikanti do të regjistrojë arsyetimet e pajtueshmërisë brenda dokumenteve të pajtueshmërisë siç përmenden në programin e certifikimit.

d) Pas përfundimit të të gjitha demonstrimeve të pajtueshmërisë në përputhje me programin e certifikimit, përfshirë çdo inspektim dhe provë në përputhje me pikën 21.A.33, dhe pas të gjitha testeve të fluturimit në përputhje me pikën 21.A.35, aplikanti do të deklarojë që:

1. ka demonstruar pajtueshmëri me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshme të operacionale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, siç përcaktohet dhe njoftohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, pas programit të certifikimit të pranuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1. dhe 2. nuk është identifikuar asnjë tipar ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

e) Aplikanti duhet të paraqesë në Autoritetin kompetent sipas pikës 21.1 deklaratën e pajtueshmërisë të parashikuar në pikën (d). Kur aplikanti mban një miratim të përshtatshëm të organizatës projektuese, deklarata e pajtueshmërisë bëhet në përputhje me nënpjesën J dhe i paraqitet Autoritetin kompetent sipas pikës 21.1.

21.A.21 Kërkesat për lëshimin e një certifikate tipi ose certifikate tipi të kufizuar

a) Për të marrë një lëshim certifikate tipi për një produkt, kur avioni nuk plotëson kërkesat thelbësore të aneksit II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1139/2018 ose të një certifikate tipi të kufizuar për një avion aplikanti duhet të:

1. demonstrojë aftësinë e tij në përputhje me pikën 21.A.14;

2. përputhet me pikën 21.A.20;

3. demonstrojë që motori dhe helika nëse instalohen në aeroplan:

A. të ketë një certifikatë tipi të lëshuar ose të përcaktuar në përputhje me këtë rregullore; ose

B. të ketë demonstruar se është në përputhje me bazën e certifikimit të tipit të avionit dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara dhe njoftuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, si të nevojshme për të garantuar fluturimin e sigurt të avionit.

b) Me përjashtim të pikës (a) (2), me kërkesë të aplikuesit të përfshirë në deklaratën e përmendur në pikën 21.A.20 (d), aplikanti ka të drejtë të ketë certifikatën e tipit të avionit ose certifikatën e tipit të kufizuar të lëshuar përpara se aplikanti të ketë demonstruar pajtueshmërinë me bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshme të operacionale, me kusht që aplikanti ta demonstrojë këtë pajtueshmëri përpara datës në të cilën këto të dhëna do të përdoren në të vërtetë.

21.A.31 Projekti i tipit

a) Projekti i tipit përbëhet nga:

1. Vizatimet, specifikimet dhe një listë të atyre vizatimeve dhe specifikimeve, të nevojshme për të përcaktuar konfigurimin dhe tiparet e projektimit të produktit që pajtohen me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore;

2. Informacioni mbi materialet, proceset dhe mbi metodat e prodhimit dhe montimit të produktit të cilat janë të nevojshme për të siguruar konformitetin e produktit;

3. Një seksion i miratuar i kufizimeve të vlefshmërisë ajrore të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore siç përcaktohet nga specifikimet e zbatueshme të certifikimit; dhe

4. çdo e dhënë tjetër që lejon me anë të krahasimit përcaktimin e vlefshmërisë ajrore dhe, nëse është e rëndësishme/nevojshme, karakteristikave mjedisore të produkteve të mëvonshme të të njëjtit tip.

b) Çdo projekt tipi identifikohet në mënyrë të përshtatshme.

21.A.33 Inspektimet dhe testet

a) (Qëllimisht e lënë bosh)

b) Para se të ndërmerret çdo testim gjatë demonstrimit të pajtueshmërisë së kërkuar nga pika 21.A.20, aplikanti do të ketë verifikuar:

1. për mostrën e provës, që:

i) materialet dhe proceset përputhen në mënyrë të përshtatshme me specifikimet për projektin tip të propozuar;

ii) pjesët e produkteve përputhen në mënyrë të përshtatshme me vizatimet në projektin tip të propozuar; dhe

iii) proceset e prodhimit, ndërtimit dhe montimit përputhen në mënyrë të përshtatshme me ato të specifikuar në projektin tip të propozuar; dhe

2. Pajisjet e testimit dhe mjetet matëse të përdorura për provat të jenë të përshtatshme për provën dhe të jenë të kalibruara siç duhet.

c) Në bazë të verifikimeve të kryera në përputhje me pikën (b), aplikanti do të lëshojë një deklaratë konformiteti duke renditur çdo papajtueshmëri të mundshme, së bashku me një justifikim se kjo nuk do të ndikojë në rezultatet e testit dhe do të lejojë Autoritetin kompetent sipas pikës 21.1 për të bërë një inspektim që e konsideron të nevojshëm për të kontrolluar vlefshmërinë e kësaj deklaratë.

d) Aplikanti lejon Autoritetin kompetent sipas pikës 21.1 të:

1. rishikojë çdo të dhënë dhe informacion në lidhje me demonstrimin e pajtueshmërisë; dhe

2. dëshmojë ose të kryejë ndonjë provë ose inspektim të kryer me qëllim të demonstrimit të pajtueshmërisë.

e) Për të gjitha testet dhe inspektimet e dëshmuara ose të kryera nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikën (d) (2):

1. Aplikanti i paraqet Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 një deklaratë të konformitetit të parashikuar në pikën (c); dhe

2. Asnjë ndryshim që ndikon në vlefshmërinë e deklaratës së konformitetit nuk do të bëhet në mostrën e provës, ose testin dhe pajisjet matëse, midis kohës kur është lëshuar deklarata e konformitetit e përcaktuar në pikën (c) dhe kohës në të cilën ekzemplari/kampioni i provës i paraqitet Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 për provë.

21.A.35 Provat e fluturimit

a) Prova e fluturimit për qëllimin e marrjes së një certifikate tip kryhet në përputhje me kushtet për një fluturim të tillë prove të specifikuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

b) Aplikanti bën të gjitha provat e fluturimit që Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 i shikon si të nevojshme:

1. Për të përcaktuar pajtueshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikatës së tipit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, dhe;

2. Për të përcaktuar nëse ka siguri të arsyeshme se avioni, pjesët dhe pajisjet e tij janë të besueshme dhe funksionojnë siç duhet për avionët që do të certifikohen sipas këtij aneksi I (pjesa 21), me përjashtim të:

i) glajderave dhe glajderave me motor;

- ii) balonave dhe aerostateve të përcaktuara sipas ELA 1 dhe ELA 2;
- iii) aeroplanëve me peshë maksimale të ngritjes (MTOM) prej 2722 kg e më pak;
- c) (e rezervuar);
- d) (e rezervuar);
- e) (e rezervuar);

f) Provat e fluturimit të përshkruara në paragrafin (b)(2) përfshijnë:

1. Për avionët që kanë të integruar motorë me turbinë të një tipi të papërdorur më parë në një certifikim tip të avionit, të paktën 300 orë operimi me një komplet të plotë motorësh që janë në përputhje me një certifikatë tip; dhe

2. Për të gjithë avionët e tjerë, të paktën 150 orë operimi.

21.A.41 Certifikata e tipit

Certifikata e tipit dhe certifikata e tipit e kufizuar përfshin projektimin e tipit, kufizimet e operimit, udhëzimet për vlefshmërinë ajrore të vazhdueshme, fletën e të dhënave të certifikatës së tipit për vlefshmërinë ajrore dhe emetimet, bazën e aplikueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit me të cilat Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 regjistron përputhshmërinë dhe çdo kusht ose kufizim tjetër të përshkruar për produktin në specifikimet e zbatueshme të certifikimit dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Certifikata e tipit të avionit dhe certifikata e tipit e kufizuar do të përfshijnë gjithashtu bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale të zbatueshme, të dhënat e përshtatshmërisë operationale dhe fletën e të dhënave të certifikatës së tipit për zhurmën. Fleta e të dhënave të certifikatës së tipit të avionit dhe të certifikatës së tipit të kufizuar duhet të përfshijë të dhënat e përputhshmërisë me emetimet e CO₂ dhe fleta e të dhënave të certifikatës së tipit të motorit duhet të përfshijë të dhënat e përputhshmërisë me emetimet e shkarkimit.

21.A.44 Detyrimet e mbajtësit

Çdo mbajtës i një certifikatë tipi ose një certifikate tipi të kufizuar, duhet:

a) marrë përsipër detyrimet e përcaktuara në pikat 21.A.3A, 21.A.3B, 21.A.4, 21.A.5, 21.A.6, 21.A.7, 21.A.9, 21.A.62 dhe 21.A.65, dhe, për këtë qëllim, do të vazhdojnë të plotësojnë kërkesat e kualifikimit për pajtueshmëri sipas pikës 21.A.13.

b) specifikojë shënimin në përputhje me nënpjesën Q.;

Nga data 18 maj 2022, detyrimi për të përmbushur detyrimet e renditura në pikën (a) do të kuptohet si referencë në pikat 21.A.3A, 21.A.3B, 21.A.4, 21.A.5, 21.A.6, 21.A.7, 21.A.62 dhe 21.A.65; dhe, për këtë qëllim, çdo mbajtës i një certifikatë tipi ose një certifikate tipi të kufizuar duhet të vazhdojë të plotësojë kërkesat e kualifikimit për përshtatshmërinë sipas pikës 21.A.14.

21.A.47 Transferueshmëria

Transferimi i një certifikate tipi ose një certifikate tipi të kufizuar ose një autorizimi ETSO për një njësi energjie ndihmëse mund të bëhet vetëm te një person fizik ose juridik që është në gjendje të marrë përsipër detyrimet e përcaktuara në pikën 21.A.44, dhe, për këtë qëllim, ka demonstruar aftësinë e tij në përputhje me pikën 21.A.14.

21.A.51 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

a) Një certifikatë e tipit dhe një certifikatë e tipit të kufizuar lëshohen për një afat kohor të pakufizuar. Ato janë të vlefshme me kusht që:

1. Mbajtësi të mbetet në përputhje me këtë aneks (pjesa 21); dhe

2. Certifikata të mos jetë dorëzuar ose revokuar sipas procedurave të zbatueshme administrative të vendosura nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata e tipit dhe certifikata e tipit e kufizuar duhet t'i kthehet Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

21.A.62 Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operationale

Mbajtësi i certifikatës së tipit ose i certifikatës së kufizuar të tipit vë në dispozicion;

a) të paktën një komplet të dhënash të plota të përshtatshmërisë operacionale të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale, për të gjithë operatorët e njohur të avionit në Shqipëri, përpara se të dhënat e përshtatshmërisë operacionale të përdoren nga një organizatë trajnuese ose nga një operator shqiptar; dhe

b) çdo ndryshim në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale për të gjithë operatorët e njohur të avionit; dhe

c) sipas kërkesës, të dhënat përkatëse të përmendura në pikat (a) dhe (b) më lart, për:

1. autoritetin kompetent përgjegjës për verifikimin e pajtueshmërisë me një ose më shumë elementë të këtij kompleti të të dhënave për përshtatshmërinë operacionale; dhe

2. çdo person të cilit i kërkohet të jetë në përputhje me një ose më shumë elementë të këtij kompleti të të dhënave për përshtatshmërinë operacionale.

21.A.65 Integriteti i vazhdueshëm strukturor për strukturat e avionëve

Mbajtësi i certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit të kufizuar për një aeroplan të madh duhet të sigurojë që programi i vazhdueshmërisë së integritetit strukturor të mbetet i vlefshëm gjatë gjithë vlefshmërisë operacionale të aeroplanit, duke marrë parasysh përvojën e shërbimit dhe operimet aktuale;

(NËNPJESA C- JO E ZBATUESHME)

NËNPJESA D - NDRYSHIMET NË CERTIFIKATAT E TIPIT DHE CERTIFIKATAT E TIPIT TË KUFIZUARA

21.A.90A Fushëveprimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për miratimin e ndryshimeve në certifikatat e tipit dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre miratimeve. Kjo nënpjesë përcakton gjithashtu ndryshimet standarde që nuk i nënshtrohen një procesi miratimi sipas kësaj nënpjesë. Në këtë nënpjesë, referencat për certifikatat e tipit përfshijnë certifikatën e tipit dhe certifikatën e kufizuar të tipit.

21.A.90B Ndryshimet standarde

a) Ndryshimet standarde janë ato ndryshime në një certifikatë tipi:

1. Në lidhje me:

i) aeroplanët me peshë maksimale ngritjeje 5700 kg ose më pak;

ii) helikopterët me peshë maksimale ngritjeje 3175 kg ose më pak;

iii) deltaplanët (*sailplanes*), deltaplanët me motor, balonat dhe aerostatet siç përcaktohen në ELA 1 dhe ELA

2. që ndjekin të dhënat e projektimit të përfshira në specifikimet e certifikimit të lëshuara nga Agjencia, që përmbajnë metoda, teknika dhe praktika të pranueshme për kryerjen dhe identifikimin e ndryshimeve standarde, duke përfshirë udhëzimet shoqëruese për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore; dhe

3. Që nuk janë në konflikt me të dhënat e mbajtësit të certifikatës së tipit.

b) Pikat 21.A.91 deri në 21.A.109 nuk janë të zbatueshme për ndryshimet standarde.

21.A.90C Ndryshime të pavarura në udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore

a) Ndryshimet e pavarura në udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore janë ndryshime që nuk përgatiten drejtpërdrejt si rezultat i një ndryshimi në projektin e tipit ose projektin e riparimit.

b) Ndryshime të pavarura në udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore mund të bëhen vetëm nga mbajtësi i miratimit të projektimit për të cilin janë krijuar këto udhëzime.

c) Pikat 21.A.91 deri në 21.A.109 nuk do të zbatohen për ndryshime të pavarura të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore që:

1. nuk ndikojnë në seksionin e kufizimeve të vlefshmërisë ajrore të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, dhe

2. nuk kërkojnë nga mbajtësi i miratimit të projektimit të kryejë ndonjë demonstrim shtesë të përputhshmërisë me bazën e certifikimit.

d) Ndryshimet e pavarura në udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të përmendura në pikën (c) do të miratohen nga mbajtësi i miratimit të projektimit sipas procedurave të dakorduara me Autoritetin kompetent sipas pikës 21.1.

21.A.91 Klasifikimi i ndryshimeve në një certifikatë tipi

Ndryshimet në një certifikatë tipi klasifikohen si të vogla dhe të mëdha. Një “ndryshim i vogël” nuk ka efekt të dukshëm në masë, ekuilibër, forcë strukturore, besueshmëri, karakteristikat operationale, të dhënat e përshtatshmërisë operationale, ose karakteristikat e tjera që ndikojnë në vlefshmërinë ajrore të produktit ose karakteristikat e tij mjedisore. Me përjashtim të pikës 21.A.19, të gjitha ndryshimet e tjera janë “ndryshime të mëdha” sipas kësaj nënpjesë. Ndryshimet e mëdha dhe të vogla duhet të miratohen në përputhje me pikat 21.A.95 ose 21.A.97, sipas rastit, dhe duhet të identifikohen në mënyrë të përshtatshme.

21.A.92 Pranueshmëria

a) Vetëm mbajtësi i certifikatës së tipit mund të aplikojë për miratimin e një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi në përputhje me këtë nënpjesë; të gjithë aplikantët e tjerë për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi duhet të aplikojnë sipas nënpjesës E.

b) Çdo person fizik ose juridik mund të aplikojë për miratimin e një ndryshimi të vogël në një certifikim tipi në përputhje me këtë nënpjesë.

21.A.93 Kërkesa/aplikimi

a) Një kërkesë/aplikim për miratimin e një ndryshimi në një certifikatë tipi bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

b) Një aplikim duhet të përfshijë, ose të plotësohet pas aplikimit fillestar nga një program certifikimi për demonstrimin e përputhshmërisë në përputhje me pikën 21.A.20, i përbërë nga:

1. një përshkrim i ndryshimit duke identifikuar:

i) konfigurimin(et) e produktit në certifikatën e tipit mbi të cilin do të bëhet ndryshimi;

ii) të gjitha zonat e produktit në certifikatën e tipit, përfshirë manualët e miratuara, që ndryshohen ose preken nga ndryshimi; dhe

iii) kur ndryshimi prek të dhënat e përshtatshmërisë operationale, çdo ndryshim të nevojshëm në të dhënat e përshtatshmërisë operationale;

2. një identifikim i çdo rishqyrtimi të nevojshëm për të demonstruar pajtueshmërinë e ndryshimit dhe zonave të prekura nga ndryshimi me bazën e certifikimit të tipit, bazën e të dhënave të përshtatshmërisë operationale të certifikimit dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit; dhe

3. për një ndryshim të madh/rëndësishëm në një certifikatë tip:

i) një propozim për bazën fillestare të certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, të përgatitur në përputhje me kërkesat dhe opsionet e specifikuar në pikën 21.A.101;

ii) një propozim për ndarjen e programit të certifikimit në grupe kuptimplota të aktiviteteve dhe të dhënave demonstruese të pajtueshmërisë, përfshirë një propozim për mjetet e pajtueshmërisë dhe dokumentet përkatëse të pajtueshmërisë;

iii) një propozim për vlerësimin e grupeve kuptimplota të aktiviteteve dhe të dhënave demonstruese të pajtueshmërisë, duke adresuar gjasat e një papajtueshmërie të paidentifikuar me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale ose kërkesat e mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimin e mundshëm të kësaj papajtueshmërie mbi sigurinë e produktit ose mbrojtjen e mjedisit. Vlerësimi i propozuar do të marrë parasysh të paktën elementet e përcaktuara në nën-pikat

(1) - (4) të pikës 21.B.100 (a). Bazuar në këtë vlerësim, aplikimi duhet të përfshijë një propozim për përfshirjen e Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 në verifikimin e aktiviteteve dhe të dhënave demonstruese të pajtueshmërisë; dhe

iv) një program i projektit që përfshin fazat/hapat kryesorë.

c) Një kërkesë për një ndryshim në një certifikatë tipi të një avioni të madh ose një rotorkrafti me përmasa të mëdha do të jetë e vlefshme për pesë vjet dhe një kërkesë për një ndryshim në çdo certifikatë tjetër tipi do të jetë e vlefshme për tre vjet. Në rastin kur ndryshimi nuk është miratuar, ose është e qartë se nuk do të miratohet, brenda afatit të parashikuar në këtë pikë, aplikanti mund të:

1. të paraqesë një kërkesë të re për një ndryshim në certifikatën e tipit dhe të jetë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, siç përcaktohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikën 21.A.101 dhe të njoftuar në përputhje me pikën 21.B.105 për datën e aplikimit të ri; ose

2. të aplikojë për një zgjatje të periudhës kohore të parashikuar në fjalinë e parë të pikës (c) për aplikimin origjinal dhe të propozojë një datë të re për dhënien e miratimit. Në këtë rast, aplikanti duhet të respektojë bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, siç përcaktohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, në përputhje me pikën 21.A.101 dhe të njoftuar në përputhje me pikën 21.B.105., për një datë që do të zgjidhet nga aplikanti. Megjithatë, kjo datë nuk do t'i paraprijë datës së re të propozuar nga aplikanti për lëshimin e miratimit për më shumë se pesë vjet për një aplikim për një ndryshim në certifikatën e tipit ose certifikatën e tipit të kufizuar për një aeroplan të madh ose një rotorkraft të madh, dhe për më shumë se tre vjet për një aplikim për një ndryshim në çdo certifikatë tjetër tipi ose certifikatë tipi të kufizuar.

21.A.95 Kërkesat për miratimin e një ndryshimi të vogël

a) Ndryshimet e vogla në një certifikatë tipi klasifikohen dhe miratohen nga:

1. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1; ose

2. një organizatë projektimi e miratuar brenda fushëveprimit të privilegjeve të saj të parashikuara në pikat (1) dhe (2) të pikës 21.A.263 (c), siç është regjistruar në kushtet e miratimit.

b) Një ndryshim i vogël në një certifikatë tipi miratohet vetëm:

1. kur është demonstruar se ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi janë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit të përfshira me referencë në certifikatën e tipit;

2. në rastin e një ndryshimi që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operationale, kur është demonstruar se ndryshimet e nevojshme në të dhënat e përshtatshmërisë operationale janë në përputhje me bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale të inkuorporuar me referencë në certifikatën e tipit;

3. kur është deklaruar pajtueshmëria me bazën e certifikimit të tipit që zbatohet në përputhje me pikën (1) dhe arsyetimet e pajtueshmërisë janë regjistruar në dokumentet e pajtueshmërisë; dhe

4. kur nuk është identifikuar ndonjë tipar ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

c) Me përjashtim të pikës (1) germa (b), specifikimet e certifikimit që u bënë të zbatueshme pas atyre të inkuorporuara me referencë në certifikatën e tipit mund të përdoren për miratimin e një ndryshimi të vogël, me kusht që ato të mos ndikojnë në demonstrimin e pajtueshmërisë.

d) Me përjashtim të pikës (a), me kërkesë të aplikantit të përfshirë në deklaratën e përmendur në pikën 21.A.20 (d), një ndryshim i vogël në një certifikatë të tipit të avionit mund të miratohet para se përputhshmëria me bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale të jetë demonstruar me kusht që aplikanti të demonstrojë këtë përputhshmëri përpara datës në të cilën këto të dhëna janë përdorur në të vërtetë.

e) Aplikanti duhet të paraqesë në Autoritetin kompetent sipas pikës 21.1 të dhënat që vërtetojnë ndryshimin dhe një deklaratë se pajtueshmëria është demonstruar në përputhje me pikën (b).

f) Një aprovim i një ndryshimi të vogël në një certifikatë tipi do të kufizohet në konfigurimin (et) specifik në certifikatën e tipit me të cilën ka të bëjë ndryshimi.

21.A.97 Kërkesat për miratimin e një ndryshimi të madh

a) Ndryshimet kryesore në një certifikatë tipi klasifikohen dhe aprovohen nga:

1. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 ose

2. nga një organizatë projektimi e miratuar brenda fushëveprimit të privilegieve të saj të parashikuara në pikat (1) dhe (8) të pikës 21.A.263 (c), siç është regjistruar në kushtet e miratimit.

b) Një ndryshim i madh në një certifikatë tipi miratohet vetëm:

1. kur është demonstruar se ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi janë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, siç përcaktohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikën 21.A.101;

2. në rastin e një ndryshimi që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale, kur është demonstruar se ndryshimet e nevojshme në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale plotësojnë bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale, siç përcaktohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikën 21.A.101; dhe

3. kur përputhshmëria me pikat (1) dhe (2) është demonstruar në përputhje me pikën 21.A.20, siç zbatohet për ndryshimin.

c) Me përjashtim të pikave (2) dhe (3) të germës (b), me kërkesën e aplikantit të përfshirë në deklaratën e përmendur në pikën 21.A.20 (d), një ndryshim i madh në një certifikatë të tipit të avionit mund të miratohet para se të jetë demonstruar përputhshmëria me bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale, me kusht që aplikanti të demonstrojë këtë përputhshmëri përpara datës në të cilën këto të dhëna janë përdorur në të vërtetë.

d) Një aprovim i një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi do të kufizohet në konfigurimin (et) specifik në certifikatën e tipit me të cilën ka të bëjë ndryshimi.

21.A.101 Baza e certifikimit të tipit, baza e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit për një ndryshim madhor në një certifikatë tipi

a) Një ndryshim i madh në një certifikatë tipi dhe zonat e prekura nga ndryshimi do të jenë në përputhje me specifikimet e certifikimit të zbatueshme për produktin e ndryshuar në datën e aplikimit për ndryshimin ose specifikimet e certifikimit të cilat u bënë të zbatueshme pas kësaj date në përputhje me pikën (f) më poshtë. Vlefshmëria e aplikimit përcaktohet në përputhje me pikën 21.A.93 (c). Për më tepër, produkti i ndryshuar duhet të jetë në përputhje me kërkesat e mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikën 21.B.85.

b) Përveç siç parashikohet në pikën (h), me përjashtim nga pika (a), një ndryshim i mëparshëm në një specifikim certifikimi të përmendur në pikën (a) dhe në çdo specifikim tjetër certifikimi që lidhet drejtpërdrejt mund të përdoret në ndonjë nga situatat e mëposhtme, përveç rastit kur ndryshimi i mëparshëm hyri në fuqi përpara datës në të cilën specifikimet përkatëse të certifikimit të përfshira me referencë në certifikatën e tipit hyn në fuqi.

1. Një ndryshim që Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 nuk e konsideron të rëndësishëm. Në përcaktimin nëse një ndryshim specifik është i rëndësishëm, Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 do të konsiderojë ndryshimin në kontekstin e të gjitha ndryshimeve të mëparshme përkatëse të projektimit dhe të gjitha rishikimet përkatëse të specifikimeve të zbatueshme të certifikimit të përfshira me referencë në certifikatën e tipit për produktin. Ndryshimet që përmbushin një nga kriteret e mëposhtme do të konsiderohen automatikisht të rëndësishme:

i) konfigurimi i përgjithshëm ose parimet e ndërtimit nuk ruhen;

ii) supozimet e përdorura për certifikimin e produktit që do të ndryshohet nuk mbeten të vlefshme;

2. Çdo zonë, sistem, pjesë ose pajisje që Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 çmon se nuk ndikohet nga ndryshimi;

3. Çdo zonë, sistem, pjesë ose pajisje që preket nga ndryshimi për të cilin Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 konstaton se pajtueshmëria me specifikimet e certifikimit të përmendura në pikën (a) nuk kontribuon materialisht në nivelin e sigurisë së produktit të ndryshuar ose çmon se është jopraktike.

c) Me përjashtim të pikës (a), në rastin e një ndryshimi në një avion (të ndryshëm nga një helikopter-rotorkraft) me peshë maksimale prej 2 722 kg (6 000 lbs) ose më pak, ose në një helikopter/rotorkraft pa turbinë me peshë maksimale prej 1 361 kg (3 000 lbs) ose më pak, ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi duhet të jenë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit të përfshirë me referencë në certifikatën e tipit. Megjithatë, nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 konstaton se ndryshimi është i rëndësishëm në një zonë, Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 mund të kërkojë që ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi të jenë në përputhje me një ndryshim në specifikimin e certifikimit të bazës së certifikimit të tipit të inkorporuar me referencë në certifikatën e tipit dhe me ndonjë specifikim tjetër të certifikimit i cili është i lidhur drejtpërdrejt, përveç nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, gjithashtu, konstaton se pajtueshmëria me atë ndryshim nuk kontribuon materialisht në nivelin e sigurisë së produktit të ndryshuar ose është jopraktike.

d) Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 konstaton se specifikimet e certifikimit të zbatueshme në datën e aplikimit për ndryshim nuk ofrojnë standarde të përshtatshme në lidhje me ndryshimin e propozuar, ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi duhet të jenë në përputhje me kushtet e veçanta dhe ndryshimet në ato kushte të veçanta, të përshkruara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikën 21.B.75, për të siguruar një nivel sigurie ekuivalent me atë të përcaktuar nga specifikimet e certifikimit në fuqi në datën e aplikimit për ndryshimin.

e) Me përjashtim të pikave (a), (b) dhe (c), ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi mund të jenë në përputhje me një alternativë të specifikimit të certifikimit të përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 nëse propozohet nga aplikuesi, me kusht që Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 të çmojë se alternativa ofron një nivel sigurie që është:

1. në rastin e një certifikate tip:

i) ekuivalente me atë të specifikimeve të certifikimit të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në paragrafët (a), (b) ose (c) më sipër; ose

ii) në përputhje me kërkesat thelbësore të aneksit II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1139/2018;

2. në rastin e një certifikate tip të kufizuar, e përshtatshme në lidhje me përdorimin e synuar.

f) Nëse një aplikant zgjedh të pajtohet me një specifikim të certifikimit të përcaktuar në një ndryshim që bëhet i zbatueshëm pas dorëzimit të aplikimit për një ndryshim në një certifikatë tipi, ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi do të jenë në përputhje me çdo specifikim tjetër të certifikimit që lidhet drejtpërdrejt.

g) Kur aplikimi për një ndryshim në një certifikatë tipi për një avion përfshin, ose plotësohet pas aplikimit fillestar për të përfshirë ndryshimet në të dhënat e përshtatshmërisë operationale, baza e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale përcaktohet në përputhje me pikat (a) - (f);

h) Për aeroplanët e mëdhenj që i nënshtrohen pikës 26.300 të aneksit I të rregullores mbi specifikimet shtesë të vlefshmërisë ajrore për një lloj të caktuar operimesh transpozim i rregullores së Komisionit (BE) 2015/640 (*1), aplikuesi duhet të përputhet me specifikimet e certifikimit që ofrojnë të paktën një nivel ekuivalent sigurie me pikat 26.300 dhe 26.330 të aneksit I të rregullores mbi specifikimet shtesë të vlefshmërisë ajrore për një lloj të caktuar operimesh transpozim i rregullores

(BE) 2015/640, me përjashtim të aplikuesëve për certifikata plotësuese tipi të cilëve nuk u kërkohet të marrin parasysh pikën 26.303.

21.A.108 Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale

Në rastin e një ndryshimi që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale, zotëruesi i miratimit të ndryshimit të vogël vë në dispozicion:

a) të paktën një komplet të ndryshimeve për të dhënat e përshtatshmërisë operacionale të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale, për të gjithë operatorët e njohur të avionit të ndryshuar, përpara se të dhënat e përshtatshmërisë operacionale të përdoren nga një organizatë trajnuese ose një operator vendas; dhe

b) çdo ndryshim tjetër në të dhënat e prekura të përshtatshmërisë operacionale, për të gjithë operatorët e njohur të avionit të ndryshuar; dhe

c) sipas kërkesës, pjesët përkatëse të ndryshimeve në pikat (a) dhe (b) më lart, për:

1. autoritetin kompetent përgjegjës për verifikimin e përputhshmërisë me një ose më shumë elementë të të dhënave të prekura të përshtatshmërisë operacionale; dhe

2. çdo person të cilit i kërkohet që të jetë në përputhshmëri me një ose me më shumë elementë të këtij grupi të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale.

21.A.109 Detyrimet dhe shënjimi MEP (EPA)

Zotëruesi i miratimit të një ndryshimi të vogël në një certifikatë tipi:

a) merr përsipër detyrimet e përcaktuara në pikat 21.A.4, 21.A.5, 21.A.6, 21.A.7, 21.A.9 dhe 21.A.108;

b) specifikon shenjën, duke përfshirë shkronjat MPE (Miratimi Evropian i Pjesës- EPA), në përputhje me pikën 21.A.804 (a).

NËNPJESA E - CERTIFIKATAT PLOTËSUESE TË TIPIT

21.A.111 Fushëveprimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për miratimin e ndryshimeve të mëdha në certifikatën e tipit sipas procedurave të certifikatës plotësuese të tipit dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre certifikatave. Në këtë nënpjesë, referencat për certifikatat e tipit përfshijnë certifikatat e tipit dhe certifikatat e tipit të kufizuara.

21.A.112A Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik që ka demonstruar, ose është në proces demonstrimi, të aftësisë së tij në përputhje me pikën 21.A.112B mund të aplikojë për një certifikatë tipi plotësuese në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë nënpjesë.

21.A.112B Demonstrimi i aftësisë

a) Një aplikant për një certifikatë plotësuese tipi do të demonstrojë aftësinë e tij duke mbajtur një miratim të organizatës projektuese të lëshuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me nënpjesën J.

b) Me përjashtim të paragrafit (a), si një procedurë alternative për të demonstruar aftësinë e tij, një aplikant mund të kërkojë miratimin e Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 për përdorimin e procedurave që përcaktojnë praktikat specifike të projektimit, burimet dhe rendin e aktiviteteve të nevojshme për t'u përputhur me këtë nënpjesë.

c) Me përjashtim të paragrafit (a), në rastin e produkteve të referuara në pikën 21.A.14 (c), një aplikant mund të demonstrojë aftësinë e tij duke marrë pranimin nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 të programit të tij të certifikuar të përcaktuar në përputhje me pikën 21.A.93 (b);

21.A.113 Aplikimi për një certifikatë plotësuese të tipit

a) Një aplikim për një certifikatë tip plotësuese bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

b) Kur aplikon për një certifikatë tipi plotësuese aplikanti, duhet të:

i) përfshijë në kërkesë informacionin e kërkuar sipas pikës 21.A.93 (b);

ii) specifikojë nëse të dhënat e certifikimit janë përgatitur ose do të përgatiten plotësisht nga kërkuuesi ose në bazë të një marrëveshjeje me pronarin e të dhënave të certifikimit të tipit.

c) Pika 21.A.93 (c) zbatohet për kërkesat për afatet kohore të efektivitetit të aplikimit si dhe kërkesat në lidhje me nevojën për të përditësuar bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore kur ndryshimi nuk është miratuar ose është e qartë se nuk do të miratohet brenda afatit të caktuar;

21.A.115 Kërkesat për miratimin e ndryshimeve të mëdha në formën e një certifikate plotësuese të tipit

a) Certifikatat e tipit plotësuese do të lëshohen nga:

1. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1; ose

2. një organizatë e miratuar projektuese brenda fushëveprimit të privilegjeve të saj të parashikuara në pikat (1) dhe (9) të pikës 21.A.263 (c), siç është regjistruar në kushtet e miratimit.

b) Një certifikatë plotësuese e tipit lëshohet vetëm kur:

1. aplikanti ka demonstruar aftësinë e tij në përputhje me pikën 21.A.112B;

2. është demonstruar se ndryshimi në një certifikatë tipi dhe zonat e prekura nga ndryshimi përputhen me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, siç përcaktohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikën 21.A.101;

3. në rastin e një certifikate tip plotësuese që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operationale, është demonstruar se ndryshimet e nevojshme në të dhënat e përshtatshmërisë operationale plotësojnë bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale, siç përcaktohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikën 21.A.101;

4. pajtueshmëria me pikat (2) dhe (3) është demonstruar në përputhje me pikën 21.A.20, siç zbatohet për ndryshimin; dhe

5. në rast se aplikanti ka specifikuar që ka siguruar të dhëna certifikimi në bazë të një marrëveshjeje me pronarin e të dhënave të certifikimit të tipit në përputhje me pikën 21.A.113 (b):

i) mbajtësi i certifikatës së tipit ka treguar se nuk ka kundërshtim teknik ndaj informacionit të paraqitur në pikën 21.A.93; dhe

ii) mbajtësi i certifikatës së tipit ka rënë dakord të bashkëpunojë me mbajtësin e certifikatës të tipit për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve për ruajtjen e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë së produktit të ndryshuar përmes pajtueshmërisë me pikat 21.A.44 dhe 21.A.118A.

c) Me përjashtim të pikave (3) dhe (4) të paragrafit (b), me kërkesën e aplikantit të përfshirë në deklaratën e përmendur në pikën 21.A.20 (d), aplikanti ka të drejtë të ketë një certifikatë plotësuese të tipit për një avion të lëshuar para se aplikanti të ketë demonstruar pajtueshmëri me bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale, me kusht që aplikanti të demonstrojë një pajtueshmëri të tillë përpara datës në të cilën këto të dhëna do të përdoren në të vërtetë.

d) Një certifikatë plotësuese e tipit do të kufizohet në konfigurimin(et) specifik në certifikatën e tipit, të cilit i referohet ndryshimi kryesor përkatës.

21.A.116 Mundësia për t'u transferuar

Një certifikatë e tipit plotësuese transferohet vetëm te një person fizik ose juridik i cili është në gjendje të ndërmarrë detyrimet e pikës 21.A.118A dhe për këtë qëllim ka demonstruar aftësinë e tij për t'u kualifikuar sipas kriterëve të pikës 21.A.112B me përjashtim të avionëve ELA1 për të cilët personi fizik ose juridik ka kërkuar marrëveshjen e Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, për përdorimin e procedurave që përcaktojnë aktivitetet e tij për të ndërmarrë këto detyrime.

21.A.117 Ndryshimet në atë pjesë të produktit që mbulohet nga një certifikatë e tipit plotësuese

a) Ndryshimet e vogla në atë pjesë të produktit të mbuluar nga një certifikatë e tipit plotësuese klasifikohen dhe miratohen në përputhje me nënpjesën D.

b) Çdo ndryshim madhor në atë pjesë të produktit të mbuluar nga një certifikatë e tipit plotësuese miratohet si një certifikatë e tipit plotësuese më vete në përputhje me këtë nënpjesë.

c) Me përjashtim të paragrafit (b), një ndryshim i madh i pjesës së produktit të mbuluar nga një certifikatë e tipit plotësuese e paraqitur nga vetë mbajtësi i certifikatës së tipit plotësuese mund të miratohet si një ndryshim ndaj certifikatës së tipit plotësuese ekzistuese.

21.A.118A Detyrimet dhe shënjimi MEP (EPA)

Çdo mbajtës i një certifikate tipi plotësuese:

a) Merr përsipër detyrimet:

1. të përcaktuara në pikat 21.A.3A, 21.A.3B, 21.A.4, 21.A.5, 21.A.6, 21.A.7, 21.A.9 dhe 21.A. 120B.

2. Të nënkuptuara në bashkëpunim me mbajtësin e certifikatës së tipit në përputhje me pikën 21.A.115 (d) (2); dhe

për këtë qëllim vazhdon të plotësojë kriteret e pikës 21.A.112B;

b) Specifikon shënimin, duke përfshirë shkronjat MEP (EPA), në përputhje me pikën 21.A.804(a).

21.A.118B Kohëzgjatja dhe vlefshmëria në vazhdueshmëri

a) Një certifikatë e tipit plotësuese lëshohet për një periudhë kohore pa afat. Ajo mbetet e vlefshme në varësi të:

1. Qëndrimit të mbajtësit në pajtueshmëri me këtë aneks (pjesa 21); dhe

2. Mos dorëzimit ose revokimit të certifikatës sipas procedurave të zbatueshme administrative të vendosura nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata e tipit plotësuese i kthehet Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

21.A.120B Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale

Në rastin e një ndryshimi që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale, zotëruesi i certifikatës plotësuese të tipit vë në dispozicion:

a) të paktën një komplet ndryshimesh për të dhënat e përshtatshmërisë operacionale të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale, për të gjithë operatorët e njohur të BE-së dhe ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, ose operatorëve vendas të avionit të ndryshuar, përpara se të dhënat e përshtatshmërisë operacionale të përdoren nga një organizatë trajnuese ose një operator vendas, ose i BE-së dhe ZPEA-së; dhe

b) çdo ndryshim tjetër në të dhënat e prekura të përshtatshmërisë operacionale, për të gjithë operatorët e njohur të BE-së dhe ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, ose operatorëve vendas të avionit të ndryshuar; dhe

c) sipas kërkesës, pjesët përkatëse të ndryshimeve në pikat (a) dhe (b) më lart, për:

1. Autoritetin kompetent përgjegjës për verifikimin e përputhshmërisë me një ose më shumë elementë të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale të prekura nga ndryshimi; dhe

2. Çdo person të cilit i kërkohet që të jetë në përputhshmëri me një ose më shumë elementë të këtij kompleti të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale.

NËNpjesa F - PRODHIMI PA MIRATIMIN E ORGANIZATËS PRODHUESE

21.A.121 Qëllimi

a) Kjo nënpjesë vendos procedurën për të demonstruar përputhshmërinë me të dhënat e zbatueshme të projektimit të një produkti, pjese, ose pajisjeje e cila synohet të prodhohet pa miratimin e një organizate prodhuese sipas nënpjesës G.

b) Kjo nënpjesë vendos rregullat që drejtojnë detyrimet e prodhuesit të një produkti, pjese ose pajisjeje që prodhohet sipas kësaj nënpjesë.

21.A.122 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik mund të aplikojë për të treguar pajtueshmërinë e produkteve individuale, pjesëve dhe pajisjeve sipas kësaj nënpjesë, nëse:

a) mban ose ka aplikuar për një miratim që mbulon projektin e atij produkti, asaj pjese ose pajisjeje; ose

b) ka siguruar koordinimin e kënaqshëm midis prodhimit dhe projektimit, nëpërmjet një marrëveshjeje të përshtatshme me aplikantin ose mbajtësin e miratimit të një projekti të tillë.

21.A.124 Aplikimi

a) Çdo aplikim për një marrëveshje për të treguar pajtueshmërinë e produkteve individuale, pjesëve dhe pajisjeve sipas kësaj nënpjesë bëhet në një formë dhe mënyrë të vendosur nga AAC.

b) Një aplikim i tillë përmban:

1. Të dhëna që demonstrojnë, atje ku është e zbatueshme, se:

i) lëshimi i një miratimi të organizatës prodhuese sipas nënpjesës G do të ishte i papërshtatshëm; ose

ii) certifikimi ose miratimi i një produkti, pjese ose pajisjeje sipas kësaj nënpjesë është i nevojshëm në pritje të lëshimit të miratimit të një organizate prodhuese sipas nënujësës G.

2. Një përshkrim të informacionit të kërkuar nga pika 21.A.125(b).

21.A.124A Mjetet e përputhshmërisë

a) Një organizatë mund të përdorë çdo mjet alternativ përputhshmërie për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë rregullore.

b) Nëse një organizatë dëshiron të përdorë një mjet alternativ përputhshmërie, para se ta përdorë, duhet t'i japë AAC-së një përshkrim të plotë. Përshkrimi duhet të përfshijë çdo rishikim të manualeve ose procedurave që mund të jenë relevante, si dhe një shpjegim që tregon se si arrihet përputhshmëria me këtë rregullore.

Organizata mund të përdorë këto mjete alternative të përputhshmërisë, që t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga AAC-ja.

21.A.125A Lëshimi i një letër marrëveshjeje

Aplikanti ka të drejtë të ketë një letër marrëveshjeje të lëshuar nga AAC-ja duke rënë dakord për të treguar përputhshmërinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve individuale sipas kësaj nënpjesë, pasi:

a) të ketë vendosur një sistem të inspektimit të prodhimit i cili siguron se çdo produkt, pjesë ose pajisje përputhet me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe është në gjendje për operim të sigurt.

b) të ketë siguruar një manual i cili përmban:

1. Një përshkrim të sistemit të inspektimit të prodhimit të kërkuar sipas paragrafit (a),

2. Një përshkrim të mjeteve për përcaktimin e sistemit të inspektimit të prodhimit;

3. Një përshkrim të provave të kërkuara nga paragrafët 21.A.127 dhe 21.A.128, dhe emrat e personave të autorizuar për qëllimin e paragrafit 21.A.130(a).

c) të ketë demonstruar që është i aftë të japë asistencë në përputhje me pikat 21.A.3 dhe 21.A.129(d).

21.A.125B Gjetjet dhe vëzhgimet

a) Pas marrjes së njoftimit të gjetjeve në përputhje me pikën 21.B.125, mbajtësi i një letre marrëveshjeje do të:

1. të identifikojë shkaku(et) kryesor të mospërputhjes dhe faktorët që kontribuojnë në të;

2. të përcaktojë një plan veprimi korigjues;

3. të demonstrojë zbatimin e veprimeve korigjuese sipas rregullave të AAC-së.

b) Veprimet e përmendura në pikën (a) do të kryhen brenda periudhës së rënë dakord me AAC-në në përputhje me pikën 21.B.125.

c) Vëzhgimet e marra në përputhje me pikën 21.B.125(e) do të merren parasysh rregullisht nga mbajtësi i letrës së marrëveshjes. Organizata duhet të regjistrojë vendimet e marra në lidhje me ato vëzhgime.;

21.A.125C Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë:

a) Letra e marrëveshjes do të lëshohet për një periudhë kohe të kufizuar që në çdo rast nuk do të kalojë 1 vit. Ajo do të mbetet e vlefshme në varësi të përputhshmërisë së organizatës me të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. organizata prodhuese vazhdon të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të këtij aneksi;

2. organizata prodhuese ose ndonjë nga partnerët, furnitorët ose nënkontraktuesit e saj pranon se AAC-ja mund të kryejë hetime në përputhje me pikën 21.A.9;

3. organizata prodhuese është në gjendje t'i sigurojë AAC-së prova që tregojnë se ajo zotëron kontroll të duhur të prodhimit të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve sipas letrës së marrëveshjes;

4. letra e marrëveshjes nuk është revokuar nga AAC-ja sipas pikës 21.B.65, nuk është dorëzuar nga organizata prodhuese dhe kohëzgjatja e saj nuk ka skaduar.

b) Pas dorëzimit, revokimit ose skadimit, letra e marrëveshjes i kthehet AAC-së.

21.A.126 Sistemi i inspektimit të prodhimit

a) Sistemi i inspektimit të prodhimit i kërkuar sipas pikës 21.A.125A(a) duhet të japë mjetet për të përcaktuar që:

1. Materialet që vijnë dhe pjesët e blera ose të nënkontraktuar, të përdorura në produktin e përfunduar janë të njëjta siç janë specifikuar në të dhënat e zbatueshme të projektimit.

2. Materialet që vijnë dhe pjesët e blera ose të nënkontraktuar janë të identifikuar në mënyrën e duhur.

3. Proceset, teknikat e prodhimit dhe metodat e montimit që ndikojnë në cilësinë dhe sigurinë e produktit të përfunduar janë kryer në përputhje me udhëzimet e pranuar nga AAC-ja.

4. Ndryshimet e projektit, duke përfshirë zëvendësimet e materialit, janë miratuar sipas nënpjesës D ose E dhe janë kontrolluar përpara se të integrohen në produktin e përfunduar.

b) Sistemi i inspektimit të prodhimit i kërkuar sipas pikës 21.A.125(a), duhet të jetë i tillë që të sigurojë që:

1. Pjesët në proces janë inspektuar për përputhshmëri me të dhënat e zbatueshme të projektimit në ato pika gjatë procesit në të cilat mund të bëhen përcaktime të sakta.

2. Materialet që dëmtohen dhe prishen, ruhen në mënyrë të përshtatshme dhe mbrohen në mënyrë të mjaftueshme.

3. Vizatimet aktuale të projektit janë të gatshme për personelin prodhues dhe inspektues dhe përdoren kur është e nevojshme.

4. Materialet dhe pjesët e refuzuara të jenë veçuar dhe identifikuar në një mënyrë e cila përjashton instalimin në produktin e përfunduar.

5. Materialet dhe pjesët që janë mbajtur për shkak të devijimeve nga projektimi i tipit ose specifikimet e prodhimit, dhe që duhet të merren parasysh për instalim në produktin e përfunduar, i nënshtrohen një procedure të miratuar të rishikimit inxhinierik dhe të prodhimit. Ato materiale dhe pjesë që janë konstatuar në atë procedurë si të përdorshme do të identifikohen dhe riinspektohen rregullisht nëse është e nevojshme të ripërpunohen ose riparohen. Materialet dhe pjesët e refuzuara në atë procedurë do të shënohen dhe asgjësohen për t'u siguruar që të mos përfshihen në produktin e përfundimtar.

21.A.127 Provat: avionët

a) Çdo prodhues i një avioni të prodhuar sipas kësaj nënpjesë vendos një bazë të miratuar prodhimi, një procedurë të testimit të fluturimit dhe format e kontrollit dhe në përputhje me këto forma, testohet çdo avion i prodhuar, si një mënyrë e vendosjes së aspekteve përkatëse të pajtueshmërisë me pikën 21.A.125(a).

b) Çdo procedurë e testimit të prodhimit përfshin të paktën sa më poshtë:

1. Një kontroll mbi cilësitë e përdorimit;
2. Një kontroll mbi performancën e fluturimit (duke përdorur instrumentet normal të avionit);
3. Një kontroll mbi funksionimin e duhur të të gjitha pajisjeve dhe sistemeve të avionit;
4. Një përcaktim se të gjithë instrumentet janë të shënjuar në mënyrën e duhur dhe të gjitha tabelat dhe manualët e kërkuara të fluturimit janë instaluar pas provës së fluturimit;
5. Një kontroll të karakteristikave funksionale të avionit në tokë;
6. Një kontroll mbi çdo artikull tjetër të veçantë të avionit të testuar.

21.A.128 Provat: motorët dhe helikat

Çdo prodhues motorësh, ose helikash të prodhuara sipas kësaj nënpjesë vendos çdo motor ose helikë me regjistrim në një provë të pranueshme funksionale siç specifikohet në dokumentacionin e mbajtësit të certifikatës së tipit, për të përcaktuar nëse punon në mënyrën e duhur brenda funksionit për të cilën ka marrë certifikatë të tipit, si një mënyrë për të vendosur aspekte përkatëse të pajtueshmërisë me pikën 21.A.125A(a).

21.A.129 Detyrimet e organizatës prodhuese

Çdo prodhues i një produkti, pjesë ose pajisjeje që prodhohet sipas kësaj nënpjesë:

- a) Vendos në dispozicion çdo produkt, pjesë ose pajisje për inspektim nga AAC-ja.
- b) Ruan në vendin e prodhimit të dhënat dhe vizatimet teknike që janë të nevojshme për të përcaktuar nëse produkti pajtohet me të dhënat e zbatueshme të projektimit.
- c) Ruan sistemin e inspektimit të prodhimit i cili siguron që çdo produkt përputhet me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe është në gjendje për operim të sigurt.
- d) Jep asistencë për mbajtësin e certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar ose miratimit të projektit për sa i përket çdo veprimi të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore që është i lidhur me produktin, pjesën ose pajisjen që është prodhuar.
- e) në përputhje me nënpjesën A të këtij seksioni.

21.A.130 Deklarata e përputhshmërisë

a) Çdo prodhues i një produkti, pjesë ose pajisjeje të prodhuar sipas kësaj nënpjesë harton një deklaratë të përputhshmërisë, sipas një forme 52 të Republikës së Shqipërisë sipas modelit EASA (shiko shtojcën VIII), për gjithë avionin, ose sipas një forme 1 të Republikës së Shqipërisë sipas modelit të EASA-s (shiko shtojcën I), për produktet, pjesët ose pajisjet e tjera. Kjo deklaratë duhet të firmoset nga një person i autorizuar i cili mban një pozicion me përgjegjësi në organizatën prodhuese.

b) Një deklaratë përputhshmërie përfshin të gjitha më poshtë:

1. për çdo produkt, pjesë ose pajisje, një deklaratë që produkti, pjesa ose pajisja përputhet me të dhënat e miratuara të projektit dhe është në gjendje për funksionimin e sigurt;
2. për çdo avion, një deklaratë se avioni është kontrolluar në tokë dhe fluturim në përputhje me pikën 21.A.127 (a);
3. për çdo motor ose helikë të ndryshueshme, një deklaratë që motori ose helika e ndryshueshme i është nënshtruar nga prodhuesi një prove funksionale përfundimtare në përputhje me pikën 21.A.128;
4. gjithashtu, në rastin e kërkesave për mbrojtjen e mjedisit:
 - i) një deklaratë që motori i kompletuar është në përputhje me kërkesat e aplikueshme për emetimet e shkarkimit të motorit në datën e prodhimit të motorit, dhe

ii) një deklaratë që avioni i kompletuar është në përputhje me kërkesat e zbatueshme të emetimeve të CO₂ në datën e lëshimit të certifikatës së parë të vlefshmërisë ajrore.

c) Çdo prodhues i një produkti, pjese ose pajisjeje të tillë prezanton:

1. Pas transferimit fillestar nga ai të pronësisë së një produkti, pjese ose pajisjeje të tillë; ose
2. Pas aplikimit për lëshimin origjinal të një certifikate të vlefshmërisë ajrore të një avioni; ose
3. Pas aplikimit për lëshimin origjinal të një dokumenti lejimi të vlefshmërisë ajrore për një motor, një helikë, një pjese ose pajisje, një deklaratë aktuale të përputhshmërisë, për miratim nga AAC-ja.

d) AAC-ja miraton nëpërmjet një kundër-firme deklaratën e përputhshmërisë nëse zbulon pas inspektimit se produkti, pjesa ose pajisja përputhet me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe është në gjendje për operim të sigurt.

NËNPJESA G - MIRATIMI I ORGANIZATËS PRODHUESE

21.A.131 Qëllimi

Kjo nënpjesë vendos:

a) procedurën për lëshimin e një miratimi të organizatës prodhuese për një organizatë prodhuese e cila tregon pajtueshmërinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve me të dhënat e zbatueshme të projektit.

b) rregullat që drejtojnë të drejtat dhe detyrimet e aplikantit dhe mbajtësit të këtyre miratimeve.

21.A.133 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik ('organizatë') kualifikohet si aplikant për një miratim sipas kësaj nënpjesë. Aplikanti, duhet:

a) të justifikojë që, një miratim sipas kësaj nënpjesë është i përshtatshëm për qëllimin e shfaqjes së përputhshmërisë me një projektim specifik për një fushë të caktuar pune; dhe

b) të mbajë ose ka aplikuar për një miratim të atij projektimi specifik; ose

c) të deklarojë ose synon të deklarojë përputhshmërinë e atij projektimi specifik në përputhje me nënpjesën C të seksionit A të aneksit Ib (Pjesa 21 Light); ose

d) ka siguruar një koordinim të kënaqshëm ndërmjet prodhimit dhe projektimit, nëpërmjet një marrëveshjeje të përshtatshme me:

1) aplikantin ose mbajtësin e një miratimi të atij projektimi specifik të lëshuar në përputhje me këtë rregullore; ose

2) personin fizik ose juridik që ka bërë një deklaratë përputhshmërie të atij projektimi specifik në përputhje me nënpjesën C të seksionit A të aneksi Ib (Pjesa 21 Light).

21.A.134 Aplikimi

Çdo aplikim për miratimin e një organizate prodhuese i drejtohet AAC-së në një formë dhe mënyrë të përcaktuar nga AAC-ja dhe përfshin një përshkrim të informacionit të kërkuar nga pika 21.A.143, si dhe kushtet e miratimit të kërkuara për t'u lëshuar sipas pikës 21.A.151.

21.A.134A Mjetet e përputhshmërisë

a) Një organizatë mund të përdorë çdo mjet alternativ përputhshmërie për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë rregullore.

b) Nëse një organizatë dëshiron të përdorë një mjet alternativ përputhshmërie, para se ta përdorë, duhet t'i japë AAC-së një përshkrim të plotë. Përshkrimi duhet të përfshijë çdo rishikim të manualeve ose procedurave që mund të jenë relevante, si dhe një shpjegim që tregon se si arrihet përputhshmëria me këtë Rregullore.

Organizata mund të përdorë këto mjete alternative të përputhshmërisë, që t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga AAC.

21.A.135 Lëshimi i miratimit të organizatës prodhuese

Një organizatë i jepet e drejta të ketë një miratim të organizatës prodhuese të lëshuar nga AAC-ja kur ajo të ketë treguar pajtueshmëri me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë.

21.A.139 Sistemi i menaxhimit të prodhimit

a) Organizata prodhuese duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të prodhimit që përfshin element të menaxhimit të sigurisë dhe element të menaxhimit të cilësisë, me përgjegjshmëri dhe linja përgjegjësie të përcaktuara qartë në të gjithë organizatën.

b) Sistemi i menaxhimit të prodhimit duhet:

1. të korrespondojë me madhësinë e organizatës, dhe me natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të saj, duke marrë parasysh problemet dhe rreziqet shoqëruese në ato aktivitete;

2. të krijohet, zbatohet dhe mbahet nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të një menaxheri të vetëm të emëruar në përputhje me pikën 21.A.145(c)(1).

c) Si pjesë e elementit të menaxhimit të sigurisë së sistemit të menaxhimit të prodhimit, organizata e prodhimit duhet:

1. të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një politikë sigurie dhe objektivat përkatës të sigurisë;

2. të emërojë personelin kryesor të sigurisë në përputhje me pikën 21.A.145(c)(2);

3. të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një proces të menaxhimit të riskut të sigurisë për të identifikuar rreziqet e sigurisë që vijnë nga aktivitetet e tij të aviacionit, për t'i vlerësuar dhe për të menaxhuar risqet që lidhen me to, duke përfshirë marrjen e veprimeve për të zbutur risqet dhe për të verifikuar efektivitetin e tyre;

4. të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një proces të garantimit të sigurisë që përfshin:

i) matjen dhe monitorimin e performancës së sigurisë së organizatës;

ii) menaxhimin e ndryshimeve në përputhje me pikën 21.A.147;

iii) parimet për përmirësimin e vazhdueshëm të elementit të menaxhimit të sigurisë;

5. promovojë sigurinë në organizatë përmes:

i) trajnimit dhe edukimit;

ii) komunikimit;

6. të krijojë një sistem raportimi të ngjarjeve në përputhje me pikën 21.A.3A me qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë.

d) si pjesë e elementit të menaxhimit të cilësisë së sistemit të menaxhimit të prodhimit, organizata e prodhimit:

1. siguron që çdo produkt, pjesë ose pajisje e prodhuar nga organizata ose nga partnerët e saj, furnizuar nga ose nënkontraktuar tek palët e jashtme, të jetë në përputhje me të dhënat e aplikueshme të projektimit dhe të jetë në gjendje për funksionim të sigurt, dhe kështu të ushtrojë privilegjet e përcaktuara në pikën 21.A.163;

2. harton, zbaton dhe mirëmban, sipas rastit, brenda objektit të miratimit, procedurat e kontrollit, për:

i) lëshimin, miratimin ose ndryshimin e dokumentit;

ii) shitësin dhe nënkontraktorin e vlerësimit të auditimit dhe kontrollit;

iii) verifikimin që produktet hyrëse, pjesët, materialet dhe pajisjet, duke përfshirë artikujt e rinj ose të përdorur, të furnizuar nga blerësit e produkteve, janë siç specifikohet në të dhënat e zbatueshme të projektimit;

iv) identifikimin dhe gjurmimin;

v) proceset e prodhimit;

vi) inspektimin dhe testimin, duke përfshirë testet e fluturimit të prodhimit;

vii) kalibrimin e veglave dhe pajisjeve të testimit;

viii) kontrollin e artikujve jo konform;

ix) koordinimin e vlefshmërisë ajrore me:

- A) aplikantin ose mbajtësin e miratimit të projektimit;
- B) personin fizik ose juridik që ka bërë një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit në përputhje me nënpjesën C të seksionit A të aneksit Ib (Pjesa 21 Light);
 - x) plotësimin dhe mbajtjen e të dhënave;
 - xi) kompetentcat dhe kualifikimet e personelit;
 - xii) lëshimin e dokumenteve të lëshimit të vlefshmërisë ajrore;
 - xiii) trajtimin, ruajtjen dhe paketimin;
 - xiv) auditimet e brendshme të cilësisë dhe veprimet korigjuese që rezultojnë;
 - xv) punën brenda kushteve të miratimit të kryer në çdo vend tjetër përveç objekteve të miratuara;
 - xvi) punën e kryer pas përfundimit të prodhimit, por përpara dorëzimit, për të ruajtur avionin në një gjendje për funksionim të sigurt;
 - xvii) lëshimin e një leje për fluturim dhe miratimin e kushteve të fluturimit përkatës.

3. përfshin dispozita specifike në procedurat e kontrollit për çdo pjesë kritike.

e) Organizata prodhuese do të krijojë, si pjesë e sistemit të menaxhimit të prodhimit, një funksion të pavarur monitorues për të verifikuar përputhjen e organizatës me kërkesat përkatëse të këtij aneksi, si dhe përputhshmërinë dhe përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit të prodhimit. Monitorimi do të përfshijë *feedback*-un (komente) ndaj personit ose grupit të personave të përmendur në pikën 21.A.145(c)(2) dhe menaxherit të përmendur në pikën 21.A.145(c)(1) për të siguruar, kur është e nevojshme, zbatimin e veprimeve korigjuese.

f) Nëse organizata prodhuese ka një ose më shumë certifikata shtesë të organizatës brenda fushës së zbatimit të VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, sistemi i menaxhimit të prodhimit mund të integrohet me çfarë kërkohet nga certifikatat shtesë të mbajtura.

21.A.139A Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit

Përveç sistemit të menaxhimit të prodhimit të kërkuar nga pika 21.A.139, organizata prodhuese do të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit në përputhje me rregullat për zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, për sa i takon kërkesave për menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me një impakt të mundshëm në sigurinë e operimeve për organizatat që mbulohen nga kjo rregullore dhe urdhri nr. 170/2022, transpozim i rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645. Kjo pikë do të zbatohet kur rregullat për sigurinë e informacionit të kenë hyrë në fuqi.

21.A.143 Manuali i organizatës së prodhimit

a) Organizata prodhuese do të krijojë dhe mirëmbajë një manual të organizatës prodhuese (EOP) që ofron drejtpërdrejt ose me referencë të kryqëzuar informacionin e mëposhtëm në lidhje me sistemin e menaxhimit të prodhimit siç përshkruhet në pikën 21.A.139:

1. Një deklaratë të nënshkruar nga menaxheri përgjegjës që konfirmon se manuali i organizatës së prodhimit dhe çdo manual tjetër shoqërues të cilët përcaktojnë pajtueshmërinë e organizatës së miratuar të prodhimit me këtë nënpjesë, janë në përputhje me të gjatë gjithë kohës.

2. Pozicionin (pozicionet) dhe emrat e menaxherëve të pranuar nga AAC-ja në përputhje me pikën 21.A.145(c)(2).

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherit (menaxherëve) siç kërkohet nga 21.A.145(c)(2) duke përfshirë çështjet me të cilat ata mund të merrren direkt me AAC-në në emër të organizatës.

4. Një strukturë organizative që tregon zinxhirin e përgjegjësive të menaxherëve siç kërkohet nga pika 21.A.145(c)(1) dhe (2).

5. Një listë të stafit certifikues siç citohet në pikën 21.A.145(d).

6. Një përshkrim të përgjithshëm të burimeve të fuqisë njerëzore.

7. Një përshkrim të përgjithshëm të objekteve që ndodhen në secilën adresë të specifikuar në certifikatën e miratimit të organizatës prodhuese.

8. Një përshkrim të përgjithshëm të qëllimit të punës së organizatës prodhuese që ka lidhje me kushtet e miratimit.

9. Procedurën për njoftimin tek AAC të ndryshimeve organizative.

10. Procedurën për amendimin e Manualit të organizatës prodhuese.

11. një përshkrim të sistemit të menaxhimit të prodhimit, politikës, proceseve dhe procedurave të parashikuara në pikën 21.A.139(c);

12. një listë e palëve të jashtme të përmendura në pikën 21.A.139(d)(1);

13. Nëse duhet të kryhen teste të fluturimit, duhet të jepet një manual i operimeve të testimit të fluturimit që përcakton politikën dhe procedurat e organizatës në lidhje me testin e fluturimit. Manuali i operimeve të testimit të fluturimit përfshin:

i) një përshkrim të proceseve të organizatës për testimin e fluturimit, duke përfshirë pjesëmarrjen e organizatës së testimit të fluturimit në procesin për lëshimin e lejes së fluturimit;

ii) politikën e ekuipazhit, duke përfshirë përbërjen, kompetencën, kohëzgjatjet dhe kufizimet kohore të fluturimit, në përputhje me shtojcën XII të këtij aneksi i (pjesa 21), aty ku është e aplikueshme;

iii) procedurat për transportimin e personave të ndryshëm nga anëtarët e ekuipazhit dhe për trajnimin e testit në fluturim, kur është e aplikueshme;

iv) një politikë për menaxhimin e rrezikut dhe menaxhimin e sigurisë në fluturim dhe metodologjitë përkatëse;

v) procedurat për identifikimin e instrumenteve dhe pajisjeve që do të kryhen;

vi) një listë me dokumentet që duhen përgatitur për testin e fluturimit.

b) Lëshimi fillestar i EOP-së do të miratohet nga AAC-ja.

c) EOP do të ndryshohet sipas nevojës në mënyrë që të mbetet një përshkrim i përditësuar i organizatës. Kopjet e çdo ndryshimi do t'i dorëzohen AAC-së.

21.A.145 Burimet

Organizata prodhuese duhet të demonstrojë se:

a) objektet, kushtet e punës, pajisjet dhe veglat, proceset dhe materialet shoqëruese, numri dhe kompetenca e personelit dhe organizimi i përgjithshëm janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj sipas pikës 21.A.165;

b) në lidhje me të gjitha të dhënat e nevojshme për vlefshmërinë ajrore dhe mbrojtjen e mjedisit:

1. organizata prodhuese merr të dhëna të tilla nga Agjencia dhe nga mbajtësi ose aplikanti i certifikatës së tipit, certifikatës së kufizuar të tipit ose miratimit të lëshuar në përputhje me këtë rregullore ose një person fizik ose juridik i cili ka hartuar një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit sipas nënpjesës C të seksionit A të aneksit Ib (Pjesa 21 Light), duke përfshirë çdo përjashtim të dhënë kundrejt kërkesave për mbrojtjen e mjedisit, për të përcaktuar përputhshmërinë me të dhënat e zbatueshme të projektimit;

2. organizata prodhuese ka hartuar një procedurë për të siguruar që të dhënat e vlefshmërisë ajrore dhe të mbrojtjes së mjedisit janë përfshirë saktë në të dhënat e saj të prodhimit;

3. të dhëna të tilla mbahen të përditësuara dhe vihen në dispozicion të gjithë personelit që ka nevojë për akses në këto të dhëna në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre.

c) në lidhje me menaxhimin dhe stafin:

1. një menaxher përgjegjës është caktuar nga organizata e prodhimit me autoritetin për të siguruar që, brenda organizatës, i gjithë prodhimi të kryhet sipas standardeve të kërkuara dhe që organizata e prodhimit të jetë vazhdimisht në përputhje me kërkesat e sistemit të menaxhimit të prodhimit të

përmendur në pikën. 21.A.139, dhe të dhënat dhe procedurat e identifikuara në EOP të referuara në pikën 21.A.143;

2. një person ose grup personash, të identifikuar, së bashku me nivelin e autoritetit që u është dhënë, është/janë emëruar nga menaxheri përgjegjës për të siguruar që organizata të jetë në përputhje me kërkesat e këtij Aneksi; ky person ose grup personash do të jetë përgjegjës para menaxherit përgjegjës dhe do të ketë akses të drejtpërdrejtë tek ai. Personi ose grupi i personave duhet të ketë njohuritë, kapacitetin dhe përvojën e duhur për të kryer përgjegjësitë e tyre;

3. personelit në të gjitha nivelet i është dhënë autoriteti i duhur për të qenë në gjendje të kryejë përgjegjësitë e caktuara dhe se ka një koordinim të plotë dhe efektiv brenda organizatës së prodhimit në lidhje me vlefshmërinë ajrore dhe çështjet e të dhënave të mbrojtjes së mjedisit;

d) në lidhje me personelin certifikues të autorizuar nga organizata prodhuese për të nënshkruar dokumentet e lëshuara sipas pikës 21.A.163 brenda objektit të kushteve të miratimit:

1. kanë njohuritë, kapacitetin e duhur (duke përfshirë funksione të tjera në organizatë) dhe përvojën për të kryer përgjegjësitë që u janë caktuar;

2. janë pajisur me dëshmi për qëllimin e autorizimit të tyre.

21.A.147 Ndryshime në sistemin e menaxhimit të prodhimit

Pas lëshimit të një certifikate të miratimit të organizatës prodhuese, çdo ndryshim në sistemin e menaxhimit të prodhimit që është i rëndësishëm për demonstrimin e konformitetit ose vlefshmërisë ajrore dhe karakteristikave të mbrojtjes së mjedisit të produktit, pjesës ose pajisjes, miratohet nga AAC-ja përpara se të zbatohet. Organizata prodhuese duhet t'i paraqesë një kërkesë për miratim AAC-së duke demonstruar se do të vazhdojë të jetë në përputhje me këtë aneks.

21.A.148 Ndryshimet e vendndodhjes

Një ndryshim i vendndodhjes së strukturave prodhuese të organizatës prodhuese të miratuar konsiderohet me rëndësi dhe prandaj duhet të jetë në përputhje me pikën 21.A.147.

21.A.149 Mundësia për t'u transferuar

Përveçse rasteve të ndryshimit të pronësisë, që konsiderohen me rëndësi për qëllimet e pikës 21.A.147, miratimi i organizatës prodhuese nuk është i transferueshëm.

21.A.151 Kushtet e miratimit

Kushtet e miratimit duhet të identifikojnë qëllimin e punës, produktet ose kategoritë e pjesëve dhe pajisjeve, ose të dyja, për të cilat mbajtësi ka të drejtë të ushtrojë privilegjet sipas pikës 21.A.163.

Këto kushte lëshohen si pjesë e një miratimi të organizatës prodhuese.

21.A.153 Ndryshimet në kushtet e miratimit

Çdo ndryshim në kushtet e miratimit miratohet nga AAC-ja. Një aplikim për një ndryshim në kushtet e miratimit duhet të bëhet sipas një forme dhe mënyre të vendosur nga AAC-ja. Aplikanti pajtohet me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë.

21.A.158 Gjetjet dhe observacionet

a) Pas marrjes së njoftimit të gjetjeve në përputhje me pikën 21.B.225, mbajtësi i certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese duhet:

1. të identifikojë shkaku(et) kryesor të mospërputhjes dhe faktorët që kontribuojnë në të;
2. të përcaktojë një plan veprimi korigjues;
3. të demonstrojë zbatimin e veprimeve korigjuese sipas rregullave të AAC-së.

b) Veprimet e përmendura në pikën (a) do të kryhen brenda periudhës së rënë dakord me atë AAC në përputhje me pikën 21.B.225.

c) Vëzhgimet e marra në përputhje me pikën 21.B.225(e) do të merren parasysh rregullisht nga mbajtësi i certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese. Organizata duhet të regjistrojë vendimet e marra në lidhje me ato vëzhgime.

21.A.159 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

a) Një certifikatë e miratimit të organizatës prodhuese do të lëshohet për një periudhë të pakufizuar kohe. Ajo do të mbetet e vlefshme me kusht që organizata prodhuese të përmbushë të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. Organizata prodhuese vazhdon të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të saj të deleguara dhe zbatuese;

2. AAC-ja lejohet nga organizata prodhuese ose nga ndonjë prej partnerëve, furnitorëve ose nënkontraktuesëve të saj të kryejë hetimet në përputhje me pikën 21.A.9;

3. Organizata prodhuese është në gjendje t’i sigurojë AAC-së prova që tregojnë se ajo mban inspektim të duhur të prodhimit të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve sipas miratimit;

4. Certifikata e miratimit të organizatës prodhuese nuk është revokuar nga AAC-ja sipas pikës 21.B.65 ose nuk është dorëzuar nga organizata prodhuese.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata e miratimit të organizatës prodhuese do t’i kthehet AAC-së.

21.A.163 Privilegjet

Në zbatim të kushteve të miratimit të lëshuara sipas pikës 21.A.135, mbajtësi i një miratimi të organizatës prodhuese mund:

a) të kryejë veprimtari prodhuese sipas këtij aneksi ose aneksit Ib (Pjesa 21 Light);

b) në rastin e avionit të plotë me certifikatë tipi dhe me paraqitjen e një deklaratë përputhshmërie (formulari 52 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) të lëshuar sipas pikave 21.A.174 dhe 21.A.204 të këtij aneksi ose sipas pikave 21L.A.143(c) dhe 21L.A.163 të aneksit Ib (Pjesa 2 Light), mund të marrë një certifikatë të vlefshmërisë ajrore të avionit dhe një certifikatë zhurme pa dëshmuar më tej;

c) në rastin e produkteve, pjesëve ose pajisjeve të tjera, të lëshojë certifikata të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) sipas këtij aneksi (Pjesa 21) ose sipas aneksit Ib (Pjesa 21 Light) pa dëshmuar më tej;

d) në rastin e një avioni që i nënshtrohet deklaratimit të përputhshmërie së projektimit sipas pikës 21L.A.43 të aneksit Ib (Pjesa 21 Light) dhe pas paraqitjes së një deklaratë përputhshmërie (forma 52 e RSH-së sipas modelit EASA-s) të lëshuar sipas pikave 21L.A.143(d) dhe 21L.A.163 të aneksit Ib (Pjesa 21 Light), mund të marrë një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore të avionit dhe një certifikatë të kufizuar të zhurmës pa dëshmuar më tej;

e) në rastin e produkteve ose pjesëve që do të instalohen në një avion që i nënshtrohet një deklaratë përputhshmërie projektimi sipas pikës 21L.A.43 të aneksit Ib (Pjesa 21 Light), mund të lëshojë certifikata të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) sipas aneksit Ib (Pjesa 21 Light) pa dëshmuar më tej;

f) të mirëmbajë një avion të ri që ka prodhuar dhe lëshon një certifikatë lejimi në shërbim (forma 53 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) në lidhje me atë mirëmbajtje;

g) sipas procedurave të rëna dakord me AAC-në për prodhimin, për një avion që ka prodhuar dhe kur vetë organizata e prodhimit kontrollon nën miratimin e saj si organizatë prodhimi, konfigurimin e avionit dhe po vërteton përputhshmërinë me kushtet e projektimit të miratuara për fluturimin, mund të lëshojë një leje për të fluturuar në përputhje me pikën 21. A.711(c) duke përfshirë miratimin e kushteve të fluturimit në përputhje me pikën 21.A.710(b).

21.A.165 Detyrimet e mbajtësit

1. Në zbatim të kushteve të miratimit të lëshuara sipas pikës 21.A.135, mbajtësi i miratimit të organizatës prodhuese:

a) siguron që dokumentacioni i organizatës prodhuese i pajisur në përputhje me pikën 21.A.143 dhe dokumentet të cilave u referohet, të përdoren si dokumente bazë pune brenda organizatës;

b) mban organizatën prodhuese në përputhje me të dhënat dhe procedurat e miratuara për miratimin e organizatës prodhuese;

c) përcakton që çdo avion i kompletuar është në përputhje me projektimin e tipit dhe është në gjendje për operim të sigurt përpara se të dorëzohet deklaratat e përputhshmërisë tek AAC-ja; ose

2. përcakton që produktet, pjesët ose pajisjet e tjera janë të plota dhe në përputhje me të dhënat e miratuara të projektimit ose të dhënat e deklaruara të projektimit dhe janë në gjendje për funksionim të sigurt përpara se të lëshohet një forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s për të vërtetuar përputhshmërinë me të dhënat e miratuara ose të deklaruara të projektimit dhe kushtet për funksionim të sigurt;

3. përveç kësaj, në rastin e kërkesave mjedisore përcakton se:

i) motori i plotë është në përputhje me kërkesat e zbatueshme për emetimet e gazrave të motorit në datën e prodhimit të motorit; dhe

ii) avioni i kompletuar është në përputhje me kërkesat e zbatueshme të emetimeve të CO₂ në datën e lëshimit të certifikatës së parë të vlefshmërisë ajrore.

4. përcakton që produktet, pjesët ose pajisjet e tjera janë në përputhje me të dhënat e zbatueshme përpara se të lëshohet formën 1 të RSH-së, sipas modelit të EASA-s si certifikatë përputhshmërie;

d) ofron ndihmë mbajtësit të certifikatës së tipit ose miratimit tjetër të projektimit ose një personi fizik ose juridik që ka deklaruar përputhshmërinë e projektimit sipas nënpjesës C të seksionit A të aneksit Ib (Pjesa 21 Light) në trajtimin e çdo veprimi të vazhdueshëm të vlefshmërisë ajrore që ka të bëjë me produktet, pjesët ose pajisjet që janë prodhuar;

e) kur, sipas kushteve të miratimit, mbajtësi synon të lëshojë një certifikatë lejimi në shërbim, përcakton se çdo avion i përfunduar i është nënshtruar mirëmbajtjes së nevojshme dhe është në gjendje për funksionim të sigurt, përpara lëshimit të certifikatës;

f) sipas rastit, sipas privilegjit të pikës 21.A.163(e), përcakton kushtet në të cilat mund të lëshohet një leje fluturimi;

g) aty ku është e zbatueshme, sipas privilegjit të pikës 21.A.163(e), përcakton përputhshmërinë me pikat 21.A.711(c) dhe (e) përpara lëshimit të një leje fluturimi për një avion;

h) të jetë në përputhje me nënpjesën A të këtij seksioni.”;

NËNPNJESA H - CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

21.A.171 Fushëveprimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për lëshimin e certifikatave të vlefshmërisë ajrore për avionët që janë në përputhje me një certifikatë tipi që është lëshuar në përputhje me këtë aneks.

21.A.172 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik në emrin e të cilit një avion është regjistruar ose do të regjistrohet në Republikën e Shqipërisë (shteti i regjistrimit), ose përfaqësuesi i tij, është i pranueshëm si një aplikant për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore për atë mjet fluturues sipas kësaj nënpjesë.

21.A.173 Klasifikimi

Certifikatat e vlefshmërisë ajrore klasifikohen si më poshtë:

a) Certifikatat e vlefshmërisë ajrore i lëshohen avionit i cili është në përputhje me certifikatën e tipit që është lëshuar sipas kërkesave të këtij aneksi I.

b) Certifikatat e kufizuara të vlefshmërisë ajrore duhet t'i lëshohen avionëve:

1. Të cilët përputhen me një certifikatë tip të kufizuar e cila është lëshuar në përputhje me këtë Aneks I; ose;

2. Të cilët i kanë treguar Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 se përputhen me specifikimet e veçanta të vlefshmërisë ajrore duke garantuar siguri operationale të mjaftueshme.

21.A.174 Aplikimi

a) Në vijim të parashikimeve të pikës 21.A.172, një aplikim për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore bëhet sipas një mënyre dhe forme të vendosur nga AAC-ja, kur Shqipëria është shteti ku është bërë regjistrimi.

b) çdo aplikim për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore duhet të përfshijë:

1. certifikatën e klasës së vlefshmërisë ajrore për të cilën aplikohet;

2. në lidhje me avionët e rinj:

i) një deklaratë përputhshmërie:

- lëshuar sipas pikës 21.A.163(b); ose

- lëshuar sipas pikës 21.A.130 dhe vërtetuar nga AAC-ja; ose

- për një avion të importuar, një deklaratë përputhshmërie të lëshuar sipas pikës 21.A.163(b) ose, në rastin e një avioni të importuar në përputhje me nenin 9(4) të kësaj rregulloreje, një deklaratë të nënshkruar nga autoriteti eksportues që avioni është në përputhje me një projektim të miratuar nga Agjencia;

ii) një raport peshe dhe bilanci me një plan ngarkese dhe;

iii) manualin e fluturimit, kur kërkohet nga specifikimet e zbatueshme të certifikimit për avionin e caktuar.

3. në lidhje me avionët e përdorur me origjinë nga:

i) një shtet anëtar, një certifikatë e rishikimit të vlefshmërisë ajrore të lëshuar në përputhje me aneksin I (Pjesa-M) ose aneksin Vb (Pjesa-ML) të rregullores së Komisionit (BE) nr. 1321/2014 mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra, i përditësuar, i transpozuar, “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, apo çdo përditësimi të tij;

ii) një shtet joanëtar:

- një deklaratë nga autoriteti kompetent i shtetit ku ndodhet avioni, ose është regjistruar, që pasqyron statusin e vlefshmërisë ajrore të avionit në regjistrin e tij në momentin e transferimit;

- një raport peshe dhe ekuilibri me një plan ngarkese;

- manualin e fluturimit nëse një manual i tillë kërkohet nga kodi i vlefshmërisë ajrore për avionin;

- të dhënat historike për të vendosur standardin e prodhimit, modifikimit dhe mirëmbajtjes së avionit, duke përfshirë të gjitha kufizimet që lidhen me një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore të lëshuar në përputhje me pikën 21.B.327;

- një rekomandim për lëshimin e një certifikate të vlefshmërisë ajrore ose certifikatës së kufizuar të vlefshmërisë ajrore dhe për një certifikatë të rishikimit të vlefshmërisë ajrore në përputhje me një rishikim të vlefshmërisë ajrore në përputhje me aneksin I (Pjesa-M) ose aneksin Vb (Pjesa-ML) të urdhrin të ministrit, “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, apo çdo përditësimi të tij që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014;

- datën në të cilën është lëshuar certifikata e parë e vlefshmërisë ajrore dhe, nëse zbatohen standardet e vëllimit III të aneksit 16 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, të dhënat e vlerës metrike të CO₂.”;

c) Me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe, deklaratat e cituara te nënparagrafët (b)(2)(i) dhe (b)(3)(ii) lëshohen jo më shumë se 60 ditë përpara prezantimit të mjetit fluturues në AAC.

21.A.175 Gjuha

Manualet, tabelat njoftuese, listat, dhe shenjat e instrumenteve dhe informacionet e tjera të nevojshme të kërkuara nga specifikimet e zbatueshme të certifikimit prezantohen në gjuhën shqipe, angleze ose në një gjuhë tjetër zyrtare të Bashkimit Evropian të pranueshme nga AAC-ja. Manualet mund të pranohen në gjuhën angleze.

21.A.177 Përmirësimi ose modifikimi

Një certifikatë e vlefshmërisë ajrore mund të përmirësohet ose modifikohet vetëm nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar, si autoriteti i vendit ku është bërë regjistrimi.

21.A.179 Mundësia për t'u transferuar dhe rilëshimi brenda vendeve anëtare të BE-së, ose në Republikën e Shqipërisë

a) Atëherë kur ka ndryshuar pronësia e një avioni:

1. Nëse ai qëndron në të njëjtin regjistër, certifikata e vlefshmërisë ajrore, ose certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore që përputhet vetëm me një certifikatë të tipit, transferohet së bashku me avionin;

2. Nëse avioni është i regjistruar në një shtet anëtar, certifikata e vlefshmërisë ajrore ose certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore që përputhet me një certifikatë të tipit të kufizuar lëshohet:

i) me paraqitjen e certifikatës së mëparshme të vlefshmërisë ajrore dhe të një certifikate të vlefshme të rishikimit të vlefshmërisë ajrore të lëshuar në përputhje me rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, aneksin I (Pjesa-M) ose aneksin Vb (Pjesa-ML) transpozuar me urdhrin e ministrit, “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”;

ii) kur plotëson pikën 21.A.175;

b) Kur pronësia e një avioni ka ndryshuar dhe avioni ka një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore që nuk përputhet me një certifikatë të tipit të kufizuar, certifikatat e vlefshmërisë ajrore do të transferohen së bashku me avionin me kusht që avioni të mbetet në të njëjtin regjistër ose të lëshohen vetëm me marrëveshje zyrtare të AAC-së, si autoriteti kompetent i Shtetit të Regjistrimit në të cilin është transferuar.

21.A.181 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

a) Një certifikatë e vlefshmërisë ajrore lëshohet për një periudhë të pakufizuar kohe. Ajo do të mbetet e vlefshme me kusht që të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. avioni vazhdon të përputhet me modelin e aplikueshëm të tipit dhe kërkesat e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore; dhe

2. Faktit nëse avioni mbetet në të njëjtin regjistër; dhe

3. Faktit nëse certifikata e tipit ose certifikata e kufizuar e tipit sipas së cilës është lëshuar nuk është bërë më parë e pavlefshme sipas pikës 21.A.51;

4. certifikata nuk është revokuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, si autoriteti i vendit ku është bërë regjistrimi, sipas pikës 21.B.65, ose nuk është dorëzuar nga mbajtësi i certifikatës.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata i kthehet Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar, si autoriteti i vendit ku është bërë regjistrimi.

21.A.182 Identifikimi i avionit

Çdo aplikant për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore sipas kësaj nënpjesë demonstroi që avioni i tij është identifikuar në përputhje me nënpjesën Q.

NËNPJESA I - CERTIFIKATAT E ZHURMËS

21.A.201 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për lëshimin e certifikatave të zhurmës për avionët që janë në përputhje me një certifikatë tipi që është lëshuar në përputhje me këtë aneks.

21.A.203 Mundësia për t'u zgjedhur

Çdo person fizik ose juridik nën emrin e të cilit është regjistruar ose do të regjistrohet një avion, në Republikën e Shqipërisë (shteti i regjistrimit), ose përfaqësuesi i atij personi, ka të drejtën të jetë një aplikant për një certifikatë zhurme për atë mjet fluturues sipas kësaj nënpyese.

21.A.204 Aplikimi

a) Në vijim të pikës 21.A.203, aplikimi për një certifikatë zhurme kryhet sipas formës dhe mënyrës të vendosur nga AAC-ja, si autoriteti i vendit ku është kryer regjistrimi.

b) çdo aplikim duhet të përfshijë:

1. në lidhje me avionët e rinj:

i) një deklaratë përputhshmërie:

- lëshuar sipas pikës 21.A.163(b); ose

- lëshuar sipas pikës 21.A.130 dhe vërtetuar nga AAC-ja; ose

- për një avion të importuar, një deklaratë përputhshmërie të lëshuar sipas pikës 21.A.163(b) ose, në rastin e një avioni të importuar në përputhje me nenin 9(4) të kësaj rregulloreje, një deklaratë të nënshkruar nga autoriteti eksportues që avioni është në përputhje me një projektim të miratuar nga Agjencia; dhe

ii) informacionin e zurmës së përcaktuar në përputhje me kërkesat e zbatueshme të zurmës;

2. në lidhje me avionët e përdorur:

i) informacionin e zurmës së përcaktuar në përputhje me kërkesat e zbatueshme të zurmës; dhe

ii) të dhënat historike për të vendosur standardin e prodhimit, modifikimit dhe mirëmbajtjes së avionit.

c) me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe, deklarata e cituar në nënparagrafin (b)(1) lëshohet jo më shumë se 60 ditë përpara prezantimit të avionit para AAC-së ku është kryer regjistrimi.

21.A.207 Përmirësimi ose modifikimi

Një certifikatë zhurme mund të ndryshohet ose modifikohet vetëm nga AAC-ja ku është kryer regjistrimi.

21.A.209 Mundësia për t'u transferuar dhe rilëshimi në një vend anëtar të BE-së

Atëherë kur pronësia e një mjeti fluturues ka ndryshuar:

a) nëse mjeti fluturues qëndron në të njëjtin regjistër, certifikata e zurmës transferohet së bashku me mjetin fluturues; ose

b) nëse mjeti fluturues zhvendoset në regjistrin e një vendi anëtar, certifikata e zurmës lëshohet me paraqitjen e certifikatës së mëparshme të zurmës.

21.A.211 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

a) Një certifikatë zhurme lëshohet për një periudhë të pakufizuar kohe. Ajo do të mbetet e vlefshme me kusht që të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. avioni vazhdon të përputhet me modelin e aplikueshëm të tipit dhe kërkesat e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore; dhe

-2. Faktit nëse avioni qëndron në të njëjtin regjistër; dhe

3. Faktit nëse certifikata e tipit ose certifikata e tipit e kufizuar sipas së cilës është lëshuar nuk është zhvleftësuar më parë sipas pikës 21.A.51.

4. certifikata nuk është revokuar nga AAC-ja sipas pikës 21.B.65, ose nuk është dorëzuar nga mbajtësi i certifikatës.

b) pas dorëzimit ose revokimit, certifikata i kthehet AAC-së ku është kryer regjistrimi.

NËNPyESA J - MIRATIMI I ORGANIZATËS SË PROJEKTIMIT

21.A.231 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për miratimin e organizatave të projektimit dhe rregullave që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre miratimeve. Në këtë nënpjesë, referencat për certifikatat e tipit përfshijnë certifikatat e tipit dhe certifikatat e tipit e kufizuar.

21.A.233 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik (“organizatë”) kualifikohet si aplikant për një miratim sipas kësaj Nënnpjesë:

a) në mënyrë që të dëshmojë përputhshmërinë me pikat 21.A.14, 21.A.112B, 21.A.432B ose 21.A.602B të këtij aneksi; ose

b) në mënyrë që të dëshmojë përputhshmërinë me pikat 21L.A.23, 21L.A.83 ose 21L.A.204 të aneksit Ib (Pjesa 21 Light); ose

c) për të marrë privilegjet sipas pikës 21.A.263 në lidhje me miratimin e ndryshimeve të vogla ose projektimit të riparimeve të vogla, ose lëshimin e deklaratave të përputhshmërisë në lidhje me ndryshimet e vogla ose projektimin e riparimeve të vogla të avionit për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit në përputhje me nënpjesën C të seksionit A, aneksi Ib (Pjesa 21 Light).”

21.A.234 Aplikimi

Çdo aplikim për një miratim të organizatës projektuese bëhet sipas formës dhe mënyrës së vendosur nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 dhe përfshin një përkthim të informacionit të kërkuar nga pika 21.A.243, si dhe kushtet e miratimit të kërkuara për t’u lëshuar sipas pikës 21.A.251.

21.A.235 Lëshimi i miratimit të organizatës projektuese

Një organizatë ka të drejtën që të ketë një miratim të organizatës projektuese të lëshuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, kur ajo të ketë demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat e zbatueshme sipas kësaj nënpjesë.

21.A.239 Sistemi i menaxhimit të projektimit

a) Organizata e projektimit do të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të projektimit që përfshin një element të menaxhimit të sigurisë dhe një element të sigurimit të projektimit me përgjegjshmëri dhe linja përgjegjësie të përcaktuara qartë në të gjithë organizatën.

b) Sistemi i menaxhimit të projektimit duhet:

1. të korrespondojë me madhësinë e organizatës dhe me natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të saj, duke marrë parasysh rreziqet dhe risqet shoqëruese në ato aktivitete;

2. të krijohet, zbatohet dhe mirëmbahet nën përgjegjësinë e një menaxheri të vetëm të emëruar sipas pikës 21.A.245 (a).

c) Si pjesë e elementit të menaxhimit të sigurisë të sistemit të menaxhimit të projektimit, organizata projektuese duhet:

1. të krijojë, zbatojë dhe mbajë një politikë sigurie dhe objektivat përkatës të sigurisë;

2. emërojë personelin kryesor të sigurisë në përputhje me pikën 21.A.245(b);

3. të krijojë, zbatojë dhe mbajë një proces të menaxhimit të rrezikut të sigurisë që përfshin identifikimin e rreziqeve të sigurisë së aviacionit që rrjedhin nga aktivitetet e tij, vlerësimin e tyre dhe menaxhimin e risqeve që lidhen me to, duke përfshirë ndërmarrjen e veprimeve për të zbutur rreziqet dhe verifikimin e efektivitetit të tyre;

4. të krijojë, zbatojë dhe mbajë një proces të garantimit të sigurisë që përfshin:

i) matjen dhe monitorimin e performancës së sigurisë së organizatës;

ii) menaxhimin e ndryshimeve në përputhje me pikat 21.A.243(c) dhe 21.A.247;

iii) parimet për përmirësimin e vazhdueshëm të elementit të menaxhimit të sigurisë;

5. të promovojë sigurinë në organizatë përmes:

i) trajnimit dhe edukimit;

ii) komunikimit;

6. të krijojë një sistem raportimi të ngjarjeve në përputhje me pikën 21.A.3A për të kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë.

d) si pjesë e elementit të sigurimit të projektimit të sistemit për menaxhimin e projektimit, organizata projektuese:

1. krijon, zbaton dhe mirëmban një sistem për kontrollin dhe mbikëqyrjen e projektimit, ndryshimeve dhe riparimeve të projektimit, të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të mbuluara nga kushtet e miratimit;

Ky sistem:

i) përfshin një funksion të vlefshmërisë ajrore përgjegjës për menaxhimin që projektimi i produkteve, pjesëve dhe pajisjeve, ose ndryshimet dhe riparimet e projektimit, të jenë në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit, specifikimet teknike në lidhje me hartimin e deklaratave, bazën e zbatueshme të certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;

ii) siguron përmbushjen e përgjegjësiave siç duhet në përputhje me këtë aneks dhe me kushtet e miratimit të dhëna sipas pikës 21.A.251;

2. krijon, zbaton dhe mirëmban një funksion të pavarur verifikimi për të dëshmuar përputhshmërinë, mbi bazën e të cilit organizata deklaron përputhshmëri me kërkesat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore, përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit; dhe

3. përcakton mënyrën me të cilën sistemi i sigurimit të projektimit llogarit pranueshmërinë e pjesëve ose pajisjeve që janë projektuar ose detyrat që kryhen nga partnerët ose nënkontraktorët e tij sipas metodave që janë objekt i procedurave të shkruara.

e) Organizata e projektimit do të krijojë, si pjesë e sistemit të menaxhimit të projektimit, një funksion të pavarur monitorues për të verifikuar përputhshmërinë e organizatës me kërkesat përkatëse të këtij aneksi, si dhe përputhshmërinë dhe përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit të projektimit. Monitorimi do të përfshijë reagime (*feedback*) ndaj personit ose grupit të personave të përmendur në pikën 21.A.245(b) dhe menaxherit të përmendur në pikën 21.A.245(a) për të siguruar, kur është e nevojshme, zbatimin e veprimit të korrigjimit

f) Nëse organizata e projektimit zotëron një ose më shumë certifikata organizative shtesë brenda objektit të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, sistemi i menaxhimit të projektimit mund të integrohet me atë që kërkohet nga certifikata(at) shtesë.

21.A.239A Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit

Përveç sistemit të menaxhimit të projektimit të kërkuar nga pika 21.A.239, organizata projektuese do të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit në përputhje me rregullat për zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, për sa i takon kërkesave për menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me një impakt të mundshëm në sigurinë e operimeve për organizatat që mbulohen nga kjo rregullore dhe urdhri nr. 170/2022, transpozim i rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645. Kjo pikë do të zbatohet kur rregullat për sigurinë e informacionit të kenë hyrë në fuqi.

21.A.243 Manual

a) Si pjesë e sistemit të menaxhimit të projektimit, organizata e projektimit duhet të krijojë dhe t'i japë Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, një manual që përshkruan, drejtpërdrejt ose me referencë të kryqëzuar, organizatën, politikën, proceset dhe procedurat e saj përkatëse, llojin e punës së projektimit, dhe kategoritë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve për të cilat organizata e projektimit ka një miratim të organizatës së projektimit, siç identifikohet në kushtet e miratimit të lëshuara në përputhje me pikën 21.A.251 dhe, sipas rastit, ndërveprimet dhe kontrollin e partnerëve të saj ose nënkontraktuesit.

Nëse do të kryhen teste fluturimi, do të krijohet dhe do t'i dorëzohet gjithashtu Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, një manual i operimeve të testimiit të fluturimit që përcakton politikat dhe procedurat e organizatës në lidhje me testet e fluturimit. Manuali i operacioneve të testimiit të fluturimit duhet të përfshijë:

1. Një përshkrim të proceseve të organizatës për testet e fluturimit, duke përfshirë pjesëmarrjen e saj në procesin e dhënies së lejes për fluturim;
2. Politika e ekuipazhit, duke përfshirë përbërjen, kompetencën, monedhën dhe kufizimet e kohës së fluturimit, në përputhje me aneksin XII, aty ku është e aplikueshme;
3. Procedurat për transportin e personave të ndryshëm nga anëtarët e ekuipazhit dhe për trajnimin e testimiit të fluturimit, kur është e aplikueshme;
4. Një politikë për menaxhimin e rrezikut dhe sigurisë dhe metodologjitë përkatëse;
5. Procedurat për identifikimin e instrumenteve dhe pajisjeve që do të barten në bord;
6. Një listë dokumentesh që duhen prodhuar për testin e fluturimit.

b) Kur ndonjë pjesë ose pajisje ose ndonjë ndryshim në produkte është projektuar nga organizata partnere ose nënkontraktuese, manuali duhet të përfshijë një deklaratë se si organizata projektuese është në gjendje të demonstrojë, për të gjitha pjesët dhe pajisjet, përputhshmërinë në përputhje me pikën 21.A.239(d)(2), dhe do të përmbajë, drejtpërdrejt ose me referencë të kryqëzuar, përshkrime dhe informacion mbi aktivitetet e projektimit dhe organizimin e organizatave partnere ose nënkontraktuesëve, sipas nevojës për të përcaktuar deklaratën.

c) Udhëzuesi do të ndryshohet sipas nevojës për të mbetur një përshkrim i përditësuar i organizatës, dhe kopjet e ndryshimeve do t'i sigurohen Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1.

d) Organizata e projektimit duhet të krijojë dhe të mbajë një deklaratë të kualifikimeve dhe përvojës së stafit drejtues dhe të personave të tjerë në organizatë që janë përgjegjës për marrjen e vendimeve që ndikojnë në vlefshmërinë ajrore, të dhënat e përshtatshmërisë operationale dhe çështjet e mbrojtjes së mjedisit. Ajo ia dorëzon deklaratën AAC-së.

21.A.245 Burimet

a) Organizata do të emërojë një drejtues të organizatës projektuese me autoritetin për të siguruar që, brenda organizatës, të gjitha aktivitetet e projektimit të kryhen sipas standardeve të kërkuara dhe që organizata projektuese të jetë vazhdimisht në përputhje me kërkesat e sistemit të menaxhimit të projektimit referuar në pikën 21.A.239 dhe procedurat e përcaktuara në manualin e përmendur në pikën 21.A.243.

b) Drejtuesi i organizatës së projektimit do të emërojë dhe specifikojë nivelin e autoritetit të:

1. Kreut të funksionit të vlefshmërisë ajrore;
2. Kreut të funksionit të pavarur të monitorimit;

3. në varësi të madhësisë së organizatës dhe natyrës dhe kompleksitetit të aktiviteteve të saj, çdo person tjetër ose grup personash që kërkohet të sigurohet që organizata të përmbush kërkesat e këtij aneksi.

c) Me përjashtim nga pika 21.A.245(b)(1), funksioni i vlefshmërisë ajrore të përmendur në pikën 21.A.239(d)(1)(i) mund të kryhet nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të drejtuesit të organizatës së projektimit në njërin nga rastet e mëposhtme:

1. kur fushëveprimi i aktiviteteve/të punës së organizatës projektuese, siç përcaktohet në kushtet e miratimit të lëshuar sipas pikës 21.A.251, kufizohet në ndryshime të vogla dhe/ose riparime të vogla;
2. për një periudhë të kufizuar kohore kur organizata projektuese nuk ka një kryetar të emëruar të funksionit të vlefshmërisë ajrore dhe ushtrimi i këtij funksioni nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të drejtuesit të organizatës së projektimit është në përpjesëtim me qëllimin dhe nivelin e aktiviteteve të organizatës.

d) Personi ose grupi i personave të emëruar në përputhje me pikën (b):

1. i përgjigjet drejtuesit të organizatës projektuese dhe të ketë akses të drejtpërdrejtë tek ai;
2. duhet të ketë njohuritë, formimin dhe përvojën e duhur për të kryer përgjegjësitë e tyre.

e) Organizata e projektimit duhet të sigurojë që:

1. Stafit në të gjitha departamentet teknike është si në numër dhe me përvojë të mjaftueshme dhe i është dhënë autoriteti i duhur për të qenë në gjendje të kryejë përgjegjësitë që i janë caktuar dhe pajisjet dhe akomodimet janë të përshtatshme për t'i mundësuar personelit të përmbushë vlefshmërinë ajrore, të dhënat e përshtatshme operationale dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit në lidhje me produktin;
2. Ekziston një koordinim i plotë dhe efikas ndërmjet departamenteve dhe brenda departamenteve në lidhje me vlefshmërinë ajrore, të dhënat e përshtatshme operationale dhe çështjet e mbrojtjes së mjedisit.

21.A.247 Ndryshime në sistemin e menaxhimit të projektimit

Pas lëshimit të miratimit të një organizate projektuese, çdo ndryshim në sistemin e menaxhimit të projektimit që është i rëndësishëm për demonstrimin e përputhshmërisë ose aftësisë ajrore, përshtatshmërisë operationale dhe mbrojtjes së mjedisit të produktit, pjesës ose pajisjes do të miratohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 përpara se të zbatohet. Organizata e projektimit do t'i paraqesë Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 një kërkesë për miratim që tregon, në bazë të ndryshimeve të propozuara në udhëzues, se do të vazhdojë të jetë në përputhje me këtë aneks.

21.A.249 Mundësia e transferimit

Përveç rezultatit të një ndryshimi në pronësi, i cili konsiderohet i rëndësishëm për qëllimet e pikës 21.A.247, një miratim i organizatës projektuese nuk është i transferueshëm.

21.A.251 Kushtet e miratimit

Kushtet e miratimit identifikojnë llojet e punës së projektimit, kategoritë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve për të cilat organizata e projektimit mban një miratim të organizatës së projektimit, dhe funksionet dhe detyrat që organizata është miratuar të kryejë në lidhje me vlefshmërinë ajrore, përshtatshmërinë operationale dhe karakteristikat mjedisore të produkteve. Për miratimet e organizatave të projektimit që mbulojnë certifikimin e tipit ose autorizimin ETSO për Njësinë Ndihmëse të Energjisë (APU), kushtet e miratimit duhet të përmbajnë gjithashtu listën e produkteve ose APU-në. Këto kushte do të lëshohen si pjesë e miratimit të një organizate projektuese.

21.A.253 Ndryshimet në kushtet e miratimit

Çdo ndryshim në kushtet e miratimit miratohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1. Aplikimi për ndryshimin e kushteve të miratimit bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1. Organizata projektuese duhet të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë.

21.A.258 Gjetje dhe observacione

a) Pas marrjes së njoftimit të gjetjeve në përputhje me pikën 21.B.433, mbajtësi i miratimit të organizatës së projektimit duhet:

1. të identifikojë shkaku(et) kryesor të mospërputhshmërisë dhe faktorët që kontribuojnë në të;
2. të krijojë një plan veprimi korigjues;
3. të demonstrojë zbatimin e veprimeve korigjuese sipas kriterëve të Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1.

b) Veprimet e përmendura në pikën (a) do të kryhen brenda periudhës së rënë dakord nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

në përputhje me pikën 21.B.433.

c) Vëzhgimet e marra në përputhje me pikën 21.B.433(e) do të merren parasysh siç duhet nga mbajtësi i miratimit të organizatës së projektimit. Organizata duhet të regjistrojë vendimet e marra në lidhje me ato vëzhgime.

21.A.259 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

a) Miratimi i organizatës së projektimit do të lëshohet për një periudhë të pakufizuar kohe. Ai do të mbetet i vlefshëm në varësi të pajtueshmërisë së organizatës projektuese me të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. organizata projektuese vazhdon të jetë në përputhje me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese; duke marrë parasysh dispozitat e pikës 21.B.433 të këtij Aneksi lidhur me trajtimin e gjetjeve;

2. mbajtësi i miratimit të organizatës së projektimit ose çdo partner ose nënkontraktues i tij pranon se AAC mund të kryejë hetime në përputhje me pikën 21.A.9;

3. Organizata e projektimit është në gjendje t’i ofrojë Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 dëshmi që tregojnë se sistemi i menaxhimit të projektimit të organizatës kontrollon dhe mbikëqyr sic duhet projektimin e produkteve, riparimeve dhe ndryshimeve të tyre sipas miratimit;

4. Certifikata nuk është revokuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 sipas pikës 21.B.65 ose nuk është dorëzuar nga organizata projektuese.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata do t’i kthehet Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1.

21.A.263 Privilegjet

a) (Qëllimisht e lënë bosh)

b) (Qëllimisht e lënë bosh)

c) Mbajtësi i miratimit të një organizate projektimi ka të drejtë, brenda objektivit të kushteve të miratimit të lëshuar sipas pikës 21.A.251 dhe sipas procedurave përkatëse të sistemit të menaxhimit të projektimit:

1. të klasifikojë ndryshimet në një certifikatë tipi ose në një certifikatë plotësuese tipi dhe projektimet e riparimit si “të mëdha” ose “të vogla”;

2. të miratojë ndryshime të vogla në një certifikatë tipi ose në një certifikatë plotësuese tipi dhe projekte riparimesh të vogla sipas këtij aneksi (Pjesa 21) ose sipas aneksit Ib (Pjesa 21 Light);

3. të deklarojë përputhshmërinë e një ndryshimi të vogël ose riparimi të vogël në projektimin e një avioni për të cilin deklaruesi ka deklaruar përputhshmërinë e projektimit sipas pikës 21L.A.43 të nënpjesës C, seksionit A, të aneksit Ib (Pjesa 21 Light);

4. të deklarojë përputhshmërinë e një projekti të ndryshuar të avionit, në përputhje me pikën 21L.A.43 të aneksit Ib (Pjesa 21 Light), në rast se personi fizik ose juridik i cili fillimisht hartoi një deklaratë përputhshmërie projektimi në lidhje me atë avion sipas pikës 21L.A.43 të aneksit Ib (Pjesa 21 Light) nuk është më aktive ose nuk i përgjigjet kërkesave për deklaratën e përputhshmërisë së ndryshimeve të projektit;

5. të miratojë disa projekte të riparimeve të mëdha sipas nënpjesës M të këtij aneksi për produktet ose njësitë ndihmëse të energjisë (APU-të);

6. të miratojë për avionë të caktuar kushtet e fluturimit në të cilat mund të lëshohet një leje fluturimi në përputhje me pikën 21.A.710(a)(2), me përjashtim të lejeve për fluturim që do të lëshohen për qëllimin e pikës 21.A. 701(a)(15);

7. të lëshojë një leje fluturimi në përputhje me pikën 21.A.711(b) për një avion që ka projektuar ose modifikuar, ose për të cilin ka miratuar, në përputhje me pikën 21.A.263(c)(6), kushtet e fluturimit në të cilat mund të lëshohet leja për të fluturuar dhe kur mbajtësi i një miratimi si organizate projektimi:

i) kontrollon konfigurimin e avionit, dhe

ii) vërteton përputhshmërinë me kushtet e projektimit të miratuara për fluturimin;

8. të miratojë disa ndryshime të mëdha në një certifikatë tipi sipas nënpjesës D të këtij aneksi ose nënpjesës D, seksioni A të aneksit Ib (Pjesa 21 Light); dhe

9. të lëshojë disa certifikata plotësuese tipi sipas nënpjesës E të këtij aneksi ose sipas nënpjesës E, seksioni A të aneksit Ib (Pjesa 21 Light) dhe të miratojë disa ndryshime të mëdha në ato certifikata.”

21.A.265 Detyrimet e mbajtësit

Mbajtësi i një miratimi të një organizate projektuese, brenda fushës së kushteve të tij të miratimit, siç përcaktohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, duhet të:

a) mirëmbajë manualin e kërkuar sipas pikës 21.A.243 në përputhje me sistemin e garantimit të projektit;

b) sigurojë që ky manual ose procedurat përkatëse të përfshira përmes referencave të kryqëzuara të përdoren si dokument pune bazë brenda organizatës;

c) të përcaktojë që projektimi i produkteve, i ndryshimeve ose riparimeve në to, përputhet me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit, specifikimet teknike në lidhje me hartimin e deklaratave, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe nuk kanë veçori të pasigurta;

d) t'i vëre në dispozicion Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 deklarata dhe dokumentacionin shoqërues që konfirmon pajtueshmërinë me pikën (c), përveç proceseve të miratimit të kryera në përputhje me pikën 21.A.263 (c);

e) t'i sigurojë Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, të dhëna dhe informacione në lidhje me veprimet e kërkuara sipas pikës 21.A.3B;

f) përcaktojë, në përputhje me pikën 21.A.263 (c) (6), kushtet sipas të cilave mund të lëshohet një leje për të fluturuar;

g) vendosë, në përputhje me pikën 21.A.263 (c) (7), pajtueshmërinë me paragrafët (b) dhe (e) të pikës 21.A.711 para lëshimit të lejes për fluturim të avionit;

h) të caktojë të dhënat dhe informacionin e lëshuar nën autoritetin e organizatës së miratuar të projektimit brenda fushëveprimit të kushteve të miratimit të saj të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 me deklaratën e mëposhtme: “Përmbajtja teknike e këtij dokumenti është miratuar nën autoritetin e DOA ref. RSH sipas EASA. 21 J.[XXXX]”

i) përputhet me nënpjesën A të këtij seksioni.

NËNPJESA K - PJESËT DHE PAJISJET

21.A.301 Qëllimi

Kjo nënpjesë vendos procedurën në lidhje me miratimin e pjesëve dhe pajisjeve.

21.A.303 Pajtueshmëria me kërkesat e zbatueshme

Vërtetimi i pajtueshmërisë së pjesëve dhe pajisjeve për t'u instaluar në një produkt me certifikatë tip bëhet:

a) në përputhje me procedurat e certifikimit të tipit të nënpjesës B, D ose E për produktin në të cilin do të instalohet; ose

b) atje ku është e zbatueshme, sipas procedurave të autorizimit ETSO të nënpjesës O; ose

c) në rastin e pjesëve standarde, në përputhje me standarde të njohura zyrtarisht.

21.A.305 Miratimi i pjesëve dhe pajisjeve

Në të gjitha rastet kur miratimi i një pjese ose pajisje kërkohet shprehimisht nga ligji i Bashkimit Evropian ose nga masat e Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, pjesa ose pajisja duhet të jetë në përputhje me ETSO-n e zbatueshme ose me specifikimet e pranuar si ekuivalente nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në rastin e veçantë.

21.A.307 Përshtatshmëria e pjesëve dhe pajisjeve për instalim

a) Një pjesë ose pajisje kualifikohet për instalim në një produkt të certifikuar tipi kur është në gjendje për funksionim të sigurt, të shënuar në përputhje me nënpjesën Q dhe të shoqëruar me një certifikatë lëshimi të autorizuar (formulari 1 i RSH-së sipas EASA), që vërteton se njësia është prodhuar në përputhje me të dhënat e miratuara të projektimit.

b) Me përjashtim të pikës (a) dhe me kusht që të plotësohen kushtet në pikën (c), pjesët ose pajisjet e mëposhtme nuk kërkojnë një Formular 1 i RSH-së sipas EASA në mënyrë që të jenë të pranueshëm për instalim në një produkt të certifikuar:

1) një pjesë standarde;

2) në rastin e ELA1 ose ELA2, një pjesë ose pajisje që është:

i) nuk është i kufizuar në periudhë vlefshmërie, as pjesë e strukturës parësore, as pjesë e kontrolleve të fluturimit;

ii) të identifikuar për instalim në aeroplanin specifik;

iii) të instalohet në një avion, pronari i të cilit ka verifikuar përputhjen me kushtet e zbatueshme në (i) dhe (ii) dhe ka pranuar përgjegjësinë për këtë përputhje;

3) një pjesë ose pajisje për të cilën pasojat e një mospërputhjeje me të dhënat e miratuara të projektimit ka një efekt të papërfillshëm sigurie në produkt dhe që identifikohet si i tillë nga mbajtësi i miratimit të projektimit në udhëzimet për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore. Për të përcaktuar efektet e sigurisë të një pjese ose pajisjeje që nuk përputhet, mbajtësi i miratimit të projektimit mund të përcaktojë në udhëzimet për vazhdimësinë e vlefshmërisë ajrore, aktivitete specifike të verifikimit që do të kryhen nga instaluesi i pjesës ose pajisjes në produkt;

4) në rastin e konstatimit të një ndryshimi standard në përputhje me pikën 21.A.90B ose një riparimi standard në përputhje me pikën 21.A.431B, një pjesë ose pajisje, për të cilën pasojat e një mospërputhjeje të dhënat e tij të projektimit kanë efekt të papërfillshëm sigurie mbi produktin, dhe i cili identifikohet si i tillë në specifikimet e certifikimit për ndryshimet standarde dhe riparimet standarde të lëshuara në përputhje me pikën (a)(2) të pikës 21.A.90B dhe pikën (a)(2) të pikës 21.A.431B. Për të përcaktuar efektet e sigurisë të një pjese ose pajisjeje që nuk përputhet, aktivitetet specifike të verifikimit që do të kryhen nga personi që instalon pjesën ose pajisjen në produkt mund të përcaktohen në specifikimet e certifikimit të përmendura më sipër;

5) një pjesë ose pajisje që përjashtohet nga miratimi i vlefshmërisë ajrore në përputhje me urdhrin nr. 80, datë 30.6.2023 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”; dhe

6) një pjesë ose pajisje që është një pjesë e një montimi më të lartë të identifikuar në pikat (b) (1) deri në (b) (5).

7) një pjesë ose pajisje e prodhuar nga një person ose organizatë e përmendur në nenin 9(4) të kësaj rregulloreje.

c) Pjesët dhe pajisjet e renditura në pikën (b) janë të pranueshme për instalim në një produkt të certifikuar pa u shoqëruar nga formulari 1 i RSH-së sipas EASA, me kusht që instaluesi të ketë një dokument të lëshuar nga personi ose organizata që ka prodhuar pjesën ose pajisjen, i cili deklaron emrin e pjesës ose pajisjes, numrin e pjesës dhe përputhshmërinë e pjesës ose pajisjes me të dhënat e projektimit dhe që përmban datën e lëshimit.

(NËNPJESA L - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

NËNPJESA M – RIPARIMET

21.A.431 Fushëveprimi

a) Kjo nënpjesë përcakton procedurën për miratimin e projektit të riparimit të një produkti, pjese ose pajisjeje dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe të mbajtësve të këtyre miratimeve.

b) Kjo nënpjesë përcakton riparimet standarde që nuk janë subjekt i një procesi miratimi sipas kësaj nënpjesë.

c) Një “riparim” nënkupton eliminimin e dëmtimit dhe/ose rikthimin në një gjendje të vlefshmërisë ajrore pas lejimit fillestar në shërbim nga prodhuesi të çdo produkti, pjese ose pajisjeje.

d) Eliminimi i dëmtimit nëpërmjet zëvendësimit të pjesëve ose pajisjeve pa nevojën e aktiviteteve të projektimit do të konsiderohet si një detyrë mirëmbajtjeje dhe për këtë arsye nuk kërkon miratim sipas këtij aneksi.

e) Një riparim ndaj një artikulli ETSO përveç njësisë ndihmëse të energjisë (APU) trajtohet si një ndryshim ndaj projektit ETSO dhe përpunohet në përputhje me pikën 21.A.611.

f) Në këtë nënpjesë, referencat për certifikatat e tipit përfshijnë certifikatat e tipit dhe certifikatat e tipit të kufizuara.

21.A.431B Riparimet standarde

a) Riparimet standarde janë riparime:

1. Në lidhje me:

i) aeroplanët me peshë maksimale ngritjeje (MTOM) 5700 kg ose më pak;

ii) helikopterët me MTOM 3175 kg ose më pak;

iii) deltaplanët dhe deltaplanët me motorë, balonat dhe aerostatet siç përcaktohet në ELA 1 dhe ELA 2.

2. që ndjekin të dhënat e projektimit të përfshira në specifikimet e certifikimit të lëshuara nga Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, që përmbajnë metoda, teknika dhe praktika të pranueshme për kryerjen dhe identifikimin e riparimeve standarde, duke përfshirë udhëzimet shoqëruese për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore; dhe

3. Që s’janë në konflikt me të dhënat e zotëruesve të certifikatës së tipit (TC).

b) Pikat 21.A.432A deri në 21.A.451 nuk janë të zbatueshme për riparimet standarde.

21.A.432A Pranueshmëria

a) Çdo person fizik ose juridik që ka demonstruar, ose është në proces demonstrimi të aftësisë së tij sipas pikës 21.A.432 B, është i pranueshëm si një aplikant për një miratim riparimi të madh të projektit sipas kushteve të parashtruara në këtë nënpjesë.

b) Çdo person fizik ose juridik është i pranueshëm të aplikojë për miratimin e një riparimi të vogël të projektit.

21.A.432B Demonstrimi i aftësisë

a) Një aplikant për një miratim të një projekti riparimi të madh duhet të demonstrojë aftësinë e tij duke mbajtur një miratim të organizatës projektuese, të lëshuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, në përputhje me nënpjesën J.

b) Me përjashtim të paragrafit (a), aplikanti mund të kërkojë miratimin e Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, për përdorimin e procedurave që përcaktojnë praktikat specifike të projektimit, burimet dhe rendin e aktiviteteve të nevojshme për t’u pajtuar me këtë nënpjesë, si një procedurë alternative për demonstrimin e aftësisë së tij.

c) Me përjashtim të paragrafit (a), në rastin e produkteve të përmendura në pikën 21.A.14 (c), një aplikant mund të demonstrojë aftësinë e tij duke marrë pranimin nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, të programit të tij të certifikimit të përcaktuar në përputhje me pikën 21.A.432C (b).

21.A.432C Kërkesa/aplikimi për miratimin e projektit të riparimit

a) Një kërkesë/aplikim për miratimin e projektit të riparimit do të bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

b) Një aplikim për miratim të projektit të riparimit të madh duhet të përfshijë ose të plotësohet pas aplikimit fillestar nga një program certifikimi që përmban:

1. një përshkrim të dëmit dhe projektit të riparimit që identifikon konfigurimin e projektit të tipit mbi të cilin bëhet riparimi;

2. një identifikim të të gjitha zonave të projektit të tipit dhe manualeve të miratuara që ndryshohen ose preken nga projekti i riparimit;

3. identifikimin e çdo ri-hetimi të nevojshëm për të demonstruar pajtueshmërinë e projektit të riparimit dhe zonave të prekura nga projekti i riparimit me bazën e certifikimit të tipit të inkorporuar përmes referencës në, sipas rastit, certifikatën e tipit, certifikatën plotësuese të tipit ose në autorizimin ETSO APU;

4. çdo ndryshim të propozuar në bazën e certifikimit të tipit, të përfshirë me referencë, sipas rastit, ose në certifikatën e tipit, certifikatën plotësuese të tipit ose autorizimin ETSO APU;

5. një propozim për ndarjen e programit të certifikimit në grupe kuptimplotë të aktiviteteve dhe të dhënave të demonstrimit të përputhshmërisë, përfshirë mjetet dhe procesin e propozuar për t'u ndjekur për të demonstruar pajtueshmërinë me pikën 21.A.433 (a) (1) dhe referencat për dokumentet përkatëse të pajtueshmërisë;

6. një propozim për vlerësimin e grupeve kuptimplota të aktiviteteve dhe të dhënave demonstruese të pajtueshmërisë, adresimin e mundshëm të një mospërputhshmërie të paidentifikuar me bazën e certifikimit të tipit dhe ndikimi i mundshëm i kësaj mospërputhshmërie mbi sigurinë e produktit. Vlerësimi i propozuar do të marrë parasysh të paktën elementet e përcaktuara në nënparagrafët (1) - (4) të pikës 21.B.100 (a). Bazuar në këtë vlerësim, aplikimi do të përfshijë një propozim për përfshirjen e Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, në verifikimin e aktiviteteve dhe të dhënave të demonstrimit të përputhshmërisë dhe të dhënat; dhe

7. specifikimi nëse të dhënat e certifikimit përgatiten plotësisht nga aplikuesi ose në bazë të një marrëveshjeje me pronarin e të dhënave të certifikimit të tipit.

21.A.433 Kërkesat për miratimin e një projekti riparimi

a) Një projekt riparimi miratohet vetëm:

1. kur është demonstruar, duke ndjekur programin e certifikimit të parashikuar në pikën 21.A.432C (b), që projekti i riparimit është në përputhje me bazën e certifikimit të tipit të integruara me anë të citimeve, sipas rastit, në certifikatën e tipit, certifikatën e tipit plotësuese ose autorizimin APU ETSO, si dhe me çdo ndryshim të përcaktuar dhe njoftuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikën 21.B.450;

2. kur është deklaruar përputhshmëria me bazën e certifikimit të tipit që zbatohet në përputhje me pikën (a) (1) dhe arsyetimet e përputhshmërisë janë regjistruar në dokumentet e përputhshmërisë;

3. kur nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi; dhe

4. kur aplikanti ka specifikuar se ka siguruar të dhënat e certifikimit mbi bazën e një marrëveshjeje me pronarin e të dhënave të certifikimit të tipit në përputhje me pikën 21.A.432C (b) (7):

i) kur mbajtësi ka treguar se nuk ka kundërshtim teknik ndaj informacionit të paraqitur në përputhje me pikën (a) (2); dhe

ii) kur mbajtësi ka rënë dakord të bashkëpunojë me mbajtësin e miratimit të projektit të riparimit për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve për ruajtjen e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të produktit të ndryshuar/modifikuar nëpërmjet përputhshmërisë me pikën 21.A.451.

5. kur, për një riparim të një aeroplani që i nënshtrohet pikës 26.302 të aneksit I të rregullores (BE) 2015/640, transpozuar me urdhrin e ministrit për miratimin e rregullores “Për specifikimet shtesë të vlefshmërisë ajrore për një tip të caktuar të operimeve” është demonstruar se integriteti strukturor i riparimit dhe strukturës së prekur është të paktën i barabartë me nivelin e integritetit strukturor të vendosur për strukturën bazë sipas pikës 26.302 të aneksit I të rregullores (BE) 2015/640.

b) Aplikanti duhet të paraqesë pranë Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 deklaratën e përmendur në germën (a) paragrafi (2) dhe, me kërkesë të këtij Autoriteti, të gjitha të dhënat justifikuese të nevojshme.

21.A.435 Klasifikimi dhe miratimi i projekteve të riparimit

a) Një projekt riparimi do të klasifikohet si “i madh” ose “i vogël” në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 21.A.91 për një ndryshim në certifikatën e tipit.

b) Një projekt riparimi klasifikohet dhe aprovohet nga:

1. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1; ose

2. një organizatë projektuese e miratuar brenda fushës së privilegjeve të saj të parashikuara në paragrafët (1), (2) dhe (5) të pikës 21.A.263 (c), siç është regjistruar në kushtet e miratimit.

21.A.439 Prodhimi i pjesëve riparuese

Pjesët dhe pajisjet për t’u përdorur për riparimin prodhohen në përputhje me të dhënat prodhuese duke u bazuar mbi të gjitha të dhënat e nevojshme projektuese të vendosura në dispozicion nga mbajtësi i miratimit të riparimit të projektit:

a) Sipas nënpjesës F; ose

b) Nga një organizatë e miratuar në mënyrën e duhur në përputhje me nënpjesën G; ose

c) Nga një organizatë mirëmbajtjeje e miratuar në mënyrën e duhur.

21.A.441 Kryerja e riparimit

a) realizimi i një riparimi do të bëhet në përputhje me aneksin I (Pjesa-M), aneksin II (Pjesa-145), aneksin Vb (Pjesa-ML) ose aneksin Vd (Pjesa-CAO) të urdhrit të ministrit “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, i ndryshuar që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, ose nga një organizatë prodhimi e miratuar në përputhje me nënpjesën G të këtij aneksi, sipas privilegjit të parashikuar në pikën 21.A.163 (d).

b) Organizata projektuese i transmeton organizatës që kryen riparimin të gjitha udhëzimet e nevojshme të instalimit.

21.A.443 Kufizimet

Një projekt i riparimit mund të miratohet duke qenë subjekt i kufizimeve, rast në të cilin miratimi i riparimit të projektit duhet të përfshijë të gjitha udhëzimet dhe kufizimet e nevojshme. Këto udhëzime dhe kufizime i transmetohen operatorit nga mbajtësi i miratimit të riparimit të projektit në përputhje me një procedurë të rënë dakord me Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

21.A.445 Dëmtim i riparuar

a) Kur një produkt, pjesë ose pajisje e dëmtuar, është lënë e riparuar dhe nuk mbulohet nga të dhëna të miratuara më parë, vlerësimi i dëmtimit për pasojat e tij mbi vlefshmërinë ajrore mund të bëhet vetëm:

1. Nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 ose

2. Nga një organizatë projektuese e miratuar siç duhet, sipas një procedure të rënë dakord me Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

Çdo kufizim i nevojshëm përpunohet në përputhje me procedurat e pikës 21.A.443.

b) Atëherë kur organizata që vlerëson dëmtimin sipas paragrafit (a) nuk është as Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, as mbajtësi i certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit të kufizuar ose mbajtësit të autorizimit APU ETSO, kjo organizatë duhet të justifikojë se informacioni mbi të cilin është bazuar vlerësimi është i mjaftueshëm qoftë nga burimet e veta të organizatës ose nëpërmjet një marrëveshjeje me mbajtësin e certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit plotësuese ose mbajtësit të autorizimit APU ETSO, ose prodhuesi, në varësi se cila nga këto është e zbatueshme.

21.A.451 Detyrimet dhe shënimi MEP

a) Çdo mbajtës i një miratimi për një riparim të madh të projektit:

1. Ndërmerr detyrat:

i) të përcaktuara në pikat 21.A.3A, 21.A.3B, 21.A.4, 21.A.5, 21.A.6, 21.A.7, 21.A.9, 21.A.439, 21.A.441 dhe 21.A.443;

ii) që nënkuptohen në bashkëpunimin midis mbajtësit të certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit plotësuese ose mbajtësit të autorizimit APU ETSO, sipas pikës 21.A.433 (b), në varësi të përshtatshmërisë.

2. Specifikon shënjinin, duke përfshirë shkronjat MEP (“Miratimi Evropian i Pjesës”), në përputhje me pikën 21.A.804(a).

b) Përveç mbajtësve të certifikatës së tipit për të cilën zbatohet pika 21.A.44, mbajtësi i miratimit për riparim të vogël të projektit:

1. të marrë përsipër detyrimet e përcaktuara në pikat 21.A.4, 21.A.5 dhe 21.A.7;

2. Specifikon shënjinin, duke përfshirë shkronjat MEP, në përputhje me pikën 21.A.804(a).

(NËNPJESA N - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

NËNPJESA O - AUTORIZIMET E URDHËRIT EVROPIAN TË STANDARDEVE TEKNIKE

21.A.601 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për dhënien e autorizimeve mbi standardet evropiane teknike (ETSO) dhe rregullat që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve ose zotëruesve të këtyre autorizimeve.

21.A.602A Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik që prodhon ose përgatitet për të prodhuar një artikull ETSO dhe që ka demonstruar ose është në proces demonstrimi të aftësisë sipas pikës 21.A.602B duhet të pranohet si aplikant për një autorizim ETSO.

21.A.602B Demonstrimi i aftësisë

Çdo aplikant për një autorizim ETSO vërteton aftësinë e tij si më poshtë:

a) Aftësinë për të prodhuar, duke marrë një miratim si organizatë prodhuese, të lëshuar në përputhje me nënpjesën G, ose duke përmbushur procedurat e nënpjesës F; dhe

b) Aftësinë për projektim:

1. Për një Njësi Ndihmëse të Energjisë (APU), duke marrë një miratim si organizatë projektimi, të lëshuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me nënpjesën J;

2. Për të gjithë artikujt e tjerë, duke përdorur procedura që përcaktojnë praktikën e veçanta të projektimit, burimet dhe sekuencat e aktiviteteve të nevojshme, të cilat janë në përputhje me këtë aneks I.

21.A.603 Aplikimi

a) Aplikimi për një autorizim ETSO bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 dhe duhet të përmbajë një përmbledhje të informacionit të kërkuar nga pika 21.A.605.

b) Kur parashikohet një seri ndryshimesh të vogla në përputhje me pikën 21.A.611, aplikanti përcakton në aplikimin e tij numrin bazë të modelit të artikullit dhe numrat e pjesëve përkatëse me kllapa të hapura pas saj për të treguar se shkronjat e ndryshimit të prapashitesës ose numrat (ose kombinimet e tyre) do të shtohen kohë pas kohe.

21.A.604 Autorizimi ETSO për një njësi ndihmëse të energjisë (APU)

Në lidhje me një autorizim ETSO për një APU:

a) me përjashtim nga pikat 21.A.9, 21.A.603, 21.A.610 dhe 21.A.621, do të zbatohen pikat e mëposhtme: pikat 21.A.15, 21.A.20, 21.A.21, 21.A.31, 21.A.33, 21.A.44, 21.A.47, 21.B.75 dhe 21.B.80. Megjithatë, një autorizim ETSO do të lëshohet në përputhje me pikën 21.A.606 në vend të certifikatës së tipit;

b) me përjashtim të pikës 21.A.611, kërkesat e nënpjesës D do të zbatohen për miratimin e ndryshimeve të projektimit nga mbajtësi i autorizimit APU ETSO, ndryshimet e projektimit nga aplikantë të tjerë të klasifikuara si një ndryshime të vogla dhe kërkesat e nënpjesës E do të zbatohen për miratimin e ndryshimeve të projektimit nga aplikantët e tjerë të klasifikuara si ndryshime të mëdha. Aty ku zbatohen kërkesat e nënpjesës E, do të lëshohet një autorizim i veçantë ETSO në vend të një certifikate tip plotësuese; dhe

c) kërkesat e nënpjesës M zbatohen për miratimin e projekteve të riparimit.

21.A.605 Kërkesat e të dhënave

a) Aplikanti paraqet pranë Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, dokumentet e mëposhtme:

1. Një program certifikimi për autorizimin ETSO, që përcakton mjetet për të demonstruar pajtueshmërinë me pikën 21.A.606 (b);

2. një deklaratë pajtueshmërie që vërteton që aplikanti ka përmbushur kërkesat e kësaj nënpjesë;

3. një deklaratë të projektimit dhe performancës (DDP), që vërteton se aplikanti ka demonstruar se artikulli përputhet me ETSO-në e zbatueshme në përputhje me programin e certifikimit;

4. një kopje të të dhënave teknike që kërkohen nga ETSO-ja e zbatueshme;

5. Prezantimin, ose një referencë për prezantimin të përmendur në pikën 21.A.143 për qëllim të marrjes së një miratimi të përshtatshëm të organizatës prodhuese sipas nënpjesës G ose manualit, ose një referencë në manual, sipas pikës 21.A.125A (b) për qëllimin e prodhimit sipas nënpjesës F pa miratimin e organizatës prodhuese;

6. për një APU, manualin ose një referencë të manualit, referuar në pikën 21.A.243 për qëllim të marrjes së një miratimi të përshtatshëm të organizatës projektuese sipas nënpjesës J;

7. për të gjithë artikujt e tjerë, procedurat ose referencën për procedurat, të referuara në pikën 21.A.602B (b) (2);

b) Aplikanti do t'i raportojë Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1, çdo vështirësi ose ngjarje të hasur gjatë procesit të miratimit që mund të ndikojë ndjeshëm në autorizimin ETSO.

21.A.606 Kërkesat për lëshimin e një autorizimi ETSO

Në mënyrë që të lëshohet një autorizim ETSO, aplikanti duhet të:

a) vërtetojë aftësinë e tij në përputhje me pikën 21.A.602B;

b) vërtetojë që artikulli përputhet me kushtet teknike të ETSO-së së zbatueshme ose me devijimet e miratuara prej tyre në përputhje me pikën 21.A.610, nëse ka;

c) të jetë në përputhje me kërkesat e kësaj nënpjesë; dhe

d) të deklarojë se nuk është identifikuar asnjë tipar ose karakteristikë që mund ta bëjë artikullin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

21.A.607 Privilegjet e autorizimit ETSO

Zotëruesi i autorizimit ETSO ka të drejtën për të prodhuar dhe shënjuar artikullin me shenjën e duhur të ETSO-s.

21.A.608 Deklarata e projektimit dhe performancës (DPP)

a) DPP-ja përmban së paku informacionin si më poshtë:

1. Informacionin e kërkuar sipas pikës 21.A.31(a) dhe (b), që përcakton artikullin dhe projektimin e tij, si dhe standardet e testimit.

2. Performancën e vlerësuar të këtij artikulli, kur është e përshtatshme, drejtpërdrejt ose duke iu referuar dokumenteve të tjera plotësuese;

3. Një deklaratë pajtueshmërie që certifikon se artikulli përmbush siç duhet ETSO-n e duhur;

4. Referencën për raportet përkatëse të testimit.

5. Referencën në manualin e mirëmbajtjes së duhur, kontrollit të përgjithshëm dhe riparimit.

6. Nivelet e pajtueshmërisë, ku nivelet të ndryshme pajtueshmërie lejohen nga ETSO.

7. Listën e devijimeve të pranuar në përputhje me pikën 21.A.610.

b) DPP-ja nënshkruhet me datën dhe firmën e mbajtësit të autorizimit ose të një përfaqësuesi të autorizuar prej tij.

21.A.609 Detyrimet e mbajtësve të autorizimeve ETSO

Mbajtësi i një autorizimi ETSO sipas kësaj nënpjesë:

a) Prodhon çdo artikull në përputhje me nënpjesën G ose nënpjesën F, që siguron se çdo artikull i përfunduar përputhet me të dhënat e tij të projektimit dhe është i sigurt për t'u instaluar.

b) të përgatisë dhe të mbajë, për çdo model të çdo njësie për të cilin është lëshuar një autorizim ETSO, një grup të përditësuar të dhënash dhe regjistrimesh të plota teknike në përputhje me pikën 21.A.5;

c) Përgatit, mban dhe përditëson kopjet origjinale të të gjitha manualeve të kërkuara nga specifikimet e vlefshmërisë ajrore të zbatueshme për artikullin;

d) Vë në dispozicion të përdoruesve të këtij neni dhe Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, sipas kërkesës, manualët e mirëmbajtjes dhe riparimit të nevojshme për përdorimin dhe mirëmbajtjen e artikullit dhe ndryshimet në ato manuale;

e) Shënjon çdo artikull në përputhje me pikën 21.A.807; dhe

f) përputhet me pikat 21.A.3A, 21.A.3B, 21.A.4 dhe 21.A.9;

g) Vazhdon të përmbushë kërkesat e kualifikimit në përputhje me pikën 21.A.602B.

21.A.610 Miratimi për devijimet

a) Çdo prodhues që kërkon miratim për të devijuar nga ndonjë standard performance të një ETSO-je demonstroi se standardet për të cilat kërkohet devijimi kompensohen nga faktorë apo karakteristika të projektimit që sigurojnë një nivel të barabartë të sigurisë.

b) Kërkesa për miratimin e devijimit, së bashku me të gjitha të dhënat përkatëse, i paraqiten Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

21.A.611 Ndryshimet e projektit

a) Mbajtësi i autorizimit ETSO mund të bëjë ndryshime të vogla në projektim (çdo ndryshim përveç ndryshimeve të mëdha) pa autorizim të mëtejshëm nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1. Në këtë rast, artikulli i ndryshuar mban numrin e modelit origjinal (ndryshimet e numrit të pjesës apo ndryshime të tjera përdoren për të identifikuar ndryshimet e vogla) dhe mbajtësi i dërgon Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 çdo të dhënë të rishikuar që nevojitet për përputhshmërinë me pikën 21.A.603(b).

b) Çdo ndryshim projekti nga mbajtësi i autorizimit ETSO, që është aq i madh sa të kërkojë një investigim të plotë për të përcaktuar përputhshmërinë me një ETSO, është një ndryshim i madh. Përpara se të bëjë një ndryshim të tillë, mbajtësi përcakton një tip ose model të ri projektimi dhe aplikon për një autorizim të ri sipas pikës 21.A.603.

c) Asnjë ndryshim i bërë nga çdo person fizik ose juridik përveç mbajtësit të autorizimit ETSO, i cili ka dorëzuar deklaratën e pajtueshmërisë për artikullin, nuk ka të drejtë për miratim sipas kësaj nënpjesë O, vetëm nëse personi që kërkon miratimin aplikon sipas pikës 21.A.603 për një autorizim ETSO të veçantë.

21.A.619 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhdueshme

a) Një autorizim ETSO do të lëshohet për një periudhë kohe të pakufizuar. Ai do të mbetet i vlefshëm me kusht që të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. Kushtet e vendosura kur është dhënë autorizimi ETSO vazhdojnë të respektohen nga aplikuesi;

2. Detyrimet e përcaktuara në pikën 21.A.609 vazhdojnë të përmbushen nga mbajtësi i autorizimit ETSO;

3. Mbajtësi i autorizimit ETSO ose ndonjë nga partnerët, furnitorët ose nënkontraktuesit e tij pranojnë se Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 mund të kryejë hetime në përputhje me pikën 21.A.9;

4. Është vërtetuar se njësisia ETSO nuk shkakton rreziqe të papranueshme në shërbim;
5. Autorizimi ETSO nuk është revokuar nga Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1 sipas pikës 21.B.65, ose nuk është dorëzuar nga mbajtësi i saj.
6. (b) Pas dorëzimit ose revokimit, autorizimi ETSO do t'i kthehet Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1.

21.A.621 Transferueshmëria

Përveç një ndryshimi në pronësinë e mbajtësit, i cili konsiderohet si një ndryshim me rëndësi, dhe prandaj duhet të përputhet me pikat 21.A.147 dhe 21.A.247 sipas rastit të zbatueshmërisë, një autorizim ETSO i lëshuar sipas këtij aneksi nuk është i transferueshëm.

NËNPJESA P -LEJA PËR FLUTURIM

21.A.701 Fushëveprimi

a) Lejet për fluturim lëshohen në përputhje me këtë nënpjesë për avionët që nuk përmbushin ose nuk kanë demonstruar të përmbushin kërkesat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore, por që janë në gjendje të fluturimit të sigurt nën kushte të përcaktuara dhe për qëllimet e mëposhtme:

1. Zhvillimi;
 2. Demonstrimi të përputhshmërisë me rregulloret ose specifikimet e certifikimit;
 3. Trajnimi të ekuipazhit të organizatave të projektimit ose prodhimit;
 4. Testimi të prodhimit në fluturim për avionët e prodhimit të ri;
 5. Fluturimi të avionit ende në prodhim, nga një facilitet prodhues të tjetri;
 6. Fluturimi të avionit për praninë nga klienti porositës;
 7. Dërgimi në destinacion ose eksportimi të avionit;
 8. Fluturimi të avionit për praninë nga Autoriteti;
 9. Studimi të tregut përfshirë trajnimin e ekuipazhit të klientit porositës;
 10. Ekspozimi dhe shfaqje ajrore;
 11. Fluturimi të avionit deri në vendin ku do të kryhet mirëmbajtja ose rishikimi i vlefshmërisë ajrore, ose në një vend magazinimi;
 12. Fluturimi të një avioni me një peshë që tejkalon peshën maksimale të certifikuar të ngritjes për fluturim përtej diapazonit normal mbi ujë, ose mbi zonat tokësore ku nuk janë në dispozicion pajisjet e duhura të uljes ose nuk është e vlefshme lënda djegëse;
 13. Thyerje rekordi, gara ajrore ose konkurrencë e ngjashme;
 14. Fluturimi të avionit që plotëson kërkesat e zbatueshme të fluturimit, përpara se të jetë konform me kërkesat mjedisore;
 15. Për aktivitetin fluturues jo-komercial me avionë individuale jo-komplekse ose tipa për të cilët nuk kërkohet një certifikatë e vlefshmërisë ajrore ose e kufizuar e vlefshmërisë ajrore.
- b) Kjo nënpjesë vendos procedurën për lëshimin e lejeve për fluturim dhe miratimin e kushteve shoqëruese për fluturim dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre lejeve dhe miratimeve të kushteve për fluturim.
16. pilotimi/drejtimi i një avioni për qëllime të zgjidhjes së problemeve ose për të kontrolluar funksionimin e një ose më shumë sistemeve, pjesëve ose pajisjeve pas mirëmbajtjes.

21.A.703 Pranueshmëria

a) Çdo person fizik ose juridik pranohet si aplikues për leje për fluturim përveç lejes për fluturim kërkuar për qëllimin e pikës 21.A.701 (a) (15) ku aplikuesi duhet të jetë vetë pronari.

b) Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën të aplikojë për miratimin e kushteve për fluturim.

21.A.707 Aplikimi për leje për fluturim

a) Në zbatim të pikës 21.A.703 dhe kur aplikantit nuk i është dhënë privilegji që të lëshojë një leje për fluturim, tek autoriteti kompetent bëhet një kërkesë për një leje për fluturim në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga ky autoritet.

b) Çdo kërkesë për një leje për fluturim përfshin:

1. Qëllimin(et) i/e fluturimit (eve), në përputhje me pikën 21.A.701;

2. Mënyrat në të cilat avioni nuk është në përputhje me kërkesat e vlefshmërisë ajrore të zbatueshme;

3. Kushtet e fluturimit të miratuara në përputhje me pikën 21.A.710.

c) Kur kushtet e fluturimit nuk janë miratuar në kohën e aplikimit për një leje për të fluturuar, një kërkesë për miratimin e kushteve për fluturim bëhet në përputhje me pikën 21.A.709.

21.A.708 Kushtet e fluturimit

Kushtet e fluturimit përfshijnë:

a) Konfigurimin(et) për të cilën(at) kërkohet leja për fluturim;

b) Çfarëdolloj kushti ose kufizimi të nevojshëm për operimin e sigurt të avionit, duke përfshirë:

1. Kushtet ose kufizimet të vendosur në itineraret ose hapësirën ajrore, ose të dyja, të nevojshme për fluturim(et);

2. Çdo kusht ose kufizim të vendosur në ekuipazhin e fluturimit për të fluturuar avionin, përveç atyre të përcaktuar në shtojcën XII të këtij aneksi I (pjesa 21);

3. Kufizimet në lidhje me transportin e personave të tjerë përveç ekuipazhit të fluturimit;

4. Kufizimet e operimit, procedurat specifike ose kushtet teknike që duhet të përmbushen;

5. Programin specifik të testimit në fluturim (nëse është i aplikueshëm);

6. Udhëzimet specifike të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore, duke përfshirë udhëzimet e mirëmbajtjes dhe regjimin nën të cilin ato do të kryhen;

c) Provën se avioni është i aftë për fluturim të sigurt sipas kushteve ose kufizimeve të pikës (b);

d) Metodën e përdorur për kontrollin e konfigurimit të avionit, në mënyrë që të mbetet brenda kushteve të vendosura.

21.A.709 Aplikimi për miratimin e kushteve të fluturimit

a) Në zbatim të pikës 21.A.707 (c) dhe kur aplikantit nuk i është dhënë privilegji që të miratojë kushtet e fluturimit, bëhet një kërkesë për miratimin e kushteve të fluturimit:

1. Tek Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, kur miratimi i kushteve të fluturimit është i lidhur me sigurinë e projektimit, në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga ky autoritet; ose

2. Tek Autoriteti kompetent, kur miratimi i kushteve të fluturimit nuk është i lidhur me sigurinë e projektimit, në formën dhe mënyrën e caktuar nga ky autoritet.

b) Çdo kërkesë për miratimin e kushteve të fluturimit përfshin:

1. Kushtet e propozuara të fluturimit;

2. Dokumentacionin në mbështetje të këtyre kushteve; dhe

3. Një deklaratë që avioni është i aftë për fluturim të sigurt, sipas kushteve ose kufizimeve të pikës 21.A.708 (b).

21.A.710 Miratimi i kushteve të fluturimit

a) Kur miratimi i kushteve të fluturimit është i lidhur me sigurinë e projektimit, kushtet e fluturimit miratohen nga:

1. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1; ose

2. Një organizatë projektimi e miratuar siç duhet sipas privilegjit të pikës 21.A.263(c)(6).

b) Kur miratimi i kushteve të fluturimit nuk është i lidhur me sigurinë e projektimit, kushtet e fluturimit miratohen nga autoriteti kompetent, ose nga organizata e miratuar, që do të lëshojë gjithashtu lejen për fluturim.

c) Para miratimit të kushteve të fluturimit, Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 apo organizata e miratuar, duhet të jenë të bindur që avioni është i aftë për fluturim të sigurt nën kushtet dhe kufizimet e specifikuar. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 mund të bëjë ose t'i kërkojë aplikantit të bëjë inspektimet ose testimet e nevojshme për këtë qëllim.

21.A.711 Lëshimi i lejes për fluturim

a) Një leje për fluturim (formulari 20a, i Republikës së Shqipërisë, sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën III) mund të lëshohet nga autoriteti kompetent sipas kushteve të specifikuar në pikën 21.B.525.

b) Një organizatë projektimi e miratuar siç duhet mund të lëshojë një leje për fluturim (formulari 20b, i Republikës së Shqipërisë, sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën IV) në bazë të privilegjit të dhënë sipas pikës 21.A.263 (c) (7), kur kushtet e fluturimit referuar në pikën 21.A.708 janë miratuar në përputhje me pikën 21.A.710.

c) Një organizatë prodhimi e miratuar siç duhet mund të lëshojë një leje për fluturim (formulari 20b, i Republikës së Shqipërisë sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën IV) në bazë të privilegjit të dhënë sipas pikës 21.A.163 (e), kur kushtet e fluturimit të referuara në pikën 21.A.708 janë miratuar në përputhje me pikën 21.A.710.

(d) Një organizatë e miratuar mund të lëshojë një leje për fluturim (formulari 20b, i Republikës së Shqipërisë, sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën IV) sipas privilegjit të dhënë në përputhje me pikën M.A.711 të aneksit I (Pjesa-M) të urdhrimit të ministrit “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, apo çdo përditësim i tij që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, ose pikës CAMO.A.125 të aneksit Vc (Pjesa-CAMO) të urdhrimit të ministrit “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, apo çdo përditësim i tij që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014 ose pika CAO.A.095 e aneksit Vd (Pjesa-CAO) të urdhrimit të ministrit “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, apo çdo përditësim i tij që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, kur kushtet e fluturimit referohen në pikën 21.A.708 të këtij aneksi janë miratuar në përputhje me pikën 21.A.710 të këtij Aneksi;

e) Leja për fluturim specifikon qëllimin(et) dhe të gjitha kushtet dhe kufizimet të cilat janë miratuar në përputhje me pikën 21.A.710.

f) Për lejet e lëshuara sipas pikave (b), (c) ose (d), një kopje e lejes për fluturim dhe e kushteve shoqëruese të fluturimit, i dorëzohet autoriteti kompetent në rastin më të parë, por jo më vonë se 3 ditë.

g) Me marrjen e dëshmisë se ndonjë nga kushtet e përcaktuara në pikën 21.A.723 (a) nuk është plotësuar për një leje për fluturim që një organizatë ka lëshuar në përputhje me pikat (b), (c) ose (d), ajo organizatë revokon menjëherë atë leje për fluturim dhe informon pa vonesë autoritetin kompetent.

21.A.713 Ndryshimet

a) Çdo ndryshim që zhvlerëson kushtet e fluturimit ose provën lidhur me to për lejen për fluturim, miratohet në përputhje me pikën 21.A.710. Kur është rasti, bëhet një aplikim në përputhje me pikën 21.A.709.

b) Një ndryshim që ndikon në përmbajtjen e lejes për të fluturuar kërkon lëshimin e lejes së re për të fluturuar në përputhje me pikën 21.A.711.

21.A.715 Gjuha

Manualet, pllakatet, listimet, shënimet e instrumenteve dhe informacionet e tjera të nevojshme të kërkuara nga specifikimet e zbatueshme të certifikimit paraqiten në një ose më shumë nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian të pranueshme nga AAC-ja dhe në gjuhën shqipe. Manualet, apo dokumente të dala nga prodhuesi apo projektuesi pranohen edhe në gjuhën angleze.

21.A.719 Transferueshmëria

a) Leja për fluturim nuk transferohet.

b) Pavarësisht pikës (a) për një leje për fluturim lëshuar për qëllim të pikës 21.A.701 (a),(15), nëse pronësia e avionit ka ndryshuar, leja për fluturim transferohet bashkë me avionin, me kusht që avioni të mbetet në të njëjtin regjistër, ose lëshohet vetëm me pëlqimin e Autoritetit Kompetent të shtetit në regjistrin e të cilit ai është transferuar.

21.A.723 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

a) Një leje fluturimi do të lëshohet për një periudhë maksimale prej 12 muajsh dhe do të mbetet e vlefshme në varësi të plotësimit të të gjitha kushteve të mëposhtme:

1. Organizata vazhdon të respektojë kushtet dhe kufizimet që lidhen me lejen për të fluturuar siç përcaktohet në pikën 21.A.711(e);

2. Mbajtësi ose ndonjë nga partnerët, furnitorët ose nënkontraktuesit e tij pranojnë se AAC-ja mund të kryejë hetime në përputhje me pikën 21.A.9;

3. Leja për fluturim nuk është hequr nga AAC-ja sipas pikës 21.B.65, ose nuk është dorëzuar nga mbajtësi i saj;

4. Avioni mbetet në të njëjtin regjistër.

b) Pavarësisht pikës (a), një leje për fluturim lëshuar për qëllim të pikës 21.A.701(a)(15) mund të lëshohet për kohëzgjatje të pacaktuar.

c) Me dorëzimin apo revokimin, leja për fluturim i kthehet autoritetit kompetent.

21.A.725 Rinovimi i lejes për fluturim

Rinovimi i lejes për fluturim bëhet si një ndryshim në përputhje me pikën 21.A.713.

21.A.727 Detyrimet e mbajtësit të një lejeje për fluturim

Mbajtësi i lejes për fluturim siguron se janë plotësuar dhe mbajtur të gjitha kushtet dhe kufizimet që lidhen me një leje për fluturim.

NËNPJESA Q - IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE, PJESËVE DHE PAJISJEVE

21.A.801 Identifikimi i produkteve

a) Identifikimi i produkteve duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

1. emri i prodhuesit;

2. emërtimi i produktit;

3. numrin serial të prodhuesit;

4. shenjën “EXEMPT” në rastin e një motori, kur AAC-ja ka dhënë një përjashtim nga kërkesat e mbrojtjes së mjedisit;

5. çdo informacion tjetër që Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, e sheh të përshtatshme.

b) Çdo person fizik apo juridik që prodhon një avion ose motor sipas nënpjesës G ose nënpjesës F, identifikon atë avion ose motor me anë të një pllake rezistente ndaj zjarrit, e cila përmban informacionin e kërkuar në paragrafin (a) të shënuar në të me gërvishtje, stampim, gdhendje, ose me një metodë tjetër të miratuar shënimi zjarrdurues. Pllaka identifikuese sigurohet në mënyrë që të jetë e arritshme dhe e lexueshme dhe nuk duhet të dëmtohet apo zhvendoset gjatë shërbimit normal, apo të humbasë ose të shkatërrohet në rast aksidenti.

c) Çdo person fizik apo juridik që prodhon helikë, teh helike, ose bosht helike sipas nënpjesës G ose nënpjesës F, e identifikon atë, me anë të një pllake, nëpërmjet gërvishtjes, stampimit, gdhendjes,

ose përmes një metode tjetër të miratuar shënimi, zjarrdurues që është vendosur në një sipërfaqe jo kritike dhe përmban informacionin e specifikuar në paragrafin (a), dhe nuk ka të ngjarë që të dëmtohet apo të hiqet gjatë shërbimit normal apo të humbasë ose të shkatërrohet në rast aksidenti.

d) Për balonat e pilotuara me drejtëm të lirë, pllaka identifikuese e përcaktuar në paragrafin (b) sigurohet në mbështjellën e balonës dhe vendoset, nëse është praktike, atje ku është e lexueshme për operatorin, gjatë kohës kur balona është fryrë. Për më tepër koshi i balonës, struktura e mbajtjes së ngarkesës dhe çdo pajisje ngrohëse duhet të jetë e shënuar në mënyrë të qëndrueshme, si dhe duhet të jetë e lexueshme me emrin e prodhuesit, numrin e pjesës, ose ekuivalentin dhe numrin e serisë ose ekuivalentin e tij.

21.A.803 Trajtimi i të dhënave të identifikimit

a) Asnjë person nuk heq, ndryshon ose vendos informacionin identifikues të referuar në pikën 21.A.801(a) në asnjë avion, motor, helikë, teh helike ose bosht helike ose në pikën 21.A.807(a) për një APU, pa miratimin e Autoritetit kompetent sipas pikës 21.1.

b) Asnjë person nuk heq ose instalon asnjë pllakë identifikuese të përcaktuar në pikën 21.A.801, ose në pikën 21.A.807 për një APU, pa miratimin e Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1.

c) Duke përjashtuar paragrafët (a) dhe (b), çdo person fizik apo juridik që kryen punë mirëmbajtëse sipas rregullave përkatëse të zbatueshme, në përputhje me metodat, teknikat dhe praktikat e përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1:

1. Heq, ndryshon ose vendos informacionin identifikues referuar në pikën 21.A.801(a) në çdo avion, motor, helikë, teh helike ose nyje helike ose në pikën 21.A.807(a) për një APU; ose

2. Heq një pllakë identifikuese të përcaktuar sipas pikës 21.A.801, ose pikës 21.A.807 për një APU, kur është e nevojshme gjatë shërbimeve të mirëmbajtjes.

d) Asnjë person nuk instalon një pllakë identifikuese të hequr në përputhje me nënparagrafin (c)(2), në një avion, motor, helikë, teh helike ose nyje helike, përveç asaj që është hequr.

21.A.804 Identifikimi i pjesëve dhe pajisjeve

a) Çdo pjesë ose pajisje që është e përshtatshme për instalim në një produkt të certifikuar duhet të shënohet në mënyrë të përhershme dhe të lexueshme me:

1. një emër, markë tregtare ose simbol që identifikon prodhuesin në një mënyrë të identifikuar nga të dhënat e aplikueshme të projektimit;

2. numrin e pjesës, siç përcaktohet në të dhënat e aplikueshme të projektimit; dhe

3. shkronjat EPA për pjesët ose pajisjet e prodhuara në përputhje me të dhënat e miratuara të projektimit që nuk i përkasin mbajtësit të certifikatës së tipit të produktit përkatës, me përjashtim të njësisve ETSO dhe për pjesët dhe pajisjet e mbuluara në pikën (b) të pikës 21.A. 307.

b) Me përjashtim të pikës (a), nëse Agjencia bie dakord që një pjesë ose pajisje është shumë e vogël ose se është ndryshe jopraktike të shënohet një pjesë ose pajisje me ndonjë nga informacionet e kërkuara nga pika (a), Dokumenti i autorizuar i lëshimit që shoqëron pjesën ose pajisjen ose kontejnerin e saj duhet të përfshijë informacionin që nuk mund të shënohet në pjesë ose pajisje.

21.A.805 Identifikimi i pjesëve kritike

Përveç kërkesave të pikës 21.A.804, çdo prodhues i një pjese që do të vendoset në një produkt me certifikim të tipit, që është identifikuar si një pjesë kritike duhet ta shënojë atë pjesë në mënyrë të lexueshme dhe të përhershme me një numër pjese dhe një numër serie.

21.A.807 Identifikimi i artikujve ETSO

a) Çdo mbajtës i një autorizimi ETSO sipas nënpjesës O shënon në mënyrë të përhershme dhe të lexueshme çdo artikull me informacionin e mëposhtëm:

1. Emrin dhe adresën e prodhuesit;

2. Emrin, tipin, numrin e pjesës ose përcaktimin e modelit për artikullin;

3. Numrin e serisë ose datën e prodhimit, ose të dyja, dhe

4. Numrin ETSO të zbatueshëm.

b) Duke përjashtuar paragrafin (a), nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 bie dakord se një pjese është shumë e vogël ose ndryshe nuk është praktike për t'u shënuar me çdo informacion të kërkuar në paragrafin (a), dokumenti i autorizuar i lejimit në shërbim që shoqëron pjesën ose kontejnerin e saj duhet të përmbajë informacionin që nuk mund të shënohet në atë pjesë.

c) Çdo person që prodhon një APU sipas nënpjesës G ose nënpjesës F identifikon atë APU me një pllakë rezistente ndaj zjarrit, që ka të gjithë informacionin e kërkuar në paragrafin (a) të shënuar me gërvishtje, stampim, gdhendje ose ndonjë metodë tjetër shënimi zjarrdurues. Pllaka identifikuese sigurohet në mënyrë të tillë që të jetë e qëndrueshme dhe mos të dëmtohet apo zhvendoset gjatë shërbimit normal ose të humbasë apo të shkatërrohet në rast aksidenti.

SEKSIONI B - PROCEDURAT PËR AUTORITETET KOMPETENTE NËNPJESA A - PARIME TË PËRGJITHSHME

21.B.10 Dokumentacioni i mbikëqyrjes

AAC-ja do t'i sigurojë personelit përkatës të gjitha aktet legjislative, standardet, rregullat, publikimet teknike dhe dokumentet përkatëse për t'i lejuar të kryejnë detyrat e tyre dhe të realizojnë përgjegjësitë e tyre.

21.B.15 Informacion për Agjencinë

a) AAC-ja do të njoftojë Agjencinë në rast të ndonjë problemi të rëndësishëm me zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe akteve të saj të deleguara dhe zbatuese brenda 30 ditëve nga momenti kur AAC-ja ka marrë dijeni për problemin.

b) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë", dhe akteve të tij të deleguara dhe zbatuese, AAC-ja do t'i japë Agjencisë sa më shpejt të jetë e mundur çdo informacion të rëndësishëm për sigurinë që rrjedh nga raportimi i ngjarjeve të ruajtura në bazën e të dhënave kombëtare në përputhje me nenin 6(6) të urdhrin të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 për miratimin e rregullores "Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë".

c) AAC-ja do t'i japë Agjencisë sa më shpejt të jetë e mundur informacione të rëndësishme sigurie që rrjedhin nga raportet e sigurisë së informacionit që ka marrë në përputhje me pikën IS.D.OR.230 të aneksit (Pjesa-IS.D.OR) të rregullores për zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil", për sa i takon kërkesave për menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me një impakt të mundshëm në sigurinë e operimeve për organizatat që mbulohen nga kjo rregullore dhe urdhri nr. 170/2022, transpozim i rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645. Kjo pikë do të zbatohet kur rregullat për sigurinë e informacionit të kenë hyrë në fuqi.

21.B. 20 Reagimi (Feedback-u) i menjëhershëm ndaj një problemi sigurie

a) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të tij, AAC-ja do të zbatojë një sistem për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë në mënyrë të përshtatshme informacionin e sigurisë.

b) Agjencia zbaton një sistem për të analizuar në mënyrë të përshtatshme çdo informacion përkatës të sigurisë të marrë dhe, kur të jetë e zbatueshme, pa vonesë të panevojshme, do t'i sigurojë AAC-së dhe Komisionit çdo informacion, duke përfshirë rekomandimet ose veprimet korrigjuese që duhet të ndërmerren, që është e nevojshme që të reagojnë në kohën e duhur ndaj një problemi sigurie që përfshin produkte, pjesë, pajisje, persona ose organizata që i nënshtrohen rregullores (EU) 2018/1139,

transpozuar në Shqipëri me VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të saj të deleguara dhe zbatuese.

c) Me marrjen e informacionit të përmendur në pikat (a) dhe (b), AAC-ja do të marrë masat e duhura për të adresuar problemin e sigurisë.

d) AAC-ja do të njoftojë menjëherë masat e marra sipas pikës (c) për të gjithë personat ose organizatat që duhet të respektojnë VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese. AAC-ja do t’i njoftojë gjithashtu këto masa Agjencisë dhe, kur kërkohet veprim i kombinuar, shteteve të tjera anëtare të interesuara

21.B.20A Reagimi i menjëhershëm ndaj një incidenti ose cenueshmërie të sigurisë së informacionit me ndikim në sigurinë në operime të aviacionit

a) AAC-ja do të zbatojë një sistem për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë siç duhet informacionin në lidhje me incidentet dhe cenueshmëritë e sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit që janë raportuar nga organizatat. Kjo do të bëhet në koordinim me çdo autoritet tjetër përkatës përgjegjës për sigurinë e informacionit ose sigurinë kibernetike brenda Shtetit Anëtar për të rritur koordinimin dhe përputhshmërinë e skemave të raportimit.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 do të zbatojë një sistem për të analizuar në mënyrë të përshtatshme çdo informacion të rëndësishëm të sigurisë të marrë në përputhje me pikën 21.B.15(c), dhe pa vonesë të panevojshme do t’u japë Shteteve të tjera dhe kur është e zbatueshme edhe Komisionit çdo informacion, duke përfshirë rekomandimet ose veprimet korrigjuese që duhen ndërmarrë, të nevojshme për ata që të reagojnë në kohën e duhur ndaj një incidenti ose cenueshmërie të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit që përfshin produkte, pjesë, pajisje të pa instaluar, persona ose organizata që i nënshtrohen VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese apo rregullores (BE) 2018/1139 dhe akteve të saj të deleguara dhe zbatuese.

c) Me marrjen e informacionit të përmendur në pikat (a) dhe (b), AAC-ja do të marrë masat e duhura për të adresuar ndikimin e mundshëm në sigurinë e aviacionit të incidentit ose cenueshmërisë së sigurisë së informacionit.

d) Masat e marra në përputhje me pikën (c) do t’u njoftohen menjëherë të gjithë personave ose organizatave që do t’i zbatojnë ato sipas VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese apo rregullores (BE) 2018/1139 dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të saj. Kur është e zbatueshme, AAC-ja do t’i njoftojë gjithashtu këto masa Agjencisë dhe, kur kërkohet veprim i kombinuar, autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare të interesuara.

21.B.25 Sistemi i menaxhimit

a) AAC-ja do të krijojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi, duke përfshirë minimalisht:

1. politikat dhe procedurat e dokumentuara për të përshkruar organizimin e tij, mjetet dhe metodat për vendosjen e përputhshmërisë me VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e deleguara dhe zbatuese. Procedurat do të mbahen të përditësuara dhe do të shërbejnë si dokumente bazë të punës brenda AAC-së për të gjitha detyrat që lidhen me të;

2. një numër të mjaftueshëm personeli për të kryer detyrat dhe për të kryer përgjegjësitë e veta. Duhet të krijohet një sistem për të planifikuar disponueshmërinë e personelit në mënyrë që të sigurohet përfundimi i duhur i të gjitha detyrave;

3. personelin që është i kualifikuar për të kryer detyrat e caktuara dhe që ka njohuritë dhe përvojën e nevojshme dhe merr trajnim fillestar dhe të përsëritur për të siguruar aftësi të vazhdueshme;

4. Facilitete të përshtatshme dhe akomodim zyresh për personelin për të kryer detyrat e caktuara;

5. Një funksion për të monitoruar përputhshmërinë e sistemit të menaxhimit me kërkesat përkatëse, dhe përshtatshmërinë e procedurave, duke përfshirë ngritjen e një procesi të auditimit të brendshëm dhe një procesi të menaxhimit të rrezikut të sigurisë. Monitorimi i përputhshmërisë do të përfshijë një sistem reagimi (*feedback*-u) të gjetjeve të auditimit për menaxhimin e lartë të AAC-së për të siguruar zbatimin e veprimeve korrigjuese sipas nevojës;

6. një person ose grup personash që kanë përgjegjësi ndaj menaxhimit të lartë të AAC-së për funksionin e monitorimit të përputhshmërisë.

b) AAC-ja, për çdo fushë të veprimtarisë, duke përfshirë sistemin e menaxhimit, cakton një ose më shumë persona me përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin e detyrës(ve) përkatëse.

c) AAC-ja do të vendosë procedura për pjesëmarrjen në një shkëmbim të ndërsjellë të të gjithë informacionit dhe asistencës së nevojshme me çdo autoritet tjetër kompetent në fjalë, qoftë nga Republika e Shqipërisë ose nga shtete të tjera, duke përfshirë:

1. të gjitha gjetjet e ngritura dhe çdo veprim pasues i ndërmarrë si rezultat i mbikëqyrjes së personave dhe organizatave që kryejnë aktivitete në territorin Republikës së Shqipërisë, por të certifikuar nga autoriteti kompetent i një Shteti tjetër ose nga Agjencia;

2. informacioni që rrjedh nga raportimi i detyrueshëm dhe vullnetar i ngjarjeve siç kërkohet nga 21.A.3A.

d) Kur është zbatueshme, një kopje e procedurave që lidhen me sistemin e menaxhimit të AAC-së dhe ndryshimet e tyre i vihen në dispozicion Agjencisë për qëllime standardizimi.

e) Përveç kërkesave të përfshira në pikën (a), sistemi i menaxhimit i krijuar dhe i mirëmbajtur nga autoriteti kompetent duhet të jetë në përputhje me aneksin I (Pjesa-IS.AR) të rregullores për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 për sa i takon kërkesave për menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me impakt të mundshëm për organizatat e mbuluara nga urdhri i ministrit “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, urdhri i ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, urdhri i ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, urdhri nr. 91, datë 21.2.2019, urdhri i ministrit nr. 193, datë 6.10.2022 dhe urdhri i ministrit nr. 119, datë 29.9.2023 dhe për autoritetet kompetente të mbuluara nga këta urdhra, transpozim i rregullores zbatuese (BE) 2023/203. Kjo pikë do të zbatohet kur rregullat për sigurinë e informacionit të kenë hyrë në fuqi.

21.B.30 Ndarja e detyrave

a) Subjekteve të kualifikuara mund t’u ndahen detyra që lidhen me certifikimin fillestar ose me mbikëqyrjen e vazhdueshme të produkteve dhe pjesëve, si dhe të personave fizikë ose juridikë që i nënshtrohen VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”. Gjatë ndarjes së detyrave, AAC-ja duhet të sigurojë që ai ka:

1. vendosur një sistem për të vlerësuar fillimisht dhe në vazhdimësi nëse subjekti i kualifikuar është në përputhje me aneksin VI të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”. Ai sistem dhe rezultatet e vlerësimeve do të dokumentohen;

2. lidhur një marrëveshje me shkrim me subjektin e kualifikuar, të miratuar nga të dyja palët në nivelin e duhur drejtues, e cila përcakton:

i) detyrat që do të kryhen;

ii) deklaratat, raportet dhe të dhënat që duhen dhënë;

iii) kushtet teknike që duhen plotësuar gjatë kryerjes së këtyre detyrave;

iv) mbulimin lidhur me detyrimin;

v) mbrojtjen që i jepet informacionit të marrë gjatë kryerjes së detyrave të tilla.

b) AAC-ja do të sigurojë që procesi i auditimit të brendshëm dhe procesi i menaxhimit të rrezikut të sigurisë, i krijuar në përputhje me pikën 21.B.25(a)(5) mbulon të gjitha detyrat e certifikimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të kryera nga subjekti i kualifikuar në emër të tij

c) Për certifikimin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së organizatës me pikat 21.A.139A dhe 21.A.239A, autoriteti kompetent mund t'u ndajë detyra subjekteve të kualifikuara në përputhje me pikën (a), ose çdo autoriteti përkatës përgjegjës për sigurinë e informacionit ose sigurinë kibernetike. Kur për ndarjen e detyrave, autoriteti kompetent siguron, që:

1) të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë e aviacionit koordinohen dhe merren parasysh nga subjekti i kualifikuar ose autoriteti përkatës;

2) rezultatet e aktiviteteve të certifikimit dhe mbikëqyrjes të kryera nga subjekti i kualifikuar ose autoriteti përkatës janë të integruara në dosjet e përgjithshme të certifikimit dhe mbikëqyrjes të organizatës;

3) sistemi i tij i menaxhimit të sigurisë së informacionit i krijuar në përputhje me pikën 21.B.25(e) mbulon të gjitha detyrat e certifikimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të kryera në emër të tij.

21.B.35 Ndryshime në sistemin e menaxhimit

a) AAC-ja do të ketë një sistem për të identifikuar ndryshimet që ndikojnë në aftësinë e tij për të kryer detyrat e tij dhe për të përmbushur përgjegjësitë siç përcaktohet në VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese. Ky sistem do t'i mundësojë AAC-së të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar që sistemi i tij i menaxhimit të mbetet i përshtatshëm dhe efektiv.

b) AAC-ja do të përditësojë në kohën e duhur sistemin e tij të menaxhimit për të pasqyruar çdo ndryshim në VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese në mënyrë që të sigurojë zbatimin efektiv të saj.

c) AAC-ja do të njoftojë Agjencinë për çdo ndryshim që ndikon në aftësinë për të kryer detyrat e tij dhe për të përmbushur përgjegjësitë e tij siç parashikohet në VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese.

21.B.55 Mbajtja e të dhënave

a) AAC-ja do të krijojë një sistem të mbajtjes së të dhënave që lejon ruajtjen e duhur, aksesueshmërinë dhe gjurmueshmërinë e besueshme të:

1. politikave dhe procedurave të dokumentuara të sistemit të menaxhimit;

2. trajnimit, kualifikimit dhe autorizimit të personelit të tij;

3. ndarjen e detyrave, duke mbuluar elementet e kërkuara nga pika 21.B.30, si dhe detajet e detyrave të caktuara;

4. proceset e certifikimit dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e organizatave të certifikuara, duke përfshirë:

i) aplikimin për një certifikatë, miratim, autorizim dhe letër marrëveshjeje;

ii) programin e mbikëqyrjes së vazhdueshme të AAC-së, duke përfshirë të gjitha vlerësimet, auditimet dhe të dhënat e inspektimit;

iii) certifikatat, miratimet, autorizimet dhe letrat e marrëveshjes të lëshuara, duke përfshirë çdo ndryshim në to;

iv) një kopje të programit të mbikëqyrjes, duke renditur datat kur janë caktuar auditimet dhe kur janë kryer.

v) kopjet e të gjithë korrespondencës formale;

vi) rekomandimet për lëshimin ose vazhdimin e një certifikate, një autorizim miratimi ose një letre marrëveshjeje, detaje të gjetjeve dhe veprimeve të ndërmarra nga organizatat për mbylljen e këtyre gjetjeve, duke përfshirë datën e mbylljes, veprimet e zbatimit dhe vëzhgimet;

vii) çdo raport vlerësimi, auditimi dhe inspektimi të lëshuar nga një autoritet tjetër kompetent në përputhje me pikat 21.B.120(d), 21.B.221(c) ose 21.B.431(c);

viii) kopjet e të gjitha ekspozive udhëzuesve ose manualeve të organizatës dhe çdo ndryshimi të tyre;

ix) kopjet e çdo dokumenti tjetër të miratuar nga AAC-ja;

5. Deklaratat e konformitetit (forma 52 e RSH-së sipas modelit të EASA-s, referojuni shtojcës VIII) dhe certifikatat e autorizuara për lejim (forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s, referojuni shtojcës I) që i ka validuar për organizatat që prodhojnë produkte, pjesë ose pajisje pa një certifikatë miratimi të organizatës prodhuese sipas nënpjesës F të seksionit A të këtij aneksi.

b) AAC-ja përfshin në mbajtjen e të dhënave:

1. dokumente që mbështesin përdorimin e mjeteve alternative të përputhshmërisë
2. informacionin e sigurisë në përputhje me pikën 21.B.15 dhe masat pasuese;
3. përdorimin e dispozitave të mbrojtjes dhe fleksibilitetit në përputhje me nenet 70, 71(1) dhe 76(4) të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”.

c) AAC-ja do të mbajë një listë të të gjitha certifikatave, miratimeve, autorizimeve dhe letrave të marrëveshjes që ka lëshuar.

d) Të gjitha të dhënat e përmendura në pikat (a), (b) dhe (c) do të mbahen për një periudhë minimale prej 5 vjetësh, duke iu nënshtuar ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

e) Të gjitha të dhënat e përmendura në pikat (a), (b) dhe (c) do t'i vihen në dispozicion, sipas kërkesës, autoriteteve kompetente të një shteti tjetër ose Agjencisë.

21.B.65 Pezullimi, kufizimi dhe revokimi

AAC-ja do të:

a) pezullojë një certifikatë, miratim, leje për fluturim, autorizim ose letër marrëveshjeje kur mendon se ka arsye të bazuara që ky veprim është i nevojshëm për të parandaluar një kërcënim të besueshëm për sigurinë e avionit;

b) pezullojë, revokojë ose kufizojë një certifikatë, miratim, leje për fluturim, autorizim ose letër marrëveshjeje nëse ky veprim kërkohet në përputhje me pikat 21.B.125, 21.B.225 ose 21.B.433;

c) të pezullojë ose të revokojë një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë zhurme nëse dëshmohet se disa nga kushtet e specifikuara në pikat 21.A.181(a) ose 21.A.211(a) nuk janë përmbushur;

d) pezullojë ose kufizojë tërësisht ose pjesërisht një certifikatë, miratim, leje për fluturim, autorizim ose letër marrëveshjeje nëse rrethanat e paparashikueshme jashtë kontrollit të AAC-së i pengojnë inspektorët e tij të kryejnë përgjegjësitë e tyre të mbikëqyrjes gjatë ciklit të planifikimit të mbikëqyrjes.

NËNPJESA B - CERTIFIKATAT E TIPIIT DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË TIPIIT

21.B.70 Specifikimet e certifikimit

Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, në përputhje respektivisht me nenin 76 (3) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, ose të rregullores se BE-së nr. 1139/2018, lëshon specifikime të certifikimit dhe specifikime të tjera të hollësishme, përfshirë specifikimet e certifikimit për vlefshmërinë ajrore, të dhënat e përshtatshmërisë operationale dhe mbrojtjes së mjedisit, që autoritetet kompetente, organizatat dhe personeli mund të përdorin për të demonstruar pajtueshmërinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve me kërkesat përkatëse thelbësore të përcaktuara në anekset II, IV dhe V të kësaj rregulloreje, si dhe me ato për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nenin 9 (2) dhe aneksin III të kësaj rregulloreje. Këto specifikime duhet të jenë mjaft të hollësishme dhe specifike për t'u treguar aplikuesve kushtet mbi bazën e të cilave do të lëshohen, ndryshohen ose plotësohen certifikatat.

21.B.75 Kushtet e veçanta

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 përshkruan specifikime teknike të veçanta në mënyrë të detajuar, të emërtuara “kushte të veçanta”, për një produkt nëse specifikimet përkatëse të certifikimit nuk përmbajnë standardet e duhura ose të përshtatshme të sigurisë për produktin sepse:

1. produkti ka karakteristika të reja ose të pazakonta të projektimit në krahasim me praktikën e projektimit mbi të cilat bazohen specifikimet e certifikimit të zbatueshme;

2. përdorimi i synuar i produktit është jokonvencional; ose

3. përvoja e produkteve të tjerë të ngjashëm në shërbim ose produkteve me karakteristika projektimi të ngjashme ose e rreziqeve të identifikuara së fundmi kanë treguar se mund të zhvillohen kushte të pasigurta.

b) Kushtet e veçanta përmbajnë standarde të tilla sigurie që Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 i çmon të nevojshme për të vendosur një nivel sigurie ekuivalente me atë të specifikimeve të certifikimit të zbatueshme.

21.B.80 Baza e certifikimit të tipit për një certifikatë tip ose certifikatë tipi të kufizuar

Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 krijon bazën e certifikimit të tipit dhe ia njofton atë aplikantit për një certifikatë tip ose certifikatë tipi të kufizuar. Baza e certifikimit të tipit përbëhet nga:

a) specifikimet e certifikimit për vlefshmërinë ajrore të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 mes atyre të zbatueshme për produktin në datën e aplikimit për këtë certifikatë, përveç nëse:

1. aplikanti zgjedh të pajtohet, ose i kërkohet të jetë në përputhje me pikën 21.A.15 (f), me specifikimet e certifikimit të cilat janë bërë të zbatueshme pas datës së aplikimit; Nëse një aplikant zgjedh të jetë në përputhje me një specifikim certifikimi i cili është bërë i zbatueshëm pas datës së aplikimit, Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 do të përfshijë në bazën e certifikimit të tipit çdo specifikim tjetër të certifikimit që lidhet drejtpërdrejtë; ose

2. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 pranon çdo alternativë ndaj një specifikimi të caktuar të certifikimit që nuk mund të respektohet, për të cilën janë gjetur faktorë kompensues që ofrojnë një nivel ekuivalent të sigurisë; ose

3. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 pranon ose përshkruan mjete të tjera që:

i) në rastin e një certifikate tip, demonstrojnë pajtueshmërinë me kërkesat thelbësore të aneksit II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1139/2018; ose

ii) në rastin e një certifikate tip të kufizuar, garantojnë një nivel sigurie të duhur në krahasim me përdorimin e synuar; dhe

b) çdo kusht të veçantë të përshkruar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në përputhje me pikën 21.B.75 (a).

21.B.82 Baza e certifikimit e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale për një certifikatë tipi avioni ose certifikatë tip të kufizuar

Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 do të vendosë bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale dhe do t’ia njoftojë atë aplikantit për një certifikatë tipi të avionit ose certifikatë tipi të kufizuar. Baza e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale duhet të konsistojë në:

a) specifikimet e certifikimit për të dhënat e përshtatshmërisë operacionale të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 në krahasim me ato që zbatohen për avionin në datën e aplikimit ose në datën e aplikimit shtesë për të dhënat e përshtatshmërisë operacionale, cilado datë është më e vonshme, përveç nëse:

1. aplikanti zgjedh të pajtohet, ose sipas pikës 21.A.15 (f) i kërkohet të jetë në përputhje me specifikimet e certifikatës të cilat janë bërë të zbatueshme pas datës së aplikimit; Nëse një aplikant zgjedh të jetë në përputhje me një specifikim të certifikimit i cili është bërë i zbatueshëm pas datës së

aplikimit, Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 do të përfshijë në bazën e certifikimit të tipit çdo specifikim tjetër të certifikimit që lidhet drejtpërdrejtë; ose

2. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 pranon ose përshkruan mjete alternative për të demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat thelbësore të anekseve II, IV dhe V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, që transpozon rregulloren e BE-së nr. 1139/2018.

b) çdo kusht të veçantë të përshkruar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, në përputhje me pikën 21.B.75 (a).

21.B.85 Përcaktimi i kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për një certifikatë tipi ose një certifikatë tipi të kufizuar

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, do të caktojë dhe njoftojë aplikantin për kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për një certifikatë tipi ose një certifikatë tipi të kufizuar për një avion ose për një certifikatë tipi për një motor. Emërtimi dhe njoftimi duhet të përmbajë:

1. kërkesat e zbatueshme të zhurmës të përcaktuara në:

i) Aneksi 16 i Konventës së Çikagos, vëllimi I, pjesa II, kapitulli 1 dhe:

A) për aeroplanët reaktivë nënsonikë, në Kapitujt 2, 3, 4 dhe 14;

B) për aeroplanët me helikë, në kapitujt 3, 4, 5, 6, 10 dhe 14;

C) për helikopterët, në kapitujt 8 dhe 11;

D) për aeroplanët supersonikë, në kapitullin 12; dhe

E) për rotorët e animit, në kapitullin 13.

ii) aneksi 16 e Konventës së Çikagos, vëllimi I:

A) Shtojca 1 për aeroplanët për të cilët zbatohen kapitujt 2 dhe 12 të aneksit 16 të Konventës së Çikagos, vëllimi I, pjesa II;

B) Shtojca 2 për aeroplanët për të cilët zbatohen kapitujt 3, 4, 5, 8, 13 dhe 14 të aneksit 16 të Konventës së Çikagos, vëllimi I, pjesa II;

C) Shtojca 3 për aeroplanët për të cilët zbatohet kapitulli 6 i aneksit 16 të Konventës së Çikagos, vëllimi I, pjesa II;

D) Shtojca 4 për aeroplanët për të cilët zbatohet kapitulli 11 i aneksit 16 të Konventës së Çikagos, vëllimi I, pjesa II; dhe

E) Shtojca 6 për aeroplanët për të cilët zbatohet kapitulli 10 i aneksit 16 të Konventës së Çikagos, vëllimi I, Pjesa II;

2. kërkesat e zbatueshme të emetimeve për parandalimin e shkarkimit të qëllimshëm të karburantit për avionët e përcaktuar në aneksin 16 të Konventës së Çikagos, vëllimi II, Pjesa II, kapitujt 1 dhe 2;

3. Kërkesat e aplikueshme për emetimet e tymit, të gazit dhe grimcave të motorit të përcaktuara në:

i) Aneksin 16 të Konventës së Çikagos, vëllimi II, Pjesa III, kapitulli 1 dhe:

A) për emetimet e tymit dhe gazit të motorëve turbojet dhe turbofanëve të destinuar për shtytje vetëm me shpejtësi nënsonike, në kapitullin 2;

B) për emetimet e tymit dhe gazit të motorëve turbojet dhe turbofanëve të destinuar për shtytje me shpejtësi supersonike, në Kapitullin 3; dhe

C) për emetimet e grimcave të motorëve turbojet dhe turbofan të destinuar për shtytje vetëm me shpejtësi nënsonike, në kapitullin 4;

ii) Aneksi 16 i Konventës së Çikagos, vëllimi II:

A) Shtojca 1 për matjen e raportit të presionit të referencës;

B) Shtojca 2 për vlerësimin e emetimeve të tymit;

C) Shtojca 3 për instrumentet dhe teknikat e matjes për emetimet e gazta;

D) Shtojca 4 për specifikimet për karburantin që do të përdoret në testimin e emetimeve të motorit të turbinave të avionëve;

E) Shtojca 5 për teknikat e instrumentimit dhe matjes për emetimet e gazrave nga motorët e turbinave me gaz pas djegies;

F) Shtojca 6 për procedurën e pajtueshmërisë për emetimet e gazit, tymit dhe grimcave; dhe

G) Shtojca 7 për instrumentet dhe teknikat e matjes për grimcat jo të paqëndrueshme;

4. kërkesat e zbatueshme për emetimet e CO₂ të avionit të përcaktuara në:

i) Aneksi 16 i Konventës së Çikagos, vëllimi III, pjesa II, kapitulli 1, dhe:

A) për aeroplanët reaktivë nënsonikë, në kapitullin 2; dhe

B) për aeroplanët nënsonikë me helikë, në kapitullin 2;

ii) Aneksi 16 i Konventës së Çikagos, vëllimi III, shtojcat 1 dhe 2, për aeroplanët për të cilët zbatohet kapitulli 2 i aneksit 16 të Konventës së Çikagos, vëllimi III, Pjesa II;

5. për motorët, kërkesat e zbatueshme në aneksin 16 të Konventës së Çikagos, vëllimi II, pjesa IV dhe Shtojca 8 në lidhje me vlerësimin e grimcave jo të paqëndrueshme për qëllime të inventarit dhe modelimit.

b) (e rezervuar).

21.B.100 Niveli i përfshirjes

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 përcakton përfshirjen e tij/saj në verifikimin e aktiviteteve demonstruese të pajtueshmërisë dhe të dhënave në lidhje me aplikimin për një certifikatë tip, certifikatë tipi të kufizuar, miratim të një ndryshimi të madh/rëndësishëm, certifikatë tipi plotësuese, miratim projekti të riparimit të madh ose autorizim ETSO për APU. Këtë do ta bëjë mbi bazën e një vlerësimi të grupeve kuptimplota të aktiviteteve demonstruese të pajtueshmërisë dhe të dhënave të programit të certifikimit. Ky vlerësim duhet të adresojë:

- probabilitetin e një mospërputhjeje të identifikuar në bazën e certifikimit të tipit, në bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale ose me kërkesat e mbrojtjes mjedisore; dhe

- ndikimin e mundshëm të kësaj mospërputhjeje mbi sigurinë e produktit ose mbrojtjen mjedisore, dhe të marrë parasysh të paktën elementët e mëposhtëm:

1. karakteristikat e reja ose të pazakonta të projektit të certifikimit, përfshirë aspektet operative, organizuese dhe menaxhuese;

2. kompleksitetin e projektit dhe / ose demonstrimin e përputhshmërisë;

3. çështjet kritike të projektit ose teknologjisë dhe rreziqet e lidhura me sigurinë dhe mjedisin, përfshirë ato të identifikuara në projekte të ngjashme; dhe

4. performancën dhe përvojën e organizimit të projektimit të aplikantit në sektorin përkatës/të interesuar.

b) Për miratimin e një projekti të riparimit të vogël, ndryshimit të vogël ose autorizimit ETSO përveç asaj për APU, Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 përcakton përfshirjen e tij/saj në nivelin e të gjithë projektit të certifikimit, duke marrë parasysh çdo karakteristikë të re ose të pazakontë, kompleksitetin e projektit dhe / ose demonstrimin e përputhshmërisë, çështjet kritike të projektit ose teknologjisë, si dhe performancën dhe përvojën e organizatës projektuese të aplikantit.

c) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 njofton aplikantin për nivelin e përfshirjes së tij/saj dhe përditëson nivelin vetjak të përfshirjes kur kjo garantohet/justifikohet nga informacioni i cili ka një ndikim të dukshëm në rrezikun e vlerësuar më parë në përputhje me pikën (a) ose (b). Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 njofton aplikantin për ndryshimin në nivelin e përfshirjes.

21.B.103 Lëshimi i një certifikate tipi ose një certifikate të kufizuar tipi

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 lëshon një certifikate tip të avionit, motorit ose helikës, ose një certifikate tipi të kufizuar për avionin, me kusht që:

1. aplikanti ka respektuar pikën 21.A.21;

2. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 njofton, përmes verifikimeve të demonstrimit të pajtueshmërisë në përputhje me përfshirjen e tij/saj të përcaktuar në përputhje me pikën 21.B.100, se

nuk ka gjetur ndonjë mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale, kur është e zbatueshme, në përputhje me pikën 21.B.82, dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit; dhe

3. asnjë tipar ose karakteristikë nuk është identifikuar që mund ta bëjë produktin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

b) Me përjashtim të pikës (a), me kërkesën e aplikuesit të përfshirë në deklaratën e përmendur në pikën 21.A.20 (d), Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 mund të lëshojë një certifikatë të tipit të avionit përpara se të jetë demonstruar përputhshmëria me bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale me kusht që aplikanti të demonstrojë këtë përputhshmëri para datës në të cilën ato këto të dhëna do të përdoren në të vërtetë.

(NËNPJESA C - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

NËNPJESA D - NDRYSHIME TË CERTIFIKATAVE TË TIPIT DHE CERTIFIKATAVE TË KUFIZUARA TË TIPIT

21.B.105 Baza e certifikimit të tipit, kërkesat e mbrojtjes mjedisore dhe baza për certifikimin e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale për një ndryshim të madh në një certifikatë të tipit

Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 vendos bazën e aplikueshme të certifikimit të tipit, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe në rastin e një ndryshimi që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale përcaktuar në përputhje me pikën 21.A.101 dhe ia njofton ato kërkuarit për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi.

21.B.107 Lëshimi i miratimit të ndryshimit të një certifikate tipi

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 lëshon një miratim të një ndryshimi në një certifikatë të tipit, me kusht që:

1. aplikanti për një miratim të ketë përmbushur:

i) pikën 21.A.95 për një ndryshim të vogël; ose

ii) pikën 21.A.97 për një ndryshim të madh;

2. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, përmes verifikimit të tij/saj të demonstrimit të përputhshmërisë mbi bazën e nivelit të përfshirjes së tij/saj të përcaktuar në përputhje me paragrafin (a) ose (b) të pikës 21.B.100 nuk ka gjetur ndonjë mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale, kur është e zbatueshme në përputhje me pikën 21.B.82, dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit; dhe

3. asnjë tipar ose karakteristikë nuk është identifikuar që mund ta bëjë produktin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

b) Në rastin e një ndryshimi që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale, me përjashtim të pikave (1) dhe (2) të paragrafit (a), mbi bazën e kërkesës së aplikantit të përfshirë në deklaratën e përmendur në pikën 21.A.20 (d), Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 mund të miratojë një ndryshim në një certifikatë të tipit të avionit përpara se të jetë demonstruar përputhshmëria me bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale, me kusht që aplikanti të demonstrojë këtë përputhshmëri përpara datës në të cilën këto të dhëna do të përdoren në të vërtetë.

c) Miratimi i ndryshimeve në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale do të përfshihet në miratimin e ndryshimit të certifikatës së tipit.

d) Miratimi i një ndryshimi në një certifikatë tipi do të kufizohet në konfigurimin(et) specifik në certifikatën tip me të cilën ka të bëjë ndryshimi.

NËNPJESA E - CERTIFIKATA PLOTËSUESE E TIPIT

Në këtë nënpjesë, referencat për certifikatat e tipit përfshijnë certifikatat e tipit dhe certifikatat e tipit të kufizuar.

21.B.109 Baza e certifikimit të tipit, kërkesat e mbrojtjes mjedisore dhe baza për certifikimin e të dhënave të përshtatshmërisë operationale për certifikatën tip plotësuese

Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 vendos bazën e aplikueshme të certifikimit të tipit, kërkesat e mbrojtjes së mjedisit dhe, në rastin e një ndryshimi që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operationale, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale të përcaktuar në përputhje me pikën 21.A.101 dhe ia njofton ato kërkuarit për një certifikatë plotësuese e tipit.

21.B.111 Lëshimi i një certifikate plotësuese e tipit

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 lëshon një certifikatë plotësuese e tipit, me kusht që:

1. aplikanti të ketë respektuar pikën 21.A.115 (b);

2. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, përmes verifikimit të tij/saj të demonstrimit të përputhshmërisë mbi bazën e nivelit të përfshirjes së tij/saj të përcaktuar në përputhje me pikën 21.B.100 (a), nuk ka gjetur ndonjë mospërputhje me bazën e certifikimit, bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale kur është e zbatueshme në përputhje me pika 21.B.82, dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit; dhe

3. asnjë tipar ose karakteristikë nuk është identifikuar që mund ta bëjë produktin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

b) Në rastin e një certifikate plotësuese të tipit që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operationale, me përjashtim të pikave (1) dhe (2) të paragrafit (a), me kërkesën e aplikantit të përfshirë në deklaratën e përmendur në pikën 21.A.20 (d), Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 mund të lëshojë një certifikatë plotësuese të tipit para se të jetë demonstruar përputhshmëria me bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operationale, me kusht që aplikanti ta demonstrojë këtë përputhshmëri para datës në të cilën këto të dhëna do të përdoren në të vërtetë.

c) Miratimi i ndryshimeve në të dhënat e përshtatshmërisë operationale do të përfshihet në certifikatën plotësuese të tipit.

d) Certifikata plotësuese e tipit do të jetë e kufizuar në konfigurimin (et) specifik në certifikatën e tipit të cilës i referohet modifikimi kryesor përkatës.

21.B.115 Mjetet e përputhshmërisë

a) Agjencia do të zhvillojë mjete të pranueshme përputhshmërie ("AMC") që mund të përdoren për të përcaktuar përputhshmërinë me rregulloren (BE) 2018/1139 transpozuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 "Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil". Autoriteti i Aviacionit Civil pranon AMC-në e Agjencisë për të përcaktuar përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 "Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe aktet e saj të deleguara e zbatuese.

b) Mjetet alternative të përputhshmërisë mund të përdoren për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë rregullore.

c) Kur është zbatueshme, AAC-ja do të informojnë Agjencinë për çdo mjet alternativ përputhshmërie të përdorur nga organizatat nën mbikëqyrjen e tij ose nga vetë ai për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë rregullore.

NËNPJESA F - PRODHIMI PA MIRATIMIN E ORGANIZATËS PRODHUESE

21.B.120 Procedura fillestare e certifikimit

a) Pas marrjes së një aplikimi për lëshimin e një letre marrëveshjeje me qëllim të demonstrimit të konformitetit të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve individuale, AAC-ja do të verifikojë përputhjen e aplikantit me kërkesat e zbatueshme.

b) AAC-ja do të regjistrojë të gjitha gjetjet e nxjerra, veprimet e mbylljes, si dhe rekomandimet për lëshimin e letrës së marrëveshjes.

c) AAC-ja do t'i konfirmojë aplikantit me shkrim të gjitha gjetjet e ngritura gjatë verifikimit. Për certifikimin fillestar, të gjitha gjetjet duhet të korrigjohen sipas rregullave të AAC-së përpara se të lëshohet letra e marrëveshjes.

d) Kur bindet se aplikanti përputhet me kërkesat e zbatueshme, AAC-ja do të lëshojë letrën e marrëveshjes (forma 65 e RSH-së sipas modelit të EASA-s (referojuni shtojcës XI).

e) Letra e marrëveshjes do të përmbajë objektin e marrëveshjes, një datë përfundimi dhe, kur është e zbatueshme, kufizimet e duhura.

f) Kohëzgjatja e letrës së marrëveshjes nuk duhet të kalojë 1 vit.

21.B.125 Gjetjet dhe veprime korrigjuese; vëzhgimet

a) AAC-ja do të ketë një sistem për të analizuar gjetjet për rëndësinë e tyre të sigurisë.

b) Një gjetje e nivelit 1 do të lëshohet nga AAC-ja kur zbulohen mospërputhje të rëndësishme me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, me procedurat dhe manualët e organizatës, ose me kushtet e letrës së marrëveshjes që ul sigurinë ose rrezikon seriozisht sigurinë e fluturimit.

Gjetjet e nivelit 1 do të përfshijnë gjithashtu:

1. Mosdhënënia akses AAC-së në objektet e organizatës të përmendura në pikën 21.A.9 gjatë orarit normal të punës dhe pas dy kërkesave me shkrim;

2. Marrja e letrës së marrëveshjes ose ruajtja e vlefshmërisë së saj nëpërmjet falsifikimit të provave dokumentare të paraqitura; dhe

3. Çdo dëshmi për keqpërdorim ose përdorim mashtrimi të letrës së marrëveshjes.

c) Një gjetje e nivelit 2 do të lëshohet nga AAC-ja kur zbulohen mospërputhje me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, me procedurat dhe manualët e organizatës, ose me kushtet e letrës së marrëveshjes, e cila nuk klasifikohet si gjetje e nivelit 1.

d) Kur një gjetje zbulohet gjatë mbikëqyrjes ose ndonjë mënyrë tjetër, AAC-ja, pa cenuar asnjë veprim shtesë të kërkuar nga VKM-ja nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, do t'ia komunikojë me shkrim gjetjen organizatës dhe të kërkojë veprime korrigjuese për të adresuar mospërputhjet e identifikuara. Kur një gjetje e nivelit 1 lidhet drejtpërdrejt me një avion, AAC-ja informon autoritetin kompetent të shtetit në të cilin është regjistruar avioni.

1. Nëse ka ndonjë gjetje të nivelit 1, AAC-ja, do të ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe të përshtatshme për të ndaluar ose kufizuar aktivitetet e organizatës së përfshirë dhe, nëse është e përshtatshme, do të ndërmarrë veprime për të revokuar letrën e marrëveshjes ose për ta kufizuar ose pezulluar tërësisht ose pjesërisht, në varësi të shtrirjes së gjetjes së nivelit 1, derisa organizata të ketë ndërmarrë veprime korrigjuese të suksesshme.

2. Nëse ka gjetje të nivelit 2, AAC-ja, do:

i) t'i japë organizatës një periudhë zbatimi të veprimeve korrigjuese që është e përshtatshme për natyrën e gjetjes dhe që në çdo rast fillimisht nuk duhet të jetë më shumë se 3 muaj. Periudha do të fillojë nga data e komunikimit me shkrim të gjetjes drejt organizatës, duke kërkuar veprime korrigjuese për të adresuar mospërputhshmërinë e identifikuar. Në fund të kësaj periudhe, dhe në varësi të natyrës

së gjetjes, AAC-ja mund të zgjasë periudhën 3-mujore me kusht që të jetë rënë dakord për një plan veprimi korigjues;

ii) të vlerësojë planin e veprimit korigjues dhe planin e zbatimit të propozuar nga organizata, dhe nëse vlerësimi arrin në përfundimin se janë të mjaftueshme për të adresuar mospërputhjen, i pranon;

iii) nëse organizata dështon të paraqesë një plan veprimi korigjues të pranueshëm, ose nuk arrin të kryejë veprimin korigjues brenda periudhës kohore të pranuar ose të zgjatur nga AAC-ja, gjetja do të kalojë si gjetje e nivelit 1 dhe do të ndërmerren veprime siç përcaktohet në pikën (f) (1) (i).

e) AAC-ja, mund të kërkojë të kryhen vëzhgime për cilindo nga rastet e mëposhtme që nuk kërkojnë gjetje të nivelit 1 ose të nivelit 2:

1. për çdo njësi, performanca e të cilit është vlerësuar si joefektive;

2. kur është identifikuar se një njësi ka potencialin të shkaktojë një mospërputhje sipas pikave (b) ose (c);

3. kur sugjerimet ose përmirësimet janë me interes për performancën e përgjithshme të sigurisë të organizatës.

Vëzhgimet e nxjerra sipas kësaj pike do t'i komunikohen me shkrim organizatës dhe do të regjistrohen nga AAC-ja.

21.B.135 Ruajtja e letër marrëveshjes

AAC-ja ruan letër marrëveshjen për aq kohë sa:

a) Prodhuesi përdor në mënyrën e duhur formën 52 të Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s (shih shtojcën VIII) si një deklaratë pajtueshmërie për avionin e kompletuar dhe formën 1 të Republikës së Shqipërisë sipas modelit të EASA-s (shih shtojcën) për produktet e tjera përveç avionëve, si pjesë dhe pajisje, dhe

b) Inspektimet e bëra nga AAC-ja përpara miratimit të formës 52, sipas EASA-s ose formularit 1, sipas EASA-s, sipas pikës 21.A.130(c) nuk tregojnë ndonjë mos pajtueshmëri me kërkesat dhe proceduarat që përmban manuali i siguruar nga prodhuesi, ose mungesë pajtueshmërie të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve përkatëse. Këto inspektime duhet së paku të kontrollojnë se:

1. Marrëveshja mbulon produktin, pjesën ose pajisjen që po miratohet dhe mbetet e vlefshme.

2. Manuali i përshkruar në pikën 21.A.125(b) dhe ndryshimet në statusin e tij të referuar në letër marrëveshje, përdoren si një dokument kryesor pune nga prodhuesi; në të kundërt, inspektimi nuk duhet të vazhdojë dhe për rrjedhojë certifikatat e lejimit në shërbim nuk miratohen;

3. Prodhimi është realizuar sipas kushteve të përshkruara në letër marrëveshje dhe është kryer në mënyrë të kënaqshme;

4. Inspektimet dhe testimet (përfshi edhe testimet në fluturim, nëse duhen) sipas pikave 21.A.130(b)(2) dhe/ose (b)(3), janë realizuar sipas kushteve të përshkruara në letër marrëveshje dhe janë kryer në mënyrë të kënaqshme;

5. Inspektimet nga AAC-ja të përshkruara ose përmendura në letër marrëveshje janë kryer dhe konsiderohen të pranueshme;

6. Deklarata e pajtueshmërisë në përputhje me pikën 21.A.130, dhe informacioni i siguruar nga kjo deklaratë nuk pengon miratimin e saj; dhe

c) Nuk ka arritur ndonjë datë përfundimi të letër marrëveshjes.

21.B.140 Ndryshimi i një letër marrëveshjeje

a) AAC-ja duhet të investigojë, kur është e nevojshme, në përputhje me pikën 21.B.120, çdo ndryshim në letër marrëveshje.

b) Kur AAC-ja bindet se kërkesat e seksionit A, nënpjesa F, vazhdojnë të jenë në pajtueshmëri me të, ai ndryshon letër marrëveshjen sipas rrethanave.

21.B.215 Mjetet e përputhshmërisë

a) Agjencia do të zhvillojë mjete të pranueshme të përputhshmërisë (“AMC”) që mund të përdoren për të përcaktuar përputhshmërinë me rregulloren (BE) 2018/1139 transpozuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”. Autoriteti i Aviacionit Civil pranon AMC-në e Agjencisë për të përcaktuar përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara e zbatuese..

b) Mjetet alternative të përputhshmërisë mund të përdoren për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë rregullore.

c) Kur është e zbatueshme, AAC-ja do të informojnë Agjencinë për çdo mjet alternativ përputhshmërie të përdorur nga organizatat nën mbikëqyrjen e tij ose nga vetë ai për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë rregullore.

21.B.220 Procedura fillestare e certifikimit

a) Me marrjen e një aplikimi për lëshimin fillestar të një certifikate të miratimit të organizatës prodhuese, AAC-ja do të verifikojë përputhjen e aplikantit me kërkesat e zbatueshme.

b) Një takim me menaxherin përgjegjës të aplikantit do të thirret të paktën një herë gjatë hetimit për certifikimin fillestar për të siguruar që ky person e kupton rolin dhe përgjegjësinë e tij/saj.

c) AAC-ja regjistron të gjitha gjetjet e nxjerra, veprimet e mbylljes, si dhe rekomandimet për lëshimin e certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese.

d) AAC-ja do t’i konfirmojë aplikantit me shkrim të gjitha gjetjet e ngritura gjatë verifikimit. Për certifikimin fillestar, të gjitha gjetjet duhet të korrigjohen sipas rregullave të AAC-së përpara se të lëshohet certifikata.

e) Kur bindet se aplikanti është në përputhje me kërkesat e zbatueshme, AAC-ja do të lëshojë certifikatën e miratimit të organizatës prodhuese (forma 55 e RSH-së sipas modelit të EASA-s, ref. shtojcës X).

f) Numri i referencës së certifikatës do të përfshihet në formën 55 të RSH-së, sipas modelit të EASA-s në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia.

g) Certifikata do të lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Privilegjet dhe qëllimi i aktiviteteve që organizata është miratuar të kryejë, duke përfshirë çdo kufizim sipas rastit, do të specifikohen në kushtet e miratimit bashkëngjitur certifikatës.

21.B.221 Parimet e mbikëqyrjes

a) Autoriteti kompetent do të verifikojë:

1. përputhshmërinë me kërkesat që janë të zbatueshme për organizatat, përpara lëshimit të certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese;

2. përputhshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme të organizatave që ka certifikuar;

3. zbatimin e masave të duhura të sigurisë të mandatuara nga AAC-ja sipas pikave 21.B.20(c) dhe (d).

b) Ky verifikim do të:

1. mbështetet nga dokumentacioni i synuar posaçërisht për t’i siguruar personelit përgjegjës për mbikëqyrjen, udhëzime për kryerjen e funksioneve të tyre;

2. sigurojë organizatave të interesuara rezultatet e aktiviteteve të mbikëqyrjes;

3. bazohet në vlerësime, auditime, inspektime dhe, nëse është e nevojshme, në inspektime të paparalajmëruara;

4. t’i sigurojë AAC-ja provat e nevojshme në rast se kërkohet veprim i mëtejshëm, përfshirë masat e parashikuara në pikën 21.B.225.

c) AAC-ja do të përcaktojë fushën e mbikëqyrjes të përcaktuar në pikat (a) dhe (b) duke marrë parasysh rezultatet e aktiviteteve të mëparshme të mbikëqyrjes dhe prioritetet e sigurisë.

d) Nëse ambientet e një organizate ndodhen në më shumë se një shtet, AAC-ja, siç përcaktohet në pikën 21.1, mund të pranojë që detyrat e mbikëqyrjes të kryhen nga autoriteti(et) kompetent i shtetit(eve) ku objektet janë të vendosura, ose nga Agjencia për objektet që ndodhen jashtë një territori për të cilin Shqipëria është përgjegjëse sipas Konventës së Çikagos. Çdo organizatë që i nënshtrohet një marrëveshjeje të tillë do të informohet për ekzistencën dhe për qëllimin e saj.

e) Për çdo aktivitet mbikëqyrës që kryhet nga AAC-ja në objektet e vendosura në një shtet të ndryshëm nga vendi ku organizata ka selinë biznesit, AAC, siç përcaktohet në pikën 21.1, duhet të informojë autoritetin kompetent të atij shteti përpara se të kryejë çdo auditim ose inspektim në vend të objekteve.

f) AAC-ja mbledh dhe përpunon çdo informacion që konsiderohet i nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes.

g) Në lidhje me certifikimin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së organizatës me pikën 21.A.139A, përveç pajtueshmërisë me pikat (a) deri (f), AAC-ja, kur është autoriteti kompetent, pas ciklit të zbatueshëm të kontrollit të mbikëqyrjes dhe sa herë që zbatohen ndryshime në fushën e punës së organizatës, do të shqyrtojë çdo miratim të dhënë sipas pikës IS.I. OR.200(e) të kësaj rregulloreje ose pikës IS.D.OR.200(e) të rregullores për zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, për sa i takon kërkesave për menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me një impakt të mundshëm në sigurinë e operimeve për organizatat që mbulohen nga kjo rregullore dhe urdhri nr. 170/2022, transpozim i rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645. Kjo pikë do të zbatohet kur rregullat për sigurinë e informacionit të kenë hyrë në fuqi.

21.B.222 Programi i mbikëqyrjes

a) AAC-ja do të krijojë dhe mbajë një program mbikëqyrjeje që mbulon aktivitetet e mbikëqyrjes të kërkuara nga pika 21.B.221(a).

b) Programi i mbikëqyrjes do të marrë parasysh natyrën specifike të organizatës, kompleksitetin e aktiviteteve të saj, rezultatet e certifikimit dhe/ose aktiviteteve të mbikëqyrjes në të kaluarën, dhe do të bazohet në vlerësimin e risqeve të lidhura. Ai do të përfshijë, brenda çdo cikli të planifikimit të mbikëqyrjes:

1. vlerësimet, auditimet dhe inspektimet, duke përfshirë, sipas rastit:

i) vlerësimet e sistemit të menaxhimit dhe auditimet e procesit;

ii) auditimet e produktit të një kampioni përkatës të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve që janë brenda objektit të organizatës;

iii) marrjen e kampioneve të punës së kryer; dhe

iv) inspektime të paparalajmëruara;

2. Takimet e thirrura ndërmjet menaxherit përgjegjës dhe AAC-së për të siguruar që të dyja palët të jenë të informuara për të gjitha çështjet e rëndësishme.

c) Cikli i planifikimit të mbikëqyrjes nuk duhet të kalojë 24 muaj.

d) Pavarësisht nga pika (c), cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të zgjatet në 36 muaj nëse AAC-ja ka vërtetuar se gjatë 24 muajve të mëparshëm:

1. organizata ka demonstruar se mund të identifikojë në mënyrë efektive rreziqet e sigurisë së aviacionit dhe të menaxhojë rreziqet që lidhen me to;

2. organizata ka demonstruar vazhdimisht përputhshmëri me pikat 21.A.147 dhe 21.A.148 dhe ka kontroll të plotë mbi të gjitha ndryshimet në sistemin e menaxhimit të prodhimit;

3. nuk janë nxjerrë gjetje të nivelit 1;

4. të gjitha veprimet korigjuese janë zbatuar brenda periudhës kohore që është pranuar ose zgjatur nga AAC-ja, siç përcaktohet në pikën 21.B.225.

Pavarësisht nga pika (c), cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të zgjatet më tej në një maksimum prej 48 muajsh nëse, përveç kushteve të parashikuara në pikat 1 deri 4 më sipër, organizata ka krijuar, dhe AAC-ja ka miratuar, një sistem efektiv të vazhdueshëm për raportimin tek AAC-ja mbi performancën e sigurisë dhe përputhshmërinë rregullatore të vetë organizatës.

e) Cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të reduktohet nëse ka dëshmi se performanca e sigurisë së organizatës është ulur.

f) Programi i mbikëqyrjes do të përfshijë të dhënat e datave kur janë caktuar vlerësimet, auditimet, inspektimet dhe takimet, dhe kur këto vlerësime, auditime, inspektime dhe takime janë kryer në mënyrë efektive.

g) Në përfundim të çdo cikli të planifikimit të mbikëqyrjes, AAC-ja do të nxjerrë një raport rekomandimi për vazhdimin e miratimit, duke pasqyruar rezultatet e mbikëqyrjes.

21.B.225 Gjetjet dhe veprime korigjuese; observacionet

a) AAC-ja do të ketë një sistem për të analizuar gjetjet për rëndësinë e tyre në sigurinë në operim.

b) Një gjetje e nivelit 1 do të lëshohet nga AAC-ja kur zbulohen papajtueshmëri të rëndësishme me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, me procedurat dhe manualët e organizatës, ose me certifikatën duke përfshirë kushtet e miratimit që ul sigurinë ose rrezikon seriozisht sigurinë e fluturimit.

Gjetjet e nivelit 1 do të përfshijnë gjithashtu:

1. Mosdhënie akses AAC-ja në objektet e organizatës të përmendura në pikën 21.A.9 gjatë orarit normal të punës dhe pas dy kërkesave me shkrim;

2. Marrja e certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese ose ruajtjen e vlefshmërisë së saj nëpërmjet falsifikimit të provave dokumentare të paraqitura;

3. çdo dëshmi për keqpërdorim ose përdorim mashtrimi të certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese; dhe

4. mosaktimi i një menaxheri të përgjegjshëm në përputhje me pikën 21.A.245(a)

c) Një gjetje e nivelit 2 do të lëshohet nga AAC-ja kur zbulohen papajtueshmëri me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, me procedurat dhe manualët e organizatës, ose me certifikatën duke përfshirë kushtet e miratimit, e cila nuk klasifikohet si gjetje e nivelit 1.

d) Kur një gjetje zbulohet gjatë mbikëqyrjes ose në ndonjë mënyrë tjetër, AAC-ja, pa cenuar asnjë veprim shtesë të kërkuar nga VKM-ja nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, do t’ia komunikojë me shkrim gjetjen organizatës dhe të kërkojë veprime korigjuese për të adresuar mospërputhjet e identifikuara. Kur një gjetje e nivelit 1 lidhet drejtpërdrejt me një avion, AAC-ja informon autoritetin kompetent të shtetit në të cilin është regjistruar avioni.

1. Nëse ka ndonjë gjetje të nivelit 1, AAC-ja do të ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe të përshtatshme për të ndaluar ose kufizuar aktivitetet e organizatës së përfshirë dhe, nëse është e përshtatshme, do të marrë masa për të revokuar certifikatën e miratimit të organizatës prodhuese ose për të kufizuar ose pezulluar në tërësi ose pjesërisht, në varësi të shtrirjes së gjetjes së nivelit 1, derisa të jetë ndërmarrë një veprim korigjues i suksesshëm nga organizata.

2. Nëse ka ndonjë gjetje të nivelit 2, AAC-ja, do:

i) t’i japë organizatës një periudhë zbatimi të veprimeve korigjuese që është e përshtatshme për natyrën e gjetjes dhe që në çdo rast fillimisht nuk duhet të jetë më shumë se 3 muaj. Periudha do të fillojë nga data e komunikimit me shkrim të gjetjes organizatës që kërkon veprime korigjuese për të

adresuar mospërputhjen e identifikuar. Në fund të kësaj periudhe, dhe në varësi të natyrës së gjetjes, AAC-ja mund të zgjasë periudhën 3-mujore me kusht që të jetë rënë dakord për një plan veprimi korrigjues nga AAC-ja;

ii) të vlerësojë planin e veprimit korrigjues dhe planin e zbatimit të propozuar nga organizata, dhe nëse vlerësimi arrin në përfundimin se janë të mjaftueshme për të adresuar mospërputhjen, i pranon;

iii) nëse organizata nuk paraqet një plan veprimi korrigjues të pranueshëm, ose nuk arrin të kryejë veprimin korrigjues brenda periudhës kohore të pranuar ose të zgjatur nga AAC-ja, gjetja do të ngrihet në nivelin 1 dhe do të ndërmerren veprime siç përcaktohet në pikën (d) (1).

e) AAC-ja mund të kërkojë të kryhen vëzhgime për cilindo nga rastet e mëposhtme që nuk kërkojnë gjetje të nivelit 1 ose të nivelit 2:

1. për çdo njësi, performanca e të cilit është vlerësuar si joefektive; ose

2. kur është identifikuar se një njësi ka potencialin të shkaktojë mospërputhje sipas pikave (b) ose (c); ose

3. kur sugjerimet ose përmirësimet janë me interes për performancën e përgjithshme të sigurisë të organizatës.

Vëzhgimet e nxjerra sipas kësaj pike do t'i komunikohen me shkrim organizatës dhe do të regjistrohen nga AAC-ja;

21.B.240 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të prodhimit

a) Me marrjen e aplikimit për një ndryshim të rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të prodhimit, AAC-ja do të verifikojë përputhjen e organizatës me kërkesat e zbatueshme të këtij Aneksi përpara se të lëshojë miratimin.

b) AAC-ja do të përcaktojë kushtet në të cilat organizata mund të operojë gjatë vlerësimit të një ndryshimi, përveç nëse AAC-ja përcakton se certifikata e miratimit të organizatës prodhuese duhet të pezullohet.

c) Kur vërtetohet që organizata përmbush kërkesat e zbatueshme, AAC-ja do të miratojë ndryshimin.

d) Pa cenuar masat shtesë të zbatimit, nëse organizata zbaton një ndryshim të rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të prodhimit pa marrë miratimin e AAC-së në përputhje me pikën (c), AAC-ja do të marrë parasysh nevojën për të pezulluar, kufizuar ose revokuar certifikatën e organizatës.

e) Për ndryshime jo të rëndësishme në sistemin e menaxhimit të prodhimit, AAC-ja përfshin shqyrtimin e këtyre ndryshimeve në mbikëqyrjen e tij të vazhdueshme në përputhje me parimet e përcaktuara në pikën 21.B.221. Nëse konstatohet mospërputhje, AAC-ja njofton organizatën, kërkon ndryshime të mëtejshme dhe vepron në përputhje me pikën 21.B.225.

21.B.240A Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

a) Për ndryshimet e menaxhuara dhe të njoftuara tek AAC-ja në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën IS.D.OR.255(a) të aneksit (Pjesa-IS.D.OR) të rregullores për zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, për sa i takon kërkesave për menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me një impakt të mundshëm në sigurinë e operimeve për organizatat që mbulohen nga kjo rregullore dhe urdhri nr. 170/2022, transpozim i rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645, AAC-ja përfshin shqyrtimin e këtyre ndryshimeve në mbikëqyrjen e tij të vazhdueshme në përputhje me parimet e përcaktuara në pikën 21.B.221. Nëse konstatohet ndonjë papajtueshmëri, AAC-ja njofton organizatën, kërkon ndryshime të mëtejshme dhe vepron në përputhje me pikën 21.B.225. Kjo pikë do të zbatohet kur rregullat për sigurinë e informacionit të kenë hyrë në fuqi

b) Për ndryshime të tjera që kërkojnë një aplikim për miratim në përputhje me pikën IS.D.OR.255(b) të aneksit (Pjesa-IS.D.OR) të rregullores për zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, për sa i takon kërkesave për

menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me një impakt të mundshëm në sigurinë e operimeve për organizatat që mbulohen nga kjo rregullore dhe urdhri nr. 170/2022, transpozim i rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645:

1) me marrjen e aplikimit për ndryshim, autoriteti kompetent do të kontrollojë përputhshmërinë e organizatës me kërkesat e zbatueshme përpara se të lëshojë miratimin;

2) autoriteti kompetent do të përcaktojë kushtet në të cilat organizata mund të funksionojë gjatë zbatimit të ndryshimit;

3) nëse është i bindur se organizata është në përputhje me kërkesat e aplikueshme, autoriteti kompetent do të miratojë ndryshimin.

Kjo pikë do të zbatohet kur rregullat për sigurinë e informacionit të kenë hyrë në fuqi.

NËNPJESA H- CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

21.B.320 Investigimi

a) AAC-ja kryen aktivitete të mjaftueshme investiguese për një aplikant ose zotëruesin e një certifikate vlefshmërie ajrore, për të justifikuar lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose revokimin e certifikatës ose lejes.

b) AAC-ja përgatit procedurat e vlerësimit që mbulojnë së paku elementët e mëposhtëm:

1. Vlerësimin e përshtatshmërisë së aplikantit;
2. Vlerësimin e përshtatshmërisë së aplikimit;
3. Klasifikimin e certifikatave të vlefshmërisë ajrore;
4. Vlerësimin e dokumentacionit të marrë me aplikimin;
5. Inspektimin e avionit;
6. Përcaktimin e kushteve të nevojshme dhe kufizimeve për certifikatat e vlefshmërisë ajrore.

21.B.325 Lëshimi i certifikatës së vlefshmërisë ajrore

a) AAC-ja lëshon ose ndryshon një certifikatë vlefshmërie ajrore (forma 25 e Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s, shih shtojcën VI), pa vonesa, kur është i bindur se janë plotësuar kërkesat e zbatueshme në pikën 21.B.326 dhe kërkesat e aplikueshme të seksionit A, nënpjesa H të këtij aneksi I.

b) AAC-ja lëshon ose ndryshon një certifikatë të kufizuar vlefshmërie ajrore (forma 24 e Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s, shih shtojcën V), pa vonesa, kur është i bindur se janë plotësuar kërkesat e zbatueshme në pikën 21.B.326 dhe kërkesat e aplikueshme të seksionit A, nënpjesa H të këtij aneksi I.

c) Për avionët e rinj dhe avionët e përdorur me origjinë nga një shtet tjetër, përveç certifikatës së përshtatshme të vlefshmërisë ajrore të përmendur në pikën (a) ose (b), AAC-ja, kur Shqipëria është i shteti i regjistrimit lëshon:

1. për avionët që i nënshtrohen aneksit I (Pjesa-M) të urdhrit të ministrit “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, ose çdo përditësim i tij, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, një certifikatë fillestare e rishikimit të vlefshmërisë ajrore (forma 15a e RSH-së sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën II);

2. për avionët e rinj që i nënshtrohen aneksit Vb (Pjesa-ML) të urdhrit të ministrit “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, ose çdo përditësim i tij, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, një certifikatë fillestare e rishikimit të vlefshmërisë ajrore (forma 15c e RSH-së, sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën II);

3. për avionët e përdorur me origjinë nga një shtet tjetër dhe që i nënshtrohet aneksit Vb (Pjesa-ML) të urdhrit të ministrit “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, ose çdo përditësim i tij, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, një certifikatë fillestare e rishikimit të vlefshmërisë ajrore (forma 15c e RSH-së, sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën II), kur AAC-ja ka kryer rishikimin e vlefshmërisë ajrore.

21.B.326 Certifikata e vlefshmërisë ajrore

AAC-ja lëshon një certifikatë të vlefshmërisë ajrore:

a) për avionët e rinj:

1. pas paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar nga pika 21.A.174 (b) (2);

2. kur AAC-ja është bindur që avioni përputhet me një projekt të miratuar dhe është në gjendje për operim të sigurt; kjo mund të përfshijë inspektime nga AAC-ja; dhe

3. kur AAC-ja është bindur që avioni është në përputhje me kërkesat e zbatueshme të emetimeve të CO₂ në datën në të cilën lëshohet për herë të parë certifikata e vlefshmërisë ajrore.

b) për avionët e përdorur:

1. pas paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar nga pika 21.A.174 (b) (3) që demonstroi se:

i) avioni përputhet me një projekt tipi të miratuar nën një certifikatë tipi dhe çdo certifikatë tipi plotësuese, ndryshim ose riparim të miratuar në përputhje me këtë aneks I (Pjesa 21) dhe;

ii) janë përmbushur direktivat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore dhe;

iii) avioni inspektohet në përputhje me dispozitat e aneksit I (Pjesa-M) ose aneksit Vb (Pjesa-ML) të urdhrit të ministrit “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, apo çdo përditësim i tij, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014 dhe;

iv) avioni ka qenë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të emetimeve të CO₂ në datën e lëshimit të parë të certifikatës së vlefshmërisë ajrore;

2. kur AAC-ja është bindur që avioni është në përputhje me një projekt të miratuar dhe është në një gjendje për operim të sigurt; kjo mund të përfshijë inspektime nga AAC-ja dhe;

3. kur AAC-ja është bindur që avioni ka qenë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të emetimeve të CO₂ në datën në të cilën certifikata e vlefshmërisë ajrore është lëshuar për herë të parë.

21.B.327 Certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore

a) AAC-ja lëshon një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore, për:

1. avionët e rinj:

i) pas paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar nga pika 21.A.174(b)(2);

ii) kur AAC-ja bindet që avioni përputhet me një projekt të miratuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, sipas një certifikate të tipit të kufizuar ose në përputhje me specifikimet e veçanta të vlefshmërisë ajrore, dhe është në gjendje për operim të sigurt. Kjo mund të përfshijë inspektimet nga AAC-ja;

2. avionët e përdorur:

i) pas prezantimit të dokumentacionit që kërkohet nga pika 21.A.174(b)(3), duke demonstruar që:

A) avioni përputhet me një projekt të miratuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 sipas një certifikate të kufizuar të tipit ose në përputhje me specifikimet e veçanta të vlefshmërisë ajrore, dhe me çdo certifikatë të tipit plotësuese për ndryshime apo riparime të miratuara në pajtim me aneksin I (pjesa 21); dhe

B) janë përmbushur direktivat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore; dhe

C) avioni inspektohet në përputhje me dispozitat e aneksit I (Pjesa-M) ose aneksit Vb (Pjesa-ML) të urdhrit të ministrit “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të

avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, apo çdo përditësim i tij që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, sipas rastit.

ii) Kur AAC-ja bindet që avioni është në përputhje me projektin e miratuar dhe është në gjendje për operimin e sigurt. Kjo mund të përfshijë inspektimet nga AAC-ja;

b) Për një avion që nuk është në përputhje me kërkesat bazë të përmendura VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil” dhe i cili nuk plotëson kushtet për një certifikate tipi të kufizuar, nëse është e nevojshme Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, sipas nevojës, për të marrë parasysh devijimet nga këto kërkesa bazë:

1. Lëshon dhe kontrollon pajtueshmërinë me specifikimet e veçanta të vlefshmërisë ajrore duke garantuar sigurinë e përshtatshme në lidhje me përdorimin e synuar, dhe

2. Përcakton kufizimet për përdorimin e këtij avioni.

c) Kufizimet për përdorim shoqërohen me certifikata të kufizuara të vlefshmërisë ajrore, duke përfshirë kufizime të hapësirës ajrore, si të nevojshme për të marrë parasysh devijimet nga kërkesat bazë të përcaktuara në VKM- në nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”.

NËNPJESA I -CERTIFIKATAT E ZHURMËS

21.B.420 Investigimi

a) AAC-ja kryen aktivitete investiguese të mjaftueshme për një aplikant ose zotërues të certifikatës së zhurmës për të argumentuar lëshimin, ndryshimin, pezullimin ose revokimin e certifikatës.

b) AAC-ja përgatit procedurat e vlerësimit, si pjesë e procedurave të dokumentuara që përfshijnë të paktën elementet në vijim:

1. Vlerësimin e pranueshmërisë;

2. Vlerësimin e dokumentacionit të marrë me aplikimin;

3. Inspektimin e avionëve.

21.B.425 Lëshimi i certifikatave të zhurmës

AAC, sipas rastit, lëshon ose ndryshon certifikatat e zhurmës (forma 45 e Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s, shih shtojcën VII) pa vonesa, nëse është i bindur se janë plotësuar kërkesat e seksionit A nënpjesa I.

NËNPJESA J – MIRATIMI I ORGANIZATËS SË PROJEKTIMIT

21.B.430 Procedura fillestare e certifikimit

a) Me marrjen e një aplikimi për lëshimin fillestar të miratimit të një organizate projektimi, AAC-ja do të verifikojë përputhjen e aplikantit me kërkesat e zbatueshme,

b) Një takim me drejtuesin e organizatës së projektimit do të bëhet të paktën një herë gjatë hetimit për certifikimin fillestar për të siguruar që ky person e kupton rolin dhe përgjegjësinë e tij.

c) AAC-ja do të regjistrojë të gjitha gjetjet e ngritura, veprimet e mbylljes si dhe rekomandimet për lëshimin e miratimit të organizatës së projektimit.

d) AAC-ja do t'i konfirmojë aplikantit me shkrim të gjitha gjetjet e ngritura gjatë verifikimit. Për certifikimin fillestar, të gjitha gjetjet duhet të korrigjohen sipas kriterëve të AAC-së përpara se të mund të lëshohet miratimi i organizatës së projektimit.

e) Kur është i bindur se aplikuesi është në përputhje me kërkesat e zbatueshme, AAC-ja do të lëshojë miratimin e organizatës së projektimit.

f) Numri i referencës së certifikatës do të përfshihet në miratimin e organizatës së projektimit në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia.

g) Certifikata do të lëshohet për një periudhë kohe të pakufizuar. Privilegjet dhe qëllimi i aktiviteteve që është miratuar të kryejë organizata projektuese, duke përfshirë çdo kufizim të zbatueshëm, do të specifikohen në kushtet e miratimit bashkëngjitur miratimit të organizatës së projektimit.

21.B.431 Parimet e mbikëqyrjes

AAC-ja do të verifikojë nëse organizatat e certifikuara vazhdojnë të jenë në përputhje me kërkesat e zbatueshme

a) Verifikimi do të:

1. mbështetet nga dokumentacioni i synuar posaçërisht për t'i siguruar personelit përgjegjës për mbikëqyrjen udhëzime në mënyrë që të kryejnë funksionet e tyre;

2. Sigurojë organizatat e interesuara me rezultatet e aktiviteteve të mbikëqyrjes;

3. të bazohet në vlerësime, auditime, inspektime dhe, nëse është e nevojshme, në inspektime të paparalajmëruara;

4. t'i sigurojë AAC-së provat e nevojshme në rast se kërkohet veprim i mëtejshëm, përfshirë masat e parashikuara në pikën 21.B.433.

b) AAC-ja do të përcaktojë fushën e mbikëqyrjes të përcaktuar në pikën (a) duke marrë parasysh rezultatet e aktiviteteve të mëparshme të mbikëqyrjes dhe prioritetet e sigurisë.

c) AAC-ja mbledh dhe përpunon çdo informacion që konsiderohet i nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes.

d) Për certifikimin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së organizatës me pikën 21.A.239A, përveç pajtueshmërisë me pikat (a) deri (c), AAC-ja kur është autoriteti kompetent duhet të jetë në përputhje me parimet e mëposhtme:

1) AAC-ja do të shqyrtojë ndërveprimet dhe rreziqet shoqëruese të identifikuara nga çdo organizatë që i nënshtrohet mbikëqyrjes së tij në përputhje me pikën IS.D.OR.205(b) të aneksit (Pjesa-IS.D.OR) të Rregullores për zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil", për sa i takon kërkesave për menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me një impakt të mundshëm në sigurinë e operimeve për organizatat që mbulohen nga kjo rregullore dhe urdhri nr. 170/2022, transpozim i rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645. Kjo pikë do të zbatohet kur rregullat për sigurinë e informacionit të kenë hyrë në fuqi;

2) nëse konstatohen mospërputhje në ndërlidhjet/ndërveprimet e ndërsjella dhe rreziqet shoqëruese të identifikuara nga organizata të ndryshme, AAC-ja do t'i shqyrtojë ato me organizatat e prekura dhe, nëse është e nevojshme, do të nxjerrë gjetjet e duhura për të siguruar zbatimin e veprimeve korigjuuese;

3) kur dokumentacioni i rishikuar sipas pikës 2 zbulon ekzistencën e rreziqeve të rëndësishme që lidhen me organizatat që i nënshtrohen mbikëqyrjes së një autoriteti tjetër kompetent, ky informacion i komunikohet autoritetit kompetent përkatës.

21.B.432 Programi i mbikëqyrjes

a) AAC-ja do të krijojë dhe mirëmbajë një program mbikëqyrjeje që mbulon aktivitetet e mbikëqyrjes që kërkohen për të qenë në përputhje me pikën 21.B.431(a).

b) Programi i mbikëqyrjes do të marrë parasysh natyrën specifike të organizatës, kompleksitetin e aktiviteteve të saj, rezultatet certifikimit të kaluar ose aktiviteteve të mbikëqyrjes, ose të dyja, dhe do të bazohet në vlerësimin e risqeve të lidhura. Ai do të përfshijë, brenda çdo cikli të planifikimit të mbikëqyrjes:

1. vlerësimet, auditimet dhe inspektimet, duke përfshirë, sipas rastit:

i) vlerësimet e sistemit të menaxhimit dhe auditimet e procesit;

ii) auditimet e një kampioni përkatës të produktit të projektimit dhe certifikimit të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve që janë brenda fushës së punës së organizatës;

iii) marrjen e kampioneve të punës së kryer;

iv) inspektime të paparalajmëruara;

2. Takimet e thirrura ndërmjet drejtuesit të organizatës së projektimit dhe AAC-së për të siguruar që të dyja palët të jenë të informuara për të gjitha çështjet e rëndësishme.

c) Cikli i planifikimit të mbikëqyrjes nuk duhet të kalojë 24 muaj.

d) Pavarësisht nga pika (c), cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të zgjatet në 36 muaj nëse AAC-ja ka vërtetuar se gjatë 24 muajve të mëparshëm:

1. organizata ka demonstruar se mund të identifikojë në mënyrë efektive risqet e sigurisë së aviacionit dhe të menaxhojë rreziqet që lidhen me to;

2. organizata ka demonstruar vazhdimisht përputhje me pikën 21.A.247 dhe ka kontroll të plotë mbi të gjitha ndryshimet në sistemin e menaxhimit të projektimit;

3. Nuk janë nxjerrë gjetje të nivelit 1;

4. të gjitha veprimet korrigjuese janë zbatuar brenda periudhës kohore që është pranuar ose zgjatur nga AAC-ja siç parashikohet në pikën 21.B.433(d).

Pavarësisht nga pika (c), cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të zgjatet më tej në një maksimum prej 48 muajsh nëse, përveç kushteve të përcaktuara në pikat (d) (1) deri (d) (4), organizata ka vendosur, dhe AAC-ja ka miratuar, një sistem efektiv të vazhdueshëm për raportimin tek AAC-ja mbi performancën e sigurisë dhe përputhshmërinë rregullatore të vetë organizatës.

e) Cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të reduktohet nëse ka dëshmi se performanca e sigurisë e organizatës është ulur.

f) Programi i mbikëqyrjes do të përfshijë të dhënat e datave kur janë caktuar vlerësimet, auditimet, inspektimet dhe takimet, dhe kur janë kryer në mënyrë efektive vlerësimet, auditimet, inspektimet dhe takimet.

g) Në përfundim të çdo cikli të planifikimit të mbikëqyrjes, AAC-ja do të nxjerrë një raport rekomandimi për vazhdimin e miratimit, duke pasqyruar rezultatet e mbikëqyrjes.

21.B.433 Gjetjet dhe veprimet korrigjuese; observacionet

a) AAC-ja do të ketë një sistem për të analizuar gjetjet për rëndësinë e tyre në sigurinë në operim.

b) Një gjetje e nivelit 1 do të lëshohet nga AAC-ja kur zbulohen papajtueshmëri me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, me procedurat dhe manualët e organizatës, ose me certifikatën e organizatës projektuese duke përfshirë kushtet e miratimit, të cilat mund të çojnë në mospërputhje të pakontrolluara dhe në një gjendje të pasigurt potenciale.

Gjetjet e nivelit 1 do të përfshijnë gjithashtu:

1. Mosdhënie akses AAC-së në objektet e organizatës të përmendura në pikën 21.A.9 gjatë orarit normal të punës dhe pas dy kërkesave me shkrim;

2. Marrjen e miratimit të organizatës projektuese ose ruajtjen e vlefshmërisë me falsifikimin e provave dokumentare të paraqitura;

3. çdo dëshmi për keqpërdorim ose përdorim mashtrimi të miratimit të organizatës së projektimit;

4. Mosaktimi i një drejtuesi të organizatës së projektimit në zbatim të pikës 21.A.245(a).

c) Një gjetje e nivelit 2 do të lëshohet nga AAC-ja kur zbulohen papajtueshmëri me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, me procedurat dhe manualët e organizatës, ose me certifikatë duke përfshirë kushtet e miratimit, e cila nuk klasifikohet si gjetje e nivelit 1.

d) Kur një gjetje zbulohet gjatë mbikëqyrjes ose ndonjë mënyre tjetër, AAC-ja, pa cenuar asnjë veprim shtesë të kërkuar nga VKM-ja nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore

në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, do t’ia komunikojë me shkrim gjetjen organizatës dhe të kërkojë veprime korigjuese për të adresuar mospërputhjet e identifikuar. Kur një gjetje e nivelit 1 lidhet drejtpërdrejt me një produkt, AAC-ja informon autoritetin kompetent të shtetit në të cilin është regjistruar avioni.

1. Nëse ka ndonjë gjetje të nivelit 1, AAC-ja do:

i) t’i japë organizatës një periudhë zbatimi të veprimeve korigjuese që është e përshtatshme për natyrën e gjetjes dhe që në çdo rast nuk duhet të jetë më shumë se 21 ditë pune. Kjo periudhë do të fillojë që nga data e komunikimit me shkrim të gjetjes organizatës që kërkon veprime korigjuese për të adresuar mospërputhshmërinë(të) e identifikuar;

ii) të vlerësojë planin e veprimit korigjues dhe planin e zbatimit të propozuar nga organizata, dhe nëse arrin në përfundimin se janë të mjaftueshme për të adresuar mospërputhshmërinë(të), i pranon;

iii) nëse organizata nuk paraqet një plan veprimi korigjues të pranueshëm, ose nuk arrin të kryejë veprimet korigjuese brenda periudhës kohore të pranuar nga AAC-ja, ndërmerr veprime të menjëhershme dhe të përshtatshme për të ndaluar ose kufizuar aktivitetet e organizatës së përfshirë dhe, nëse është e përshtatshme, të ndërmarrë veprime për të revokuar miratimin e organizatës së projektimit ose për ta kufizuar ose pezulluar tërësisht ose pjesërisht, në varësi të shtrirjes së gjetjes së nivelit 1, derisa të jetë ndërmarrë një veprim korigjues i suksesshëm nga organizata.

2. Nëse ka ndonjë gjetje të nivelit 2, AAC-ja do:

i) t’i japë organizatës një periudhë zbatimi të veprimeve korigjuese që është e përshtatshme për natyrën e gjetjes dhe që në çdo rast fillimisht nuk duhet të jetë më shumë se 3 muaj. Kjo periudhë do të fillojë nga data e komunikimit me shkrim të gjetjes që kërkon veprim korigjues. Në fund të kësaj periudhe, dhe në varësi të natyrës së gjetjes, AAC-ja mund të zgjasë periudhën 3-mujore me kusht që të jetë rënë dakord për një plan veprimi korigjues nga AAC-ja;

ii) të vlerësojë planin e veprimit korigjues dhe planin e zbatimit të propozuar nga organizata, dhe nëse arrin në përfundimin se ato janë të mjaftueshme për të adresuar mospërputhjet, i pranon;

iii) nëse organizata nuk paraqet një plan veprimi korigjues të pranueshëm, ose nuk arrin të kryejë veprimin korigjues brenda periudhës kohore të pranuar ose të zgjatur nga AAC-ja, gjetja do të ngrihet në nivelin 1 dhe do të ndërmerren veprime siç përcaktohet në pikën (d) (1).

e) AAC-ja mund të kërkojë të kryhen vëzhgime për cilindo nga rastet e mëposhtme që nuk kërkojnë gjetje të nivelit 1 ose të nivelit 2:

1. për çdo njësi, performanca e të cilit është vlerësuar si joefektive;

2. kur është identifikuar se një njësi ka potencialin të shkaktojë mospërputhje sipas pikave (b) ose (c);

3. kur sugjerimet ose përmirësimet janë me interes për performancën e përgjithshme të sigurisë së organizatës.

Vëzhgimet e nxjerra sipas kësaj pike do t’i komunikohen me shkrim organizatës dhe do të regjistrohen nga AAC-ja.

1.B.435 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të projektimit

a) Me marrjen e aplikimit për një ndryshim të rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të projektimit, AAC-ja do të verifikojë përputhjen e organizatës me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të saj, përpara se të lëshojë miratimin.

b) AAC-ja do të përcaktojë kushtet në të cilat organizata mund të operojë gjatë ndryshimit, përveç nëse AAC-ja përcakton se miratimi i organizatës së projektimit duhet të pezullohet.

c) Kur është i bindur që organizata është në përputhje me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të saj të deleguara dhe zbatuese, AAC-ja do të miratojë ndryshimin.

d) Pa cenuar masat shtesë të zbatimit, nëse organizata zbaton një ndryshim të rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të projektimit pa marrë miratimin e AAC-së në përputhje me pikën (c), AAC-ja do të marrë parasysh nevojën për të pezulluar, kufizuar ose revokuar certifikatën e organizatës.

e) Për ndryshime jo të rëndësishme në sistemin e menaxhimit të projektimit, AAC-ja përfshin shqyrtimin e këtyre ndryshimeve në mbikëqyrjen e tij të vazhdueshme në përputhje me parimet e përcaktuara në pikën 21.B.431. Nëse konstatohet ndonjë mospërputhje, AAC-ja njofton organizatën, kërkon ndryshime të mëtejshme dhe vepron në përputhje me pikën 21.B.433.

21.B.435A Ndryshime në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

a) Për ndryshimet e menaxhuara dhe të njoftuara tek AAC-ja në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën IS.D.OR.255(a) të aneksit (Pjesa-IS.D.OR) të rregullores për zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, për sa i takon kërkesave për menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me një impakt të mundshëm në sigurinë e operimeve për organizatat që mbulohen nga kjo rregullore dhe urdhri nr. 170/2022, transpozim i rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645, AAC-ja përfshin shqyrtimin e këtyre ndryshimeve në mbikëqyrjen e tij të vazhdueshme në përputhje me parimet e përcaktuara në pikën 21.B.431. Nëse konstatohet ndonjë mospërputhje, AAC-ja njofton organizatën, kërkon ndryshime të mëtejshme dhe vepron në përputhje me pikën 21.B.433. Kjo pikë do të zbatohet kur rregullat për sigurinë e informacionit të kenë hyrë në fuqi.

b) Për ndryshime të tjera që kërkojnë një aplikim për miratim në përputhje me pikën IS.D.OR.255(b) të aneksit (Pjesa-IS.D.OR) të rregullores për zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, për sa i takon kërkesave për menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me një impakt të mundshëm në sigurinë e operimeve për organizatat që mbulohen nga kjo rregullore dhe urdhri nr. 170/2022, transpozim i rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645:

1) me marrjen e aplikimit për ndryshim, AAC-ja do të kontrollojë përputhshmërinë e organizatës me kërkesat e zbatueshme përpara se të lëshojë miratimin;

2) AAC-ja do të përcaktojë kushtet në të cilat organizata mund të funksionojë gjatë zbatimit të ndryshimit;

3) nëse është i bindur se organizata është në përputhje me kërkesat e aplikueshme AAC-ja do të miratojë ndryshimin.

Kjo pikë do të zbatohet kur rregullat për sigurinë e informacionit të kenë hyrë në fuqi.

NËNPJESA K - PJESËT DHE PAJISJET

Zbatohen procedurat administrative të përcaktuara nga EASA-ja. AAC-ja duhet të marrë masa për t'i bërë të zbatueshme në sistemin kombëtar këto procedura.

(NËNPJESA L - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

NËNPJESA M – RIPARIMET

21.B.450 Baza e certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit për miratimin e një projekti riparimi

Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 cakton çdo ndryshim në bazën e certifikimit të tipit të inkorporuar përmes referencës, sipas rastit, në certifikatën e tipit, certifikatën plotësuese e tipit ose autorizimin APU ETSO, që ky autoritet e konsideron të domosdoshme për ruajtjen e një niveli të

sigurisë në operim të barabartë me atë të vendosur më parë dhe ia njofton atë aplikantit për një projekt riparimi.

21.B.453 Lëshimi i miratimit të projektit të riparimit

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 lëshon miratimin e një projekti të riparimit kryesor/të madh, me kusht që:

1. aplikanti të ketë demonstruar aftësinë e tij në përputhje me pikën 21.A.432B;

2. aplikanti të ketë respektuar pikën 21.A.433;

3. Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 përmes verifikimit të tij/saj të demonstrimit të përputhshmërisë sipas nivelit të përfshirjes të vendosur në përputhje me pikën 21.B.100 (a), nuk ka gjetur ndonjë mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit; dhe

4. asnjë tipar ose karakteristikë nuk është identifikuar që mund ta bëjë produktin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 lëshon miratimin e një projekti riparimi të vogël, me kusht që aplikanti të ketë respektuar pikat (2) dhe (4) të paragrafit (a) dhe me kusht që ky autoritet, përmes verifikimeve të tij/ saj të demonstrimit të përputhshmërisë sipas nivelit të përfshirjes në përputhje me pikën 21.B.100 (b), nuk ka gjetur ndonjë mospërputhshmëri me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit.

(NËNPJESA N - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

NËNPJESA O - AUTORIZIMET E URDHËRIT EVROPIAN TË STANDARDEVE
TEKNIKE

21.B.480 Lëshimi i një autorizimi ETSO

Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1 lëshon një autorizim ETSO, me kusht që:

a) aplikanti ka vepruar në përputhje me pikën 21.A.606;

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, përmes verifikimeve të tij/ saj të demonstrimit të përputhshmërisë sipas nivelit të përfshirjes në përputhje me pikën 21.B.100 (b), nuk ka gjetur ndonjë mospërputhje me kushtet teknike të ETSO-së së zbatueshme ose me devijimet e tyre të miratuara në përputhje me pikën 21.A.610, nëse ka; dhe

c) asnjë tipar ose karakteristikë nuk është identifikuar që mund ta bëjë artikullin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

(NËNPJESA P - LEJA PËR FLUTURIM)

21.B.520 Investigimi

a) AAC-ja kryen veprimtari të mjaftueshme investiguese për të justifikuar lëshimin, apo revokimin e lejes për fluturim.

b) AAC-ja përgatit procedurat e vlerësimit që mbulojnë të paktën elementet e mëposhtëm:

1. Vlerësimin e pranueshmërisë së aplikantit;

2. Vlerësimin e pranueshmërisë së aplikimit;

3. Vlerësimin e dokumentacionit të marrë me aplikimin;

4. Inspektimin e avionit;

5. Miratimin e kushteve të fluturimit në përputhje me pikën 21.A.710 (b).

21.B.525 Lëshimi i lejes për fluturim

AAC-ja lëshon një leje për fluturim (forma 20a, e Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s, shih shtojcën III) pa vonesë të panevojshme:

a) me paraqitjen e të dhënave të kërkuara nga pika 21.A.707; dhe

b) kur kushtet e fluturimit të referuara në pikën 21.A.708 janë miratuar në përputhje me pikën 21.A.710; dhe

c) kur ky autoritet, përmes investigimeve të veta, të cilat mund të përfshijnë inspektimet, ose nëpërmjet procedurave të dakordësuara me aplikantin, bindet që avioni përputhet me projektin e përcaktuar sipas pikës 21.A.708 para fluturimit.

NËNPJESA Q - IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE, PJESËVE DHE PAJISJEVE

Aplikohen procedurat administrative të vendosura nga EASA-ja. AAC-ja duhet të marrë masa për t'i bërë të zbatueshme në sistemin kombëtar këto procedura.

SHTOJCAT

Format e Republikës së Shqipërisë sipas modeleve të EASA-s

Format e këtij aneksi përfshijnë dhe përkthimin në gjuhën angleze

Format e cituara në shtojcat e kësaj pjese kanë tiparet e mëposhtme detyruese. AAC-ja garanton që formularët të cilët ata publikojnë janë të identifikueshëm, si dhe ata janë përgjegjës për printimin e këtyre formave.

Shtojca I - Forma 1 e RSH-së sipas EASA-s Certifikata e autorizuar e lejimit në shërbim

Shtojca II - Certifikata e rishikimit të vlefshmërisë së ajrore forma 15a dhe 15c e RSH-së sipas modelit të EASA-s.

Shtojca III - Forma 20a e RSH-së sipas EASA-s Leja për fluturim

Shtojca IV - Forma 20b e RSH-së sipas EASA-s Leja për fluturim (lëshuar nga organizatat e miratuara)

Shtojca V - Forma 24 e RSH-së sipas EASA-s Certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore

Shtojca VI - Forma 25 e RSH-së sipas EASA-s Certifikata e vlefshmërisë ajrore

Shtojca VII - Forma 45 e RSH-së sipas EASA -s Certifikata e zhurmës

Shtojca VIII - Forma 52 e RSH-së sipas EASA-s Deklarata e pajtueshmërisë së avionit

Shtojca IX- Forma 53 e RSH-së sipas EASA-s Certifikata e lejimit në shërbim

Shtojca X - Forma 55 e RSH-së sipas EASA-s Certifikata e miratimit të organizatës prodhuese

Shtojca XI - Forma 65 e RSH-së sipas EASA-s Letër marrëveshja për prodhim pa miratim të organizatave prodhuese

Shtojca XII - Kategoritë e testeve të fluturimit dhe kualifikimi i ekuipazhit përkatës të testimit të fluturimit.

SHTOJCA I

CERTIFIKATA E AUTORIZUAR E LEJIMIT NË SHËRBIM – FORMA 1 E RSH-së SIPAS EASA-s REFERUAR NË ANEKSIN I (PJESA 21)

Autoriteti Kompetent i Miratimit/Shqipëria Approving Competent Authority/Albania		CERTIFIKATË E AUTORIZUAR E LEJIMIT NË SHËRBIM AUTHORISED RELEASE CERTIFICATE RSH FORM 1			Numri i ndjekjes së Formës Form tracking Number
Emri dhe Adresa e Organizatës: Organization Name and Address:					Urdhri i punës/Kontrata/Fatura Work Order/Contract/Invoice
Artikulli Item	Përshkrimi Description	Nr. i Pjesës Part No.	Sasia Quantity	Nr. Serisë	Statusi/puna Satus/Work

				Serial No.	
12. Vërejtje Remarks					
13a. Certifikon se artikujt e identifikuar më sipër ishin prodhuar në përputhje me: Certifies that items identified above were manufactured in conformity to: <input type="checkbox"/> Të dhënat e miratuara të projektit dhe janë në kushte për operim të sigurt Approved design data and are in condition for safe operation <input type="checkbox"/> Të dhëna jo të miratuara të projektit të specifikuara në bllokun 12 Non-approved design data specified in block 12		14a. <input type="checkbox"/> Lejimi në shërbim sipas pjesës 145.A.50 të Um nr. 167/2020 (ose çdo përditësim i tij) <input type="checkbox"/> Rregullore tjetër e specifikuar në bllokun 12 <i>MO no 167/2020(as amended) Part 145.A.50 Release to Service Other regulation specified in block 12</i> Vërteton se nëse nuk është specifikuar ndryshe në bllokun 12, puna e identifikuar në bllokun 11 dhe e përshkruar në bllokun 12 është kryer në përputhje me pjesën 145 dhe në lidhje me atë punë artikujt konsiderohen të gatshëm për t'u lejuar në shërbim. <i>Certifies that unless otherwise specified in block 12, the work identified in block 11 and described in block 12, was accomplished in accordance with Part 145 and in respect to that work the items are considered ready for release to service.</i>			
13b. Firma e autorizuar <i>Authorised Signature</i>	13c. Miratimi/Numri i autorizimit <i>Approval/ Authorisation Number</i>	14b. Firma e autorizuar <i>Authorised Signature</i>	14c. Certifikata/Nr. Referencës së miratimit <i>Certificate/ Approval ref. No.</i>		
13d. Emri <i>Name</i>	13e. Data (dd mmm vvv) <i>Date (dd mmm yyy)</i>	14d. Emri <i>Name</i>	14e. Data (dd mmm vvv) <i>Date (dd mmm yyy)</i>		
<p>PËRGJEGJËSITË E PËRDORUESIT/INSTALUESIT</p> <p>Kjo Certifikate nuk jep automatikisht autoritetin për të instaluar artikullin (artikujt). Kur përdoruesi/instaluesi kryen punë në përputhje me rregullat e një autoriteti të vlefshmërisë ajrore, ndryshe nga autoriteti i vlefshmërisë ajrore të pranojë artikujt nga autoriteti i vlefshmërisë ajrore të specifikuar në bllokun 1. Deklaratat në blloqet 13a dhe 14a nuk përbëjnë certifikimin e instalimit. Në të gjitha rastet të dhënat e mirëmbajtjes së avionëve duhet të përmbajnë një klasifikim të instalimit të lëshuar në pajtim me rregulloret kombëtare nga përdoruesi / instaluesi përpara se avioni të fluturojë.</p> <p>USER/ INSTALLER RESPONSIBILITIES</p> <p><i>This Certificate does not automatically constitute authority to install the item(s).</i></p> <p><i>Where the user/installer performs work in accordance with regulations of an airworthiness authority different than the airworthiness authority specified in block 1, it is essential that the user/installer ensures that his/her airworthiness authority accepts items from the airworthiness authority specified in block 1.</i></p> <p><i>Statements in blocks 13a and 14a do not constitute installation certification. In all cases aircraft maintenance records must contain an installation classification issued in accordance with the national regulations by the user/installer before the aircraft may be flown.</i></p>					

Udhëzime për përdorimin e formës 1 të RSH-së, sipas modelit të EASA-s:

“Këto udhëzime janë vetëm për përdorimin e formës 1 të RSH-së, sipas modelit të EASA-s, për qëllime prodhimi. Shihni me vëmendje shtojcën II të aneksit I (Pjesa-M) të urdhrin të ministrit “Për miratimin e rregullore mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, apo çdo përditësim i tij që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, e cila paraqet përdorimin e formës 1 të RSH-së, sipas modelit të EASA-s për qëllime mirëmbajtjeje.

1. QËLLIMI DHE PËRDORIMI

1.1 Qëllimi kryesor i certifikatës është deklarimi i vlefshmërisë ajrore të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të reja të aviacionit (‘artikujt’).

1.2 Duhet të vendoset përputhshmëria ndërmjet certifikatës dhe artikujve. Prodhuesi duhet të mbajë atë format certifikate që lejon verifikimin e të dhënave origjinale.

1.3 Certifikata është e pranueshme për shumë autoritete të vlefshmërisë ajrore, mirëpo mund të kushtëzohet nga marrëveshjet dypalëshe dhe/ose politika e autoritetit të vlefshmërisë ajrore.

1.4 Certifikata nuk është një shënim dorëzimi ose transporti.

1.5 Avionët nuk lejohen në shërbim duke përdorur certifikatën.

1.6 Certifikata nuk përbën miratimin për të instaluar artikullin në një avion, motor ose helikë të caktuar, por ndihmon përdoruesin e fundit të përcaktojë statusin e miratimit të vlefshmërisë ajrore.

1.7 Një kombinim i artikujve të lejuar për shërbim nga prodhimi dhe mirëmbajtja nuk lejohet në të njëjtën certifikatë.

1.8 Nuk lejohet kombinimi i artikujve të certifikuar në përputhje me “të dhënat e miratuara” dhe “të dhënat e pamiratuara” në të njëjtën certifikatë.

2. FORMATI I PËRGJITHSHËM

2.1 Certifikata duhet të jetë në përputhje me formatin bashkëlidhur duke përfshirë numrat e bllokut dhe vendndodhjen e secilit bllok. Sidoqoftë, madhësia e secilit bllok mund të ndryshojë për t’iu përshtatur aplikimit individual, por jo në atë masë që do ta bënte certifikatën të panjohur.

2.2 Certifikata duhet të jetë në formatin “landscape”, por madhësia e përgjithshme mund të rritet ose zvogëlohet konsiderueshëm për sa kohë që certifikata mbetet e dallueshme dhe e lexueshme. Në rast dyshimesh, konsultohet AAC-ja.

2.3 Deklarata e përgjegjësive së përdoruesit/instaluesit mund të vendoset në të dyja anët e formularit.

2.4 Printimi duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm.

2.5 Certifikata mund të jetë ose e printuar paraprakisht ose e krijuar nga kompjuteri, por në secilin rast printimi i rreshtave dhe karaktereve duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm dhe në përputhje me formatin e përcaktuar.

2.6 Certifikata duhet të jetë në gjuhën angleze, dhe nëse është e përshtatshme, në një ose më shumë gjuhë të tjera.

2.7 Detajet që futen në certifikatë mund të jenë ose të printuara me makinë/kompjuter ose të shkruara me dorë duke përdorur shkronjat kapitale dhe të jenë lehtësisht të lexueshme.

2.8 Kufizoni përdorimin e shkurtesave në minimum, për të qenë sa më të qartë.

2.9 Hapësira e mbetur në anën e pasme të certifikatës mund të përdoret nga hartuesi për çdo informacion shtesë, por nuk duhet të përfshijë ndonjë deklaratë certifikimi. Çdo përdorim i anës së pasme të certifikatës duhet të referohet në bllokun përkatës në anën e përparme të certifikatës.

3. KOPJET

3.1 Nuk ka asnjë kufizim në numrin e kopjeve të certifikatës që i dërgohet klientit ose që ruhet nga hartuesi.

4. GABIMET NË NJË CERTIFIKATË

4.1 Nëse një përdorues i fundit gjen një gabim në një certifikatë, ai duhet ta identifikojë atë (ato) me shkrim të hartuesit të certifikatës. Hartuesi mund të lëshojë një certifikatë të re nëse arrin të verifikojë dhe korrigjojë gabimin.

4.2 Certifikata e re duhet të ketë një numër të ri gjurmimi, nënshkrim dhe datë.

4.3 Kërkesa për një certifikatë të re mund të plotësohet pa bërë rivefikimin e gjendjes së artikujve. Certifikata e re nuk është një deklaratë e gjendjes aktuale dhe duhet t’i referohet certifikatës së mëparshme në bllokun 12 me deklaratën në vijim: “Kjo certifikatë korrigjon gabimin/et në bllok [shëno bllokun e korrigjuar] të certifikatës [shëno numrin origjinal të gjurmimit] datë [shëno datën e lëshimit origjinal] dhe nuk mbulon përputhshmërinë/gjendjen/lëshimin në shërbim”. Të dy certifikatat duhet të mbahen në përputhje me periudhën e ruajtjes të shoqëruar me të parën.

5. PLOTËSIMI I CERTIFIKATËS NGA HARTUESI

Blloku 1 Autoriteti/Shteti kompetent miratues

Shënoni emrin dhe vendin e autoritetit kompetent nën juridiksionin e të cilit lëshohet certifikata. Nëse autoriteti kompetent është Agjencia, duhet të deklarohet vetëm 'EASA'.

Blloku 2 Titulli i Formularit 1 EASA

“CERTIFIKATË PËR PËRDORIM TË AUTORIZUAR FORMULARI EASA 1”

Blloku 3 Numri i gjurmimit të formularit

Shënoni numrin unik të krijuar nga sistemi/procedura e numërimit të organizatës së identifikuar në bllokun 4; kjo mund të përfshijë karaktere alfa/numerike.

Blloku 4 Emri dhe adresa e organizatës

Shënoni emrin dhe adresën e plotë të organizatës prodhuese (referojuni formularit EASA 55 Fleta A) ose personave fizikë ose juridikë që lëshojnë artikujt e mbuluar nga kjo certifikatë. Logot etj. të organizatës lejohen nëse mund të përfshihen brenda bllokut.

Blloku 5 Urdhri i punës/kontrata/fatura

Për të lehtësuar gjurmueshmërinë e artikujve nga klienti, vendosni numrin e urdhrin të punës, numrin e kontratës, numrin e faturës ose numrin e ngjashëm të referencës.

Blloku 6 Artikulli

Shënoni numrat e artikujve të linjës nëse ka më shumë se një artikull rreshti. Ky bllok mundëson referencë të lehtë me vërejtje në bllokun 12.

Blloku 7 Përshkrimi

Shënoni emrin ose përshkrimin e artikullit. Preferenca duhet t'i jepet termit të përdorur në udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore ose mirëmbajtjes (p.sh. Katalogu i Ilustruar i Pjesëve, Manuali i Mirëmbajtjes së Avionëve, Buletini i Shërbimit, Manuali i Mirëmbajtjes së Komponentëve).

Blloku 8 Numri i pjesës

Shënoni numrin e pjesës siç shfaqet në artikull ose etiketë/paketim. Në rastin e një motori ose helike, mund të përdoret emërtimi i tipit.

Blloku 9 Sasia

Shënoni sasinë e artikujve.

Blloku 10 Numri i serisë

Nëse rregullorja kërkon që artikulli të identifikohet me një numër serie, shënoni këtu. Përveç kësaj, mund të shënohet çdo numër tjetër serie që nuk kërkohet me rregullore. Nëse nuk ka numër serie të identifikuar në artikull, shënoni “nuk ka”.

Blloku 11 Statusi/puna

Shënoni “PROTOTIP” ose “I RI”. Shënoni “PROTOTIP” për:

i) prodhimin e një artikulli të ri në përputhje me të dhënat e projektimit të pa miratuara;
ii) prodhimin e një artikulli të ri në përputhje me të dhënat e projektimit që nuk janë deklaruar ende nga një deklarues në përputhje me nënpjesën C, F ose N të seksionit A, shtojcës Ib (Pjesa 21 Light);
iii) ricertifikimin nga organizata e identifikuar në bllokun 4 të certifikatës së mëparshme pas punës së modifikimit ose korigjimit në një artikull, përpara hyrjes në shërbim, (p.sh. pas përfshirjes së një ndryshimi në projektim, korigjimit të një defekti, inspektimit ose testimit, ose rinovimit të afatit të ruajtjes). Detajet e lejimit origjinal dhe puna e modifikimit ose korigjimit duhet të shënohen në bllokun 12;

Shënoni “I RI” për:

i) prodhimin e një artikulli të ri në përputhje me të dhënat e miratuara të projektimit;
ii) prodhimin e një artikulli të ri në përputhje me të dhënat e projektimit të deklaruar nga deklaruesi në përputhje me nënpjesën C, F ose N të seksionit A të shtojcës Ib (Pjesa 21 Light);

iii) ricertifikimin nga organizata e identifikuar në bllokun 4 të certifikatës së mëparshme pas punës së modifikimit ose korigjimit në një artikull, përpara hyrjes në shërbim, (p.sh. pas përfshirjes së një ndryshimi projektimi, korigjimit të një defekti, inspektimit ose testimit, ose rinovimit të afatit të ruajtjes). Detajet e lejitimit origjinal dhe puna e modifikimit ose korigjimit duhet të shënohen në bllokun 12;

iv) ricertifikimin nga prodhuesi i produktit ose organizata e identifikuar në bllokun 4 të certifikatës së mëparshme të artikujve nga “prototip” (përputhshmëri vetëm me të dhënat e pa miratuara) në “i ri/e re” (përputhshmëri me të dhënat e miratuara dhe në një gjendje për funksionim të sigurt), pas miratimit të të dhënave të zbatueshme të projektimit, me kusht që të dhënat e projektimit të mos kenë ndryshuar.

Për produktet e certifikuar, në bllokun 12 duhet të shënohet deklarata e mëposhtme:

“RICERTIFIKIMI I ARTIKUJVE NGA “PROTOTIP” NË “I RI”: KY DOKUMENT VËRTETON MIRATIMIN E TË DHËNAVE TË PROJEKTIMIT [SHËNO NUMRIN TC/STC, NIVELI I RISHIKIMIT], DATËN [SHËNO DATËN NËSE ËSHTË E NEVOJSHME PËR IDENTIFIKIMIN E STATUSIT TË RISHIKIMIT], KUR ËSHTË (JANË) PRODHUAR KY ARTIKULL (KËTO ARTIKUJ).”

Kutia “të dhënat e projektimit të miratuara dhe janë në gjendje për funksionim të sigurt” duhet të shënohet në bllokun 13a;

Për avionët që i nënshtrohen një deklaratë përputhshmërie projektimi në përputhje me nënpjesën C të seksionit A të shtojcës Ib (Pjesa Light), deklarata e mëposhtme duhet të shënohet në bllokun 12:

“RICERTIFIKIMI I ARTIKUJVE NGA “PROTOTIP” NË “I RI”: KY DOKUMENT VËRTETON DEKLARATËN E TË DHËNAVE TË PROJEKTIMIT [SHËNO REFERENCËN E DEKLARATËS, NIVELI I RISHIKIMIT], DATËN [SHËNO DATËN NËSE ËSHTË E NEVOJSHME PËR IDENTIFIKIMIN E STATUSIT TË RISHIKIMIT], KUR ËSHTË (JANË) PRODHUAR KY ARTIKULL (KËTO ARTIKUJ).”

(v) ekzaminimi i një artikulli të ri të lëshuar përpara hyrjes në shërbim në përputhje me një standard ose specifikim të specifikuar nga klienti (detajet e të cilit dhe të lëshimit origjinal duhet të shënohen në bllokun 12) ose për të përcaktuar aftësinë fluturuese (shpjegimi i bazës së lëshimit dhe detajet e lëshimit origjinal duhet të shënohen në bllokun 12).

Blloku 12 Vërejtje

Përshkruani punën e identifikuar në bllokun 11, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose duke iu referuar dokumentacionit mbështetës, i nevojshëm që përdoruesi ose instaluesi të përcaktojë vlefshmërinë ajrore të artikujve në lidhje me punën e certifikuar. Nëse është e nevojshme, mund të përdoret një fletë e veçantë dhe të referohet nga formulari 1 i EASA-së. Çdo deklaratë duhet të identifikojë qartë se cilin artikull në bllokun 6 i referohet. Nëse nuk ka asnjë deklaratë, shënoni “Asnjë”.

Shënoni justifikimin për lëshimin e të dhënave të projektimit të pa miratuara në bllokun 12 (p.sh. certifikata tip në pritje, vetëm për testim, në pritje të të dhënave të miratuara).

Nëse artikulli është prodhuar në përputhje me të dhënat e projektimit që nuk janë deklaruar ende nga deklaruesi në përputhje me nënpjesën C, F ose N të seksionit A të shtojcës Ib (Pjesa 21 Light), atëherë deklarata e mëposhtme do të përfshihet në bllokun 12:

“DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTIMIT NË PRITJE NË PËRPUTHJE ME NËNPJESËN C, F OSE N TË SEKSIONIT A TË SHTOJCËS Ib (Pjesa 21 Light)”

Nëse artikulli është prodhuar në përputhje me të dhënat e projektimit që janë deklaruar nga deklaruesi në përputhje me nënpjesën C, F ose N të seksionit A të shtojcës Ib (Pjesa 21 Light), atëherë deklarata e mëposhtme do të përfshihet në bllokun 12:

“PRODHUAR NË PËRPUTHJE ME TË DHËNAT E PROJEKTIMIT TË DEKLARATËS SË PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTIMIT NË PËRPUTHJE ME NËNPJESËN C, F OSE N TË SEKSIONIT A TË SHTOJCËS IB (PJESA 21 Light)”

Nëse printoni të dhënat nga një formular 1 elektronik EASA, çdo e dhënë që nuk është e përshtatshme në blloqe të tjera duhet të shënohet në këtë bllok.

Blloku 13a Shënoni vetëm një nga dy kutitë:

1. Shënoni kutinë “të dhënat e projektimit të miratuara dhe që janë në gjendje për funksionim të sigurt” nëse artikujt janë prodhuar duke përdorur të dhëna të miratuara të projektimit dhe janë në gjendje për funksionim të sigurt.

2. Shënoni kutinë “të dhënat e projektimit të pa miratuara të specifikuar në bllokun 12” nëse artikujt që janë prodhuar duke përdorur të dhëna të zbatueshme të projektimit që nuk janë të miratuara.

Kjo kuti shënohet gjithashtu kur artikulli është prodhuar në përputhje me të dhënat e projektimit që janë deklaruar në përputhje me nënpjesën C, F dhe N të seksionit A të shtojcës Ib (Pjesa 21 Light).

Identifikoni të dhënat në bllokun 12 (p.sh. certifikata tip në pritje, vetëm për testim, të dhëna të miratuara në pritje, përputhshmëria me të dhënat e projektimit nga një deklaratë përputhshmërie projektimi në përputhje me nënpjesën C, F ose N të seksionit A të shtojcës Ib (Pjesa 21 Light).

Nuk lejohen kombinimet e artikujve të lëshuar kundrejt të dhënave të projektimit të miratuara dhe të pa miratuara në të njëjtën certifikatë.

Blloku 13b Nënshkrimi i autorizuar

Kjo hapësirë plotësohet me nënshkrimin e personit të autorizuar. Vetëm personat e autorizuar në mënyrë specifike sipas rregullave dhe politikave të autoritetit kompetent lejohen të nënshkruajnë këtë bllok. Për të ndihmuar njohjen, mund të shtohet një numër unik që identifikon personin e autorizuar.

Blloku 13c Numri i miratimit/ autorizimit

Shënoni numrin/referencën e miratimit/autorizimit. Ky numër ose referencë lëshohet nga autoriteti kompetent për organizatat e miratuara ose të deklaruara të prodhimit (për pjesët e prodhuara sipas shtojcës Ib (Pjesa 21 Light). Nëse organizata ka prodhuar një pjesë që përputhet me të dhënat e projektimit të deklaruara nga një deklaruues në përputhje me nënpjesën C, F ose N të seksionit A të shtojcës Ib (Pjesa 21 Light) dhe organizata nuk është një organizatë prodhuese e miratuar ose e deklaruar, atëherë ata duhet të shënojnë deklaratën e mëposhtme:

“PRODHUAR SIPAS NËNPJESËS R të seksionit A të shtojcës Ib (Pjesa 21 Light)”

Blloku 13d Emri

Shënoni emrin e personit që nënshkruan bllokun 13b në një formë të lexueshme.

Blloku 13e Data

Shënoni datën kur është nënshkruar blloku 13b, data duhet të jetë në formatin d = dita 2 shifra, m = 3 shkronjat e para të muajit, v = viti 4 shifra.

Blloku 14a-14e Kërkesa të përgjithshme për bllokun 14a-14e:

Nuk përdoret për lëshimin e prodhimit. Ngjyrosni, errësoni ose shënoni ndryshe për të përjashtuar përdorimin e paqëllimshëm ose të paautorizuar.

Përgjegjësitë e përdoruesit/instaluesit

Vendosni deklaratën e mëposhtme në certifikatë për të njoftuar përdoruesit e fundit se ata nuk janë liruar nga përgjegjësitë e tyre në lidhje me instalimin dhe përdorimin e ndonjë artikulli të shoqëruar me formularin:

“KJO CERTIFIKATË NUK JEP AUTOMATIKISHT AUTORITETIN PËR INSTALIMIN.

NËSE PËRDORUESI/INSTALUESI KRYEN PUNË NË PËRPUTHJE ME RREGULLORET E NJË AUTORITETI TË VLEFSHMËRISË AJRORE TË NDRYSHME NGA AUTORITETI I VLEFSHMËRISË AJRORE TË SPECIFIKUAR NË BLOKUN 1, ËSHTË E RËNDËSISHME QË PËRDORUESI/INSTALUESI TË SIGUROJË QË AUTORITETI I

TIJ/SAJ I AFTËSISË AJRORE TË PRANOJË ARTIKUJ NGA AUTORITETI I VLEFSHMËRISË AJRORE TË SPECIFIKUAR NË BLOKUN 1..

DEKLARATAT NË BLOKUN 13A DHE 14A NUK PËRBËJNË CERTIFIKIM INSTALIMI. NË TË GJITHA RASTET, TË DHËNAT E MIRËMBAJTJES SË AVIONIT DUHET TË PËRMBAJNË NJË CERTIFIKATË INSTALIMI TË LËSHUAR NË PËRPUTHJE ME RREGULLORET KOMBËTARE NGA PËRDORUESI/INSTALUESI PËRPARA SE AVIONI TË MUND TË FLUTUROJË”

SHTOJCA II

Certifikata e rishikimit të vlefshmërisë ajrore – Forma 15a e RSH-së sipas modelit EASA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY
CERTIFIKATË E RISHIKIMIT TË VLEFSHMËRISË AJRORE
AIRWORTHINESS REVIEW CERTIFICATE

Referenca e ARC/ARC Reference: _____

Në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, Autoriteti i Aviacionit Civil vërteton që avioni i mëposhtëm:

Pursuant to the Decision of the Council of Ministers No. 1095, dated 24.12.2020 “On the approval of essential requirements in the field of civil aviation”, the Albanian Civil Aviation Authority hereby certifies that the following aircraft:

Prodhuesi i avionit/ *Aircraft*
manufacturer: _____

Tipi i avionit/ *Manufacturer’s designation:* _____

Regjistrimi i avionit/ *Aircraft*
Registration: _____

Numri i Serisë së avionit/ *Aircraft Serial*
Number: _____

Është konsideruar në gjëndje të vlefshmërisë ajrore në kohën e rishikimit/ *is considered airworthy at the time of the review.*

Data e lëshimit/ *Date of issue:* _____ Data e skadimit/ *Date of expiry:* _____

Numri i orëve të fluturimit (FH) në datën e lëshimit/ *Airframe flight hours (FH) at the date of issue:* _____

Firmosur/ <i>Signed</i> : _____	nr. i Autorizimit/ <i>Authorization</i>
No: _____	
<p>Zgjatja e 1^{-rë} e afatit: Avioni ka mbetur në një mjedis të kontrolluar në përputhje me pikën M.A.901 të aneksit I (Pjesa-M) të urdhrit të ministrit nr. ____, datë _____.____, “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, për vitin e fundit. Avioni është konsideruar të jetë në gjendje të vlefshmërisë ajrore në kohën e lëshimit të kësaj certifikate:</p> <p><i>1st extension: The aircraft has remained in a controlled environment in accordance with point M.A.901 of Annex I (Part-M) to Minister’s Order “On the continuing airworthiness of aircraft and aeronautical products, parts and appliances, and on the approval of organisations and personnel involved in these tasks for the last year”. The aircraft is considered to be airworthy at the time of the issuance of this certificate:</i></p>	
Data e lshimit/ <i>Date if issue</i> : _____	Data e skadimit/ <i>Date of expiry</i> : _____
Numri i orëve të fluturimit (FH) në datën e lëshimit/ <i>Airframe flight hours (FH) at the date of issue</i> : _____	
Firmosur/ <i>Signed</i> : _____	Autorizimi nr. / <i>Authorization</i>
No: _____	
Emri i kompanisë/ <i>Company Name</i> : _____	Referenca e miratimit/ <i>Approval reference</i> : _____
<p>Zgjatja e 2^{-të} e afatit: Avioni ka mbetur në një mjedis të kontrolluar në përputhje me pikën M.A.901 të aneksit I (Pjesa-M) të urdhrit të ministrit nr. ____, datë _____.____.20__, “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, për vitin e fundit. Avioni është konsideruar të jetë në gjendje të vlefshmërisë ajrore në kohën e lëshimit të kësaj certifikate:</p> <p><i>2nd extension: The aircraft has remained in a controlled environment in accordance with point M.A.901 of Annex I (Part-M) to Minister’s Order No.____, dated _____.____.20__ on the continuing airworthiness of aircraft and aeronautical products, parts and appliances, and on the approval of organisations and personnel involved in these tasks for the last year. The aircraft is considered to be airworthy at the time of the issue:</i></p>	
Data e lëshimit/ <i>Date if issue</i> : _____	Data e skadimit/ <i>Date of expiry</i> : _____
Numri i orëve të fluturimit (FH) në datën e lëshimit/ <i>Airframe flight hours (FH) at the date of issue</i> : _____	
Firmosur/ <i>Signed</i> : _____	Nr. i autorizimit / <i>Authorization</i>
No: _____	
Emri i kompanisë/ <i>Company Name</i> : _____	Referenca e miratimit/ <i>Approval reference</i> : _____

Forma 15a e RSH-së sipas EASA-s

Certifikata e rishikimit të vlefshmërisë ajrore – forma 15c e RSH-së sipas modelit EASA

SHËNIM: personat dhe organizatat që kryejnë rishikimin e vlefshmërisë ajrore në kombinim me inspektimin 100-orë/vjetor mund të përdorin anën e pasme të këtij formulari për të lëshuar CRS-në e përmendur në pikën ML.A.801 që korrespondon me 100-orë/vjetor inspektimit.

CERTIFIKATË E RISHIKIMIT TË VLEFSHMËRISË AJRORE (ARC)
(për avionët që përputhen me Pjesën-ML)

AIRWORTHINESS REVIEW CERTIFICATE (ARC) (for aircraft complying with Part-ML)

Referenca e ARC:...../ARC reference:

Në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, apo çdo përditësim i tij,
Pursuant to the Decision of the Council of Ministers No. 1095, dated 24.12.2020 “On the approval of essential requirements in the field of civil aviation”, or any update thereof,

[AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL]
[ALBANIAN CIVIL AVIATION AUTHORITY]

vërteton se ka kryer një rishikim të vlefshmërisë ajrore në përputhje me urdhrin e ministrit nr. datë..... “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, për avionët e mëposhtëm:

hereby certifies that it has performed an airworthiness review in accordance with Minister’s Order No.....,dated..... “On the continuing airworthiness of aircraft and aeronautical products, parts and appliances, and on the approval of organisations and personnel involved in these tasks”, on the following aircraft:

[ose]/ [or]

.....avionin e ri të mëposhtëm/the following new aircraft:

Prodhuesi i avionit/ *Aircraft manufacturer:*

_____ Emërtimi i prodhuesit/

Manufacturer’s designation _____ Regjistrimi i avionit/ *Aircraft*

registration: _____ Numri i serisë së avionit/ *Aircraft serial*

number: _____

dhe ky avion është konsideruar në gjendje të vlefshmërisë ajrore në kohën e rishikimit/ *is considered airworthy at the time of the review/ (and that this aircraft) is considered airworthy at the time of the review.*

Data e Lëshimit/ *Date of issue:* _____ Data e skadimit/ *Date of expiry:* _____

Numri i orëve të fluturimit (FH) në datën e rishikimit/ *Airframe flight hours (FH) at the date of review:* _____

Firmosur/ *Signed:* _____ Autorizimi Nr. (nëse

ka): _____/ *Authorisation No (if applicable):* _____

[OSE]/ [OR]

[EMRI I ORGANIZATËS TË MIRATUAR, ADRESA dhe REFERENCA E MIRATUAR] (**)

/[NAME OF APPROVED ORGANISATION, ADDRESS and APPROVAL REFERENCE]

(**)

[ose]/ [or]

[EMRI I PLOTË I STAFIT CERTIFIKUES DHE NUMRI I LICENCËS SË PJESËS 66 (OSE EKUIVALENT KOMBËTAR)] (**)

/[FULL NAME OF THE CERTIFYING STAFF AND PART-66 LICENCE NUMBER (OR NATIONAL EQUIVALENT)] (**)

vërteton se ka kryer një rishikim të vlefshmërisë ajrore në përputhje me UM. Nr. për aeroplanin e mëposhtëm:

hereby certifies that it has performed an airworthiness review in accordance with Minister’s Order No. _____ on

the following aircraft:

Prodhuesi avionit / *Aircraft manufacturer*:..... Emërtimi i prodhuesit:...../ *Manufacturer's designation*:.....

Regjistrimi i avionit/ *Aircraft registration*:..... Numri serial i avionit:...../ *Aircraft serial number*:.....

(dhe se ky avion) konsiderohet i vlefshëm për fluturim në kohën e rishikimit/ *and that this aircraft is considered airworthy at the time of the review*.

Data e lëshimit/ *Date of issue*:..... Data e skadencës:...../ *Date of expiry*:.....

Orët e fluturimit të kuadrit ajror (FH) në datën e rishikimit (*)/ *Airframe flight hours (FH) at date of review (*)*:

Nënshkrimi/ *Signed*: Nr. i autorizimit (nëse ka)...../ *Authorisation No (if applicable)*:.....

Shtesa e parë: Avioni është në përputhje me kushtet e ML.A.901(c) të shtojcës Vb (Pjesa-ML)/ *1st extension: The aircraft complies with the conditions of ML.A.901(c) of Annex Vb (Part-ML)*

Data e lëshimit/ *Date of issue*:..... Data e skadencës:...../ *Date of expiry*:.....

Orët e fluturimit të kuadrit ajror (FH) në datën e lëshimit (*):...../ *Airframe flight hours (FH) at date of issue (*)*:.....

Nënshkrimi/ *Signed*:..... Nr. i autorizimit:/ *Authorisation No*:.....

Emri i Kompanisë/ *Company name*:..... Referenca e miratimit:...../ *Approval reference*:.....

Shtesa e dytë: Avioni është në përputhje me kushtet e ML.A.901(c) të shtojcës Vb (Pjesa-ML)/ *2nd extension: The aircraft complies with the conditions of ML.A.901(c) of Annex Vb (Part-ML)*

Data e lëshimit/ *Date of issue*:..... Data e skadencës:...../ *Date of expiry*:.....

Orët e fluturimit të kuadrit ajror (FH) në datën e lëshimit (*):...../ *Airframe flight hours (FH) at date of issue (*)*:.....

(*):.....

—
Nënshkrimi/ *Signed*:..... Nr.

Autorizimit:/ *Authorisation No*:.....

Emri i Kompanisë/ *Company name*:.....Referenca e miratimit:...../ *Approval reference*:.....

Forma 15c e RSH-së sipas EASA-s

(*) Përveç balonave dhe airshipeve

(**) Lëshuesi i formularit mund ta përshtatë sipas nevojës së tij duke fshirë emrin, deklaratën certifikuese, referencën për avionin dhe detajet e lëshimit që nuk janë të rëndësishme për përdorim.

SHTOJCA IV

LEJA PËR FLUTURIM – FORMA 20B e RSH-së SIPAS MODELIT TË EASA-s



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY

LEJE PËR FLUTURIM/PERMIT TO FLY

<p>Emri dhe Adresa e organizatës që lëshon lejen për fluturim. <i>Name and address of the organization issuing the permit to fly.</i></p>	
<p>Kjo leje për të fluturuar lëshohet në përputhje me urdhrin e ministrit nr. _____ që transpozon për momentin në fuqi, neni 5.4.a dhe vërteton se avioni është në gjendje për fluturim të sigurt për qëllimin dhe në kushtet e listuara më poshtë dhe është e vlefshme për territorin shqiptar. <i>This permit to fly is issued pursuant to the Minister of transport Order No _____, Article 5.4.a and certifies that the aircraft is capable of safe flight for the purpose and within the conditions listed below and is valid for Albanian territory.</i></p> <p>Kjo leje është e vlefshme edhe për fluturimin në dhe brenda shteteve të tjera, me miratimin e veçantë që merret nga autoritetet kompetente të këtyre shteteve. <i>This permit is also valid for flight to and within other States provided separate approval is obtained from the competent authorities of such States.</i></p>	<p>1. Kombësia dhe shenjat e regjistrimit: <i>Nationality and Registration Marks:</i></p>
<p>2. Prodhuesi i avionit/ tipi: <i>Aircraft Manufacturer/ type:</i></p>	<p>3. Nr. i Serisë <i>Serial No:</i></p>
<p>4. Leja mbulon: [qëllimin në përputhje me 21A.701(a)] <i>The permit covers: [purpose in accordance with 21A.701(a)]</i></p>	
<p>5. Mbajtësi: [Organizata që lëshon lejen për fluturim] <i>Holder: [Organization issuing the permit to fly]</i></p>	
<p>6. Kushtet/vërejtje: <i>Conditions/ remarks:</i></p>	
<p>7. Periudha e vlefshmërisë: <i>Validity period:</i></p>	
<p>8. Vendi dhe data e lëshimit: <i>Place and date of issue:</i></p>	<p>9. Firma e autorizuar/ <i>Authorised signature:</i> Emri/Name: Nr i referencës së miratimit/ <i>Approval Reference No</i></p>

Forma 20b e RSH-së sipas EASA-s

SHTOJCA V

CERTIFIKATË E KUFIZUAR E VLEFSHMËRISË AJRORE – FORMA 24 E RSH-së SIPAS
EASA-s

Restricted Certificate of Airworthiness — Form 24 of the Republic of Albania according to EASA

CERTIFIKATË E KUFIZUAR E VLEFSHMËRISË AJRORE
RESTRICTED CERTIFICATE OF AIRWORTHINESS

(¹)	(Logo) REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA (Logo) AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL CIVIL AVIATION AUTHORITY	(²)
1.Kombësia dhe shenjat e regjistrimit/ <i>Nationality and registration marks</i>	2.Prodhuesi dhe tipi i avionit/ <i>Manufacturer and manufacturer's designation of aircraft</i>	3.Numri i serisë së avionit/ <i>Aircraft serial number</i>
4.Kategoria/ <i>Categories:</i>		
5. Kjo certifikatë e vlefshmërisë ajrore lëshohet sipas Konventës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil datë 7 dhjetor 1944 dhe urdhrimit të ministrit nr. _____, neni 5 (4) (b) për avionin e sipërpërmendur i cili konsiderohet i sigurt për fluturim kur mirëmbahet dhe operohet në përputhje me kufizimet përkatëse operationale të mëposhtme./ <i>This Certificate of Airworthiness is issued pursuant to the Convention on International Civil Aviation dated 7 December 1944 and Minister's Order No. _____, Article 5 (4) (b) in respect of the abovementioned aircraft which is considered to be airworthy when maintained and operated in accordance with the foregoing and the pertinent operating limitations.</i>		
Përveç sa më sipër, zbatohen kufizimet e mëposhtme: <i>In addition to above the following restrictions apply:</i>		
(⁴)		
(⁵) [Avioni mund të përdoret për fluturime ndërkombëtare, pamvarësisht kufizimeve të mësipërme] / <i>[The aircraft may be used in international navigation notwithstanding above restrictions]</i>		
Data e lëshimit/Date of issue: Firma/ Signature:		
6.Kjo Certifikatë e Kufizuar e Vlefshmërisë Ajrore është e vlefshme nëse nuk revokohet nga AAC./ <i>This Restricted Certificate of Airworthiness is valid unless revoked by the CAA.</i>		

Kësaj certifikate i bashkëngjitet një Certifikatë e vlefshme e Rishikimit të Vlefshmërisë Ajrore/ *A current Airworthiness Review Certificate shall be attached to this certificate.*

Forma 24 e RSH-së sipas EASA-s, lëshimi 2/ *Form 24 of the Republic of Albania according to EASA, Issue 2*

Kjo certifikatë duhet të mbahet në bordin e avionit gjatë gjithë fluturimeve./ *This certificate shall be carried on board during all flights*

SHTOJCA VI

CERTIFIKATË E VLEFSHMËRISË AJRORE – FORMA 25 E RSH-së SIPAS EASA-s

Certificate of Airworthiness — Form 25 of the Republic of Albania according to EASA

**CERTIFIKATË E VLEFSHMËRISË AJRORE
CERTIFICATE OF AIRWORTHINESS**


(1)	(Logo) REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA (Logo) AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL CIVIL AVIATION AUTHORITY	(2)
1. Kombësia dhe shenjat e regjistrimit/ <i>Nationality and registration marks</i>	2. Prodhuesi dhe tipi i avionit/ <i>Manufacturer and manufacturer's designation of aircraft</i>	3. Numri i serisë së avionit/ <i>Aircraft serial number</i>
4. Kategoria/ <i>Categories:</i>		
<p>5. Kjo certifikatë e vlefshmërisë ajrore lëshohet sipas Konventës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil datë 7 dhjetor 1944 dhe urdhrit të ministrit nr. _____, që transponon rregulloren EC nr. _____, neni 5 (2) (c) për avionin e sipërpërmendur i cili konsiderohet i sigurt për fluturim kur mirëmbahet dhe operohet në përputhje me kufizimet përkatëse operationale të mëposhtme./ <i>This Certificate of Airworthiness is issued pursuant to the Convention on International Civil Aviation dated 7 December 1944 and Minister's Order No. _____, Article 5 (2) (c) in respect of the abovementioned aircraft which is considered to be airworthy when maintained and operated in accordance with the foregoing and the pertinent operating limitations.</i></p> <p>Kufizime/ vërejtje/ <i>Limitations/ Remark:</i></p> <p>(3)</p> <p>Data e lëshimit/ <i>Date of issue:</i> Firma/ <i>Signature:</i></p>		

<p>6.Kjo Certifikatë e vlefshmërisë ajrore është e vlefshme nëse nuk revokohet nga AAC./<i>This Certificate of Airworthiness is valid unless revoked by the CAA.</i></p> <p>Kësaj certifikate i bashkëngjitet një certifikatë e vlefshme e rishikimit të vlefshmërisë ajrore/ <i>A current Airworthiness Review Certificate shall be attached to this certificate.</i></p>

Forma 25 e RSH-së sipas EASA-s, lëshimi 2/*Form 25 of the Republic of Albania according to EASA, Issue 2*

Kjo certifikatë duhet të mbahet në bordin e avionit gjatë gjithë fluturimeve./*This certificate shall be carried on board during all flights*

SHTOJCA VII
CERTIFIKATA E ZHURMAVE – FORMA 45 E RSH-së SIPAS EASA-s

 1. REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA	2. CERTIFIKATË ZHURMASH NOISE CERTIFICATE	3. Dokumenti nr. : <i>Document No:</i>		
4. Shenja e regjistrimit: <i>Registration Marks:</i>	5. Prodhuesi dhe tipi i avionit: <i>Manufacturer and manufacturer's designation of aircraft:</i>	6. Numri serial i avionit: <i>Aircraft Serial Number:</i>		
7.Motori: <i>Engine:</i>	8.Helika: <i>Propeller:</i>			
9. Pesha maksimale në ngritje: (kg) <i>Maximum take-off mass: (kg)</i>	10. Pesha maksimale në ulje: (kg) <i>Maximum Landing Mass: (kg)</i>	11. Standartet e certifikimit të zhurmave: <i>Noise certification standards:</i>		
12. Modifikime shtesë të inkorporuara për qëllime të përputhshmërisë me standardet e certifikimit të zhurmave të aplikueshme: <i>Additional modifications incorporated for the purpose of compliance with the applicable noise certification standards:</i>				
13. Niveli i zhurmave në fuqi maksimale: <i>Lateral/full-power Noise level: (*)</i>	14. Niveli i zhurmave në afrim: <i>Approach Noise level: (*)</i>	15. Niveli i zhurmave mbi zonë: <i>Flyover Noise level: (*)</i>	16. Niveli i zhurmave në mbikalim: <i>Overflight Noise level: (*)</i>	17. Niveli i zhurmave në ngritje: <i>Take-off Noise level: (*)</i>
Shënim:				

Remarks:
<p>18. Kjo certifikatë zhurmash lëshohet sipas aneksit 16, volumit I të Konventës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil datë 7 nëntor 1944 dhe urdhrin të ministrit nr. _ neni 6 për avionin e sipërpërmendur, i cili konsiderohet në përputhje me standardet e zhurmave të treguara nëse mirëmbahet dhe operohet në përputhje me kërkesat përkatëse dhe kufizimet e operimit.</p> <p><i>This Noise Certificate is issued pursuant to Annex 16, Volume I to Convention on International Civil Aviation dated 7 November 1944 and Minister's Order No _____, Article 6 in respect of the abovementioned aircraft, which is considered to comply with the indicated noise standards when maintained and operated in accordance with the relevant requirements and operating limitations.</i></p> <p>19.Data e Lëshimit: 20.Nënshkrimi Date of issue: Signature</p>

Forma 45 e RSH-së sipas EASA-s

() Këto kuti mund të hiqen në varësi të standardit të certifikatës së zhurmës.

SHTOJCA VIII
DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË SË AVIONIT –
FORMA 52 E RSH-së SIPAS EASA-s

DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË SË AVIONIT AIRCRAFT STATEMENT OF CONFORMITY		
1. Shteti i prodhimit <i>State of manufacture</i>	2. REPUBLIKA E SHQIPËRISË <i>REPUBLIC OF ALBANIA</i>	3. Deklarata nr. ref.: <i>Statement ref No</i>
4. Organizata <i>Organization</i>		
5. Tipi i avionit <i>Aircraft Type</i>	6. Nr. i referencës së certifikatës tip: <i>Type-certificate Ref no:</i>	
7. Regjistrimi ose shenja e avionit <i>Aircraft Registration or Mark</i>	8. Nr. i identifikimit të organizatës prodhuese <i>Production organisation Identification No</i>	
9. Detajet e motorit/helikës <i>Engine/Propeller Details</i>		
10. Modifikimet dhe/ose buletinet e shërbimit <i>Modifications and/or Service Bulletins</i>		
11. Direktivat e Vlefshmërisë Ajrore <i>Airworthiness Directives</i>		
12. Lejimet <i>Concessions</i>		
13. Përjashtimet, devijimet ose heqjet <i>Exemptions, Waivers or Derogations</i>		
14. Vërejtje <i>Remarks</i>		
15. Certifikata e Vlefshmërisë Ajrore		

<i>Certificate of Airworthiness</i>		
16. Kërkesa shtesë <i>Additional Requirements</i>		
17. Deklarata e pajtueshmërisë <i>Statement of Conformity</i>		
<p>Në këtë mënyrë vërtetohet se avioni përputhet plotësisht me modelin e certifikuar tip dhe me njësitë në blloqet 9, 10, 11, 12 dhe 13.</p> <p><i>It is hereby certified that this aircraft confirms fully to the type-certificated design and to the items above in boxes 9, 10, 11, 12 and 13.</i></p> <p>Avioni është në një gjendje për operim të sigurt <i>The aircraft is in a condition for safe operation</i></p> <p>Avioni është testuar me sukses në fluturim <i>The aircraft has been satisfactorily tested in flight</i></p>		
18. Firmosur <i>Signed</i>	19. Emri <i>Name</i>	20. Data (d/m/v) <i>Date (d/m/y)</i>
21. Referenca e miratimit të organizatës së prodhimit <i>Production Organisation Approval Reference</i>		

Forma 52 e RSH-së sipas EASA-s

Udhëzime për përdorimin e “Deklaratës së konformitetit të avionit – formulari EASA 52

1. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI

1.1 Përdorimi i deklaratës së konformitetit të avionit të lëshuar nga një organizatë prodhuese që prodhon sipas pjesës 21, seksioni A, nënjësia F përshkruhet në pikën 21.A.130 dhe në mjetet përkatëse të pranueshme të përputhshmërisë (AMC).

1.2 Qëllimi i deklaratës së konformitetit të avionit (formulari EASA 52) i lëshuar sipas pjesës 21, seksioni A, nënjësia G është që t’i mundësojë mbajtësit të një certifikate të përshtatshme miratimi të organizatës prodhuese të ushtrijë privilegjin për të marrë një certifikatë individuale të vlefshmërisë ajrore dhe, nëse kërkohet, një certifikatë zhurme nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të regjistrimit.

2. TË PËRGJITHSHME

2.1 Deklarata e konformitetit duhet të jetë në përputhje me modelin, duke përfshirë numrat e bllokut dhe vendndodhjen e secilit bllok. Megjithatë, madhësia e çdo blloku mund të ndryshojë për t’iu përshtatur aplikimit individual, por jo në atë masë që do ta bënte deklaratën e konformitetit të panjohur. Nëse keni dyshime, konsultohuni me autoritetin kompetent.

2.2 Deklarata e konformitetit duhet të jetë ose e shtypur paraprakisht ose e gjeneruar nga kompjuteri, por në secilin rast, printimi i rreshtave dhe karaktereve duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm. Formulimi i shtypur paraprakisht lejohet në përputhje me modelin e bashkangjitur, por nuk lejohen deklaratat e tjera certifikimi.

2.3 Plotësimi i deklaratës mund të jetë i printuar me makineri/kompjuter ose i shkruar me dorë, duke përdorur shkronja kapitale për të lejuar leximin e lehtë. Anglishtja, dhe aty ku është e përshtatshme, një ose më shumë nga gjuhët zyrtare të shtetit anëtar lëshues, janë të pranueshme.

2.4 Një kopje e deklaratës dhe të gjitha bashkëngjitjet e referuara duhet të ruhen nga organizata e miratuar prodhuese.

3. PLOTËSIMI I DEKLARATËS SË KONFORMITETIT NGA HARTUESI

3.1 Duhet të ketë një hyrje në të gjitha blloqet për ta kthyer dokumentin në deklaratë të vlefshme.

3.2 Një deklaratë konformiteti nuk mund t'i lëshohet autoritetit kompetent të shtetit anëtar të regjistrimit, përveç rastit kur projektimi i avionit dhe produktet e tij të instaluar janë miratuar.

3.3 Informacioni i kërkuar në blloqet 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 mund të jetë me reference për t'u referuar dokumenteve të veçanta të identifikuar të mbajtura në dosje nga organizata prodhuese, përveç nëse autoriteti kompetent bie dakord ndryshe.

3.4 Kjo deklaratë e konformitetit nuk synon të përfshijë ato pjesë të pajisjeve që mund të kërkohej të montohen për të përmbushur rregullat e zbatueshme të operimit. Megjithatë, disa nga këto njësi individuale mund të përfshihen në bllokun 10 ose në modelin e tipit të miratuar. Prandaj, operatorëve u kujtohet përgjegjësia e tyre për të siguruar përputhjen me rregullat e zbatueshme operative për operimet e tyre të veçanta.

<i>Blloku 1</i>	Shkruani emrin e shtetit të prodhimit.
<i>Blloku 2</i>	Autoriteti kompetent që lëshon deklaratën e konformitetit nën autoritetin e tij.
<i>Blloku 3</i>	Një numër serial unik duhet të shtypet paraprakisht në këtë bllok për qëllime të kontrollit të deklaratës dhe gjurmueshmërisë. Përfshihet rasti i dokumenteve të krijuara nga kompjuteri: numri nuk ka nevojë të shtypet paraprakisht kur kompjuteri është programuar për të prodhuar dhe printuar një numër unik.
<i>Blloku 4</i>	Emri i plotë dhe adresa e vendndodhjes së organizatës që lëshon deklaratën. Ky bllok mund të jetë i printuar paraprakisht. Logot etj., lejohen nëse logoja etj., mund të përmbahet brenda bllokut.
<i>Blloku 5</i>	Lloji i avionit i plotë siç specifikohet në certifikatën tip dhe në fletën e të dhënave të lidhura me të.
<i>Blloku 6</i>	Numrat e referencës dhe lëshimi i certifikatës tip për avionin subjekt.
<i>Blloku 7</i>	Nëse avioni është i regjistruar, atëherë kjo shenjë do të jetë shenja e regjistrimit. Nëse avioni nuk është i regjistruar, atëherë kjo do të jetë shenja që pranohet nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar dhe, nëse zbatohet, nga autoriteti kompetent i një vendi të tretë.
<i>Blloku 8</i>	Numri i identifikimit i caktuar nga organizata prodhuese për qëllime të kontrollit dhe gjurmueshmërisë dhe mbështetjes së produktit. Ky numër nganjëherë referohet si “numri serial i organizatës prodhuese” ose “numri i konstruktorit”.
<i>Blloku 9</i>	Lloji i motorit dhe tipi(t) e helikës plotësisht siç specifikohet në certifikatën tip përkatëse dhe në fletën e të dhënave të lidhura me të. Numri i identifikimit të organizatës së tyre prodhuese dhe vendndodhja përkatëse duhet gjithashtu të tregohen.
<i>Blloku 10</i>	Ndryshimet e miratuara të projektimit në përkufizimin e avionit.
<i>Blloku 11</i>	Një listë e të gjitha direktivave të zbatueshme të vlefshmërisë ajrore (ose ekuivalente) dhe një deklaratë përputhshmërie, së bashku me një përshkrim të metodës së përputhshmërisë së subjektit avion individual, duke përfshirë produktet dhe pjesët e instaluar, pajisjet dhe mjetet. Duhet të deklarohet çdo kohë e ardhshme e kërkesës për pajtueshmëri.
<i>Blloku 12</i>	Devijimet e paqëllimshme të miratuara nga projektimi i tipit të miratuar, ndonjëherë të referuara si “koncesione”, “divergjenca” ose “mospërputhje”.
<i>Blloku 13</i>	Këtu mund të përfshihen vetëm përjashtimet, heqjet ose derogimet e miratuara.
<i>Blloku 14</i>	Komente. Çdo deklaratë, informacion, të dhëna të veçanta ose kufizim që mund të ndikojë në vlefshmërinë ajrore të avionit subjekt. Nëse nuk ka informacion ose të dhëna të tilla, shënoni “ASNJË”.
<i>Blloku 15</i>	Shkruani “certifikatë e vlefshmërisë ajrore” ose “certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore”, siç kërkohet.
<i>Blloku 16</i>	Kërkesat shtesë si Kërkesat e njoftuara nga një vend importues duhet të shënohen në këtë bllok.
<i>Blloku 17</i>	Vlefshmëria e deklaratës së konformitetit i nënshtrohet plotësisht të plotë të të gjitha blloqeve në formular. Një kopje e raportit të testit të fluturimit, së bashku me çdo defekt të regjistruar dhe detaje korrigjimi, duhet të mbahet në dosje nga mbajtësi i certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese. Raporti duhet të nënshkruhet si i rregullt nga stafi përkatës certifikues dhe një anëtar i ekuipazhit të fluturimit, p.sh. piloti testues ose inxhinieri i testimit të fluturimit. Testet e fluturimit të kryera janë ato të përcaktuara nën kontrollin e elementit të menaxhimit të cilësisë së sistemit të prodhimit me të dhënat e aplikueshme të projektimit dhe është në gjendje për funksionim të sigurt Lista e njësisë të ofruara (ose të vëna në dispozicion) për të përmbushur aspektet e kësaj deklaratë që lidhen me funksionimin e sigurt të avionit duhet të mbahet në dosje nga mbajtësi i certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese..
<i>Blloku 18</i>	Deklarata e konformitetit mund të nënshkruhet nga personi që është i autorizuar për ta bërë këtë gjë nga mbajtësi i miratimit të prodhimit në përputhje me pikën 21.A.145(d). Një nënshkrim i vulës gome nuk duhet të përdoret.

- Bloku 19 Emri i personit që nënshkruan certifikatën duhet të shtypet ose të printohet në një formë të lexueshme.
Bloku 20 Duhet të jepet data në të cilën është nënshkruar deklarata e konformitetit.
Bloku 21 Duhet të citohet referenca e miratimit nga autoriteti kompetent.

SHTOJCA IX
CERTIFIKATA E LEJIMIT PËR SHËRBIM – FORMA 53 E RSH-së SIPAS EASA-s

<p>CERTIFIKATA E LEJIMIT NË SHËRBIM <i>CERTIFICATE OF RELEASE TO SERVICE</i></p> <p>[EMRI I ORGANIZATËS SË MIRATUAR TË PRODHIMIT] [<i>APPROVED PRODUCTION ORGANISATION NAME</i>]</p> <p>Referenca e miratimit të organizatës së prodhimit: <i>Production organisation approval reference:</i></p> <p>Certifikata e lejimit në shërbim në përputhje me pikën 21A.163(d). <i>Certificate of release to service in accordance with 21A.163(d)</i></p> <p>Avioni:.....Tipi:.....nr. i prodhuesit/regjistrimi:..... <i>Aircraft: Type: Construction No/Registration</i></p> <p>Është mirëmbajtur sipas specifikimit në urdhrin e punës:..... <i>Has been maintained as specified in Work Order:</i></p> <p>Përshkrim i shkurtër i punës së kryer: <i>Brief description of work performed:</i></p> <p>Vërteton se puna e specifikuar është kryer në përputhje me 21A.163 (d) dhe në lidhje me atë punë avioni konsiderohet i gatshëm për lëshim në shërbim dhe për këtë arsye është në gjendje për operim të sigurt. <i>Certifies that the work specified was carried out in accordance with 21A.163(d) and in respect to that work the aircraft is considered ready for release to service and therefore is in condition for safe operation.</i></p> <p>Stafi certifikues (emri): <i>Certifying Staff (name):</i></p> <p>(Firma): (signature):</p> <p>Vendndodhja: <i>Location:</i></p> <p>Data: (dita, muaji, viti) <i>Date:..... (day, month, year)</i></p>
--

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN

Bloku PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PUNËS SË KRYER që paraqitet në formën 53 të RSH-së sipas EASA-s duhet të përfshijë referencën në të dhënat e miratuara të përdorura për kryerjen e punës.

Bloku VENDNDODHJA që paraqitet në formën 53 të RSH-së sipas EASA-s i referohet vendndodhjes ku është kryer mirëmbajtja, jo vendndodhjes së strukturave të organizatës (nëse janë të ndryshme).

SHTOJCA X

CERTIFIKATA E MIRATIMIT TË ORGANIZATËS SË PRODHIMIT REFERUAR NË NËNPJESËN G TË ANEKSIT I (PJESA 21) – FORMA 55 E RSH-së SIPAS EASA-s



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

CERTIFIKATA E MIRATIMIT TË ORGANIZATËS SË PRODHIMIT PRODUCTION ORGANISATION APPROVAL CERTIFICATE

Referencë: nr. [KODI AAC].21G.XXXX

Reference: [AAC CODE].No 21GXXXX

Në përputhje me VKM nr. 1095, datë 24.12., dhe urdhrin e ministrit nr. _____, për momentin në fuqi dhe sipas kushteve të specifikuara më poshtë, Autoriteti i Aviacionit Civil të Shqipërisë vërteton:

Pursuant to Minister Order _____, and to Minister Order _____, __, for the time being in force and subject to the condition specified below, Albanian Civil Aviation Authority hereby certifies:

[EMRI DHE ADRESA E KOMPANISË]/[COMPANY NAME AND ADDRESS]

si një organizatë prodhimi në përputhje me aneksin I (pjesa 21), seksioni A, e urdhrin të ministrit nr. _____, e miratuar për të prodhuar produkte, pjesë dhe pajisje të renditura në listën e bashkangjitur dhe lëshon certifikatat duke përdorur referencat e mësipërme.

as a production organisation in compliance with Annex I (Part 21), Section A, of Minister Order No _____, approved to produce products, parts and appliances listed in the attached schedule and issue certificates using the above references.

KUSHTET/CONDITIONS:

1. Ky miratim është i kufizuar në atë të specifikuar në kushtet e miratimit.

This approval is limited to that specified in the enclosed terms of approval.

2. Ky miratim kërkon pajtueshmërinë me procedurat e specifikuara në manualin e miratuar të organizatës së prodhimit.

This approval requires compliance with the procedures specified in the approved production organisation exposition.

3. Ky miratim është i vlefshëm për sa kohë organizata e miratuar e prodhimit është në pajtueshmëri me aneksin I (pjesa 21) e urdhrin të ministrit nr. _____.

This approval is valid whilst the approved production organisation remains in compliance with Annex I (Part 21) of Minister Order No _____.

4. Në varësi të përmbushjes së kushteve të mësipërme, ky miratim mbetet i vlefshëm për një periudhë të pakufizuar, përveç rasteve që miratimi më parë është dorëzuar, zëvendësuar, pezulluar ose revokuar.

Subject to compliance with the foregoing conditions, this approval shall remain valid for unlimited duration unless the approval has previously been surrendered, superseded, suspended or revoked.

Data e lëshimit original/ *Date of original issue*:.....

Data e këtij rishikimi/ *Date of this revision*:.....

Rishikimi NR. / Review
date:.....


....

Firmosur/ *Signed*:.....

Për AAC/ *For the CAA*:

Faqe 1 nga


Forma 55a – e RSH-së sipas EASA-s

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA	Kushtet e miratimit <i>Terms of Approval</i>	KM: 21GXXXX KM: 21GXXXX
Ky dokument është pjesë e Miratimit të Organizatës së Prodhimit [KODI AAC].21GXXXX lëshuar për: <i>This document is part of Production Organisation Approval Number [CAA CODE]. 21G.XXXX issued to:</i> Emri i kompanisë/ <i>Company name</i> :		
Seksioni 1 FUSHË DVEPRIMI I PUNËS/ <i>SCOPE OF WORK</i> :		
PRODHIMI I/ <i>PRODUCTION OF</i> :	PRODUKTET/ <i>KATEGORITË-PRODUCTS CATEGORIES</i>	
Për detajet dhe kufizimet referoju Manualit të Organizatës së Prodhimit. Seksioni xxx. <i>For details and limitations refer to the Production Organisation Exposition. Section xxx.</i>		
Seksioni 2. VENDNDODHJET/ <i>LOCATIONS</i> :		
Seksioni 3. PRIVILEGJET/ <i>PRIVILEGES</i> :		
Organizata e prodhimit ka të drejtë të ushtrojë, brenda termave të miratimit dhe në përputhje me procedurat e vetë Manualit të Organizatës së Prodhimit, privilegjet e parashtruara në pikën 21.A.163.		

Si më poshtë: <i>The Production Organisation is entitled to exercise, within the Terms of Approval and in accordance with the procedures of its Production Organisation Exposition, the privileges laid down in 21.A.163, subject to the following:</i>	
[mbaj vetëm tekstin e aplikueshëm] <i>[keep only applicable text]</i>	
Para miratimit të projektit të produktit mund të lëshohet një formë 1 e RSH-së sipas modelit EASA për produktin vetëm për qëllime të konformitetit. <i>Prior to approval of the design of the product a Form 1 may be issued only for conformity purposes.</i>	
Për një avion të pa miratuar nuk mund të lëshohet një Deklaratë Konformiteti. <i>A Statement of Conformity may not be issued for a non-approved aircraft.</i>	
Mirëmbajtja mund të kryhet, derisa kërkohet pajtueshmëria me rregulloret e mirëmbajtjes, në përputhje me Manualin e Organizatës Prodhuese Seksioni xxx. <i>Maintenance may be performed, until compliance with maintenance regulations is required, in accordance with the Production Organisation Exposition Section xxx.</i>	
Leja për fluturim mund të lëshohet në përputhje me Manualin e Organizatës Prodhuese Seksioni yyy. <i>Permits to fly may be issued in accordance with the Production Organisation Exposition Section yyy</i>	
Data e lëshimit origjinal/ <i>Date of original issue:</i>	Firmosur/ <i>Signed:</i>
Data e këtij rishikimi/ <i>Date of this revision:</i>	
Rishikimi Nr. / <i>Revision No:</i>	Për/ <i>for:</i> AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL

Forma 55b – e RSH-së sipas EASA-s

SHTOJCA XI
LETËR MARRËVESHJE PËR PRODHIM PA MIRATIMIN E ORGANIZATËS
PRODHUESE – FORMA 65 E RSH-s, SIPAS MODELIT EASA

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA LETËR MARRËVESHJE PËR PRODHIMIN PA MIRATIMIN E ORGANIZATËS PRODHUESE <i>LETTER OF AGREEMENT FOR PRODUCTION WITHOUT ORGANISATION APPROVAL</i>
EMRI I APLIKANTIT]/[<i>NAME OF APPLICANT</i>]: [EMRI TREGTAR (nëse është i ndryshëm nga emri i aplikantit)]/[<i>TRADE NAME (if different from the name of the applicant)</i>] [ADRESA E PLOTË POSTARE E APLIKANTIT]/[<i>FULL POSTAL ADDRESS OF THE APPLICANT</i>] Data (Dita, Muaji, Viti)/ <i>Date (Day, Month, Year)</i>
Referenca: [KODI I AAC (2)].21F.XXXX <i>Reference: [MEMBER STATE CODE (2)].21F.XXXX</i> Të nderuar z./znj [Emri i aplikantit], / <i>Dear Mr/Ms [Name of the Applicant]</i> , Sistemi juaj i inspektimit të prodhimit është vlerësuar dhe konstatohet se është në përputhje me

seksionin A, nënpjesën A dhe nënpjesën F të aneksit I (pjesa 21) të urdhrin të ministrit nr. _____.

Your production inspection system has been evaluated and found to be in compliance with Section A, Subpart A and Subpart F of Annex I (Part 21) of Minister Order No _____.

Prandaj, në bazë të kushteve të specifikuar më poshtë, ne pajtohemi që tregimi/vërtetimi i përpunueshmërisë së produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të përmendura më poshtë mund të bëhet sipas seksionit A, nënpjesa F të aneksit I (pjesa 21 e urdhrin të ministrit nr. .

Therefore, subject to the conditions specified below, we agree that showing of conformity of products, parts and appliances mentioned below may be done under Section A, Subpart F of Annex I (Part 21) of Minister Order No _____.

Nr. i njësjive/*No of Units* Nr. i pjesës/P/N Nr. i serisë/S/N

AVIONI/*AIRCRAFT*

PJESËT/*PARTS*

Kushtet e mëposhtme janë të zbatueshme sipas kësaj letër marrëveshjeje/ *The following conditions are applicable to this letter of agreement:*

1. Ajo është e vlefshme derisa [Emri i kompanisë] mbetet në pajtueshmëri me seksionin A, nënpjesa dhe nënpjesën F të aneksit I (pjesa 21) e urdhrin të ministrit nr. _____.

It is valid whilst [Company Name] remains in compliance with Section A, Subpart A and Subpart F of Annex I (Part 21) of Minister Order No _____;

2. Ajo kërkon pajtueshmëri me procedurat e specifikuar në Manualin e [Emri i Kompanisë] Ref./Lëshimi datë

It requires compliance with the procedures specified in [Company Name] Manual Ref./ Issue date

3. Ajo përfundon në datën

It terminates on

4. Deklarata e Konformitetit e lëshuar nga [Emri i Kompanisë] sipas dispozitave të pikës 21A.130 të rregullores së lartpërmendur verifikohet nga autoriteti lëshues i kësaj letër marrëveshjeje në përputhje me procedurën..... Nga manuali i referuar mësipër.

The Statement of Conformity issued by [Company Name] under the provisions of point 21A.130 of the above-mentioned regulation shall be validated by the issuing authority of this letter of agreement in accordance with the procedure of the referenced manual.

5. [Emri i kompanisë] duhet të njoftojë autoritetin lëshues të kësaj letër marrëveshjeje menjëherë për çdo ndryshim në sistemin e inspektimit të prodhimit që mund të ndikojë në inspektimin, konformitetin ose vlefshmërinë ajrore të produkteve dhe pjesëve të listuara në këtë letër.

[Company Name] shall notify the issuing authority of this letter of agreement immediately of any change to the production inspection system that may affect the inspection, conformity, or airworthiness of the products and parts listed in this letter.

Për Autoritetin Kompetent/*For competent authority:*

Data dhe Firma/*Date and Signature*

Forma 65 – e RSH-së sipas EASA-s

KATEGORITË E TESTEVE TË FLUTURIMIT DHE TË KUALIFIKIMEVE PËRKATËSE TË EKIPIZHIT TË TESTIMIT TË FLUTURIMIT

A. Të përgjithshme

Kjo shtojcë përcakton kualifikimet e nevojshme për ekuipazhin e fluturimit të përfshirë në kryerjen e testeve të fluturimit për avionët e certifikuar ose që do të certifikohen në përputhje me CS-23 për avionët me një peshë maksimale ngritëse (MTOM) prej ose mbi 2 000 kg, CS- 25, CS-27, CS-29 ose kodet ekuivalente të vlefshmërisë ajrore.

B. Përkufizime

1. “Inxhinier i testimit të fluturimit” nënkupton çdo inxhinier të përfshirë në operimet e testimit të fluturimit ose në tokë ose në fluturim.

2. “Inxhinieri drejtues i testimit të fluturimit” nënkupton një inxhinier testimi të fluturimit i caktuar për detyra në një avion me qëllim kryerjen e testeve të fluturimit ose për të ndihmuar pilotin në operimin e avionit dhe sistemeve të tij gjatë aktiviteteve të testimit të fluturimit.

3. “Testet e fluturimit” nënkupton:

3.1 fluturime për fazën e zhvillimit të një projektimi të ri (avionë, sisteme shtytëse, pjesë dhe pajisje);

3.2 fluturime për të demonstruar përputhshmërinë me bazën e certifikimit ose konformitetin me tipin e projektimit;

3.3 fluturime që synojnë të eksperimentojnë koncepte të reja të projektimit, që kërkojnë manovra ose profile jo të zakonshme për të cilat mund të jetë e mundur të dalin nga parametrat tashmë të miratuara të avionit;

3.4 fluturimet e trajnimit të testimit të fluturimit.

C. Kategoritë e testeve të fluturimit

1. Të përgjithshme

Përshkrimet më poshtë adresojnë fluturimet e kryera nga organizatat e projektimit dhe të prodhimit sipas aneksit I (pjesa 21).

2. Fushëveprimi

Nëse në një test janë përfshirë më shumë se një avion, çdo fluturim individual i avionëve vlerësohet sipas këtij aneksi për të përcaktuar nëse është një fluturim testimi dhe kur është e përshtatshme, kategorinë e tij.

Fluturimet e referuara në pikën 6(B)(3) janë fluturimet e vetme që i përkasin fushëveprimit të kësaj shtojce.

3. Kategoritë e testeve të fluturimit

Testet e fluturimit përfshijnë katër kategori si më poshtë:

3.1 Kategoria një (1)

a) Fluturimin(et) fillestar të një tipi të ri avioni ose të një avioni, për të cilin karakteristikat e fluturimit ose trajtimit mund të jenë ndryshuar dukshëm;

b) Fluturimet gjatë të cilave mund të parashikohet të ndeshen karakteristika të fluturimit në mënyrë të konsiderueshme të ndryshme nga ato që tashmë njihen;

c) Fluturimet për të hetuar tiparet ose teknikat e reja ose të pazakonta të projektimit të avionit;

d) Fluturimet për të përcaktuar ose zgjeruar parametrat e fluturimit;

e) Fluturimet për të përcaktuar performancat rregullatore, karakteristikat e fluturimit dhe cilësitë e trajtimit kur afrohen limitet e parametrave të fluturimit;

f) Trajnimi i testit të fluturimit për testet e fluturimit të kategorisë 1.

3.2 Kategoria dy (2)

a) Fluturimet që nuk janë klasifikuar në kategorinë 1 në një avion, tipi i të cilit nuk është ende i certifikuar;

b) Fluturimet që nuk janë klasifikuar në kategorinë 1 në një avion të një tipi tashmë të certifikuar, pas kryerjes së një modifikimi i cili nuk është miratuar akoma dhe i cili:

- i) kërkon një vlerësim të sjelljes së përgjithshme të avionit; ose
 - ii) kërkon një vlerësim të procedurave bazë të ekuipazhit, kur operon ose është i nevojshëm një sistem i ri ose i modifikuar; ose
 - iii) janë kërkuar që të fluturojnë qëllimisht jashtë kufizimeve të parametrave të operimit të cilat aktualisht janë të miratuara, por brenda parametrave të hetuara të fluturimit;
- c) Trajnimi i testit të fluturimit për testet e fluturimit të kategorisë 2.

3.3 Kategoria tre (3)

Fluturimet e kryera për lëshimin e deklaratës së konformitetit për një avion të ri të ndërtuar që nuk kërkon të fluturojë jashtë kufizimeve të certifikatës së tipit ose manualit të fluturimit të avionit.

3.4 Kategoria katër (4)

Fluturimet që nuk klasifikohen si kategoria 1 ose 2 në një avion të një tipi tashmë të certifikuar, në rast të kryerjes së një ndryshimi ende të pa miratuar të projektimit.

D. Kompetenca dhe eksperiencia e pilotëve dhe inxhinierëve drejtues të testimit të fluturimit

1. Të përgjithshme

Pilotët dhe inxhinierët drejtues të testimit të fluturimit kanë kompetencat dhe përvojën e specifikuar në tabelën në vijim.

Avioni	Kategoritë e testeve të fluturimit			
	1	2	3	4
CS-23, avionë rajonale ose avionët që kanë një shpejtësi maksimale absolute të projektimit (Md) mbi 0,6 ose një tavan maksimal mbi 7 260 m (25 000 ft), CS-25, CS-27, CS-29 ose kode ekuivalente të vlefshmërisë ajrore.	Niveli 1 i kompetencës	Niveli 2 i kompetencës	Niveli 3 i kompetencës	Niveli 4 i kompetencës
Tjetër CS-23 me një MTOM prej 2 000 kg ose më shumë	Niveli 2 i kompetencës	Niveli 2 i kompetencës	Niveli 3 i kompetencës	Niveli 4 i kompetencës

1.1 Niveli 1 i kompetencës

1.1.1 Pilotët duhet të jenë në përputhje me kërkesat e aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil.

1.1.2 Inxhinieri drejtues i testimit të fluturimit duhet të ketë:

- a) përfunduar në mënyrë të kënaqshme një kurs trajnimi për nivelin 1 të kompetencës; dhe
- b) një minimum prej 100 orësh përvojë fluturimi, duke përfshirë trajnimin e testit të fluturimit.

1.2 Niveli 2 i kompetencës

1.2.1 Pilotët duhet të jenë në përputhje me kërkesat e aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil.”

1.2.2 Inxhinieri drejtues i testimit të fluturimit duhet të ketë:

- a) përfunduar në mënyrë të kënaqshme një kurs trajnimi të nivelit 1 ose 2 të kompetencës; dhe
- b) një minimum prej 50 orësh përvojë fluturimi, duke përfshirë trajnimin për testimin e fluturimit.

Kurset e trajnimit për nivelin e kompetencës 1 ose për nivelin 2 për inxhinierin drejtues të testimit të fluturimit mbulojnë së paku temat në vijim:

- i) performancën;
- ii) stabilitetin dhe kontrollin/cilësinë e manovrimit;
- iii) sistemet;

- iv) menaxhimin e testeve; dhe
- v) menaxhimin e riskut/sigurisë në fluturim.

1.3 Niveli 3 i kompetencës

1.3.1 Piloti(ët) si minimum duhet të ketë(-në) një licencë të vlefshme të përshtatshme për kategorinë e avionëve në testim, të lëshuar në pajtueshmëri me pjesën-FCL dhe duhet të mbajë(në) një licencë komerciale piloti (CPL). Përveç kësaj, piloti në komandë duhet:

- a) të ketë një vlerësim kategorie të testit të fluturimit; ose
- b) të ketë së paku 1 000 orë përvojë fluturimi si pilot në komandë për avionët që kanë kompleksitet dhe karakteristika të ngjashme; dhe
- c) të ketë marrë pjesë, për secilën klasë ose tip avioni, në të gjitha fluturimet që janë pjesë e programit që çon në lëshimin e certifikatës individuale të vlefshmërisë ajrore të së paku pesë avionëve.

1.3.2 Inxhinieri drejtues i testimit të fluturimit duhet të:

- a) kënaqë nivelin 1 ose nivelin 2 të kompetencës; ose
- b) ketë fituar një sasi të konsiderueshme të eksperiencës së fluturimit në lidhje me detyrën; dhe
- c) ketë marrë pjesë në të gjitha fluturimet që janë pjesë e programit që çon në lëshimin e certifikatës individuale të vlefshmërisë ajrore të së paku pesë avionëve.

1.4 Niveli 4 i kompetencës

1.4.1 Piloti(-ët) si minimum duhet të ketë(kenë) një licencë të vlefshme të përshtatshme për kategorinë e avionëve në testim, të lëshuar në pajtueshmëri me pjesën-FCL dhe të zotërojë(-në) një CPL. Piloti në komandë duhet të ketë një vlerësim të testit të fluturimit ose duhet të ketë së paku 1000 orë si pilot në komandë për avionët që kanë kompleksitet dhe karakteristika të ngjashme.

1.4.2 Kompetenca dhe përvoja për inxhinierët drejtues të testimit të fluturimit përcaktohet në manualin e operimeve të testimit të fluturimit.

2. Inxhinierët drejtues të testimit të fluturimit

Inxhinierët drejtues të testimit të fluturimit duhet të marrin një autorizim nga organizata që i punëson ata, duke detajuar fushëveprimin e funksioneve të tyre brenda organizatës. Autorizimi përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin;
- b) datën e lindjes;
- c) eksperiencën dhe trajnimin;
- d) pozicionin në organizatë;
- e) fushëveprimin e autorizimit;
- f) datën e lëshimit të parë të autorizimit;
- g) datën e skadimit të autorizimit, nëse është e përshtatshme; dhe
- h) numrin e identifikimit të autorizimit.

Inxhinierët drejtues të testeve të fluturimit emërohen për një fluturim të caktuar vetëm nëse ata janë fizikisht dhe mendërisht të aftë për të kryer në mënyrë të sigurt detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara.

Organizata vë në dispozicion të mbajtësve të tyre të gjitha të dhënat përkatëse të lidhura me autorizimet.

E. Kompetenca dhe përvoja e inxhinierëve tjerë të testimit të fluturimit

Inxhinierët e tjerë të testimit të fluturimit në bordin e avionit duhet të kenë një sasi eksperience dhe trajnimi në përpjesëtim me detyrat që u caktohen atyre si anëtarë të ekuipazhit dhe në përputhje me manualin e operimeve të testimit të fluturimit, kur është e aplikueshme.

Organizata vë në dispozicion të inxhinierëve përkatës të testit në fluturim të gjitha të dhënat e duhura lidhur me aktivitetin e tyre të fluturimit.

PËRMBAJTJA

21L.1 Objekti

21L.2 Autoriteti Kompetent

SEKSIONI A – KËRKESAT TEKNIKE

NËNPJESA A – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

21L.A.1 Objekti

21L.A.2 Detyrimet dhe veprimet e kryera nga një person i ndryshëm nga aplikanti, mbajtësi i një certifikate ose deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi

21L.A.3 Sistemi i raportimit

21L.A.4 Direktivat e vlefshmërisë ajrore

21L.A.5 Bashkëpunimi ndërmjet projektimit dhe prodhimit

21L.A.6 Shënjimi

21L.A.7 Regjistrimi i të dhënave

21L.A.8 Manualet

21L.A.9 Udhëzime për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore

21L.A.10 Aksesit dhe hetimi

21L.A.11 Gjetjet dhe observacionet

21L.A.12 Mjetet e përputhshmërisë

NËNPJESA B – CERTIFIKATAT E TIPIT

21L.A.21 Objekti

21L.A.22 Pranueshmëria

21L.A.23 Dëshmia e aftësisë së projektimit

21L.A.24 Aplikimi për një certifikatë tipi

21L.A.25 Dëshmia e përputhshmërisë

21L.A.26 Projektimi i tipit

21L.A.27 Kërkesat për lëshimin e një certifikate tipi

21L.A.28 Detyrimet e mbajtësit të certifikatës së tipit

21L.A.29 Transferueshmëria e një certifikate tipi

21L.A.30 Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së një certifikate tipi

NËNPJESA C – DEKLARATAT E PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTIMIT TË AVIONIT

21L.A.41 Objekti

21L.A.42 Pranueshmëria

21L.A.43 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit

21L.A.44 Veprimtaritë e përputhshmërisë për një deklaratë përputhshmërie projektimi

21L.A.45 Specifikimet teknike të detajuara dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit që janë të zbatueshme për avionët që i nënshtrohen deklaratave të përputhshmërisë së projektimit

21L.A.46 Të dhënat e projektimit të avionit

21L.A.47 Detyrimet e deklaruesit për një deklaratë përputhshmërie projektimi

21L.A.48 Mos-transferueshmëria e një deklaratë përputhshmërie projektimi të avionit

NËNPJESA D – NDRYSHIME NË CERTIFIKATAT E TIPIT

21L.A.61 Objekti

21L.A.62 Ndryshimet standarde

21L.A.63 Klasifikimi i ndryshimeve në një certifikatë tipi

21L.A.64 Pranueshmëria

21L.A.65 Aplikimi për ndryshim në një certifikatë tipi

21L.A.66 Dëshmia e përputhshmërisë

21L.A.67 Kërkesat për miratimin e një ndryshimi të vogël në një certifikatë tipi

21L.A.68 Kërkesat për miratimin e një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi

21L.A.69 Miratimi i një ndryshimi në një certifikatë tipi sipas një privilegji

21L.A.70 Detyrimet për ndryshime të vogla në një certifikatë tipi

NËNPJESA E – CERTIFIKATA PLOTËSUESE E TIPIT

21L.A.81 Objekti

21L.A.82 Pranueshmëria

21L.A.83 Dëshmia e aftësisë së projektimit

21L.A.84 Aplikimi për një certifikatë plotësuese tipi

21L.A.85 Dëshmia e përputhshmërisë

21L.A.86 Kërkesat për miratimin e një certifikate plotësuese tipi

21L.A.87 Miratimi i një certifikate plotësuese tipi sipas një privilegji

21L.A.88 Detyrimet e mbajtësit të një certifikate plotësuese tipi

21L.A.89 Transferueshmëria e një certifikate plotësuese tipi

21L.A.90 Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së një certifikate plotësuese tipi

21L.A.91 Ndryshimet në një pjesë të një produkti që mbulohet nga një certifikatë plotësuese tipi

NËNPJESA F – NDRYSHIMET NË AVIONËT PËR TË CILËT ËSHTË DEKLARUAR PËRPUTHSHMËRIA ME PROJEKTIMIN

21L.A.101 Objekti

21L.A.102 Ndryshimet standarde

21L.A.103 Klasifikimi i ndryshimeve në projektimin e një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin

21L.A.104 Pranueshmëria

21L.A.105 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit për ndryshime të vogla

21L.A.106 Detyrimet e personit që bën një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit të një ndryshimi të vogël

21L.A.107 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit për një ndryshim të madh

21L.A.108 Veprimtaritë e përputhshmërisë për deklarimin e përputhshmërisë së një ndryshimi madhor

NËNPJESA G – ORGANIZATAT PRODHUESE TË DEKLARUARA

21L.A.121 Objekti

21L.A.122 Pranueshmëria

21L.A.123 Deklarata e aftësisë prodhuese

21L.A.124 Sistemi i menaxhimit të prodhimit

21L.A.125 Burimet e organizatës prodhuese të deklaruar

21L.A.126 Objekti i punës

21L.A.127 Detyrimet e organizatës prodhuese të deklaruar

21L.A.128 Njoftimi për ndryshime dhe ndërprerje të veprimtarive

NËNPJESA H – CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

21L.A.141 Objekti

21L.A.142 Pranueshmëria

21L.A.143 Aplikim për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore

21L.A.144 Detyrimet e aplikantit për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore

21L.A.145 Transferueshmëria dhe rilëshimi i një certifikate të vlefshmërisë ajrore dhe e një certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore brenda shteteve anëtare, ose në Republikën e Shqipërisë

21L.A.146 Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së një certifikate të vlefshmërisë ajrore dhe e një certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore

NËNPJESA I – CERTIFIKATAT E ZHURMËS DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË ZHURMËS

21L.A.161 Objekti

21L.A.162 Pranueshmëria

21L.A.163 Aplikimi

21L.A.164 Transferueshmëria dhe rilëshimi i certifikatave të zhurmës dhe certifikatave të kufizuara të zhurmës brenda Shteteve Anëtare

21L.A.165 Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së një certifikate zhurme dhe një certifikate të kufizuar të zhurmës

NËNPJESA J – ORGANIZATAT E DEKLARUARA TË PROJEKTIMIT

21L.A.171 Objekti

21L.A.172 Pranueshmëria

21L.A.173 Deklarata e aftësisë së projektimit

21L.A.174 Sistemi i menaxhimit për projektim

21L.A.175 Burimet e organizatës së deklaruar të projektimit

21L.A.176 Objekti i punës

21L.A.177 Detyrimet e organizatës së deklaruar të projektimit

21L.A.178 Njoftimi për ndryshime dhe ndërprerje të veprimtarive

NËNPJESA K – PJESËT

21L.A.191 Objekti

21L.A.192 Dëshmia e përputhshmërisë

21L.A.193 Lëshimi i pjesëve për instalim

NËNPJESA M – PROJEKTIMI I RIPARIMEVE TË PRODUKTEVE ME CERTIFIKATË TIPI

21L.A.201 Objekti

21L.A.202 Riparime standarde

21L.A.203 Klasifikimi i modeleve të riparimit në një produkt me certifikatë tipi

21L.A.204 Pranueshmëria

21L.A.205 Aplikimi për miratimin e një projektimi riparimi për një produkt me certifikatë tipi

21L.A.206 Dëshmia e përputhshmërisë

21L.A.207 Kërkesat për miratimin e një projektimi riparimi të vogël

21L.A.208 Kërkesat për miratimin e një projektimi riparimi të madh

21L.A.209 Miratimi i një projektimi riparimi sipas një privilegji

21L.A.210 Detyrimet e një mbajtësi të një miratimi projekti të riparimit

21L.A.211 Dëmtime të pa riparuar

NËNPJESA N – PROJEKTIMI I RIPARIMEVE TË AVIONËVE PËR TË CILËT ËSHTË DEKLARUAR PËRPUTHSHMËRIA E PROJEKTIMIT

21L.A.221 Objekti

21L.A.222 Riparime standarde

21L.A.223 Klasifikimi i projekteve të riparimit për një avion për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit

21L.A.224 Pranueshmëria

21L.A.225 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit për projektimet e riparimeve të vogla

21L.A.226 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit për projektimet e riparimeve të mëdha

21L.A.227 Veprimtaritë e përputhshmërisë për deklarimin e përputhshmërisë së një projekti riparimi të madh

21L.A.228 Detyrimet e deklaruesit për një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit të një projektimi riparimi

21L.A.229 Dëmtime të pa riparuar

NËNPJESA O –STANDARDI TEKNIK EVROPIAN AUTORIZIMET E POROSISË

NËNPJESA P – LEJET E FLUTURIMIT

21L.A.241 Leja për fluturim dhe kushtet e fluturimit

NËNPJESA Q – IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE DHE PJESËVE

21L.A.251 Objekti

21L.A.252 Projektimi i shënjimeve

21L.A.253 Identifikimi i produkteve

21L.A.254 Trajtimi i të dhënave të identifikimit

21L.A.255 Identifikimi i pjesëve

NËNPJESA R – DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË PËR AVIONIN DHE CERTIFIKATA E AUTORIZIMIT PËR LEJIM (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) PËR MOTORËT DHE HELIKAT, OSE PJESËT E TYRE, QË PËRPUTHEN ME NJË DEKLARATË PËRPUTHSHMËRIE PROJEKTIMI

21L.A.271 Objekti

21L.A.272 Pranueshmëria

21L.A.273 Sistemi i kontrollit të prodhimit

21L.A.274 Lëshimi i një deklarate përputhshmërie (forma 52B e RSH, sipas modelit të EASA-s) ose një certifikate autorizimi për lejim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s)

21L.A.275 Detyrimet e një personi fizik ose juridik që lëshon një deklaratë përputhshmërie (forma 52B e RSH, sipas modelit të EASA-s) ose një certifikate autorizimi për lejim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s)

SEKSIONI B – PROCEDURAT PËR AUTORITETET KOMPETENTE

NËNPJESA A – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

21L.B.11 Dokumentacioni i mbikëqyrjes

21L.B.12 Shkëmbimi i informacionit

21L.B.13 Informacion rreth Agjencisë

21L.B.14 Direktivat e vlefshmërisë ajrore të marra nga shtetet joanëtare

21L.B.15 Reagimi i menjëhershëm ndaj një problemi sigurie

21L.B.16 Sistemi i menaxhimit

21L.B.17 Caktimi i detyrave të subjektet e kualifikuara

21L.B.18 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit

21L.B.19 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

21L.B.20 Regjistrimi i të dhënave

21L.B.21 Gjetjet dhe vëzhgimet

21L.B.22 Masat zbatuese

21L.B.23 Direktivat e vlefshmërisë ajrore

21L.B.24 Mjetet e përputhshmërisë

NËNPJESA B – CERTIFIKATAT E TIPIT

21L.B.41 Specifikimet e certifikimit

21L.B.42 Hetimi fillestar

21L.B.43 Baza e certifikimit të tipit për një certifikatë tipi

21L.B.44 Kushtet e veçanta

21L.B.45 Përcaktimi i kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për një certifikatë tipi

21L.B.46 Hetimi

21L.B.47 Lëshimi i një certifikate tipi

21L.B.48 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të produkteve për të cilat është lëshuar një certifikatë tipi

21L.B.49 Transferimi i një certifikate tipi

NËNPJESA C – DEKLARATAT E PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTIMIT

21L.B.61 Specifikimet teknike të detajuara dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për deklaratat e përputhshmërisë së projektimit të produktit

21L.B.62 Hetimi fillestar i mbikëqyrjes

21L.B.63 Regjistrimi i një deklarate përputhshmërie projektimi

21L.B.64 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të avionëve për të cilët është deklaruar përputhshmëria me projektimin

PJESA D – NDRYSHIMET E CERTIFIKATAVE TË TIPIT

21L.B.81 Baza e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi

21L.B.82 Investigimi dhe lëshimi i një miratimi të një ndryshimi të vogël në një certifikatë tipi

21L.B.83 Investigimi i një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi

21L.B.84 Lëshimi i një miratimi të një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi

21L.B.85 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të produkteve të ndryshuara për të cilat është lëshuar një certifikatë tipi

NËNPJESA E – CERTIFIKATAT PLOTËSUESE TË TIPIT

21L.B.101 Baza e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për një certifikatë plotësuese tipi

21L.B.102 Hetimi

21L.B.103 Lëshimi i një certifikate plotësuese tipi

21L.B.104 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të produkteve për të cilat është lëshuar një certifikatë plotësuese tipi

NËNPJESA F – NDRYSHIMET NË AVIONËT PËR TË CILËT ËSHTË DEKLARUAR PËRPUTHSHMËRIA ME PROJEKTIMIN

21L.B.121 Hetimi fillestar i mbikëqyrjes së një deklarate përputhshmërie projektimi të një ndryshimi të madh në projektin e një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin

21L.B.122 Regjistrimi i një deklarate përputhshmërie projektimi për një ndryshim të madh në projektin e avionit

21L.B.123 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të një avioni të ndryshuar për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit

NËNPJESA G – ORGANIZATAT PRODHUESE TË DEKLARUARA

21L.B.141 Investigimi fillestar i mbikëqyrjes

21L.B.142 Regjistrimi i një deklarate të aftësisë prodhuese

21L.B.143 Mbikëqyrja

21L.B.144 Programi i mbikëqyrjes

21L.B.145 Veprimtaritë e mbikëqyrjes

21L.B.146 Ndryshimet në deklarata

NËNPJESA H – CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

21L.B.161 Investigimi

21L.B.162 Lëshimi ose ndryshimi i një certifikate të vlefshmërisë ajrore ose një certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore

21L.B.163 Mbikëqyrja

NËNPJESA I – CERTIFIKATAT E ZHURMËS

21L.B.171 Investigimi

21L.B.172 Lëshimi ose ndryshimi i certifikatave të zhurmës

21L.B.173 Mbikëqyrja

NËNPJESA J – ORGANIZATAT E DEKLARUARA TË PROJEKTIMIT

21L.B.181 Investigimi fillestar i mbikëqyrjes

21L.B.182 Regjistrimi i një deklarate për aftësinë e projektimit

21L.B.183 Mbikëqyrja

21L.B.184 Programi i mbikëqyrjes

21L.B.185 Veprimtaritë e mbikëqyrjes

21L.B.186 Ndryshimet në deklarata

NËNPJESA K – PJESËT

NËNPJESA M – PROJEKTIMI I RIPARIMEVE TË PRODUKTEVE ME CERTIFIKATË TIPI

21L.B.201 Baza e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për miratimin e projektimit të riparimit

21L.B.202 Hetimi dhe lëshimi i një miratimi për një projektim riparimi të vogël

21L.B.203 Hetimi i një aplikimi për miratimin e një projektimi riparimi të madh

21L.B.204 Lëshimi i një miratimi të një projektimi riparimi të madh

21L.B.205 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore për produktet për të cilat është miratuar një projektim riparimi

21L.B.206 Dëmtime të pa riparuar

NËNPJESA N – PROJEKTIMI I RIPARIMEVE TË AVIONËVE PËR TË CILËT ËSHTË DEKLARUAR PËRPUTHSHMËRIA E PROJEKTIMIT

21L.B.221 Hetimi fillestar i mbikëqyrjes i një deklarate përputhshmërie projektimi të një projekti riparimi të madh për një avion për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektin

21L.B.222 Regjistrimi i një deklarate të një projektimi riparimi të madh për një avion i cili është deklaruar përputhshmëria me projektimin

21L.B.223 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të një projekti riparimi për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit

NËNPJESA O – AUTORIZIMET E POROSIVE STANDARDE TEKNIKE EVROPIANE

NËNPJESA P – LEJA E FLUTURIMIT

21L.B.241 Investigimi para lëshimit të lejes për fluturim

21L.B.242 Investigimi përpara lëshimit të kushteve të fluturimit

NËNPJESA Q – IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE DHE PJESËVE

NËNPJESA R – DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË PËR AVIONËT DHE CERTIFIKATAT E AUTORIZIMIT TË LEJIMIT (forma 1 RSH, sipas modelit të EASA-s) PËR MOTORËT DHE HELIKAT, DHE PJESËT E TYRE, QË PËRPUTHEN ME NJË DEKLARATË PËRPUTHSHMËRIE PROJEKTIMI

21L.B.251 Mbikëqyrja

21L.B.252 Programi i mbikëqyrjes

21L.B.253 Veprimtaritë e mbikëqyrjes

Shtesat në Aneksin Ib

21L.1 Objekti

a) Seksioni A i këtij aneksi (Pjesa 21 Light) përcakton dispozitat që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e personave të mëposhtëm që kanë vendin e tyre kryesor të biznesit të vendosur në Republikën e Shqipërisë.

1. aplikanti dhe mbajtësi i çdo certifikate të lëshuar ose që do të lëshohet në përputhje me këtë Aneks;

2. personat fizikë dhe juridikë që deklarojnë, në përputhje me këtë aneks, përputhshmërinë e projektimit, aftësitë e projektimit ose aftësitë e prodhimit, ose që synojnë të japin deklarata të tilla;

3. nënshkruesi i deklaratës së përputhshmërisë për një avion, ose një certifikate të autorizuar për lejim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) për një motor, helikë ose pjesë të prodhuar në përputhje me këtë Aneks.

b) Seksioni B i këtij aneksi përcakton dispozitat që rregullojnë certifikimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin nga Autoriteti kompetent në përputhje me këtë aneks dhe përcakton kërkesat për administrimin dhe sistemet e tyre të menaxhimit në lidhje me ushtrimin e këtyre detyrave.

21L.2 Autoriteti kompetent

Për qëllimet e këtij aneksi, “autoriteti kompetent” është:

a) për seksionin A, nënpjesa A,

1. për organizatat e projektimit, AAC-ja ose Agjencia, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar i ZPEA-s; ndërkaj, AAC-ja mund të njohë certifikimet e kryera nga Agjencia si Autoritet Kompetent për këtë pikë, në Bashkimin Evropian;

2. për një organizatë prodhimi, Autoriteti i Aviacionit Civil, kur organizata

ka vendin e saj kryesor të biznesit në Shqipëri ose Agjencia, nëse ajo përgjegjësi i është caktuar përsëri Agjencisë në përputhje me nenin 64 ose 65 të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”;

b) për seksionin A, nënpjesët B, C, D, E, F, J, K, M, N dhe Q, AAC-ja ose Agjencia, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar i ZPEA; Ndërkaj, AAC-ja mund të njohë certifikimet e kryera nga Agjencia si Autoritet Kompetent për këtë pikë, në Bashkimin Evropian;

c) për seksionin A, nënpjesët G, H, I dhe R, AAC-ja kur organizata ka vendin kryesor të biznesit në Shqipëri; ose Agjencinë, nëse ajo përgjegjësi i është caktuar përsëri Agjencisë në përputhje me nenin 64 ose 65 të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”;

d) për seksionin A, nënpjesa P:

1. për avionët e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, AAC-ja;

2. për avionët e paregjistruar, autoriteti i caktuar nga Shteti që ka përshkruar shenjat e identifikimit;

3. për miratimin e kushteve të fluturimit në lidhje me sigurinë e projektimit, AAC-ja ose Agjencia, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar i ZPEA-s Agjencia; ndërkaj, AAC-ja mund të njohë certifikimet e kryera nga Agjencia si Autoritet Kompetent për këtë pikë, në Bashkimin Evropian;

SEKSIONI A KËRKESAT TEKNIKE NËNPJESA A – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

21L.A.1 Objekti

Ky seksion përcakton të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme që janë të zbatueshme, për:

a) aplikantin dhe mbajtësin e çdo certifikate të lëshuar ose që do të lëshohet në përputhje me këtë aneks;

b) çdo deklarues të aftësisë së projektimit ose prodhimit ose përputhshmërisë së projektimit; dhe

c) çdo person fizik ose juridik që lëshon një deklaratë përputhshmërie për një avion, ose një certifikatë autorizimi për lëshim (forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) për një motor, helikë ose pjesë të prodhuar.

21L.A.2 Detyrimet dhe veprimet e kryera nga një person i ndryshëm nga aplikanti, mbajtësi i një certifikate ose deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi

Veprimet dhe detyrimet që kërkohen të ndërmerren nga aplikanti ose mbajtësi i një certifikate për një produkt ose pjesë ose nga deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi sipas këtij seksioni mund të ndërmerren në emër të tij nga çdo person tjetër fizik ose juridik, me kusht që detyrimet e aplikantit, mbajtësit ose deklaruesit të jenë dhe të përmbushen siç duhet.

21L.A.3 Sistemi i raportimit

a) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të saj, çdo person fizik ose juridik që zotëron ose ka aplikuar për një certifikatë tipi, certifikatë plotësuese tipi, miratim projektimi të një riparimi madhor, ose çdo certifikatë tjetër përkatëse që konsiderohet se është lëshuar sipas këtij aneksi, ose që ka deklaruar përputhshmërinë e një projektimi avioni, ose një ndryshimi në projektim ose projektim riparimi të tij sipas këtij aneksi:

1. krijon dhe mirëmban një sistem për mbledhjen, hetimin dhe analizimin e raporteve të ngjarjeve për të identifikuar tendencat e pafavorshme ose për të adresuar mangësitë, dhe për të identifikuar ngjarjet, raportimi i të cilave është i detyrueshëm në përputhje me pikën (3) dhe ato që raportohen vullnetarisht. Sistemi i raportimit përmban:

i) raportet dhe informacionet në lidhje me mosfunksionimet, keq-funksionimet, defektet ose ngjarje të tjera që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë efekte negative në vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit ose pjesës së mbuluar nga certifikata e tipit, certifikata plotësuese e tipit, miratimi i projektimit të riparimit të madh ose çdo certifikatë tjetër përkatëse që konsiderohet të jetë lëshuar sipas këtij aneksi, ose nga deklarata e përputhshmërisë së projektimit të lëshuar sipas këtij aneksi;

ii) raportet e gabimeve, defektet e ngjashme dhe rreziqeve që nuk përfshihen në pikën (i);

2. u vë në dispozicion operatorëve të njohur të produktit ose pjesës dhe, sipas kërkesës, çdo personi të autorizuar sipas akteve të tjera zbatuese të lidhura ose akteve të deleguara, informacionin në lidhje me sistemin e krijuar në përputhje me pikën (a) (1) dhe se si të sigurojë raporte të tilla dhe informacione në lidhje me mosfunksionimet, keq-funksionimet, defektet ose ngjarje të tjera të përmendura në pikën (a) (1) (i);

3. raporton tek Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 çdo mosfunksionim, keq-funksionim, defekt ose ngjarje tjetër për të cilën ata janë në dijeni lidhur me një produkt ose pjesë, të mbuluar nga certifikata e tipit, certifikata plotësuese e tipit, miratimi i projektit të një riparimi të madh ose çdo certifikatë tjetër përkatëse që mendohet se është lëshuar sipas këtij Aneksi, ose nga një deklaratë përputhshmërie projektimi e lëshuar sipas këtij Aneksi, dhe e cila ka rezultuar ose mund të rezultojë në një gjendje të pasigurt.

b) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 për miratimin e rregullores “Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, çdo person fizik ose juridik që ka deklaruar aftësinë e tij prodhuese sipas nënpjesës G të këtij Aneksi, ose që prodhon një produkt ose pjesë sipas nënpjesës R të këtij aneksi:

1. krijon dhe të mirëmban një sistem për mbledhjen dhe vlerësimin e raporteve të ngjarjeve të brendshme, duke përfshirë raportet për gabimet e brendshme, humbjet në tentative dhe rreziqet, në mënyrë që të identifikohen tendencat negative ose të adresohen mangësitë, dhe të nxirren ngjarjet, raportimi i të cilave është i detyrueshëm në përputhje me pikat (2) dhe (3) dhe ato që raportohen në mënyrë vullnetare;

2. i raporton mbajtësit përgjegjës të miratimit të projektimit ose deklaruesit të një deklaratë përputhshmërie projektimi, të gjitha rastet në të cilat produktet ose pjesët janë lëshuar prej tyre dhe më pas janë identifikuar se kanë devijime të mundshme nga të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe heton me mbajtësin e miratimit të projektimit ose deklaruesin e një deklaratë përputhshmërie projektimi, për të identifikuar ato devijime që mund të çojnë në një gjendje të pasigurt;

3. raporton tek Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëse ka, devijimet që mund të çojnë në një gjendje të pasigurt dhe që janë identifikuar sipas pikës (2) të pikës 21L.A.3(b);

4. nëse vepron si furnizues për një organizatë tjetër prodhuese, raporton në atë organizatë tjetër të gjitha rastet në të cilat ka lëshuar produkte ose pjesë në atë organizatë dhe më pas i ka identifikuar ato që kanë devijime të mundshme nga të dhënat e zbatueshme të projektimit.

Detyrimet e raportimit të pikës 21.A.3A(b) të aneksit I për personat fizikë dhe juridikë që zotërojnë ose kanë aplikuar për miratimin e një organizate prodhuese përfshijnë ngjarjet që lidhen me produktet dhe pjesët e prodhuara në përputhje me të dhënat e projektimit të miratuara ose të deklaruara në përputhje me këtë aneks dhe, kur është deklaruar përputhshmëria e projektimit, raportohet te deklaruesit e përputhshmërisë së projektimit.

c) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, çdo person fizik ose juridik i përmendur në pikat (a) dhe (b) kur raporton në përputhje me pikat (a) (3), (b) (2), (b) (3) dhe (b) (4), ruan siç duhet konfidencialitetin e raportuesit dhe të personave të përmendur në raport.

d) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, çdo person fizik ose juridik i përmendur në pikat (a) dhe (b) harton raportet e përcaktuara në pikat (a) (3) dhe (b). (3) në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga AAC-ja sa më shpejt të jetë e mundur, dhe në çdo rast, dërgon raportet jo më vonë se 72 orë pasi personi fizik ose juridik i përmendur në pikat (a) dhe (b) të ketë identifikuar gjendjen e mundshme të pasigurt, përveç nëse rrethanat e jashtëzakonshme e pengojnë këtë.

e) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 për miratimin e rregullores “Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, nëse një ngjarje e raportuar sipas pikës (a) (3) ose nën pikën (b) (3) rezulton nga një mangësi në projektim ose një mangësi në prodhim, mbajtësi i certifikatës së tipit, certifikatës plotësuese të tipit, miratimit të projektit të riparimit të madh, ose çdo certifikatë tjetër përkatëse që konsiderohet të jetë lëshuar sipas këtij aneksi, deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi ose organizata e prodhimit të përmendur në pikën (b) sipas rastit, heton arsyen e mungesës dhe raporton tek Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëse ka, rezultatet e hetimit dhe çdo veprim që po ndërmerret ose propozon për të korigjuar atë mangësi.

f) Nëse AAC-ja konstaton se kërkohet një veprim për të korigjuar mangësitë, mbajtësi i certifikatës së tipit, certifikatës plotësuese të tipit, miratimit të projektimit të një riparimi të madhor ose çdo certifikatë tjetër përkatëse që konsiderohet të jetë lëshuar sipas këtij aneksi, deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi, ose organizata prodhuese e përmendur në pikën (b) sipas rastit, dorëzon të dhënat përkatëse tek AAC-ja me kërkesën e tij.

21L.A.4 Direktivat e vlefshmërisë ajrore

Kur duhet të lëshohet një direktivë e vlefshmërisë ajrore nga Autoriteti Kompetent në përputhje me pikën 21L.B.23 për të korigjuar një gjendje të pasigurt, ose për të kërkuar kryerjen e një inspektimi, mbajtësi i certifikatës së tipit, certifikatës plotësuese të tipit, miratimit të projektit të një riparimi të madh, ose çdo certifikatë tjetër përkatëse që konsiderohet se është lëshuar sipas këtij Aneksi, si dhe deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi, sipas rastit:

a) propozon veprimet e duhura korigjuuese ose inspektimet e nevojshme, ose të dyja, dhe dorëzon detajet e këtyre propozimeve në Autoritetin Kompetent për miratim;

b) vë në dispozicion të të gjithë operatorët ose pronarët e njohur të produktit ose pjesës dhe, sipas kërkesës, çdo personi që kërkohet të respektojë direktivën e vlefshmërisë ajrore, të dhëna përshkruese të përshtatshme dhe udhëzimet e realizimit, pas miratimit nga Autoriteti Kompetent të propozimeve të përmendura në pikën (a).

21L.A.5 Bashkëpunimi ndërmjet projektimit dhe prodhimit

Mbajtësi i një certifikate tipi, certifikate plotësuese tipi, miratimit të një ndryshimi në certifikatën e tipit ose miratimit të një projektimi riparimi, deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi dhe organizata ose personi fizik ose juridik që prodhon produkte ose pjesë të atij modeli specifik bashkëpunon për të siguruar që produkti ose pjesa të jetë në përputhje me atë projektim dhe për të siguruar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit ose pjesës.

21L.A.6 Shënjimi

a) Mbajtësi i një certifikate tipi, certifikate plotësuese tipi, miratimi të një ndryshimi në certifikatën e tipit ose miratimi të një projekti riparimi, ose deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi specifikon shënjimin për produktet ose pjesët në përputhje me Nën pjesën Q të këtij Aneksi.

b) Organizata ose personi fizik ose juridik që prodhon produkte ose pjesë i shënon këto produkte dhe pjesë në përputhje me Nën pjesën Q të këtij Aneksi.

21L.A.7 Regjistrimi i të dhënave

Të gjithë personat fizikë ose juridikë që zotërojnë ose që kanë aplikuar për një certifikatë tipi, certifikatë plotësuese tipi, miratim të projektit të riparimit ose leje për të fluturuar, të cilët kanë deklaruar përputhshmërinë e projektit, që kanë lëshuar një deklaratë të aftësisë së projektimit ose prodhimit, ose që prodhojnë produkte ose pjesët sipas kësaj rregulloreje:

a) kur projektojnë një produkt ose pjesë ose ndryshime ose riparime në të, krijojnë një sistem të mbajtjes së të dhënave që përfshin kërkesat e vendosura ndaj partnerëve dhe nënkontraktorëve dhe ruajnë informacionin/të dhënat përkatëse të projektimit dhe mbajnë në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, për të ofruar informacionin e nevojshëm për të siguruar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë së tyre ajrore dhe përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit;

b) kur prodhojnë një produkt ose pjesë, krijojnë një sistem regjistrimi dhe regjistrojnë detajet e punës në lidhje me përputhshmërinë e produkteve ose pjesëve, dhe kërkesat e vendosura ndaj partnerëve dhe furnizuesve të tij, dhe i mbajnë ato në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, për të ofruar informacionin e nevojshëm me qëllim sigurimin e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të produktit dhe pjesës;

c) në lidhje me lejet e fluturimit, përveç kërkesave për mbajtjen e të dhënave të përcaktuara në pikën 21.A.5(c) të Aneksit I, regjistrojnë çdo dokument të prodhuar për të dëshmuar përputhjen me kërkesat shtesë të përcaktuara në pikën 21L.A.241(b), dhe i mbajnë ato në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2.

d) ruajnë të dhënat e kompetencave dhe kualifikimet e personelit që është i përfshirë në projektim ose prodhim dhe funksionin e pavarur për të monitoruar përputhshmërinë, nëse kërkohet nga pikat 21L.A.125(c), 21L.A.175(b) ose 21L.A.175 (e).

21L.A.8 Manualët

Mbajtësi i një certifikate tipi ose certifikate plotësuese tipi ose deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi, prodhon, mirëmban dhe përditëson kopjet kryesore të të gjitha manualeve ose ndryshimeve në manualët e kërkuara nga baza e zbatueshme të certifikimit të tipit, specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për produktin ose pjesën, dhe i siguron Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, kopje, sipas kërkesës.

21L.A.9 Udhëzime për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore

a) Mbajtësi i një certifikate tipi, certifikate plotësuese tipi, ndryshimi të projektit ose miratimi të një projekti riparimi ose deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi, përcakton informacionin që është i nevojshëm për të siguruar që vlefshmëria ajrore e tipit të avionit dhe çdo pjesë shoqëruese, në përputhje me këtë projektim, mirëmbahet gjatë gjithë jetës operacionale.

b) Mbajtësi i një certifikate tipi, certifikate plotësuese tipi, ndryshimi të projektimit ose miratimi të projektit të riparimit ose deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi, siguron informacionin e përcaktuar në (a) përpara se ai projekt të lëshohet në shërbim.

c) Udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore sigurohen nga:

1. mbajtësi i një certifikate tipi ose nga deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi për secilin pronar të njohur të një ose më shumë produkteve me dorëzimin e tij ose pas lëshimit të certifikatës së parë të vlefshmërisë ajrore ose certifikatës së kufizuar të vlefshmërisë ajrore, sipas rastit, për avionin e prekur, cilido që të ndodhë më vonë;

2. mbajtësi i një certifikate tipi, certifikate plotësuese tipi ose miratimi të një ndryshimi të vogël ose nga deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi për një ndryshim projektimi për të gjithë operatorët e njohur të produktit të prekur nga ndryshimi pas lëshimit në shërbim të produktit të modifikuar;

3. mbajtësi i një miratimi projektimi të riparimit ose nga deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi për një projektim riparimi për të gjithë operatorët e njohur të produktit të prekur nga riparimi pas lëshimit në shërbim të produktit në të cilin është përvetësuar projektimi i riparimit. Produkti ose pjesa e riparuar mund të lëshohet për shërbim përpara se të plotësohen udhëzimet përkatëse për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, por kjo do të jetë për një periudhë shërbimi të kufizuar dhe në marrëveshje me Autoritetin Kompetent sipas pikës 21L.2.

Pas kësaj, këta mbajtës të certifikatave ose deklarues e vendosin këtë informacion në dispozicion sipas kërkesës çdo personi tjetër që duhet të veprojë në përputhje me këto udhëzime për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore.

d) Me përjashtim të pikës (b), mbajtësi i certifikatës së tipit ose deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi mund të vonojë disponueshmërinë e një pjese të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, që kanë të bëjnë me udhëzimet e gjata të kryera të një natyre të planifikuar, deri pas përfundimit të produktit ose pasi produkti i modifikuar ka hyrë në shërbim, por vë në dispozicion këto udhëzime përpara se përdorimi i këtyre të dhënave të kërkohej për produktin ose produktin e modifikuar.

e) Mbajtësi i miratimit të projektimit ose deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi, të cilit i kërkohej të japë udhëzime për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, në përputhje me pikën (b) vë gjithashtu në dispozicion të gjitha ndryshimet në këto udhëzime për të gjithë operatorët e njohur të produktit të prekur nga ndryshimi dhe, sipas kërkesës, për çdo person tjetër që kërkohej veprojë në përputhje me këto ndryshime.

21L.A.10 Aksesi dhe hetimi

Të gjithë personat fizikë ose juridikë që zotërojnë ose që kanë aplikuar për një certifikatë tipi, certifikatë plotësuese tipi, miratim projekti për riparime të mëdha, leje për fluturim, certifikatë të vlefshmërisë ajrore, certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore, certifikatë zhurme ose certifikatë të kufizuar zhurme, të cilët kanë deklaruar përputhshmërinë e projektit, kanë deklaruar aftësinë e tyre të projektimit ose prodhimit ose që prodhojnë avionë, motorë, helika ose pjesë sipas Nën-pjesës R të këtij Aneksi:

a) i japin akses AAC-së në çdo objekt, produkt, pjesë, dokument, regjistrim, të dhëna, procese, procedura ose çdo material tjetër, lejojnë rishikimin e çdo raporti, bëjnë çdo inspektim dhe kryejnë ose dëshmojnë çdo test që është i nevojshëm për të verifikuar përputhshmërinë dhe vazhdueshmërinë e përputhshmërisë me kërkesat e zbatueshme të këtij Seksioni;

b) nëse personi fizik ose juridik përdor partnerë, furnizues ose nënkontraktorë, lidh marrëveshje me ta për të siguruar që AAC-ja ka akses dhe mund të hetojë siç përshkruhet në pikën (a).

21L.A.11 Gjetjet dhe observacionet

a) Pas marrjes së njoftimit të gjetjeve, personi fizik ose juridik që zotëron ose që ka aplikuar për një certifikatë tipi, certifikatë plotësuese tipi, miratim të projektimit të riparimit të madh, leje për fluturim, certifikatë të vlefshmërisë ajrore, certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore, certifikatë zhurme ose certifikatë të kufizuar zhurme, që ka deklaruar përputhshmërinë e projektimit, aftësinë e tyre të projektimit apo prodhimit ose që prodhon avionë, motorë, helika ose pjesë sipas nënpjesës R të këtij aneksi, ndërmerri hapat në vijim brenda periudhës kohore të përcaktuar nga AAC-ja në përputhje me pikën (d) ose (e) të pikës 21L.B.21:

1. identifikon shkakun kryesor të mospërputhjes dhe faktorët kontribuues;
2. përcakton një plan veprimi korrigjues dhe ia propozon atë AAC-së;
3. dëshmon zbatimin e veprimeve korrigjuese sipas kërkesës së AAC-së.

b) Një observacion i njoftuar nga AAC-ja në përputhje me pikën (f) të pikës 21L.B.21 duhet të merret në konsideratë. Personi fizik ose juridik regjistron vendimin e marrë në lidhje me këto observacione.

21L.A.12 Mjetet e përputhshmërisë

a) Një person juridik ose fizik mund të përdorë çdo mjet alternativ përputhshmërie ndaj mjeteve të pranueshme të përputhshmërisë (AMC) për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë rregullore.

b) Nëse një person fizik ose juridik dëshiron të përdorë një mjet alternativ përputhshmërie, përpara se ta përdorin atë, paraqesin tek AAC-ja një përshkrim të plotë. Përshkrimi përfshin çdo rishikim të manualeve ose procedurave që mund të jenë të përshtatshme, si dhe një shpjegim që tregon se si arrihet përputhshmëria me këtë rregullore.

c) Personi fizik ose juridik mund të përdorë këto mjete alternative të përputhshmërisë, që i nënshtrohen miratimit paraprak nga AAC-ja.

NËNPJESA B – CERTIFIKATAT E TIPIT

21L.A.21 Objekti

Kjo nënpjesë përcakton procedurën e aplikimit për certifikata tipi dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre certifikatave për produkte, nëse produkti është një nga lista në vijim:

a) një aeroplan me një masë maksimale ngritjeje (MTOM) prej 2000 kg ose më pak, me një konfigurim për ndenjësë maksimumi për katër persona;

b) një planer (glajder) ose planer me motor me një MTOM prej 2000 kg ose më pak;

c) një balonë;

d) një aerostat me ajër të nxehtë;

e) një aerostat pasagjerësh me gaz i projektuar për jo më shumë se katër persona;

f) një helikopter me një MTOM prej 1200 kg ose më pak me një konfigurim ndenjësesh maksimumi për katër persona;

g) një motor me piston dhe një helikë me krah rrotullimi të fiksuar që synohet të instalohen në një avion siç përmendet në pikat (a) deri (f). Në raste të tilla, në specifikimet e certifikatës së tipit shënohet në mënyrë të përshtatshme që instalimi i motorit ose helikës, lejohet vetëm në një avion të tillë;

h) xhiroplanet.

21L.A.22 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik që ka dëshmuar ose është në proces dëshmimi të aftësisë së tij të projektimit në përputhje me pikën 21L.A.23, mund të aplikojë për një certifikatë tipi sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë.

21L.A.23 Dëshmia e aftësisë së projektimit

Një aplikant për një certifikatë tipi dëshmon aftësinë e tij të projektimit duke:

a) zotëruar një miratim të organizatës së projektimit me kushte miratimi që mbulojnë kategorinë përkatëse të produktit, të lëshuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, në përputhje me nënpjesën J të seksionit A të aneksit I (Pjesa 21); ose

b) duke deklaruar aftësinë e tyre projektuese për llojin e punës së projektimit dhe kategorinë e produktit në përputhje me nënpjesën J të këtij aneksi.

21L.A.24 Aplikimi për një certifikatë tipi

a) Aplikimi për certifikatë tipi bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

b) Një aplikim për një certifikatë tipi përfshin së paku:

1. një justifikim që aplikimi është brenda objektivit të përcaktuar në pikën 21L.A.21;

2. të dhënat përshkruese paraprake të produktit, përdorimin e synuar dhe llojin e funksionimit të produktit për të cilin kërkohet certifikimi;

3. një propozim për bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, të përgatitur në përputhje me kërkesat dhe opsionet e përcaktuara në pikat 21L.B.43 dhe 21L.B.45;

4. një plan dëshmie rreth përputhshmërisë që detajon mjetet dhe metodat e përputhshmërisë që do të përditësohen nga aplikanti kur ka ndryshime në projektin e certifikimit që prek pikat (1) deri në (3) ose ndonjë ndryshim në mjetet dhe metodat e përputhshmërisë.

c) Një aplikim për një certifikatë tipi mbetet i vlefshëm për 3 vjet. Në rast se një certifikatë tipi nuk është lëshuar brenda kësaj periudhe, atëherë bëhet një aplikim i ri në përputhje me pikat (a) dhe (b).

21L.A.25 Dëshmia e përputhshmërisë

a) Aplikanti i një certifikate tipi, pas pranimin të planit të dëshmisë së përputhshmërisë nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 dhe në përputhje me përmbajtjen:

1. dëshmon përputhshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit siç përcaktohet dhe njoftohet tek aplikanti nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me pikën 21L.B.43;

2. dëshmon përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç përcaktohet dhe njoftohet tek aplikanti nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me pikën 21L.B.45; dhe

3. siguron për Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, mjetet me të cilat dëshmohet një përputhshmëri e tillë.

b) Aplikanti i një certifikate tipi siguron për Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, një arsyetim të regjistruar të mjeteve të përputhshmërisë brenda dokumenteve të përputhshmërisë sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë.

c) Kur kryen teste dhe inspekte për të dëshmuar përputhshmërinë në përputhje me pikën (a), aplikanti ka verifikuar dhe dokumentuar këtë verifikim përpara kryerjes së ndonjë testimi:

1. për çdo testim provë, që:

i) materialet dhe proceset janë në përputhje të pranueshme me specifikimet për projektin e tipit të propozuar;

ii) pjesët përbërëse të produkteve përputhen në mënyrë të pranueshme me skicat në modelin e tipit të propozuar;

iii) proceset e prodhimit, ndërtimi dhe montimi janë në përputhje të pranueshme me ato të specifikuara në projektimin e tipit të propozuar; dhe

2. që testimi dhe pajisjet matëse të përdorura për testimin ishin të përshtatshme për këtë të fundit dhe të kalibruara siç duhet.

d) Testimi i fluturimit për marrjen e certifikatës së tipit kryhet në përputhje me metodat për testimin e tillë të fluturimit që përcaktohen nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2. Aplikanti për një certifikatë tipi duhet të kryejë të gjitha testimet e fluturimit të nevojshme për të përcaktuar

përputhshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit. Testimet e fluturimit përfshijnë një periudhë operimi në një konfigurim përfundimtar me një kohëzgjatje të mjaftueshme për të siguruar që nuk do të ketë probleme sigurie kur avioni të hyjë për herë të parë në shërbim.

e) Aplikanti i një certifikate tipi lejon Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 që:

1. të shqyrtojë çdo të dhënë dhe informacion në lidhje me dëshminë e përputhshmërisë;
2. të dëshmojë ose kryejë ndonjë testim ose inspektim me qëllim të dëshmisë së përputhshmërisë;
3. të kryejë një inspektim fizik të artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin përfundimtar për të verifikuar përputhjen e projektimit me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe çdo hetim tjetër të përcaktuar në përputhje me pikën 21L.B.46.

f) Pas përfundimit të dëshmisë së përputhshmërisë, aplikanti i deklaron Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 se:

1. ata kanë dëshmuar përputhshmëri me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç janë përcaktuar dhe njoftuar aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikat 21L.B.43 dhe 21L.B.45, sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë; dhe

2. nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

21L.A.26 Projektimi i tipit

Aplikanti i një certifikate tipi përcakton llojin e projektimit të produktit për të mundësuar identifikimin e tij unik dhe të paqartë, i cili përbëhet nga:

a) skicat dhe specififikimet dhe një listë e atyre skicave dhe specifikimeve që janë të nevojshme për të përcaktuar konfigurimin dhe tiparet e projektimit të produktit;

b) informacioni mbi materialet dhe proceset e përdorura;

c) informacioni mbi metodat e prodhimit dhe montimit;

d) çdo kufizim të vlefshmërisë ajrore;

e) kërkesat e përputhshmërisë mjedisore; dhe

f) çdo e dhënë tjetër që lejon krahasimin e përcaktimit të vlefshmërisë ajrore dhe, nëse është e nevojshme, përputhshmërinë mjedisore të produkteve të mëvonshme të të njëjtit lloj.

21L.A.27 Kërkesat për lëshimin e një certifikate tipi

Për t'u pajisur me një certifikatë tipi, aplikanti:

a) dëshmon aftësinë projektuese në përputhje me pikën 21L.A.23;

b) dëshmon përputhshmërinë e projektimit në përputhje me pikën 21L.A.25;

c) dëshmon, për certifikatat e tipit të avionit, se motori ose helika, ose të dyja, nëse janë të instaluar në avion, kanë ose:

1. një certifikatë tipi të lëshuar ose të përcaktuar në përputhje me aneksin I (Pjesa 21) ose të lëshuar në përputhje me këtë aneks; ose

2. është përfshirë në aplikimin për certifikatën e tipit të avionit dhe aplikanti ka siguruar përputhshmërinë e motorit dhe helikës gjatë dëshmisë të përputhshmërisë në pikën 21L.A.25;

d) dëshmon se nuk ka çështje të pazgjidhura nga inspektimi fizik i artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin përfundimtar ose ndonjë hetim tjetër i kryer nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikat (c) dhe (d) të pikës 21L.B.46.

21L.A.28 Detyrimet e mbajtësit të certifikatës së tipit

Mbajtësi i një certifikate tipi merr përsipër detyrimet e një mbajtësi të certifikatës së tipit të përcaktuar në Nën pjesën A të këtij Aneksi dhe vazhdon të përmbushë kërkesat e pranueshmërisë sipas pikës 21L.A.22.

21L.A.29 Transferueshmëria e një certifikate tipi

Një certifikatë tipi mund t'i transferohet një mbajtësi të ri, me kusht që Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 të ketë verifikuar, në përputhje me pikën 21L. B.49, që personi fizik ose juridik të cilit

synohet t'i transferohet certifikata e tipit është i përshtatshëm në përputhje me pikën 21L.A.22 për të mbajtur një certifikatë tipi dhe është në gjendje të marrë përsipër detyrimet e një mbajtësi të certifikatës së tipit sipas pikës 21L.A.28. Mbajtësi i certifikatës së tipit ose personi fizik ose juridik i cili dëshiron të miratojë certifikatën, i drejtohet Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 për të verifikuar nëse këto kushte janë përmbushur, në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga ky Autoritet.

21L.A.30 Vazhdueshmëria e vlefshmërisë të një certifikate tipi

- a) Një certifikatë tipi mbetet e vlefshme për sa kohë:
 1. certifikata e tipit nuk dorëzohet nga mbajtësi;
 2. mbajtësi i certifikatës së tipit vepron në përputhje me kërkesat përkatëse të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil", duke marrë parasysh dispozitat në lidhje me trajtimin e gjetjeve të përcaktuara në pikën 21L. B.21;
 3. certifikata e tipit nuk revokohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2. në përputhje me pikën 21L.B.22.
- b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata e tipit i kthehet Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

21L.A.41 Objekti

- a) Kjo nënpjesë përcakton procedurën për deklarimin e përputhshmërisë së projektimit të avionit dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e personave që bëjnë deklaratat të tilla.
- b) Kjo nënpjesë zbatohet për kategoritë e mëposhtme të avionëve, me kusht që projektimi i avionit të mos përfshijë karakteristika të reja ose të pazakonta të projektimit:
 1. një aeroplan me një masë maksimale ngritjeje (MTOM) prej 1200 kg ose më pak që nuk është me fuqi reaktive dhe ka një konfigurim ndenjësesh maksimumi për dy persona;
 2. një planer (glajder) ose planer me motor me një MTOM prej 1200 kg ose më pak;
 3. një balonë të projektuar për jo më shumë se katër persona;
 4. një aerostat me ajër të nxehtë i projektuar për jo më shumë se katër persona.
- c) Për qëllimin e kësaj nënpjesë, një veçori e projektimit do të konsiderohet si e re ose e pazakontë nëse në kohën kur bëhet deklarata e përputhshmërisë së projektimit, ajo veçori e projektimit nuk mbulohet nga specifikimet teknike të detajuara që janë përcaktuar dhe vënë në dispozicion nga Agjencia në përputhje me pikën 21L.B.61.

21L.A.42 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik mund të deklarojë përputhshmërinë e një projektimi avioni sipas kushteve të përcaktuara në këtë Nënpjesë.

21L.A.43 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit

- a) Përpara se të prodhojë një avion ose të bjerë dakord me një organizatë prodhuese për të prodhuar një avion, një person fizik ose juridik që projekton atë avion deklaron se projektimi i tij është në përputhje me specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të përmendura në pikën 21L.A.45.
- b) Deklarata bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 dhe përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:
 1. emrin e personit që dorëzon deklaratën dhe adresën/vendin e biznesit të tij;
 2. një referencë unike për identifikimin e avionit;
 3. tregimin e specifikimeve teknike të zbatueshme në mënyrë të detajuar dhe të kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit sipas pikës 21L.A.45 me të cilat deklaruesi deklaron përputhshmërinë;
 4. një deklaratë të nënshkruar e cila është hartuar nën përgjegjësinë e vetme të personit që bën deklaratën se projektimi i avionit, dhe nëse është e aplikueshme motori ose helika, është në përputhje me specifikimet teknike të zbatueshme në mënyrë të detajuar dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen

e mjedisit të përmendura në pikën 3, sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë të përmendur në pikën (c) (3);

5. një deklaratë të nënshkruar e cila është hartuar nën përgjegjësinë vetëm të personit që bën deklaratën se nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë nga ai person që mund ta bëjnë avionin të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimin e synuar;

6. një angazhim të nënshkruar se personi që bën deklaratën do të marrë përsipër detyrimet e përmendura në pikën 21L.A.47;

7. nëse projektimi i avionit i mbuluar nga deklarata përfshin një motor ose helikë:

i) një referencë për certifikatën e tipit të motorit ose të helikës të lëshuar ose të përcaktuar në përputhje me aneksin I (Pjesa 21) ose të lëshuar në përputhje me këtë aneks; ose

ii) në rastin e motorëve me piston dhe helikave me krah rrotullimi fiks, një deklaratë që deklarata e përputhshmërisë së projektimit të avionit mbulon përputhshmërinë e motorit ose të helikës me specifikimet teknike të zbatueshme të motorit ose të helikës;

8. udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore;

9. kufizimet e operimit;

10. fletën e të dhënave për vlefshmërinë ajrore dhe, nëse është e zbatueshme, emetimet;

11. fletën e të dhënave për zhurmën, nëse është e zbatueshme;

12. çdo kusht ose kufizim tjetër të përshkruar për avionin, dhe nëse është e aplikueshme motorin ose helikën, në specifikimet e detajuara teknike të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit me të cilat deklaruesi deklaron përputhshmërinë.

c) Deklaruesi dorëzon deklaratën e përputhshmërisë së projektimit të përmendur në pikën (b) tek Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2. Së bashku me këtë deklaratë, deklaruesi i ofron këtij Autoriteti:

1. një skicë të avionit;

2. një përshkrim të detajuar të projektimit të avionit, duke përfshirë të gjitha konfigurimet e mbuluara nga deklarata, karakteristikat e funksionimit, veçoritë e projektimit dhe çdo kufizim;

3. një plan dëshmie të përputhshmërisë që detajon mjetet me të cilat është dëshmuar përputhshmëria me specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit gjatë dëshmisë së përputhshmërisë;

4. justifikimet e regjistruara të përputhshmërisë të marra nga veprimtaritë e përputhshmërisë që janë kryer sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë;

5. nëse përputhshmëria dëshmohet me anë të testimeve, justifikimin e regjistruar të përputhshmërisë së artikujve dhe pajisjeve të testimit, duke dëshmuar:

i) për testimin provë, që:

A) materialet dhe proceset janë në përputhje të pranueshme me specifikimet për projektimin;

B) pjesët përbërëse të produkteve janë përshtatur në mënyrë të pranueshme me skicat në projektim; dhe

C) proceset e prodhimit, ndërtimi dhe montimi janë në përputhje të pranueshme me ato të specifikuar në projektim;

ii) që testimi dhe pajisjet matëse të përdorura për testimin ishin të përshtatshme për testimin dhe të kalibruara siç duhet;

6. raportet, rezultatet e inspektimeve ose testimeve që deklaruesi i ka parë të nevojshme për të përcaktuar se avioni, dhe nëse është e zbatueshme motori ose helika, përputhen me specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

21L.A.44 Veprimtaritë e përputhshmërisë për një deklaratë përputhshmërie projektimi

Përpara se të bëjë një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit në përputhje me pikën 21L.A.43, deklaruesi përgjegjës për projektimin e atij avionit, për atë projektim specifik të avionit do të:

a) hartojë një plan të dëshmisë së përputhshmërisë duke detajuar mënyrat e dëshmisë së përputhshmërisë që do të ndiqen gjatë kësaj dëshmie. Ky dokument do të përditësohet sipas nevojës;

b) regjistrojë justifikimin e përputhshmërisë në dokumentet e pajtueshmërisë sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë;

c) kryejë testimet dhe inspektimet sipas nevojës në përputhje me planin e dëshmisë së përputhshmërisë;

d) sigurojë dhe regjistrojë përputhshmërinë e artikujve dhe pajisjeve të testit dhe të sigurojë që testimi provë është në përputhje me specifikimet, skicat, proceset e prodhimit, mjetet e ndërtimit dhe montimit për projektimin;

e) sigurojë që pajisjet e testimit dhe matjes që do të përdoren për testim janë të përshtatshme për testim dhe të kalibruar siç duhet;

f) të lejojë Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2, të kryejë ose të marrë pjesë në çdo inspektim ose testim të avionit në konfigurimin përfundimtar ose të maturuar të projektimit dhe prodhimit që janë të nevojshme për të përcaktuar se produkti nuk ka asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë avionin të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimin e synuar;

g) të kryejë testimet e fluturimit, në përputhje me metodat për testimet e fluturimit të specifikuar nga Agjencia, për të përcaktuar nëse avioni është në përputhje me specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit. Testimet e fluturimit përfshijnë një periudhë operimi në një konfigurim përfundimtar me një kohëzgjatje të mjaftueshme për të siguruar që nuk do të ketë probleme sigurie kur avioni të hyjë për herë të parë në shërbim.

21L.A.45 Specifikimet teknike të detajuara dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit që janë të zbatueshme për avionët që i nënshtrohen deklaratave të përputhshmërisë së projektimit

Deklaruesi duhet të vërtetojë përputhshmërinë e projektimit të avionit me specifikimet teknike të detajuara dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të përmendura në pikën 21L.B.61, të cilat janë të zbatueshme për atë avion dhe janë efektive në datën në të cilën deklarata e përputhshmërisë së projektimit i bëhet Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

21L.A.46 Të dhënat e projektimit të avionit

a) Deklaruesi duhet të përcaktojë qartë projektimin e avionit për të mundësuar identifikimin e tij unik dhe të qartë.

b) Të dhënat e projektimit të avionit që përdoren nga deklaruesi për të përcaktuar në mënyrë unike projektimin e avionit do të përfshijnë si në vijim:

1. skicat dhe specifikimet dhe një listë e atyre skicave dhe specifikimeve që janë të nevojshme për të përcaktuar konfigurimin dhe tiparet e projektimit të produktit;

2. informacioni mbi materialet dhe proceset e përdorura;

3. informacioni mbi metodat e prodhimit dhe montimit;

4. çdo kufizim të vlefshmërisë ajrore;

5. kërkesat e përputhshmërisë mjedisore; dhe

6. çdo e dhënë tjetër që lejon krahasimin e përcaktimit të vlefshmërisë ajrore dhe, nëse është e nevojshme, përputhshmërinë mjedisore të produkteve të mëvonshme të të njëjtit lloj.

21L.A.47 Detyrimet e deklaruesit për një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit

Deklaruesi që ka bërë një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit të avionit në Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me pikën 21L.A.43 do të:

a) pas dorëzimit të deklaratës, bëjë të mundur që Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, të kryejë një inspektim fizik dhe testimet e fluturimit të artikullit të parë të atij avioni në konfigurimin përfundimtar ose të duhur të zhvilluar për të siguruar që avioni mund të arrijë një nivel të pranueshëm sigurie dhe është në përputhje me mjedisin;

b) ruajë të gjitha dokumentet mbështetëse për deklaratën e përputhshmërisë së projektimit dhe do t'i vendosë në dispozicion të Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, sipas kërkesës;

c) veprorë në përputhje me të gjitha detyrimet e tjera të zbatueshme për një deklaruës të një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit të përcaktuar në nënpjesën A të këtij aneksi.

21L.A.48 Mos-transferueshmëria e një deklarate përputhshmërie projektimi të avionit

a) Deklarata e përputhshmërisë së projektimit të avionit nuk mund të transferohet.

b) Një person fizik ose juridik që merr përsipër projektimin e një avioni për të cilin është deklaruar më parë përputhshmëria e projektimit duhet:

1. të paraqesë një deklaratë të re të përputhshmërisë të projektimit të avionit në përputhje me këtë nënpjesë;

2. të vërtetojë se deklaruesi që ka bërë më parë një deklaratë për përputhshmërinë e avionit nuk është më aktiv ose ka rënë dakord për transferimin e të dhënave të projektimit të avionit;

3. të angazhohet të përmbushë të gjitha detyrimet e zbatueshme për personat që bëjnë një deklaratë për përputhshmërinë e avionit të përcaktuar në këtë nënpjesë sipas pikës 21L.A.47.

NËNPJESA D – NDRYSHIMET NË CERTIFIKATA E TIPIT

21L.A.61 Objekti

Kjo nënpjesë përcakton:

a) procedurën e aplikimit për miratimin e ndryshimeve në certifikatat e tipit për produktet e certifikuar në përputhje me këtë aneks, me kusht që produkti i ndryshuar të jetë ende pjesë e objektit të pikës 21L.A.21;

b) të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të miratimeve që përmenden në pikën (a);

c) dispozitat në lidhje me ndryshimet standarde që nuk kërkojnë miratim.

21L.A.62 Ndryshimet standarde

a) Ndryshimet standarde nënkuptojnë ndryshimet në një certifikatë tipi të një produkti të miratuar në përputhje me nënpjesën B të seksionit B të këtij aneksi:

1. që ndjekin të dhënat e projektimit të përfshira në specifikimet e certifikimit të lëshuara nga Agjencia, që përmbajnë metodat, teknikat dhe praktikat e pranueshme për kryerjen dhe identifikimin e ndryshimeve standarde, duke përfshirë udhëzimet shoqëruese për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore; dhe

2. që nuk janë në kundërshtim me të dhënat e mbajtësit të asaj certifikate tipi.

b) Pikat 21L.A.63 deri në 21L.A.70 nuk zbatohen për ndryshimet standarde.

21L.A.63 Klasifikimi i ndryshimeve në një certifikatë tipi

a) Ndryshimet në një certifikatë tipi do të klasifikohen si ndryshime të vogla ose të mëdha.

b) Një “ndryshim i vogël” është një ndryshim që nuk ka asnjë efekt të dukshëm në masën, ekuilibrin, forcën strukturore, besueshmërinë, nivelet e certifikuar të zhurmës ose emetimeve, karakteristikat operacionale ose karakteristika të tjera që ndikojnë te vlefshmëria ajrore ose përputhshmëria mjedisore e produktit.

c) Të gjitha ndryshimet e tjera janë “ndryshime të mëdha”, përveç rasteve kur ndryshimi në projektim, fuqi, shtytje ose masë është aq i madh sa që kërkohet një hetim kryesisht i plotë i përputhshmërisë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit ose me kërkesat e zbatueshme të mbrojtjes së mjedisit ose me specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme, në të cilin rast projektimi do të certifikohet në përputhje me nënpjesën B të këtij aneksi.

d) Kërkesat për miratimin e ndryshimeve të vogla janë ato që përcaktohen në pikën 21L.A.67.

e) Kërkesat për miratimin e ndryshimeve të mëdha janë ato që përcaktohen në pikën 21L.A.68.

21L.A.64 Pranueshmëria

a) Vetëm mbajtësi i certifikatës së tipit mund të aplikojë për miratimin e një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi sipas kësaj nënpjesë; të gjithë aplikantët e tjerë do të aplikojnë për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi sipas nënpjesës E të këtij aneksi.

b) Çdo person fizik ose juridik mund të aplikojë për miratimin e një ndryshimi të vogël në një certifikatë tipi sipas kësaj nënpjesë.

21L.A.65 Aplikimi për një ndryshim të certifikatës së tipit

a) Aplikimi për miratimin e ndryshimit të certifikatës së tipit bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 AAC.

b) Për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi, aplikanti duhet të përfshijë në aplikim një plan të dëshmisë së përputhshmërisë për dëshminë e përputhshmërisë në përputhje me pikën 21L.A.66, së bashku me një propozim për bazën e certifikatës së tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, të hartuara në përputhje me kërkesat dhe opsionet e përcaktuara në pikën 21L.B.81.

21L.A.66 Dëshmia e përputhshmërisë

a) Aplikanti duhet të vërtetojë për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi përputhshmërinë me bazën e aplikueshme të certifikatës së tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç janë përcaktuar dhe njoftuar aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.81, dhe duhet t'i sigurojë Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, mjetet me të cilat është vërtetuar kjo përputhshmëri.

b) Aplikanti për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi duhet t'i sigurojë Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, një justifikim të regjistruar të mjeteve të përputhshmërisë sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë.

c) Kur kryen teste dhe inspekte për të dëshmuar përputhshmërinë në përputhje me pikën (a), aplikanti ka verifikuar dhe dokumentuar këtë verifikim përpara kryerjes së ndonjë testimi:

1. për testimin provë, që:

i) materialet dhe proceset janë në përputhje të pranueshme me specifikimet për projektimin e propozuar të tipit të ndryshuar;

ii) pjesët përbërëse të produkteve përputhen në mënyrë të pranueshme me skicat në projektimin e propozuar të tipit të ndryshuar;

iii) proceset e prodhimit, ndërtimi dhe montimi janë në përputhje të pranueshme me ato të specifikuara në projektimin e propozuar të tipit të ndryshuar; dhe

2. që testimi dhe pajisjet matëse të përdorura për testimin ishin të përshtatshme për këtë të fundit dhe të kalibruara siç duhet.

d) Testimet e fluturimit me qëllim marrjen e miratimit të një ndryshimi të madh të certifikatës së tipit do të kryhen në përputhje me metodat për këto teste të fluturimit të specifikuar nga Agjencia. Aplikanti duhet të bëjë të gjitha testimet e fluturimit të nevojshëm për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi për të përcaktuar përputhshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

e) një aplikant për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi duhet të lejojë Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2, që:

1. të shqyrtojë çdo të dhënë dhe informacion në lidhje me dëshminë e përputhshmërisë;

2. dëshmojë ose kryejë ndonjë testim ose inspektim të bërë me qëllim të dëshmisë së përputhshmërisë; dhe

3. nëse konsiderohet e nevojshme, të kryejë një inspektim fizik të artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin përfundimtar të ndryshuar për të verifikuar përputhshmërinë e projektimit me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

f) Pas përfundimit të dëshmisë së përputhshmërisë, aplikanti i deklaron Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 se:

1. ata kanë dëshmuar përputhshmëri me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç janë përcaktuar dhe njoftuar aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me pikën 21L.B.81, sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë; dhe

2. nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin e ndryshuar të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

21L.A.67 Kërkesat për miratimin e një ndryshimi të vogël në një certifikatë tipi

Për t'u pajisur me miratimin e një ndryshimi të vogël në një certifikatë tipi, aplikanti:

a) dëshmon se ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi janë në përputhje me:

1. kërkesat bazë të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të përfshira me referencë në certifikatën e tipit; ose

2. nëse aplikanti e zgjedh këtë, me specifikimet e certifikimit që janë të zbatueshme për produktin në datën e aplikimit për ndryshim;

b) deklaron përputhshmërinë me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit që zbatohen në përputhje me pikën (a) (1), ose me specifikimet e certifikimit të zgjedhura në përputhje me pikën (a) (2), regjistron arsyetimet e përputhshmërisë në dokumentet e përputhshmërisë dhe regjistron faktin se nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin e ndryshuar të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi;

c) i paraqet Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, arsyetimin e përputhshmërisë për ndryshimin dhe deklaratën e përputhshmërisë.

21L.A.68 Kërkesat për miratimin e një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi

Për t'u pajisur me miratimin e një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi, aplikanti:

a) dëshmon se ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi janë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç përcaktohet dhe i njoftohet aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me pikën 21L.B.81;

b) dëshmon përputhshmërinë në përputhje me pikën 21L.A.66;

c) dëshmon se nuk ka çështje të pazgjidhura nga inspektimi fizik i artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin e ndryshuar përfundimtar të kryer nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me pikën 21L.A.66(e)(3).

21L.A.69 Miratimi i ndryshimit në një certifikatë tipi sipas një privilegji

a) Miratimi i një ndryshimi në një certifikatë tipi që është projektuar mund të lëshohet nga një organizatë projektuese e miratuar pa aplikim sipas pikës 21L.A.65 në përputhje me fushëveprimin e privilegjeve të parashikuara në pikat (2) dhe (8) të pikës 21.A.263(c) të aneksit I (Pjesa 21) në vend të Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, siç është shënuar në kushtet e miratimit.

b) Kur lëshon një miratim të një ndryshimi të certifikatës së tipit në përputhje me pikën (a), organizata e projektimit:

1. siguron që të gjitha të dhënat mbështetëse dhe arsyetimet janë të disponueshme;

2. siguron që të jetë dëshmuar përputhshmëria e ndryshimit me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit sipas pikës (a) (1) të pikës 21L.A.67 ose pikës (a) të pikës 21L.A.68. dhe të jetë deklaruar në përputhje me pikën 21L.A.66;

3. konfirmon që nuk është gjetur:

i) asnjë mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit ose, kur është e aplikueshme, me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, ose me specifikimet e zgjedhura të certifikimit;

ii) asnjë veçori ose karakteristikë e ndryshimit që mund ta bëjë produktin e ndryshuar të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi;

4. kufizon miratimin e një ndryshimi në një certifikatë tipi në konfigurimet specifike në certifikatën e tipit me të cilin lidhet ndryshimi.

21L.A.70 Detyrimet për ndryshime të vogla në certifikatën e tipit

Mbajtësi i miratimit të një ndryshimi të vogël në një certifikatë tipi duhet të sigurojë që të përmbushen detyrimet për mbajtësit e miratimeve të ndryshimeve të vogla të nënpjesës A të këtij aneksi.

NËNPJESA E – CERTIFIKATAT PLOTËSUESE E TIPIT

21L.A.81 Objekti

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për personat fizikë ose juridikë të ndryshëm nga mbajtësi i asaj certifikate tipi për zbatimin e miratimit të ndryshimeve të mëdha në certifikatat e tipit, të lëshuara sipas aneksit I (Pjesa 21) ose këtij aneksi, të produkteve brenda fushëveprimit të pikës 21L.A.21, me kusht që produkti i ndryshuar të jetë brenda objektit të asaj pike, dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre certifikatave.

21L.A.82 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik që ka dëshmuar ose është në proces dëshmimi, ose ka deklaruar aftësinë e tij të projektimit në përputhje me pikën 21L.A.83, mund të aplikojë për një certifikatë tipi shtesë sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë.

21L.A.83 Dëshmia e aftësisë së projektimit

Një aplikant për një certifikatë tipi plotësuese dëshmon aftësinë e tij të projektimit duke:

a) zotëruar miratimin e organizatës së projektimit me kushte miratimi që mbulojnë kategorinë përkatëse të produktit, të lëshuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21.1, në përputhje me nënpjesën J të seksionit A të aneksit I (Pjesa 21); ose

b) duke deklaruar aftësinë e tij për projektimin për objektin e produktit në përputhje me nënpjesën J të këtij aneksi.

21L.A.84 Aplikimi për një certifikatë plotësuese tipi

a) Aplikimi për certifikatë tipi plotësuese bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

b) Kur aplikon për një certifikatë tipi plotësuese, aplikanti:

1. përfshin në aplikim informacionin që kërkohet në pikën 21L.A.65(b);

2. specifikon nëse të dhënat e certifikimit janë përgatitur ose do të përgatiten plotësisht nga aplikanti ose në bazë të një marrëveshjeje me pronarin e të dhënave të certifikimit të tipit.

21L.A.85 Dëshmia e përputhshmërisë

a) Aplikanti duhet të vërtetojë për një certifikatë tipi plotësuese përputhshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç i janë përcaktuar dhe njoftuar aplikantit nga Agjencia në përputhje me pikën 21L.B.101, dhe duhet t'i sigurojë Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, mjetet me të cilat është vërtetuar kjo përputhshmëri.

b) Aplikanti i një certifikate tipi plotësuese siguron për Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, një arsyetim të regjistruar të mjeteve të përputhshmërisë brenda dokumenteve të përputhshmërisë sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë.

c) Kur kryen teste dhe inspekte për të dëshmuar përputhshmërinë në përputhje me pikën (a), aplikanti duhet të ketë verifikuar dhe dokumentuar këtë verifikim përpara kryerjes së ndonjë testimi:

1. për testimin provë, që:

i) materialet dhe proceset janë në përputhje të pranueshme me specifikimet për propozimin e ndryshimit të projektimit të tipit;

ii) pjesët përbërëse të produkteve përputhen në mënyrë të pranueshme me skicat në projektimin e propozuar të tipit të ndryshuar;

iii) proceset e prodhimit, ndërtimit dhe montimit janë në përputhje të pranueshme me ato të specifikuara në projektimin e propozuar të tipit të ndryshuar; dhe

2. që testimi dhe pajisjet matëse të përdorura për testimin ishin të përshtatshme për këtë të fundit dhe të kalibruara siç duhet.

d) Testimi i fluturimit me qëllim marrjen e certifikatës plotësuese të tipit do të kryhet në përputhje me metodat të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 për këto teste të fluturimi. Aplikanti për një certifikatë tipi plotësuese duhet të kryejë të gjitha testimet e fluturimit të nevojshme për të përcaktuar përputhshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit.

e) Aplikanti për një certifikatë plotësuese tipi lejon Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2 që:

1. të shqyrtojë çdo të dhënë dhe informacion në lidhje me dëshminë e përputhshmërisë;

2. dëshmojë ose kryejë ndonjë testim ose inspektim të kryer me qëllim të dëshmisë së përputhshmërisë; dhe

3. të kryejë një inspektim fizik të artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin përfundimtar të ndryshuar për të verifikuar përputhshmërinë e projektimit me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

f) Pas përfundimit të demonstrimit të përputhshmërisë, aplikanti për certifikatë tipi plotësuese i deklaron Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 se:

1. ka dëshmuar përputhshmëri me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç i janë përcaktuar dhe njoftuar aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.101, sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë; dhe

2. nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin e ndryshuar të pasigurt ose të papajtueshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

21L.A.86 Kërkesat për miratimin e një certifikate tipi plotësuese

a) Për t'u pajisur me një certifikatë tipi plotësuese, aplikanti:

1. dëshmon aftësinë projektuese në përputhje me pikën 21L.A.83;

2. dëshmon se ndryshimi në një certifikatë tipi dhe zonat e prekura nga ndryshimi janë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.101;

3. dëshmon përputhshmërinë në përputhje me pikën 21L.A.85;

4. nëse aplikanti ka specifikuar se ata kanë ofruar të dhëna certifikimi në bazë të një marrëveshjeje me pronarin e të dhënave të certifikimit të tipit në përputhje me pikën 21L.A.84(b), ai dëshmon se mbajtësi i certifikatës së tipit:

i) nuk ka asnjë kundërshtim teknik për informacionin e paraqitur në pikën 21L.A.65; dhe

ii) ka rënë dakord të bashkëpunojë me aplikantin për të siguruar përmbushjen e të gjitha detyrimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit të ndryshuar nëpërmjet përputhshmërisë me pikat 21L.A.28 dhe 21L.A.88;

5. dëshmon se nuk ka çështje të pazgjidhura nga inspektimi fizik i artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin e ndryshuar përfundimtar të kryer nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.A.85(e)(3).

b) Një certifikatë tipi plotësuese do të kufizohet në konfigurimet specifike në certifikatën e tipit me të cilin lidhet ndryshimi i madh përkatës.

21L.A.87 Miratimi i një certifikate tipi plotësuese sipas një privilegji

a) Miratimi i një certifikate tipi plotësuese për një ndryshim të madh që është projektuar mund të lëshohet nga një organizatë projektuese e miratuar pa aplikim sipas pikës 21L.A.84 në përputhje me qëllimin e privilegjeve të parashikuara në pikën (9) të pikës 21.A.263(c) të aneksit I (Pjesa 21) në vend të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, siç është regjistruar në kushtet e miratimit.

b) Kur lëshon një certifikatë tipi plotësuese në përputhje me pikën (a), organizata e projektimit:

1. siguron që të gjitha të dhënat mbështetëse dhe arsyetimet janë të disponueshme;

2. siguron që të jetë dëshmuar dhe deklaruar përputhshmëria e ndryshimit me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit;

3. konfirmon që nuk është gjetur:

i) asnjë mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit ose, kur është e aplikueshme, me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, ose me specifikimet e zgjedhura të certifikimit;

ii) asnjë veçori ose karakteristikë e ndryshimit që mund ta bëjë produktin e ndryshuar të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi;

4. kufizon miratimin e certifikatës së tipit plotësuese në konfigurimet specifike në certifikatën e tipit me të cilën lidhet ndryshimi.

21L.A.88 Detyrimet e mbajtësit të një certifikate tipi plotësues

Çdo mbajtës i një certifikate tipi plotësuese merr përsipër detyrimet e një mbajtësi të certifikatës së tipit plotësues të përcaktuar në nënpjesën A të këtij aneksi dhe vazhdon të përmbushë kërkesat e pranueshmërisë sipas pikës 21L.A.82.

21L.A.89 Transferueshmëria e një certifikate tipi plotësuese

Certifikata plotësuese e tipit mund të transferohet te një mbajtës i ri, me kusht që Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 të ketë verifikuar se personi fizik ose juridik të cilit synohet t'i transferohet certifikata e tipit është i përshtatshëm në përputhje me pikën 21L.A.83 për të mbajtur një certifikatë plotësuese tipi dhe është në gjendje të marrë përsipër detyrimet e një mbajtësi të certifikatës plotësuese të tipit sipas pikës 21L.A.88.

21L.A.90 Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së një certifikate plotësuese tipi

a) Një certifikatë tipi plotësuese mbetet e vlefshme për sa kohë:

1. certifikata plotësuese e tipit nuk dorëzohet nga mbajtësi;

2. mbajtësi i certifikatës plotësuese të tipit vepron në përputhje me kërkesat përkatëse të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, duke marrë parasysh dispozitat në lidhje me trajtimin e gjetjeve të përcaktuara në pikën 21L. B.21;

3. certifikata plotësuese e tipit nuk revokohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.22.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata e tipit i kthehet Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2.

21L.A.91 Ndryshimet në një pjesë të një produkti që mbulohet nga një certifikatë plotësuese tipi

a) Një ndryshim i vogël në një pjesë të një produkti që mbulohet nga një certifikatë plotësuese tipi do të miratohet në përputhje me nënpjesën D të këtij aneksi.

b) Një ndryshim i madh në pjesën e një produkti që mbulohet nga një certifikatë tipi plotësuese do të miratohet si një certifikatë tipi plotësuese e veçantë në përputhje me këtë nënpjesë.

c) Me përjashtim të pikës (b), një ndryshim i madh në pjesën e produktit të mbuluar nga një certifikatë tipi plotësuese e paraqitur nga mbajtësi i certifikatës plotësuese të tipit mund të miratohet si një ndryshim në certifikatën ekzistuese plotësuese të tipit në përputhje me pikat 21L.A.63 deri në 21L.A.69.

NËNPJESA F – NDRYSHIMET NË AVIONËT PËR TË CILËT ËSHTË DEKLARUAR PËRPUTHSHMËRIA ME PROJEKTIMIN

21L.A.101 Objekti

Kjo nënpjesë përcakton:

a) procedurën për deklarimin e përputhshmërisë së një ndryshimi në projektimin e një avioni që ka qenë subjekt i një deklarate të bërë në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi;

b) të drejtat dhe detyrimet e deklaruesit që ka bërë një deklaratë për përputhshmërinë e ndryshimit të përmendur në pikën (a); dhe

c) dispozitat në lidhje me ndryshimet standarde që nuk kërkojnë deklaratë të përputhshmërisë së projektimit.

21L.A.102 Ndryshimet standarde

a) Ndryshimet standarde nënkuptojnë ndryshimet në projektimin e avionit, i cili ka qenë subjekt i një deklaratë të bërë në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi dhe që:

1. që ndjekin të dhënat e projektimit të përfshira në specifikimet e certifikimit të lëshuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, që përmbajnë metodat, teknikat dhe praktikatat e pranueshme për kryerjen dhe identifikimin e ndryshimeve standarde, duke përfshirë udhëzimet shoqëruese për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore; dhe

2. nuk janë në kundërshtim me të dhënat e projektimit të përfshira në deklaratën e përputhshmërisë së projektimit të avionit të bërë në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi.

b) Pikat 21L.A.103 deri në 21L.A.108 nuk zbatohen për ndryshimet standarde.

21L.A.103 Klasifikimi i ndryshimeve në projektimin e një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin

a) Ndryshimet në projektimin e avionit që ka qenë subjekt i një deklaratë të bërë në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi do të klasifikohen si ndryshime të vogla ose të mëdha, duke përdorur kriteret e përcaktuara në pikat 21L.A.63 (b) dhe (c).

b) Përputhshmëria e projektimit të një ndryshimi të vogël deklarohet në përputhje me pikën 21L.A.105.

c) Përputhshmëria e projektimit të një ndryshimi të madh deklarohet në përputhje me pikën 21L.A.107.

21L.A.104 Pranueshmëria

a) Një deklaruues, i cili ka bërë një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit të avionit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi, mund të deklarojë përputhshmërinë e një ndryshimi të vogël në modelin e atij avioni sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë. Për më tepër, deklarata e përputhshmërisë mund të bëhet gjithashtu, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë, nga një organizatë projektuese e miratuar në përputhje me pikën (c)(3) të pikës 21.A.263 të aneksit I (Pjesa 21).

b) Vetëm deklaruuesi që ka bërë një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit të avionit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi mund të deklarojë përputhshmërinë e një ndryshimi të madh në projektimin e avionit për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë.

c) Me përjashtim të pikës (b) të pikës 21L.A.104, nëse deklaruuesi i cili ka bërë një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit të avionit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi nuk është më aktiv ose nuk i përgjigjet kërkesave për ndryshime të projektimit, përputhshmëria e një projekti të ndryshuar të avionit mund të deklarohet gjithashtu në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi nga një organizatë projektuese e miratuar në përputhje me pikën (c)(4) të pikës 21.A.263 të aneksit I (pjesa 21) brenda objektit të kushteve të tyre të miratimit, ose nga çdo person tjetër fizik ose juridik që mund të marrë përsipër detyrimet e përcaktuara në pikën 21L.A.47 në lidhje me avionin që ka qenë subjekt i ndryshimeve.

21L.A.105 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit për ndryshime të vogla

a) Përpara instalimit, përfshirjes ose marrëveshjes me një organizatë të prodhimit për të instaluar ose përfshirë një ndryshim të vogël në projektimin e avionit për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi, organizata që ka projektuar ndryshimin e vogël duhet të deklarojë se projekti i atij ndryshimi të vogël është në përputhje me:

1. specifikimet teknike të detajuara, të përfshira me referencë në deklaratën e përputhshmërisë së projektimit të avionit, përveç rasteve kur ato specifikime teknike të detajuara ose pjesë të tyre nuk janë më të zbatueshme në përputhje me pikën 21L.B.61 sepse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 ka vendosur bazuar në përvojën nga produkte të tjera të ngjashme në shërbim ose produktet që kanë veçori të ngjashme të projektimit, kanë treguar se mund të zhvillohen kushte të pasigurta dhe

specifikimet teknike të detajuara që janë referuar në deklaratën e përputhshmërisë së projektimit të avionit nuk e trajtojnë këtë gjendje të pasigurt; ose

2. specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme, në datën në të cilën është bërë deklarimi në përputhje me pikën 21L.B.61, nëse zgjidhet nga deklaruesi; dhe

3. kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të përmendura në pikën 21L.B.61 të cilat janë të zbatueshme në datën në të cilën është bërë deklarimi.

b) Deklarata e përputhshmërisë së projektimit bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

c) Deklaruesi ose organizata që ka projektuar ndryshimin e vogël duhet të mbajë një regjistër të ndryshimeve të vogla në projektimin e avionit për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin dhe të bëjë çdo deklaratë që është bërë në përputhje me pikën (a) në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, sipas kërkesës.

21L.A.106 Detyrimet e personit që bën një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit të një ndryshimi të vogël

Çdo person që ka bërë një deklaratë përputhshmërie për një ndryshim të vogël në projektimin e avionit në përputhje me pikën 21L.A.105:

a) mban një regjistër të këtyre deklaratave dhe i vë ato në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, sipas kërkesës;

b) ruan të gjitha dokumentet mbështetëse për deklaratën e përputhshmërisë së projektimit dhe i vë ato në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2 sipas kërkesës;

c) merr përsipër të gjitha detyrimet e tjera të një deklaruesi për një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit të përcaktuar në nënpjesën A të këtij aneksi.

21L.A.107 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit për një ndryshim madhor.

a) Përpara instalimit, inkorporimit ose marrëveshjes me një organizatë prodhimi për të instaluar ose përfshirë një ndryshim të madh në projektimin e një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi, organizata që ka projektuar atë ndryshim të madh duhet të deklarojë se projektimi i atij ndryshimi të madh dhe zonat e prekura nga ai ndryshim janë në përputhje me:

1. specifikimet teknike të detajuara, të përfshira me referencë në deklaratën e përputhshmërisë së projektimit të avionit, përveç rasteve kur ato specifikime teknike të detajuara ose pjesë të tyre nuk janë më të zbatueshme në përputhje me pikën 21L.B.61 sepse Agjencia ka zgjedhur atë përvojë nga produkte të tjera të ngjashme në shërbim ose produktet që kanë veçori të ngjashme të projektimit kanë treguar se mund të zhvillohen kushte të pasigurta dhe specifikimet teknike të detajuara që janë referuar në deklaratën e përputhshmërisë së projektimit të avionit nuk e trajtojnë këtë gjendje të pasigurt, ose

2. specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme në datën në të cilën është bërë deklarimi në përputhje me pikën 21L.B.61, nëse zgjidhet nga deklaruesi; dhe

3. kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të përmendura në pikën 21L.B.61 të cilat janë të zbatueshme në datën në të cilën është bërë deklarimi.

b) Deklarata e përputhshmërisë së projektimit bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

c) Deklarata përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. emrin e personit që dorëzon deklaratën dhe adresën/vendin e biznesit të tij;

2. numrin e referencës së deklaratës së avionit me të cilin lidhet ndryshimi i madh;

3. një referencë unike për identifikimin e ndryshimit të madh;

4. treguesin e specifikimeve teknike të detajuara dhe kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit me të cilat deklaruesi deklaroi përputhshmërinë;

5. një deklaratë të nënshkruar nën përgjegjësinë e vetme të personit që bën deklaratën se projektimi i ndryshimit të madh është në përputhje me specifikimet teknike të detajuara dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të përmendura në pikën (4), sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë të përmendur në pikën (d) (3);

6. një deklaratë të nënshkruar e cila është hartuar nën përgjegjësinë e vetme të personit që bën deklaratën se nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë nga ai person që mund ta bëjnë avionin të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimin e synuar;

7. një angazhim të nënshkruar se personi që bën deklaratën do të marrë përsipër detyrimet e përmendura në pikën 21L.A.47 në lidhje me projektimin e ndryshuar të avionit;

8. udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore;

9. kufizimet e operimit, nëse ndryshohen;

10. fletën e të dhënave për vlefshmërinë ajrore dhe, nëse është e zbatueshme, të dhënat e përputhshmërisë me emetimet;

11. fletën e të dhënave për zhurmën, nëse është e zbatueshme;

12. çdo kusht ose kufizim tjetër të përshkruar për avionin në specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit me anë të të cilave deklaruesi deklaron përputhshmërinë.

d) Deklaruesi që deklaron një ndryshim të madh i dorëzon Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2 deklaratën e përmendur në pikën (c). Së bashku me këtë deklaratë, deklaruesi i ofron Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2:

1. një përshkrimin të ndryshimit të madh;

2. të dhënat bazë për ndryshimin e madh, duke përfshirë karakteristikat e operimit, veçoritë e projektimit dhe çdo kufizim;

3. një plan të dëshmisë së përputhshmërisë që detajon metodat që janë ndjekur gjatë kësaj dëshmie;

4. justifikimet e regjistruara të përputhshmërisë brenda të dhënave të përputhshmërisë të marra nga veprimtaritë e përputhshmërisë që janë kryer sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë;

5. mënyrat me të cilat është dëshmuar përputhshmëria me specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit në pikën 21L.B.61;

6. nëse përputhshmëria dëshmohet me anë të testeve, justifikimin e regjistruar të përputhshmërisë së artikujve dhe pajisjeve të testimit, duke dëshmuar:

i) për testimin provë, që:

A. materialet dhe proceset janë në përputhje të pranueshme me specifikimet për projektimin;

B. pjesët përbërëse të produkteve janë përshtatur në mënyrë të pranueshme me skicat në projektim; dhe

C. proceset e prodhimit, ndërtimi dhe montimi janë në përputhje të pranueshme me ato të specifikuara në projektim;

ii) që pajisjet testuese dhe matëse të përdorura për testimin ishin të përshtatshme dhe të kalibruara siç duhet;

7. raportet, rezultatet e inspektimeve ose testeve që deklaruesi i ka konsideruar të nevojshme për të përcaktuar nëse avioni është në përputhje me specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

e) Deklarata e një ndryshimi të madh në një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit do të kufizohet në konfigurimet specifike në deklaratën e përputhshmërisë së projektimit me të cilën lidhet ndryshimi.

21L.A.108 Veprimtaritë e përputhshmërisë për deklarimin e përputhshmërisë së një ndryshimi madhor

Përpara se të bëjë një deklaratë përputhshmërie në përputhje me pikën 21L.A.107, deklaruesi, për atë model specifik do të:

a) hartojë një plan të demonstrimit të përputhshmërisë duke detajuar mënyrat e demonstrimit të përputhshmërisë që do të ndiqen gjatë këtij demonstrimi. Ky dokument do të përditësohet sipas nevojës;

b) regjistrojë justifikimin e përputhshmërisë në dokumentet e pajtueshmërisë sipas planit të demonstrimit të përputhshmërisë;

c) kryejë teste dhe inspekte sipas nevojës në përputhje me planin e demonstrimit të përputhshmërisë;

d) sigurojë dhe regjistrojë përputhshmërinë e artikujve dhe pajisjeve të provës dhe të sigurojë që testimi provë është në përputhje me specifikimet, skicat, proceset e prodhimit, mjetet e ndërtimit dhe montimit për projektimin;

e) sigurojë që pajisjet e testimit dhe matjes që do të përdoren për testim janë të përshtatshme për testim dhe të kalibruar siç duhet;

f) lejojë Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2 të kryejë ose të marrë pjesë në çdo inspektim ose testim të avionit në konfigurimin përfundimtar ose të zhvilluar të duhur të projektimit dhe prodhimit që është i nevojshëm për të përcaktuar se produkti nuk ka asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë avionin të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimin e synuar;

g) kryejë testimet e fluturimit, në përputhje me metodat për testimet e fluturimit të specifikuar nga Agjencia, sipas nevojës për të përcaktuar nëse avioni është në përputhje me specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

NËNPJESA G – ORGANIZATAT PRODHUESE TË DEKLARUARA

21L.A.121 Objekti

a) Kjo nënpjesë përcakton:

1. procedurat për deklarimin e aftësisë së prodhimit të personave fizikë dhe juridikë që shfaqin përputhshmërinë e produkteve dhe pjesëve me të dhënat e projektimit në fuqi;

2. të drejtat dhe detyrimet e personave fizikë dhe juridikë që bëjnë deklaratën e aftësisë prodhuese të përmendur në pikën 1.

b) Kategoritë e mëposhtme të produkteve dhe pjesëve mund të prodhohen nga organizata që kanë bërë një deklaratë të aftësisë prodhuese në përputhje me këtë nënpjesë:

1. produktet dhe pjesët, projektimi i të cilave është certifikuar në përputhje me këtë aneks;

2. avionët, projektimi i të cilëve mbulohet nga një deklaratë e bërë në përputhje me këtë aneks, dhe motorët, helikat dhe pjesët e tyre.

21L.A.122 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik (“organizatë”) mund të deklarojë aftësinë e tij të prodhimit sipas kësaj nënpjese, nëse ky person:

a) ka aplikuar ose synon të aplikojë për miratimin e projektit të produktit ose pjesës në përputhje me këtë Aneks; ose

b) ka deklaruar ose synon të deklarojë përputhshmërinë e projektimit të avionit në përputhje me këtë Aneks; ose

c) është duke bashkëpunuar me aplikantin ose mbajtësin e miratimit të projektimit të produktit që do të lëshohet në përputhje me këtë aneks, ose me organizatën që ka deklaruar ose synon të deklarojë përputhshmërinë e projektimit të avionit në përputhje me këtë aneks, për të siguruar që produkti ose pjesa e prodhuar është në përputhje me projektimin, dhe për të siguruar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit ose pjesës.

21L.A.123 Deklarata e aftësisë prodhuese

a) Organizata që synon të paraqesë përputhshmërinë e këtyre produkteve ose pjesëve me të dhënat e projektimit të aplikueshëm duhet të deklarojë aftësinë e saj të prodhimit përpara prodhimit të ndonjë produkti ose pjese.

b) Deklarata dhe çdo ndryshim pasues i saj do të bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga AAC-ja.

c) Deklarata duhet të përfshijë informacionin e nevojshëm që AAC-ja të njihet me organizatën dhe objektin e synuar të punës dhe duhet të përfshijë të paktën si në vijim:

1. emrin zyrtar të organizatës;
2. të dhënat e kontaktit të adresës së regjistruar të organizatës të vendit të tyre kryesor të biznesit dhe, sipas rastit, kontaktit dhe vendeve të operimit të organizatës;
3. emrat dhe të dhënat e kontaktit të menaxherit përgjegjës të organizatës të emëruar në përputhje me pikën (c)(1) të pikës 21L.A.125;
4. objekti i synuar i punës;
5. datën e fillimit të synuar të prodhimit;
6. një deklaratë që vërteton që organizata:
 - i) ka një sistem menaxhimi të prodhimit në përputhje me pikën (a) të pikës 21L.A.124; dhe
 - ii) do të mbajë sistemin e menaxhimit të prodhimit në përputhje me këtë nënpjesë;
7. një deklaratë që konfirmon se organizata do të ndjekë proceset dhe procedurat e përcaktuara në përputhje me pikën (d) të pikës 21L.A.124;
8. një deklaratë ku organizata pranon të ndër marrë detyrimet e organizatës së deklaruar të prodhimit në përputhje me pikën 21L.A.127.

d) Deklarata e aftësisë prodhuese i dorëzohet AAC-së.

21L.A.124 Sistemi i menaxhimit të prodhimit

a) Organizata prodhuese e deklaruar do të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë me përgjegjshmëri dhe linja të qarta përgjegjësie një sistem menaxhimi të prodhimit në të gjithë organizatën që:

1. korrespondon me natyrën dhe kompleksitetin e veprimtarive të saj dhe madhësinë e organizatës, dhe merr parasysh risqet dhe rreziqet që lidhen me këto aktivitete;
2. themelohet nën përgjegjësinë e një menaxheri përgjegjës të emëruar sipas pikës (c)(1) të pikës 21L. A.125.

b) Sistemi i menaxhimit të prodhimit do të përfshijë një mënyrë për të menaxhuar cilësinë duke ruajtur një sistem për cilësinë që:

1. siguron që çdo produkt ose pjesë e prodhuar nga organizata prodhuese e deklaruar ose nga partnerët e saj, ose e furnizuar nga ose nënkontraktuar palëve të jashtme, është në përputhje me të dhënat e aplikueshme të projektimit dhe është në gjendje për funksionim të sigurt;
2. harton, zbaton dhe mirëmban, sipas rastit, brenda objektit të veprimtarive të tyre, procedurat e kontrollit për:
 - i) lëshimin, miratimin ose ndryshimin e dokumentit;
 - ii) vlerësimin, auditimin dhe kontrollin e shitësit dhe nënkontraktorit;
 - iii) verifikimin që produktet hyrëse, pjesët, materialet dhe pajisjet, duke përfshirë artikujt e rinj ose të përdorur, të furnizuar nga blerësit e produkteve, janë siç specifikohet në të dhënat e zbatueshme të projektimit;
 - iv) identifikimin dhe gjurmimin;
 - v) proceset e prodhimit;
 - vi) inspektimin dhe testimin, duke përfshirë testet e fluturimit të prodhimit;
 - vii) kalibrimin e veglave dhe pajisjeve të testimit;
 - viii) kontrollin e artikujve jo konform;

ix) bashkëpunimin me aplikantin ose mbajtësin e miratimit të projektimit ose deklaruesin e deklaratës së përputhshmërisë së projektimit;

x) plotësimin dhe mbajtjen e të dhënave;

xi) garantimi i kompetencave dhe kualifikimeve të personelit;

xii) çështjen e lëshimit të dokumenteve të vlefshmërisë ajrore;

xiii) trajtimin, ruajtjen dhe paketimin;

xiv) auditimet e brendshme të cilësisë dhe veprimet korrigjuese që rezultojnë;

xv) puna e kryer në çdo vendndodhje tjetër përveç vendeve operative të përfshira në deklaratë;

xvi) punën e kryer pas përfundimit të prodhimit, por përpara dorëzimit, për të ruajtur avionin në një gjendje për funksionim të sigurt;

xvii) kërkesën për dhënien e lejeve të fluturimit dhe miratimin e kushteve të fluturimit përkatës;

3. të përfshijë dispozita specifike në procedurat e kontrollit për çdo pjesë kritike.

c) Organizata prodhuese e deklaruar do të krijojë, si pjesë të sistemit të saj të menaxhimit të prodhimit, një funksion të pavarur për të monitoruar përputhshmërinë e organizatës me kërkesat përkatëse, dhe përputhshmërinë dhe përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit të prodhimit. Ky monitorim përfshin një sistem që ofron reagime për personin ose grupin e personave të përmendur në pikat (c)(1) dhe (2) të pikës 21L.A.125, në mënyrë që të sigurojë sipas nevojës, veprime korrigjuese.

d) Organizata prodhuese e deklaruar do të krijojë, mirëmbajë dhe përditësojë, si pjesë e sistemit të saj të menaxhimit të prodhimit, proceset dhe procedurat që sigurojnë përputhshmërinë e produkteve që prodhohen, me të dhënat e aplikueshme të projektimit. Organizata prodhuese e deklaruar duhet t'i vërë në dispozicion AAC-së prova shkresore të këtyre proceseve dhe procedurave sipas kërkesës.

e) Organizata prodhuese e deklaruar duhet të ketë procedura për të siguruar që avionët e sapoprodhuar të mirëmbahen në përputhje me udhëzimet e zbatueshme të mirëmbajtjes dhe të mbahen në gjendje të përshtatshme për fluturim dhe, nëse është e zbatueshme, të lëshohet një certifikatë e lejimit në shërbim për çdo mirëmbajtje që është përfunduar.

f) Nëse organizata prodhuese e deklaruar ka (një) certifikatë tjetër të organizatës të lëshuar në bazë të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil" dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, organizata prodhuese mund të integrojë sistemin e menaxhimit të prodhimit me sistemin e menaxhimit që kërkohet për lëshimin e certifikatave të tjera.

21L.A.125 Burimet e organizatës prodhuese të deklaruar

Organizata prodhuese e deklaruar duhet të sigurojë që:

a) objektet, kushtet e punës, pajisjet dhe mjetet, proceset dhe materialet shoqëruese, numri dhe kompetenca e personelit dhe organizimi i përgjithshëm janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj sipas pikës 21L.A.127;

b) në lidhje me të gjitha të dhënat e nevojshme për vlefshmërinë ajrore dhe mbrojtjen e mjedisit:

1. i merr këto të dhëna nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 dhe nga deklaruesi i përputhshmërisë së projektimit, mbajtësi ose aplikanti për certifikatën e tipit ose miratimin e projektimit, për të përcaktuar përputhshmërinë e tij me të dhënat e aplikueshme të projektimit;

2. organizata prodhuese ka hartuar një procedurë për të siguruar që të dhënat e vlefshmërisë ajrore dhe të mbrojtjes së mjedisit janë përfshirë siç duhet në të dhënat e saj të prodhimit;

3. këto të dhëna përditësohen dhe vihen në dispozicion të gjithë personelit që ka nevojë për akses në këto të dhëna për të kryer detyrat e tyre;

c) në lidhje me stafin drejtues dhe personelin:

1. një menaxher përgjegjës është emëruar nga organizata prodhuese e deklaruar me kompetencë për të siguruar që gjithë prodhimi brenda organizatës të kryhet sipas standardeve të kërkuara dhe që organizata prodhuese e deklaruar vazhdon të veprojë në përputhje me kërkesat e sistemit të

menaxhimit për prodhimin e përmendur në pikën (a) të pikës 21L.A.124, dhe proceset dhe procedurat e përcaktuara në pikën (d) të pikës 21L.A.124;

2. një person ose grup personash është emëruar nga menaxheri përgjegjës për të siguruar që organizata vepron në përputhje me kërkesat e kësaj nënpjesë dhe është (janë) njohur, gjithashtu me objektin e autoritetit të tyre. Një person ose grup personash mban përgjegjësi para menaxherit të përgjithshëm dhe do të ketë akses të drejtpërdrejtë tek ata. Ata duhet të kenë njohuritë, formimin dhe përvojën e duhur për të përmbushur përgjegjësitë e tyre;

3. personelit në të gjitha nivelet i është dhënë autoriteti i duhur për të qenë në gjendje të përmbushë përgjegjësitë e tyre të caktuara dhe zotëron një koordinim të plotë dhe efektiv brenda organizatës prodhuese të deklaruar në lidhje me çështjet e vlefshmërisë ajrore dhe të të dhënave të përputhshmërisë mjedisore;

4. struktura organizative e organizatës së bashku me personelin kyç që është përgjegjës për të siguruar që organizata vepron në përputhje me këtë nënpjesë dokumentohet dhe përditësohet;

d) për sa i përket personelit certifikues, i autorizuar nga organizata prodhuese e deklaruar për të nënshkruar dokumentet e lëshuara sipas pikës 21L.A.126 brenda objektit të aktiviteteve të deklaruara të prodhimit:

1. njohuritë, formimi (përfshirë funksionet e tjera në organizatë) dhe përvoja e personelit certifikues janë të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë e tyre të caktuara;

2. personeli certifikues pajiset me dëshminë e objektit të autorizimit të tyre. Organizata prodhuese e deklaruar mban një listë të personelit certifikues.

21L.A.126 Objekti i punës

a) Një organizatë prodhuese e deklaruar ka të drejtë të dëshmojë përputhshmërinë e produkteve dhe pjesëve që bëjnë pjesë në objektin e këtij seksioni dhe që janë prodhuar brenda objektit të deklaruar të punës, me të dhënat e projektimit në fuqi.

b) Një organizatë prodhuese e deklaruar ka të drejtë, për një avion të plotë, pas paraqitjes së deklaratës së përputhshmërisë së avionit (forma 52B e RSH-së sipas modelit të EASA-s), të aplikojë:

1. për një avion që është në përputhje me një model tipi të miratuar sipas nënpjesës B të seksionit B të këtij aneksi, për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore dhe një certifikatë zhurme;

2. për një avion që është në përputhje me një projektim për të cilin është deklaruar përputhshmëria sipas nënpjesës C të këtij aneksi, për një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore dhe një certifikatë të kufizuar të zhurmës.

c) Një organizatë prodhuese e deklaruar ka të drejtë të lëshojë certifikatë të autorizuar të lejimit për shërbim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) për motorët, helikat dhe pjesët që janë në përputhje me:

1. të dhënat e miratuara të projektimit të lëshuara sipas nënpjesës B, D, E ose M të seksionit B të këtij aneksi;

2. të dhënat e deklaruara të projektimit për të cilat është deklaruar përputhshmëria e projektimit sipas nënpjesës C, F ose N të këtij aneksi;

3. të dhënat e prodhimit bazuar në të gjitha të dhënat e nevojshme të miratuara të projektimit siç ofrohen nga një mbajtës i miratimit të projektimit të riparimit.

d) Një organizatë prodhuese e deklaruar ka të drejtë të rekomandojë kushtet për një avion që ka prodhuar dhe për të cilin ka vërtetuar përputhshmërinë me të dhënat e zbatueshme të projektimit, sipas të cilave një leje fluturimi mund të lëshohet nga AAC-ja sipas nënpjesës P të aneksit I (Pjesa 21).

e) Një organizatë prodhuese e deklaruar ka të drejtë të mirëmbajë një avion të ri që ka prodhuar, sipas nevojës për ta mbajtur atë në gjendje të përshtatshme për fluturim, përveç rasteve kur Rregullorja “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra” që

transponon rregulloren e (BE) nr. 1321/2014, kërkon që mirëmbajtja të kryhet sipas rregullave të tilla, dhe të lëshojë një certifikatë të lejimit në shërbim (forma 53B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) në lidhje me atë mirëmbajtje.

21L.A.127 Detyrimet e organizatës prodhuese të deklaruar

a) Organizata prodhuese e deklaruar funksionon në përputhje me procedurat, praktikat dhe proceset e përcaktuara qartazi.

b) Nëse organizata prodhuese e deklaruar synon të kryejë teste fluturimi, atëherë ajo përgatit, mirëmban dhe përditëson një manual të operimeve që përfshin një përshkrim të politikave dhe proceseve të organizatës për testimin e fluturimit. Organizata prodhuese e deklaruar vë në dispozicion këtë manual për AAC-në sipas kërkesës.

c) Për avionët e plotë, përpara dorëzimit të një deklaratë përputhshmërie të avionit (forma 52B e RSH-së sipas modelit të EASA-s) tek AAC-ja, organizata prodhuese e deklaruar siguron që avioni është në gjendje për funksionim të sigurt dhe është në përputhje me:

1. modelin e miratuar të tipit të një produkti me certifikatë tipi të lëshuar sipas nënpjesës B të seksionit B të këtij aneksi, ose

2. të dhënat e projektimit të një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit sipas nënpjesës C të këtij aneksi.

d) Për produktet (përveç avionëve të plotë) dhe pjesët, organizata prodhuese e deklaruar siguron përpara lëshimit të një certifikate të autorizuar të lejimit për shërbim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) që produkti ose pjesa është në gjendje për funksionim të sigurt dhe është në përputhje me modelin e tipit të aprovuar të një produkti me certifikatë tipi të lëshuar sipas nënpjesës B, D, E ose M të seksionit B të këtij aneksi ose është në përputhje me të dhënat e projektimit të një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit sipas nënpjesës C, F ose M të këtij aneksi.

e) Për motorët, organizata prodhuese e deklaruar siguron që motori i plotë është në përputhje me kërkesat e zbatueshme për emetimet e gazrave të motorit të zbatueshme në datën e prodhimit të motorit.

f) Organizata prodhuese e deklaruar përfshin numrin e referencës të lëshuar AAC-ja në përputhje me pikën 21L.B.142 për këtë organizatë prodhuese të deklaruar në çdo certifikatë të lejimit për shërbim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) që lëshohet prej saj.

g) Organizata prodhuese e deklaruar siguron që organizata regjistron të dhënat e çdo pune të përfunduar.

h) Organizata prodhuese e deklaruar i siguron mbështetje të vazhdueshme të vlefshmërisë ajrore për çdo produkt ose pjesë që ka prodhuar, mbajtësit të projektimit ose deklaruesit të një deklaratë përputhshmërie projektimi.

i) Organizata prodhuese e deklaruar ka një sistem arkivimi që regjistron kërkesat që u janë vendosur organizatave të tjera, të tillë si furnitorët dhe nënkontraktorët. Organizata prodhuese e deklaruar vë në dispozicion të dhënat e arkivuara tek AAC-ja për qëllime të vlefshmërisë ajrore të vazhdueshme.

j) Për prodhimin e avionëve të rinj, organizata prodhuese e deklaruar siguron që avioni të mbahet në gjendje të përshtatshme për fluturim dhe të kryhet mirëmbajtja, duke përfshirë çdo riparim të nevojshëm në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektimit, përpara lëshimit të deklaratës së përputhshmërisë së avionit. (Forma 52B e RSH-së sipas modelit të EASA-s.)

k) Nëse organizata prodhuese e deklaruar lëshon një certifikatë lejimi për shërbim pas një mirëmbajtjeje të tillë, ajo përcakton që çdo avion i plotë i është nënshtruar mirëmbajtjes së nevojshme dhe është në gjendje për funksionim të sigurt, përpara lëshimit të asaj certifikate.

l) Organizata prodhuese e deklaruar vepron në përputhje me kërkesat në nënpjesën A të këtij aneksi të zbatueshme për një organizatë të deklaruar prodhuese.

21L.A.128 Njoftimi për ndryshime dhe ndërprerje të veprimtarive

Organizata prodhuese e deklaruar njofton AAC-në pa vonesë të panevojshme për çështjet në vijim:

- a) çdo ndryshim në informacionin që është deklaruar në përputhje me pikën (c) të pikës 21L.A.123;
- b) çdo ndryshim në sistemin e menaxhimit të prodhimit që është i rëndësishëm për dëshminë e përputhshmërisë ose për karakteristikat e vlefshmërisë ajrore dhe përputhshmërisë mjedisore të produktit ose pjesës;

- c) ndërprerjen e disa ose të gjitha aktiviteteve të mbuluara nga deklarata.

NËNPJESA H – CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

21L.A.141 Objekti

Kjo Nënpjesë përcakton procedurën për aplikimin për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore për një avion, projektimi i të cilit është certifikuar ose deklaruar në përputhje me këtë aneks, dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të certifikatave.

21L.A.142 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik nën emrin e të cilit është regjistruar ose do të regjistrohet një avion në Republikën e Shqipërisë (“Shteti anëtar i regjistrimit”) mund të aplikojë për certifikatën e vlefshmërisë ajrore ose për certifikatën e kufizuar të vlefshmërisë ajrore për atë avion sipas kushteve që përcaktohen në këtë nënpjesë.

21L.A.143 Aplikim për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore

- a) Një person fizik ose juridik aplikon për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil kur RSH është shteti i regjistrit;

- b) Një person fizik ose juridik mund të aplikojë për:

- 1. një certifikatë vlefshmërie ajrore për avionët që janë në përputhje me një certifikatë tipi që është lëshuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 sipas nënpjesës B të seksionit B të këtij aneksi; ose

- 2. një certifikatë e kufizuar vlefshmërie ajrore për avionët që janë në përputhje me një deklaratë përputhshmërie projektimi sipas nënpjesës C të këtij Aneksi, e cila është regjistruar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.63 në momentin e aplikimit.

- c) Për një avion të ri që është në përputhje me një certifikatë tipi të lëshuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

- 1. një deklaratë përputhshmërie avioni (forma 52 e RSH-së sipas modelit të EASA-s ose forma 52B e RSH-së sipas modelit të EASA-s) që lëshohet ose nënshkruhet nga:

- i) një organizatë prodhuese që ka deklaruar aftësinë e saj prodhuese sipas nënpjesës G të këtij aneksi dhe është regjistruar nga AAC-ja në përputhje me pikën 21L.B.142; ose

- ii) një mbajtës i miratimit të organizatës prodhuese sipas përcaktimeve të pikës (b) të pikës 21.A.163 të aneksit I (Pjesa 21);

- 2. një raport mase dhe ekuilibri me një plan ngarkese;

- 3. manualin e fluturimit nëse kërkohet nga baza e zbatueshme e certifikimit të tipit.

- d) Për një avion të ri që është në përputhje me një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit, e cila është regjistruar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, aplikanti dorëzon gjatë aplikimit si në vijim:

- 1. një deklaratë përputhshmërie avioni (forma 52B e RSH-së sipas modelit të EASA-s) që lëshohet ose nënshkruhet nga:

- i) një person fizik ose juridik në përputhje me nënpjesën R të këtij aneksi;

- ii) një organizatë prodhuese që ka deklaruar aftësinë e saj prodhuese sipas nënpjesës G të këtij Aneksi dhe është regjistruar nga AAC-ja në përputhje me pikën 21L.B.142; ose

iii) një mbajtës i miratimit të organizatës prodhuese sipas përcaktimeve të pikës (d) të pikës 21.A.163 të aneksit I (Pjesa 21);

2. një raport peshe dhe ekuilibri me një plan ngarkese;

3. manualin e fluturimit nëse kërkohet nga specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme për deklaratën e përputhshmërisë së projektimit.

e) Për një avion të përdorur me origjinë nga një shtet anëtar, aplikanti përfshin në aplikim një certifikatë rishikimi të vlefshmërisë ajrore të lëshuar në përputhje me aneksin I (Pjesa-M) ose aneksin Vb (Pjesa-ML) të rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”.

f) Për një avion të përdorur me origjinë nga një shtet joanëtar, aplikanti dorëzon gjatë aplikimit si në vijim:

1. një deklaratë nga autoriteti kompetent i shtetit ku avioni është ose ishte regjistruar, që pasqyron statusin e vlefshmërisë ajrore të avionit në momentin e transferimit;

2. të dhënat historike për të vendosur standardin e prodhimit, modifikimit dhe mirëmbajtjes së avionit;

3. një raport peshe dhe ekuilibri me një plan ngarkese;

4. manualin e fluturimit;

5. një rekomandim për lëshimin e një certifikate të vlefshmërisë ajrore ose një certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore dhe rekomandimin për një certifikatë të rishikimit të vlefshmërisë ajrore në përputhje me një rishikim të vlefshmërisë ajrore në përputhje me aneksin I (Pjesa-M) të rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra” transpozim i rregullores (BE) nr. 1321/2014 ose një certifikatë të rishikimit të vlefshmërisë ajrore në përputhje me aneksin Vb (Pjesa-ML) të rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra” transpozim i rregullores (BE) nr. 1321/2014.

g) Përveç nëse është rënë dakord ndryshe, deklaratat e përmendura në pikat (c) (1), (d) (1) dhe (f) (1) lëshohen jo më shumë se 60 ditë përpara paraqitjes së avionit tek Autoriteti i Aviacionit Civil kur RSH-ja është shteti i regjistrimit

21L.A.144 Detyrimet e aplikantit për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore

Aplikanti për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose për një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore:

a) paraqet manualet, njoftimet, listat dhe shenjat e instrumenteve dhe informacione të tjera të nevojshme që kërkohen nga baza e zbatueshme e certifikimit të tipit ose nga specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme për deklaratat e përputhshmërisë së projektimit në një ose më shumë gjuhë zyrtare të Bashkimit Evropian të pranueshme tek Autoriteti i Aviacionit Civil kur RSH-ja është shteti i regjistrimit;

b) dëshmon se avioni është identifikuar në përputhje me nënpjesën Q të këtij aneksi;

c) merr masa për inspektimet e Autoritetit të Aviacionit Civil nëse RSH-ja është shteti i regjistrimit për të vlerësuar nëse avioni ka ndonjë papajtueshmëri që mund të ndikojë në sigurinë e avionit.

21L.A.145 Transferueshmëria dhe rilëshimi i një certifikate të vlefshmërisë ajrore dhe i një certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore brenda shteteve anëtare

Në rastet kur pronësia e një avionit ka ndryshuar:

a) nëse mbetet në të njëjtin regjistër, certifikata e vlefshmërisë ajrore, ose certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore që është lëshuar në përputhje me nënpjesën H të seksionit B të këtij aneksi, transferohet së bashku me avionin;

b) nëse avioni synohet të regjistrohet në një shtet tjetër, personi fizik ose juridik nën emrin e të cilit do të regjistrohet avioni aplikon tek autoriteti kompetent i shtetit të ri anëtar të regjistrimit për një certifikatë të re të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore dhe përfshin në këtë aplikim certifikatën e mëparshme të vlefshmërisë ajrore ose certifikatën e kufizuar të vlefshmërisë ajrore që është lëshuar në përputhje me nënpjesën H të seksionit B të këtij aneksi dhe një certifikatë të vlefshme të rishikimit të vlefshmërisë ajrore që është lëshuar në përputhje me aneksin I (Pjesa-M) ose aneksin Vb (Pjesa-ML) të rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra” transpozim i rregullores (BE) nr. 1321/2014.

21L.A.146 Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së një certifikate të vlefshmërisë ajrore dhe e një certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore

a) Një certifikatë e vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore mbetet e vlefshme për aq kohë sa:

1. avioni mbetet në të njëjtin regjistër;
2. certifikata nuk është dorëzuar nga mbajtësi;

3. avioni vazhdon të jetë në përputhje me kërkesat përkatëse të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj dhe me modelin e tipit të ose me të dhënat e zbatueshme të projektimit të një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin, dhe me kërkesat e vazhdueshme të vlefshmërisë ajrore, duke marrë parasysh dispozitat në lidhje me trajtimin e gjetjeve të përcaktuara në pikën 21L. B.21;

4. certifikata nuk është revokuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil nëse RSH-ja është shteti i regjistrimit.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata i kthehet Autoriteti i Aviacionit Civil nëse RSH-ja është shteti i regjistrimit

NËNpjesa I – CERTIFIKATAT E ZHURMËS DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË ZHURMËS

21L.A.161 Objekti

Kjo nënpjesë përcakton procedurën e aplikimit për një certifikatë zhurme ose një certifikatë të kufizuar zhurme për një avion, projektimi i të cilit është certifikuar ose deklaruar në përputhje me këtë Aneks, si dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre certifikatave.

21L.A.162 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik nën emrin e të cilit është regjistruar ose do të regjistrohet një avion mund të aplikojë për një certifikatë zhurme ose një certifikatë të kufizuar zhurme për atë avion sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë.

21L.A.163 Aplikimi

a) Një person fizik ose juridik aplikon për një certifikatë zhurme ose një certifikatë të kufizuar të zhurmës sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil nëse RSH-ja është shteti i regjistrimit

b) Një person fizik ose juridik mund të aplikojë për:

1. një certifikatë zhurme për avionët që janë në përputhje me një certifikatë tipi që është lëshuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 AAC-ja sipas nënpjesës B të seksionit B të këtij aneksi; ose
2. një certifikatë të kufizuar zhurme për avionët që janë në përputhje me një deklaratë përputhshmërie projektimi të dorëzuar sipas nënpjesës C të këtij aneksi, e cila është regjistruar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.63 në momentin e aplikimit.

c) Aplikanti dorëzon gjatë aplikimit:

1. në lidhje me avionët e rinj:

i) një deklaratë përputhshmërie avioni (forma 52 e RSH-së sipas modelit të EASA-s ose forma 52B e RSH-së sipas modelit të EASA-s) që lëshohet ose nënshkruhet nga:

A. një person fizik ose juridik në përputhje me nënpjesën R të këtij aneksi;

B. një organizatë prodhuese që ka deklaruar aftësinë e saj prodhuese sipas nënpjesës G të këtij aneksi, është regjistruar nga AAC-ja në përputhje me pikën 21L.B.142; ose

C. një mbajtës i miratimit të organizatës prodhuese sipas përcaktimeve të pikës (b) të pikës 21.A.163 të aneksit I (Pjesa 21);

ii) referencën për regjistrimin e zhurmës brenda bazës së të dhënave të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2 për nivelet e zhurmës që pasqyron informacionin rreth zhurmës që është përcaktuar në përputhje me kërkesat e zbatueshme të zhurmës;

2. në lidhje me avionët e përdorur:

i) referencën për regjistrimin e zhurmës brenda bazës së të dhënave të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2 për nivelet e zhurmës që pasqyron informacionin rreth zhurmës që është përcaktuar në përputhje me kërkesat e zbatueshme të zhurmës; dhe

ii) të dhënat historike për të vendosur standardin e prodhimit, modifikimit dhe mirëmbajtjes së avionit.

d) Përveç nëse është rënë dakord ndryshe, deklaratat e përmendura në pikën (c) (1) (i) lëshohen jo më shumë se 60 ditë përpara paraqitjes së avionit tek Autoriteti i Aviacionit Civil kur RSH është shteti i regjistrit.

21L.A.164 Transferueshmëria dhe rilëshimi i certifikatave të zhurmës dhe certifikatave të kufizuara të zhurmës brenda Shteteve Anëtare ose në Republikën e Shqipërisë

Në rastet kur pronësia e një avioni ka ndryshuar:

a) nëse avioni mbetet në të njëjtin regjistër, certifikata e zhurmës ose certifikata e kufizuar e zhurmës që është lëshuar në përputhje me nënpjesën I të seksionit B të këtij aneksi, transferohet së bashku me avionin;

b) nëse avioni synohet të regjistrohet në një shtet tjetër anëtar, personi fizik ose juridik nën emrin e të cilit do të regjistrohet avioni, aplikon tek autoriteti kompetent i shtetit të ri anëtar të regjistrimit për një certifikatë të re zhurme ose certifikatë të kufizuar të zhurmës dhe përfshin në këtë aplikim certifikatën e mëparshme të zhurmës ose certifikatën e kufizuar të zhurmës që është lëshuar në përputhje me nënpjesën I të seksionit B të këtij aneksi.

21L.A.165 Vazhdueshmëria e vlefshmërisë e një certifikate zhurme dhe një certifikate të kufizuar të zhurmës

a) Një certifikatë zhurme ose një certifikatë e kufizuar zhurme mbetet e vlefshme për sa kohë që:

1. avioni mbetet në të njëjtin regjistër;

2. certifikata nuk është dorëzuar nga mbajtësi;

3. avioni vazhdon të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të mbrojtjes së mjedisit të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj dhe me modelin e tipit të zbatueshëm ose me të dhënat e zbatueshme të projektimit të një avioni për të cilin përputhshmëria e projektimit është deklaruar, duke marrë parasysh dispozitat në lidhje me trajtimin e gjetjeve të përcaktuara në pikën 21L.B.21;

4. certifikata nuk është revokuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil nëse RSH-ja është shteti i regjistrit sipas pikës 21L. B.22.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata i kthehet Autoriteti i Aviacionit Civil kur RSH-ja është shteti i regjistrit.

NËNPJESA J – ORGANIZATAT E DEKLARUARA TË PROJEKTIMIT

21L.A.171 Objekti

Kjo nënpjesë përcakton:

a) procedurën për deklarimin e aftësisë projektuese nga personat fizikë dhe juridikë të cilët projektojnë produkte sipas këtij seksioni; dhe

b) të drejtat dhe detyrimet e personave që bëjnë deklaratat e aftësisë së projektimit të përmendura në pikën (a).

21L.A.172 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik (“organizatë” në këtë nënpjesë) që sipas pikës 21L.A.22, pikës 21L.A.82 ose pikës 21L.A.204 dëshmon aftësinë e tij të projektimit, mund të deklarojë aftësinë e tij sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë.

21L.A.173 Deklarata e aftësisë së projektimit

a) Përpara ose në të njëjtën kohë me aplikimin për një miratim projektimi sipas këtij seksioni, ose përpara dorëzimit të aplikimit për miratimin e kushteve të fluturimit në përputhje me pikën 21.A.710 të aneksit I (Pjesa 21) të një produkti të projektuar, cilado qoftë e para, organizata dorëzon tek Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 një deklaratë të aftësisë së projektimit.

b) Deklarata dhe çdo ndryshim i mëvonshëm i saj bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

c) Deklarata përmban informacionin e nevojshëm që Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, të njihet me organizatën dhe objektin e synuar të punës, si dhe përmban të paktën si në vijim:

1. emrin zyrtar të organizatës;

2. të dhënat e kontaktit të adresës së regjistruar të organizatës të vendit kryesor të biznesit dhe, sipas rastit, të vendeve të operimit të organizatës;

3. emrat dhe të dhënat e kontaktit të drejtuesit të organizatës së projektimit;

4. objektin e synuar të punës;

5. një deklaratë që vërteton që organizata:

i) ka një sistem menaxhimi për projektim në përputhje me pikën (a) të pikës 21L.A.174; dhe

ii) mirëmban sistemin e menaxhimit për projektim në përputhje me këtë nënpjesë;

6. një deklaratë që konfirmon se organizata do të ndjekë proceset dhe procedurat e përcaktuara në përputhje me pikën (d) të pikës 21L.A.174;

7. një deklaratë që organizata pranon të marrë përsipër detyrimet e një organizate projektimi të deklaruar në përputhje me pikën 21L.A.177.

d) Deklarata e aftësisë së projektimit dorëzohet tek Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

21L.A.174 Sistemi i menaxhimit për projektimin

a) Organizata e deklaruar e projektimit krijon, zbaton dhe mirëmban një sistem menaxhimi për projektim me përgjegjshmëri dhe linja të qarta përgjegjësie në të gjithë organizatën që:

1. korrespondon me natyrën dhe kompleksitetin e veprimtarive të saj dhe madhësinë e organizatës, dhe merr parasysh risqet dhe rreziqet që lidhen me këto aktivitete;

2. themelohet nën përgjegjësinë e një menaxheri të vetëm që emërohet si drejtues i organizatës së projektimit sipas pikës (a) të pikës 21L.A.175.

b) Si pjesë e sistemit të menaxhimit për projektimin, organizata e deklaruar e projektimit ka një mjet për të siguruar sigurinë e projektimit duke vendosur, zbatuar dhe mirëmbajtur një sistem për kontrollin dhe mbikëqyrjen e projektimit, si dhe të ndryshimeve dhe riparimeve të projektimit të produkteve. Sistemi:

1. përmban një funksion të vlefshmërisë ajrore përgjegjëse që të sigurojë që projektimet e produkteve dhe projektimet e ndryshimeve dhe riparimeve të tyre në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit;

2. krijon, zbaton dhe mirëmban një funksion të pavarur për të verifikuar dëshminë e përputhshmërisë në bazë të së cilës organizata deklaron përputhshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe me kërkesat e zbatueshme të mbrojtjes së mjedisit;

3. përcakton mënyrën me të cilën sistemi i sigurimit të projektimit llogarit pranueshmërinë e pjesëve që janë projektuar ose detyrat që kryhen nga partnerët ose nënkontraktorët sipas metodave që janë objekt i procedurave të shkruara.

c) Si pjesë e sistemit të menaxhimit për projektimin, organizata e deklaruar e projektimit krijon një funksion të pavarur për të monitoruar përputhshmërinë e organizatës me kërkesat përkatëse, dhe përputhshmërinë dhe përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit për projektim. Ky monitorim përfshin një sistem që ofron reagime për personin ose një grup personash të përmendur në pikën (b) të pikës 21L.A.175 dhe për menaxherin përgjegjës të përmendur në pikën (a) të pikës 21L.A. 175 në mënyrë që të sigurojë, sipas nevojës, veprime korigjuese.

d) Organizata e deklaruar e projektimit krijon, mirëmban dhe përditëson proceset dhe procedurat që sigurojnë përputhshmërinë e projektimit të produkteve me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit, specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit. Organizata e deklaruar e projektimit vë në dispozicion për Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2, dëshmi dokumentare të këtyre proceseve dhe procedurave sipas kërkesës.

e) Nëse ndonjë pjesë ose ndonjë ndryshim në produkte është projektuar nga organizata bashkëpunëtoare ose nënkontraktorë, proceset dhe procedurat në pikën (d) përfshijnë një përshkrim se si organizata projektuese është në gjendje të sigurojë përputhshmërinë, për të gjitha pjesët, sipas pikës (b)(2), si dhe përmban, drejtpërdrejt ose me referencë të kryqëzuar, përshkrime dhe informacion mbi aktivitetet e projektimit dhe organizimin e këtyre partnerëve ose nënkontraktorëve.

f) Nëse organizata e deklaruar e projektimit zotëron (një) certifikatë të organizatës tjetër që është lëshuar në bazë të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, organizata e deklaruar e projektimit mund të integrojë sistemin e menaxhimit të projektimit me sistemin e menaxhimit që kërkohet për lëshimin e certifikatave të tjera.

21L.A.175 Burimet e organizatës së deklaruar të projektimit

a) Organizata e deklaruar e projektimit emëron një drejtues të organizatës së projektimit me autoritetin për të siguruar që, brenda organizatës, të gjitha aktivitetet e projektimit të kryhen sipas standardeve të kërkuara dhe që organizata e deklaruar e projektimit të veprojë vazhdimisht në përputhje me kërkesat për sistemin e menaxhimit për projektimin, referuar në pikat (a) deri (c) të pikës 21L.A.174 dhe proceset dhe procedurat e përmendura në pikën (d) të pikës 21L.A.174.

b) Drejtuesi i organizatës së projektimit emëron dhe përcakton personelin kryesor brenda organizatës që është përgjegjës, për:

1. sigurimin që projektimet e produkteve dhe ndryshimeve, si dhe riparimeve të tyre të jenë në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit, specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit;

2. monitorimin e pavarur të funksionit të përputhshmërisë dhe përshtatshmërisë; dhe

3. në varësi të madhësisë së organizatës, çdo person tjetër ose grup personash që nevojitet ose nevojiten për të siguruar që organizata vepron në përputhje me kërkesat e këtij seksioni.

c) Personi ose grupi i personave të identifikuar në pikën (b):

1. është përgjegjës ndaj drejtuesit të organizatës së projektimit dhe ka akses të drejtpërdrejtë tek ai;

2. ka njohuritë, formimin dhe përvojën e duhur për të përmbushur përgjegjësitë e tyre të caktuara.

d) Organizata e deklaruar e projektimit siguron që:

1. ka numër të mjaftueshëm personeli me përvojën e duhur në të gjitha departamentet teknike dhe ka autoritetin e duhur për të qenë në gjendje të kryejë përgjegjësitë e caktuara dhe se këto, së bashku

me akomodimin, objektet dhe pajisjet, janë të përshtatshme për t'i mundësuar personelit të sigurojë që produktet e projektuara janë të përshtatshme për fluturim dhe të përshtatshme me mjedisin;

2. organizata e deklaruar e projektimit ka një koordinim të plotë dhe efikas brenda saj për sa i përket çështjeve të vlefshmërisë ajrore dhe pajtueshmërisë mjedisore.

e) Organizata e deklaruar e projektimit dokumenton strukturën organizative të organizatës së saj, së bashku me personelin kryesor që është përgjegjës për të siguruar që organizata vepron në përputhje me këtë nënpjesë, i përditëson dhe i vë në dispozicion Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2, sipas kërkesës.

21L.A.176 Objekti i punës

Organizata e deklaruar e projektimit identifikon llojet e punës së projektimit, kategoritë e produkteve për të cilat kryhen aktivitetet e projektimit, si dhe funksionet dhe detyrat që organizata kryen në lidhje me vlefshmërinë ajrore dhe përputhshmërinë mjedisore të produkteve.

21L.A.177 Detyrimet e organizatës së deklaruar të projektimit

Një organizatë e deklaruar e projektimit:

a) funksionon në përputhje me procedurat, praktikat dhe proceset e përcaktuara qartazi;

b) nëse organizata e deklaruar e projektimit synon të kryejë testimin e fluturimit, mirëmban dhe përditëson një manual operimi që ofron një përshkrim të politikave dhe proceseve të organizatës për testimin e fluturimit dhe e vë këtë manual në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, sipas kërkesës;

c) përcakton nëse projektimet e produkteve, duke përfshirë ndryshimet dhe riparimet, nuk kanë ndonjë veçori që e bëjnë të pasigurt dhe janë në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit, dhe me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, dhe i siguron Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, deklarata/dokumentacion që konfirmon këtë;

d) ofron tek Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 informacion ose udhëzime në lidhje me veprimet e vazhdueshme të vlefshmërisë ajrore;

e) vepron në përputhje me kërkesat në nënpjesën A të këtij aneksi të zbatueshme për organizatat e deklaruara të projektimit.

21L.A.178 Njoftimi për ndryshime dhe ndërprerje të veprimtarive

Organizata e deklaruar e projektimit njofton Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2 pa krijuar vonesa të panevojshme për çështjet në vijim:

a) çdo ndryshim në informacionin që është deklaruar në përputhje me pikën (c) të pikës 21L.A.173;

b) ndryshimet në sistemin e menaxhimit për projektim që janë të rëndësishme për dëshminë e përputhshmërisë së produktit të projektuar prej tyre;

c) ndërprerjen e disa ose të gjitha aktiviteteve që mbulon deklarata.

NËNPJESA K – PJESËT

21L.A.191 Objekti

Kjo Nënpjesë përcakton se si duhet të dëshmohet përputhshmëria e pjesëve me kërkesat e vlefshmërisë ajrore.

21L.A.192 Dëshmia e përputhshmërisë

a) Dëshmia e përputhshmërisë me kërkesat e vlefshmërisë ajrore të pjesëve që do të instalohen në një produkt të certifikuar tip ose një avion për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit bëhet:

1. sipas procedurave të certifikimit të tipit të nënpjesës B, D ose E të këtij aneksi për produktin në të cilin do të instalohet; ose

2. sipas deklaratës së procedurave të përputhshmërisë së projektimit të nënpjesës C ose F të këtij Aneksi për produktin në të cilin do të instalohet; ose

3. sipas procedurës së autorizimit ETSO të nënpjesës O të seksionit A të aneksit I (Pjesa 21); ose

4. në përputhje me standardet e njohura zyrtarisht në rastin e pjesëve standarde.

b) Pjesa duhet të jetë në përputhje me ETSO e zbatueshme ose me specifikimet e njohura si ekuivalente nga Agjencia në rastin e veçantë dhe në gjitha rastet kur miratimi i një pjese kërkohet në mënyrë eksplicite nga ligji i Bashkimit ose masat e Agjencisë.

21L.A.193 Lejimi i pjesëve për instalim

a) Një pjesë ose produkt instalohet në një produkt vetëm pasi identifikohet nga mbajtësi i një certifikate tipi, certifikate tipi shtesë, ndryshimi të projektimit, miratimi të projektimit të riparimit ose me një deklaratë përputhshmërie të projektimit si të përshtatshme për instalim, dhe kur është:

1. në gjendje për funksionim të sigurt;

2. shënuar në përputhje me nënpjesën Q të këtij aneksi; dhe

3. shoqëruar me një certifikatë të autorizuar për lejim (forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) që vërteton se artikulli është prodhuar në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektimit.

b) Me përjashtim të pikës (a) (3) dhe me kusht që të plotësohen kushtet në pikën (c), pjesët në vijim nuk kërkojnë një certifikatë të autorizuar për lejim (forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) për t'u instaluar në një produkt të certifikuar tipi ose në një avion për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit:

1. një pjesë standarde;

2. një pjesë që:

i) nuk ka jetëgjatësi të kufizuar, nuk është pjesë e strukturës parësore, as pjesë e kontrolleve të fluturimit;

ii) njihet për instalim në avionin specifik nga mbajtësi i një certifikate tipi, certifikate tipi shtesë, ndryshimi projektimi, miratimi të projektimit të riparimit ose një deklaratë përputhshmërie projektimi;

iii) që do të instalohet në një avion, pronari i të cilit ka verifikuar përputhshmërinë me kushtet e zbatueshme në (i) dhe (ii) dhe ka pranuar përgjegjësinë për këtë përputhshmëri;

3. një pjesë për të cilën pasojat e një mospërputhjeje me të dhënat e miratuara të projektimit ose të dhënat e deklaruara të projektimit kanë një efekt të papërfillshëm sigurie mbi produktin dhe që identifikohet si e tillë nga mbajtësi i miratimit të projektimit ose deklaruesi i përputhshmërisë së projektimit në udhëzimet për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore. Mbajtësi i miratimit të projektimit ose deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi mund të përcaktojë në udhëzimet për vazhdimësinë e vlefshmërisë ajrore aktivitete specifike të verifikimit që do të kryhen nga instaluesi i pjesës në produkt në mënyrë që të përcaktojë efektet e sigurisë të një pjese që nuk përputhet;

4. në rastin e përvetësimit të një ndryshimi standard sipas pikës 21L.A.102 ose një riparimi standard sipas pikës 21L.A.202, një pjesë për të cilën pasojat e një mospërputhjeje me të dhënat e saj të projektimit kanë një efekt të papërfillshëm sigurie mbi produktin, dhe pjesa është identifikuar si e tillë në përcaktimet e certifikimit për ndryshime standarde dhe riparime standarde të lëshuara në përputhje me pikën 21.B.70 të aneksit I (Pjesa 21). Në këto specifikime certifikimi mund të përcaktohen aktivitete specifike verifikimi që do të kryhen nga personi që instalon pjesën në produkt në mënyrë që të përcaktohen efektet e sigurisë së një pjese që nuk përputhet;

5. një pjesë që përjashtohet nga miratimi i vlefshmërisë ajrore në përputhje me urdhrin e ministrit nr. 80, datë 30.6.2023 “Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore” (2); dhe

6. një pjesë që përbën një artikull të një montimi më të madh të përcaktuar në pikat (b) (1) deri në (b) (5).

c) Pjesët e renditura në pikën (b) janë të përshtatshme për instalim në një produkt të certifikuar tipi ose në një avion për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin pa u shoqëruar nga Forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s, me kusht që instaluesi të ketë një dokument të lëshuar nga personi

ose organizata që ka prodhuar pjesën, ku deklarohet emri i pjesës, numri i pjesës dhe përputhshmëria e pjesës me të dhënat e projektimit të saj dhe që përmban datën e lëshimit.

2) Urdhri i ministrit nr. 80 datë 30.6.2023 “Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore” që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative lidhur me operacionet ajrore në përputhje me VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”.

NËNPJESA M – PROJEKTIMI I RIPARIMEVE TË PRODUKTEVE ME CERTIFIKATË TIPI

21L.A.201 Objekti

Kjo Nën pjesë përcakton:

- a) procedurën e aplikimit për miratimet e modeleve të riparimit të produkteve me certifikatë tipi;
- b) të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të miratimeve që përmenden në pikën (a);
- c) dispozitat për riparimet standarde që nuk kërkojnë miratim.

21L.A.202 Riparime standarde

a) Riparimet standarde janë projektme riparimi për një produkt me certifikatë të licencuar në përputhje me nën pjesën B të seksionit B të këtij aneksi dhe të cilat:

1. ndjekin të dhënat e projektimit të përfshira në specifikimet e certifikimit të lëshuara nga Agjencia që përmbajnë metodat, teknikat dhe praktikën e pranueshme për kryerjen dhe identifikimin e riparimeve standarde, duke përfshirë udhëzimet shoqëruese për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore; dhe

2. nuk janë në kundërshtim me të dhënat e mbajtësit të asaj certifikate tipi.

b) Pikat 21L.A.203 deri në 21L.A.211 nuk zbatohen për riparimet standarde.

21L.A.203 Klasifikimi i modeleve të riparimit në një produkt me certifikatë tipi

a) Projektimet e riparimeve në një produkt me certifikatë tipi do të klasifikohen si ndryshime të vogla ose të mëdha.

b) Një “riparim i vogël” nënkupton një projektim riparimi që nuk ka efekt të dukshëm në masën, ekuilibrin, forcën strukturore, besueshmërinë, nivelin e certifikuar të zhurmës ose emetimeve, karakteristikat operacionale ose karakteristika të tjera që ndikojnë te vlefshmëria ajrore ose përputhshmëria mjedisore e produktit.

c) Të gjitha projektimet e tjera të riparimit konsiderohen “riparime të mëdha”.

d) Kërkesat për miratimin e projekteve të riparimeve të vogla janë ato që parashikohen në pikën 21L.A.207.

e) Kërkesat për miratimin e projekteve të riparimeve të mëdha janë ato që përcaktohen në pikën 21L.A.208.

21L.A.204 Pranueshmëria

a) Çdo person fizik ose juridik që ka dëshmuar ose është në proces dëshmimi të aftësisë së tij të projektimit në përputhje me pikën 21L.A.23, mund të aplikojë për miratimin e projektimit të riparimit të madh të një produkti me certifikatë tipi sipas kushteve të përcaktuara në këtë nën pjesë.

b) Çdo person fizik ose juridik mund të aplikojë për miratimin e projektimit të një riparimi të vogël në një produkt me certifikatë tipi sipas kushteve të parashikuara në këtë nën pjesë.

21L.A.205 Aplikim për miratimin e një projektimi riparimi për një produkt me certifikatë tipi

a) Aplikimi për miratimin e projektimit të riparimit në një produkt me certifikatë tipi bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

b) Për miratimin e projektimit të një riparimi të madh, aplikanti përfshin në aplikim ose dorëzon pas aplikimit fillestar, një plan të dëshmisë së përputhshmërisë që:

1. përmban përshkrimin e dëmtimit dhe projektimin e riparimit, që identifikon konfigurimin e projektimit të tipit mbi të cilin është bërë projektimi i riparimit;

2. identifikon të gjitha fushat e projektimit të tipit dhe manualët e miratuara që ndryshohen ose preken nga projekti i riparimit;

3. identifikon çdo rihetim të nevojshëm për të demonstruar përputhshmërinë e projektit të riparimit dhe zonat e prekura nga projektimi i riparimit me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, të përfshira me referencë, sipas rastit, në certifikatën e tipit ose në certifikatën e tipit shtesë;

4. identifikon çdo ndryshim të propozuar në bazën e certifikimit të tipit të përfshirë me referencë, sipas rastit, në certifikatën e tipit ose në certifikatën e tipit shtesë;

5. specifikon nëse të dhënat e certifikimit janë përgatitur ose do të përgatiten plotësisht nga aplikanti ose në bazë të një marrëveshjeje me pronarin e të dhënave të certifikimit të tipit.

21L.A.206 Dëshmia e përputhshmërisë

a) Aplikanti duhet të vërtetojë për miratimin e projektimit të një riparimi të madh përputhshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikatës së tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç janë përcaktuar dhe njoftuar aplikantit nga Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.201, dhe duhet t'i garantojë Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2 mjetet me të cilat është vërtetuar kjo përputhshmëri.

b) Aplikanti për miratimin e projektimit të një riparimi të madh siguron për Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2, një arsytim të regjistruar të mjeteve të përputhshmërisë brenda dokumenteve të përputhshmërisë sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë.

c) Kur kryen teste dhe inspekte për të dëshmuar përputhshmërinë në përputhje me pikën (a), aplikanti ka verifikuar dhe dokumentuar këtë verifikim përpara kryerjes së ndonjë testimi:

1. për testimin provë, që:

i) materialet dhe proceset janë në përputhje të pranueshme me specifikimet për projektin e tipit të propozuar;

ii) pjesët përbërëse të produkteve përputhen në mënyrë të pranueshme me skicat në modelin e tipit të propozuar;

iii) proceset e prodhimit, ndërtimi dhe montimi janë në përputhje të pranueshme me ato të specifikuar në projektimin e tipit të propozuar; dhe

2. që testimi dhe pajisjet matëse të përdorura për testimin ishin të përshtatshme për këtë të fundit dhe të kalibruara siç duhet.

d) Testimet e fluturimit me qëllim marrjen e miratimit të projektimit të një riparimi të madh do të kryhen në përputhje me metodat për këto teste fluturimi të përcaktuara nga Agjencia. Aplikanti duhet të bëjë të gjitha testimet e fluturimit të nevojshëm për të përcaktuar përputhshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

e) Një aplikant për miratimin e projektimit të një riparimi të madh i lejon Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2:

1. të shqyrtojë çdo të dhënë dhe informacion në lidhje me dëshminë e përputhshmërisë;

2. të dëshmojë ose kryejë ndonjë testim ose inspektim të kryer me qëllim të dëshmisë së përputhshmërisë; dhe

3. nëse konsiderohet e nevojshme, të kryejë një inspektim fizik të produktit të riparuar për të verifikuar përputhshmërinë e projektimit me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

f) Pas përfundimit të demonstrimit të përputhshmërisë, aplikanti i deklaron Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, se:

1. ka dëshmuar përputhshmëri me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç i janë përcaktuar dhe njoftuar aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.201, sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë; dhe

2. nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin me projektim riparimi të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

21L.A.207 Kërkesat për miratimin e projektimit të një riparimi të vogël

Për t'u pajisur me miratimin e projektimit të një riparimi të vogël në një produkt me certifikatë tipi, aplikanti:

a) dëshmon se projektimi i riparimit dhe zonat e prekura nga projektimi i riparimit janë në përputhje me:

1. me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të përfshira me referencë në certifikatën e tipit; ose

2. nëse aplikanti zgjedh, me specifikimet e certifikimit që janë të zbatueshme për produktin në datën e aplikimit për miratimin e projektimit të riparimit;

b) të deklarojë përputhshmërinë me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit që zbatohen në përputhje me pikën (a)(1), ose me specifikimet e certifikimit të zgjedhura në përputhje me pikën (a)(2), të regjistrojë arsyetimet e përputhshmërisë në dokumentet e përputhshmërisë dhe regjistron faktin se nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin e ndryshuar të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi;

c) t'i paraqesë Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, arsyetimin e përputhshmërisë për riparimin dhe deklaratën e përputhshmërisë.

21L.A.208 Kërkesat për miratimin e projektimit të një riparimi të madh

Për t'u pajisur me miratimin e projektimit të një riparimi të madh në një certifikatë tipi, aplikanti:

a) dëshmon se projekti i riparimit dhe zonat e prekura nga projekti i riparimit janë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç përcaktohet dhe i njoftohet aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me pikën 21L.B.201;

b) dëshmon përputhshmërinë në përputhje me pikën 21L.A.206;

c) nëse aplikanti ka specifikuar se ata kanë ofruar të dhëna certifikimi në bazë të një marrëveshjeje me pronarin e të dhënave të certifikimit të tipit në përputhje me pikën 21L.A.205(b)(5), ai dëshmon se mbajtësi i certifikatës së tipit:

1. nuk ka asnjë kundërshtim teknik për informacionin e paraqitur në pikën 21L.A.205; dhe

2. ka rënë dakord të bashkëpunojë me aplikantin për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të produktit të riparuar nëpërmjet veprimit në përputhje me pikat 21L.A.28 dhe 21L.A.88;

d) dëshmon se nga inspektimi fizik i artikullit të parë të atij produkti nuk ka çështje të pazgjidhura lidhur me projektimin e riparimit në konfigurimin e ndryshuar përfundimtar të kryer nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me pikën 21L.A.206(e)(3).

21L.A.209 Miratimi i një projektimi riparimi shtesë sipas një privilegji

a) Miratimi i një projektimi riparimi që është projektuar mund të lëshohet nga një organizatë projektuese e miratuar pa aplikim sipas pikës 21L.A.205 në përputhje me objektin e privilegjeve të parashikuara në pikat (2) dhe (5) të pikës 21.A.263(c) të aneksit I (Pjesa 21) në vend të Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, siç është shënuar në kushtet e miratimit.

b) Kur lëshon një miratim riparimi në përputhje me pikën (a), organizata e projektimit:

1. siguron që të gjitha të dhënat mbështetëse dhe arsyetimet janë të disponueshme;

2. garanton se është dëshmuar përputhshmëria e ndryshimit me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit sipas pikës (a) të pikës 21L.A.207 ose pikës (a) të pikës 21L.A.208 dhe është deklaruar në përputhje me pikën 21L.A.206;

3. konfirmon që nuk është gjetur:

i) asnjë mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit ose, kur është e aplikueshme, me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, ose me specifikimet e zgjedhura të certifikimit;

ii) asnjë veçori ose karakteristikë e riparimit që mund ta bëjë produktin e ndryshuar të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi;

4. kufizon miratimin e një riparimi në një certifikatë tipi në konfigurimet specifike në certifikatën e tipit me të cilin lidhet riparimi.

21L.A.210 Detyrimet e mbajtësit të miratimit të projektimit të riparimit

Mbajtësi i miratimit të projektimit të riparimit:

a) nëse ai nuk është mbajtës i certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit shtesë, dhe të dhënat e certifikimit janë dhënë në përputhje me 21L.A.205 (b)(5), nënshkruhet një marrëveshje me mbajtësin përkatës;

b) i siguron organizatës që kryen riparimin të gjitha udhëzimet e nevojshme për të instaluar ose përvetësuar modelin e riparimit;

c) mbështet çdo organizatë prodhuese që prodhon pjesë për projektimin e riparimit dhe siguron që ato pjesë të prodhohen duke përdorur të dhënat e prodhimit që bazohen në të dhënat e projektimit të ofruara nga mbajtësi i miratimit të projektimit të riparimit;

d) siguron që projektimi i riparimit të përfshijë të gjitha udhëzimet dhe kufizimet e nevojshme, nëse një projekt riparimi miratohet si subjekt i kufizimeve. Mbajtësi i miratimit të projektit të riparimit i përcjell këto udhëzime dhe kufizime operatorit në përputhje me procedurën e rënë dakord me Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2;

e) ndërmerr detyrimet e mbajtësit të miratimit të projektit të riparimit të nënpjesës A të këtij aneksi.

21L.A.211 Dëmtime të riparueshme

Dëmtimi i një produkti, projektimi i të cilit është miratuar në përputhje me seksionin B, mund të mos kërkojë një projekt riparimi nëse vlerësimi i pasojave të vlefshmërisë ajrore e justifikon atë. Ky vlerësim duhet të bëhet nga Autoriteti kompetent ose nga një organizatë projektuese e cila është miratuar në përputhje me nënpjesën J të seksionit A të aneksit I (pjesa 21), sipas një procedure të miratuar nga Autoriteti kompetent. Nëse nga vlerësimi arrihet në përfundimin se dëmtimi i riparueshëm kërkon kufizime, ato do të përpunohen në përputhje me pikën (d) të pikës 21L.A.210.

NËNPJESA N – PROJEKTIMI I RIPARIMEVE TË AVIONËVE PËR TË CILËT ËSHTË DEKLARUAR PËRPUTHSHMËRIA E PROJEKTIMIT

21L.A.221 Objekti

Kjo nënpjesë përcakton:

a) procedurën për deklarimin e përputhshmërisë së projekteve të riparimeve për avionin që ka qenë subjekt i një deklarate të bërë në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi;

b) të drejtat dhe detyrimet e deklaruesit që ka bërë një deklaratë për përputhshmërinë e ndryshimit të përmendur në pikën (a);

c) dispozitat në lidhje me riparimet standarde që nuk kërkojnë deklaratën e përputhshmërisë së projektimit.

21L.A.222 Riparime standarde

a) Riparimet standarde nënkuptojnë projektimet e riparimeve në një avion që ka qenë subjekt i një deklarate të bërë në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi dhe që:

1. ndjekin të dhënat e projektimit të përfshira në specifikimet e certifikimit të lëshuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 që përmbajnë metodat, teknikat dhe praktikatat e pranueshme për kryerjen

dhe identifikimin e riparimeve standarde, duke përfshirë udhëzimet shoqëruese për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore; dhe

2. nuk janë në kundërshtim me të dhënat e projektimit të përfshira në deklaratën e përputhshmërisë së projektimit të avionit të bërë në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi.

b) Pikat 21L.A.223 deri në 21L.A.229 nuk zbatohen për riparimet standarde.

21L.A.223 Klasifikimi i projekteve të riparimit për një avion për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit

a) Projektimet e riparimeve të një avioni që ka qenë subjekt i një deklarate të bërë në përputhje me nënpjesën C të kësaj shtojce klasifikohen si riparime të mëdha ose të vogla, duke përdorur kriteret e përcaktuara në pikat (b) dhe (c) të 21L.A.203.

b) Përputhshmëria e projektimit të riparimit të vogël deklarohet në përputhje me pikën 21L.A.225.

c) Përputhshmëria e projektimit të riparimit deklarohet në përputhje me pikën 21L.A.226.

21L.A.224 Pranueshmëria

a) Një deklarues që ka bërë një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit të avionit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi mund të deklarojë përputhshmërinë e projektimit të një riparimi të vogël në atë avion sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë. Për më tepër, deklarata e përputhshmërisë mund të bëhet gjithashtu, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë, nga një organizatë projektuese e miratuar në përputhje me pikën (c)(3) të pikës 21.A.263 të aneksit I (Pjesa 21).

b) Vetëm deklaruesi që ka bërë një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit të avionit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi mund të deklarojë përputhshmërinë e një projekti riparimi të madh në avionin, për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë.

c) Me përjashtim të pikës (b), nëse deklaruesi i cili ka bërë një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit të avionit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi nuk është më aktiv ose nuk i përgjigjet kërkesave për projekte riparimi, përputhshmëria e një projekti të ndryshuar të avionit mund të deklarohet gjithashtu në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi nga një organizatë projektuese e miratuar në përputhje me pikën (c)(2) të pikës 21.A.263 të aneksit I (pjesa 21) brenda objektit të kushteve të tyre të miratimit, ose nga çdo person tjetër fizik ose juridik që mund të marrë përsipër detyrimet e përcaktuara në pikën 21L.A.47 në lidhje me avionin që ka qenë subjekt i ndryshimeve.

21L.A.225 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit për projekte riparimesh të vogla

a) Përpara përfshirjes, përvetësimit ose marrëveshjes me një organizatë prodhuese për të përfshirë ose përvetësuar një projektim të një riparimi të vogël në një avion për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi, deklaruesi ose organizata që ka projektuar riparimin e vogël deklarohet se projektimi i riparimit të vogël është në përputhje me specifikimet teknike të detajuara dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit me të cilat është deklaruar përputhshmëria sipas pikës 21L.A.43.

b) Deklarata e përputhshmërisë së projektimit bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

c) Deklaruesi ose organizata që ka projektuar ndryshimin e vogël duhet të mbajë një regjistër të projekteve të riparimeve të vogla në avionin, për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin dhe të bëjë çdo deklaratë që është bërë në përputhje me pikën (a) në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2 sipas kërkesës.

21L.A.226 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit për projekte riparimesh të mëdha

a) Përpara përfshirjes, përvetësimit ose marrëveshjes me një organizatë prodhuese për të përfshirë ose përvetësuar një projektim të riparimit të madh në një avion për të cilin është deklaruar

përputhshmëria e projektimit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi, deklaruesi deklaron se projektimi i riparimit të madh është në përputhje me specifikimet teknike të detajuara dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit me të cilat është deklaruar përputhshmëria sipas pikës 21L.A.43.

b) Deklarata e përputhshmërisë së projektimit bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2.

c) Deklarata përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. emrin e personit që dorëzon deklaratën dhe adresën/vendin e biznesit të tij;
2. numrin e referencës së deklaratës së avionit me të cilin lidhet projektimi i riparimit të madh;
3. një referencë unike për identifikimin e projektimit të riparimit të madh;
4. treguesin e specifikimeve teknike të detajuara dhe të kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, me të cilat deklaruesi ka deklaruar përputhshmërinë e avionit sipas pikës 21L.A.43;

5. një deklaratë e nënshkruar nën përgjegjësinë e vetme të personit që bën deklaratën se projektimi i riparimit të madh është në përputhje me specifikimet teknike të detajuara dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të përmendura në pikën (4), sipas planit të dëshmisë të përputhshmërisë të përmendur në pikën (d) (3);

6. një deklaratë e nënshkruar nën përgjegjësinë e vetme të personit që bën deklaratën se nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë nga ai person që mund ta bëjnë avionin të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimin e synuar;

7. një përshkrim i dëmtimit dhe projektimin e riparimit që përcakton konfigurimin e projektimit të tipit në bazë të të cilit është bërë riparimi;

8. identifikimin e të gjitha zonave të projektimit të tipit dhe manualeve të miratuara që ndryshohen ose preken nga projektimi i riparimit.

d) Deklaruesi që projektin një riparim të madh i dorëzon Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2 deklaratën e përmendur në pikën (c). Së bashku me këtë deklaratë, deklaruesi i ofron Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2:

1. një përshkrimin të riparimit të madh;
2. të dhënat bazë për riparimin e madh, duke përfshirë karakteristikat e operimit, veçoritë e projektimit dhe çdo kufizim;

3. një plan të dëshmisë së përputhshmërisë që detajon mënyrat e dëshmisë së përputhshmërisë që janë ndjekur gjatë kësaj dëshmie;

4. arsyetimet e regjistruara të përputhshmërisë në të dhënat e përputhshmërisë të marra nga veprimtaritë e përputhshmërisë që janë kryer sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë;

5. metodat me anë të të cilave janë përmbushur specifikimet e detajuara teknike dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, me të cilat deklaruesi ka deklaruar se përputhshmëria e atij avioni sipas pikës 21L.A.43, është dëshmuar;

6. justifikimin e regjistruar të përputhshmërisë së artikujve dhe pajisjeve të testimit, në rastet kur përputhshmëria dëshmohet duke kryer teste, duke dëshmuar:

i) për testimin provë, që:

A. materialet dhe proceset janë në përputhje të pranueshme me specifikimet për projektimin;

B. pjesët përbërëse të produkteve janë përshtatur në mënyrë të pranueshme me skicat në projektim; dhe

C. proceset e prodhimit, ndërtimi dhe montimi janë në përputhje të pranueshme me ato të specifikuar në projektim;

ii) testimi dhe pajisjet matëse të përdorura për testimin ishin të përshtatshme për testimin dhe të kalibruara siç duhet;

7. raportet, rezultatet e inspektimeve ose testimet që deklaruesi i ka konsideruar të nevojshme për të përcaktuar nëse avioni është në përputhje me specifikimet teknike të detajuara dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

e) Deklarata e një riparimi të madh në një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit do të kufizohet në konfigurimet specifike në deklaratën e përputhshmërisë së projektimit me të cilën lidhet ndryshimi.

21L.A.227 Veprimtaritë e përputhshmërisë për deklarimin e përputhshmërisë së një projektimi të riparimit të madh

Përpara se të bëjë një deklaratë përputhshmërie në përputhje me pikën 21L.A.226, deklaruesi, për atë model specifik do të:

a) hartojë një plan të dëshmisë së përputhshmërisë duke detajuar mënyrat e dëshmisë së përputhshmërisë që do të ndiqen gjatë kësaj dëshmie. Ky dokument do të përditësohet sipas nevojës;

b) regjistrojë justifikimin e përputhshmërisë në dokumentet e pajtueshmërisë sipas planit të dëshmisë së përputhshmërisë;

c) kryejë teste dhe inspektime sipas nevojës në përputhje me planin e dëshmisë së përputhshmërisë;

d) sigurojë dhe regjistrojë përputhshmërinë e artikujve dhe pajisjeve të provës dhe të sigurojë që testimi provë është në përputhje me specifikimet, skicat, proceset e prodhimit, mjetet e ndërtimit dhe montimit për projektimin;

e) sigurojë që pajisjet e testimit dhe matjes që do të përdoren për testim janë të përshtatshme për testim dhe të kalibruar siç duhet;

f) lejojë Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, të kryejë ose të marrë pjesë në çdo inspektim ose testim të avionit në konfigurimin përfundimtar ose të zhvilluar të duhur të projektimit dhe prodhimit që është i nevojshëm për të përcaktuar se produkti me projektimin e riparimit nuk ka asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë avionin të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimin e synuar;

g) kryejë testimet e fluturimit, në përputhje me kushtet e fluturimit për testimet e fluturimit të specifikuar nga Agjencia, sipas nevojës për të përcaktuar nëse avioni është në përputhje me specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

21L.A.228 Detyrimet e deklaruesit për një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit të riparimit

Deklaruesi i deklaratës së përputhshmërisë së projektimit:

a) mban një regjistër të atyre deklaratave për projektet e riparimeve të vogla dhe i vë këto deklarata në dispozicion të Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2 sipas kërkesës;

b) i siguron organizatës që kryen riparimin të gjitha udhëzimet e nevojshme për të instaluar ose përvetësuar modelin e riparimit;

c) mbështet çdo organizatë prodhuese që prodhon pjesë për projektimin e riparimit dhe siguron që ato pjesë të prodhohen duke përdorur të dhënat e prodhimit që bazohen në të dhënat e projektimit të ofruara nga deklaruesi;

d) nëse një projektim riparimi deklarohet se është subjekt i kufizimeve, i përcjell këto kufizime operatorit duke përdorur një procedurë të dokumentuar që i vihet në dispozicion Autoritetit kompetent sipas pikës 21L.2, sipas kërkesës;

e) ndërmerr detyrimet e një deklaruesi të përputhshmërisë së projektimit të një projektimi të riparimi të nënpjesës A të këtij aneksi.

21L.A.229 Dëmtime të riparuar

Deklaruesi i përputhshmërisë së projektimit të një avionit në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi ose një organizatë projektimi e miratuar me privilegje që parashikohen në përputhje me pikën

(c)(3) të pikës 21.A.263 të aneksit I (pjesa 21) dhe me objektin e duhur të miratimit kryen një vlerësim të vlefshmërisë ajrore dhe pasojave të përputhshmërisë mjedisore të çdo dëmtimi të avionit që nuk është riparuar dhe që nuk mbulohet nga të dhënat e deklaruara më parë. Çdo kufizim i nevojshëm trajtohet në përputhje me pikën (d) të pikës 21L.A.228.

NËNPJESA O – AUTORIZIMET E URDHRAVE TEKNIKE EVROPIAN (ETSO)

(Rezervë)

NËNPJESA P – LEJA E FLUTURIMIT

21L.A.241 Leja e fluturimit dhe kushtet e fluturimit

a) Procedurat për aplikimin për lëshimin e lejeve për fluturim dhe kushtet përkatëse të fluturimit për avionët brenda objektit të këtij aneksi janë të përcaktuara në nënpjesën P të seksionit A të aneksit I (pjesa 21) dhe të përcaktuara në paragrafin (b) (c) të pikës 21L.A.241

b) Kur aplikon për një leje fluturimi në përputhje me pikën 21.A.707 të aneksit I (Pjesa 21), aplikanti organizon që AAC-ja të kryejë një inspektim të përputhshmërisë të avionit kur aplikimi për leje fluturimi ka të bëjë me:

1. dëshminë e aktiviteteve të përputhshmërisë në pikën 21L.A.25 për një avion i cili është, ose synohet të jetë me certifikatë tipi;

2. dëshminë e aktiviteteve të përputhshmërisë në pikën 21L.A.44 për një avion, për të cilin është ose synohet të deklarohej përputhshmëria e projektimit.

c) Për aplikimin e kushteve të fluturimit në përputhje me pikën 21.A.709 të aneksit I (Pjesa 21), aplikanti organizon për Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2:

1. inspektimin dhe vlerësimin fizik në avion nëse kushtet e fluturimit lidhen me dëshminë e përputhshmërisë për të mbështetur deklaratën e përputhshmërisë së projektimit në pikën 21L.A.44 dhe nëse kërkohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 gjatë dëshmisë të aktiviteteve të përputhshmërisë siç përmendet në paragrafin (b) të pikës 21L.B.121 dhe paragrafin (c) të pikës 21L.B.203; ose

2. inspektimin dhe vlerësimin fizik në avion dhe për të kryer një rishikim kritik të projektimit nëse kushtet e fluturimit lidhen me dëshminë e përputhshmërisë lidhur me certifikimin e projektimit në pikën 21L.A.25 dhe nëse kërkohet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në pikën 21L.B.83, 21L.B.102 dhe pikën 21L.B.203.

NËNPJESA Q – IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE DHE PJESËVE

21L.A.251 Objekti

Kjo Nën pjesë përcakton kërkesat për identifikimin e produkteve dhe pjesëve të projektuara dhe prodhuara sipas këtij Aneksi.

21L.A.252 Projektimi i shënjimeve

a) Mbajtësi i një certifikate tipi, certifikate tipi shtesë, miratimi të një ndryshimi në certifikatën e tipit ose miratimi të një projektimi riparimi, ose deklaruesi i një deklaratë përputhshmërie projektimi specifikon të dhënat për shënjimin e produkteve ose pjesëve të projektuara në përputhje këtë Aneks.

b) Specifikimet e shënjitimit përfshijnë të dhënat e mëposhtme:

1. për produktet:

i) emrin e organizatës të prodhimit;

ii) emërtimin e produktit;

iii) numri e serisë të produktit;

iv) çdo informacion tjetër të përshtatshëm për identifikimin e produktit;

2. për pjesët:

i) emrin, markën tregtare ose simbolin që identifikon organizatën e prodhimit;

ii) numrin e pjesës;

iii) numrin e serisë, në rastet kur një pjesë që vendoset në një produkt është identifikuar si pjesë kritike.

c) Specifikimin e pjesëve në përputhje me paragrafin (ii) të pikës (b)(2) përfshijnë shkronjën “(R)” në fund të numrit të pjesës kur:

1. pjesa është nga një projektim që i nënshtrohet një deklaratë përputhshmërie projektimi në përputhje me nënpjesën C të këtij aneksi;

2. pjesa përcaktohet në formën 1 RSH, sipas modelit të EASA-s në përputhje me paragrafin (a) të pikës 21L.A.193; dhe

3. pjesa është prodhuar në përputhje me nënpjesën R të këtij aneksi.

21L.A.253 Identifikimi i produkteve

a) Çdo person fizik ose juridik që prodhon produkte sipas nënpjesës G të seksionit A të aneksit I (pjesa 21) ose nënpjesës G ose R të këtij aneksi për të cilin projektimi është miratuar ose deklaruar në përputhje me këtë aneks, duhet ta identifikojë atë produkt siç specifikohet në përputhje me 21L.A.252 me anë të një shënimi rezistent ndaj zjarrit të vendosur në pllakë.

b) Pllaka e identifikimit sigurohet në mënyrë të tillë që të jetë e aksesueshme dhe e lexueshme, dhe nuk ka të ngjarë të prishet ose hiqet gjatë shërbimit normal, ose të humbasë ose shkatërrohet në një aksident, dhe në rastin e një helike, teht të helikës ose qendrës së helikës, vendosur në një sipërfaqe jo të rrezikshme të artikullit.

c) Për balonat me pilot, pllaka e identifikimit vendoset në pjesën e jashtme të balonës dhe duhet të vendoset, nëse është e mundur, aty ku është e lexueshme për operatorin kur është balona e fryrë. Përveç kësaj, koshi, montimi i pajisjes furnizuese dhe montimi i ngrohësit shënohen në mënyrë të përherëshme dhe të lexueshme me emrin e organizatës të prodhimit, numrin e pjesës ose ekuivalentin e tij, dhe numrin e serisë ose ekuivalentin e tij.

21L.A.254 Trajtimi i të dhënave të identifikimit

a) Çdo person fizik ose juridik që kryen punë mirëmbajtjeje në përputhje me rregulloren “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, në përputhje me metodat, teknikat dhe praktikatat e përcaktuara nga Agjencia mund të:

1. heqë, ndryshojë ose vendosë informacionin e identifikimit të përmendur në pikën 21L.A.253; ose

2. heqë ose instalojë një pllakë identifikimi të përmendur në pikën 21L.A.253, kur është e nevojshme gjatë operacioneve të mirëmbajtjes.

b) Përveç nëse për qëllimet e përcaktuara në pikën (a) të pikës 21L.A.254, asnjë person nuk duhet të heqë, ndryshojë ose vendosë informacionin e identifikimit të përmendur në pikën (a) të pikës 21L.A.253.

c) Përveç nëse për qëllimet e përcaktuara në pikën (a) të pikës 21L.A.254, asnjë person nuk duhet të heqë ose instalojë asnjë pllakë identifikimi të përmendur në pikën (a) të pikës 21L.A.253.

d) Asnjë person nuk duhet të instalojë një pllakë identifikimi të hequr në përputhje me pikën (a)(2) në një avion, motor, helikë, teht të helikës ose rotor të helikës, përveç atij nga i cili është hequr.

21L.A.255 Identifikimi i pjesëve

Çdo person fizik ose juridik që prodhon pjesë sipas nënpjesës G të seksionit A të aneksit I (pjesa 21) ose sipas nënpjesës G ose R të këtij aneksi për një produkt për të cilin është miratuar ose deklaruar projektimi në përputhje me këtë aneks, duhet të shënohet në mënyrë të lexueshme ajo pjesë siç specifikohet në përputhje me pikën 21L.A.252.

NËNPJESA R – DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË PËR AVIONËT DHE CERTIFIKATA E AUTORIZUAR PËR PËRDORIM (forma 1 E RSH-së, SIPAS MODELIT TË

EASA-s) PËR MOTORËT DHE HELIKAT, OSE PJESËT E TYRE, QË PËRPUTHEN ME NJË DEKLARATË PËRPUTHSHMËRIE PROJEKTIMI

21L.A.271 Objekti

Kjo Nën pjesë përcakton procedurat për lëshimin e deklaratave të përputhshmërisë për avionët (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) dhe certifikatat e autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) për motorët dhe helikat, ose pjesët e tyre, që janë prodhuar në përputhje me të dhënat e projektimit të një deklarate të përputhshmërisë së projektimit dhe të drejtat dhe detyrimet e deklaruesit.

21L.A.272 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik të cilit i jepet akses në të dhënat e aplikueshme të projektimit dhe arrin të marrë përsipër detyrimet e përcaktuara në pikën 21L.A.275, mund të lëshojë një deklaratë përputhshmërie (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) për një avion ose një certifikatë të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) për një motor ose helikë, ose një pjesë të tyre, sipas kushteve që përcaktohen në këtë nën pjesë.

21L.A.273 Sistemi i kontrollit të prodhimit

Një person fizik ose juridik që lëshon një deklaratë përputhshmërie (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose një certifikatë të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) me të dhënat e zbatueshme të deklaruara të projektimit të një avioni, motori ose helike, ose një pjesë të tij, që ata kanë prodhuar, krijuar, zbatuar dhe mirëmbajnë një sistem për kontrollin e prodhimit që:

a) përfshin procese dhe procedura që sigurojnë që avioni, motori ose helika, dhe çdo pjesë e tyre, përputhen me të dhënat e zbatueshme të deklaruara të projektimit;

b) siguron që çdo deklaratë përputhshmërie (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose certifikatë të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) të nënshkruhet vetëm nga persona të autorizuar;

c) nëse testet e fluturimit janë të nevojshme brenda fushës së prodhimit, ka procese të vendosura që sigurojnë që çdo test fluturimi të kryhet në mënyrë të sigurt;

d) siguron që personi fizik ose juridik të marrë të gjitha të dhënat e nevojshme të vlefshmërisë ajrore dhe të përputhshmërisë mjedisore për të përcaktuar përputhshmëri;

e) ka procedura të vendosura që sigurojnë që të dhënat e vlefshmërisë ajrore dhe përputhshmërisë mjedisore të përfshihen saktë në të dhënat e prodhimit, të mbahen të përditësuara dhe të vihen në dispozicion të gjithë personelit që ka nevojë për akses në të dhëna të tilla për të kryer detyrat e tyre;

f) përfshin një sistem inspektimi që siguron që çdo avion, motor ose helikë, dhe çdo pjesë e tij, që prodhohet nga personi fizik ose juridik duke përfshirë partnerët e tyre, ose është furnizuar ose nënkontraktuar me palët e jashtme, dhe është në përputhje me të dhënat e aplikueshme të projektimit të deklaruar dhe janë në gjendje për funksionim të sigurt;

g) përfshin një sistem arkivimi që regjistron kërkesat që u janë vendosur organizatave të tjera si furnizuesit dhe nënkontraktorët. Të dhënat e arkivuara do t'i vihen në dispozicion AAC-së për qëllime të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore;

h) siguron që mirëmbajtja e një avionit të sapoprodhuar të kryhet në përputhje me udhëzimet e zbatueshme të mirëmbajtjes dhe të mbahen në gjendje të përshtatshme për fluturim dhe, nëse është e zbatueshme, të lëshohet një certifikatë e lejimit në shërbim për çdo mirëmbajtje që ka është përfunduar.

i) përfshin një sistem të brendshëm të raportimit të ngjarjeve në interes të sigurisë, për të mundësuar mbledhjen dhe vlerësimin e raporteve të ngjarjeve të mbledhura në përputhje me pikën 21L.A.3, në mënyrë që të identifikojë tendencat e pafavorshme ose për të trajtuar mangësitë dhe për të nxjerrë

veprime të raportueshme. Ky sistem përfshin vlerësimin e informacionit përkatës në lidhje me ngjarjet dhe shpalljen e informacionit përkatës.

21L.A.274 Lëshimi i një deklaratë përputhshmërie (forma 52B e RSH-s, sipas modelit të EASA-s) ose një certifikatë të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s)

a) Kur personi fizik ose juridik lëshon një deklaratë përputhshmërie (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose një certifikatë të autorizuar për lejim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s), duhet të përfshijë të gjitha si në vijim:

1. një deklaratë që avioni, motori ose helika, ose ndonjë pjesë e tyre, përputhet me të dhënat e zbatueshme të deklaruara të projektimit dhe është në gjendje për funksionim të sigurt;
2. për çdo avion, një deklaratë që avioni është kontrolluar në tokë dhe në fluturim;
3. për çdo motor ose helikë me krah rrotullimi, një deklaratë që motori ose helika me krah rrotullimi i është nënshtruar një testi funksional përfundimtar;
4. nëse është e zbatueshme, një deklaratë që vërteton se motori i plotë është në përputhje me kërkesat e zbatueshme për emetimet e gazrave të motorit, në fuqi në datën e prodhimit të motorit.

b) Personi fizik ose juridik lëshon një deklaratë përputhshmërie (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose një certifikatë të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) në lidhje me:

1. transferimi fillestar i pronësisë së avionit, motorit ose helikës, ose pjesëve të tyre; ose
2. për avionët, aplikimi për lëshimin e certifikatës së kufizuar të vlefshmërisë ajrore për mjetin fluturues.

21L.A.275 Detyrimet e një personi fizik ose juridik që lëshon një deklaratë përputhshmërie (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose një certifikatë të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s)

Personi fizik ose juridik që lëshon një deklaratë përputhshmërie (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose një certifikatë të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s):

- a) informon AAC-në se ata synojnë të prodhojnë një avion, motor ose helikë, ose një pjesë të tij, në përputhje me të dhënat e projektimit të një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit dhe se ata do të lëshojnë deklarata përputhshmërie (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose certifikata të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) në përputhje me këtë nënpjesë;
- b) siguron që të shënohen detajet e çdo pune të përfunduar;
- c) të shënohen, në vendin e prodhimit, të dhënat teknike dhe vizatimet e nevojshme për të përcaktuar nëse avioni, motori ose helika, ose një pjesë e tyre, përputhet me të dhënat e zbatueshme të deklaruara të projektimit;
- d) siguron mbështetje të vazhdueshme për vlefshmërinë ajrore për deklaruesin e një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit për çdo avion, motor ose helikë, ose një pjesë të tij, që ata kanë prodhuar;
- e) për avionët e rinj që ata kanë prodhuar, siguron që avioni të mbahet në gjendje të përshtatshme për fluturim dhe që të kryhet mirëmbajtja, përveç rasteve kur rregullorja “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, që transponon rregulloren e BE-së nr. 1321/2014, kërkon që mirëmbajtja të kryhet sipas rregullave të tilla, duke përfshirë çdo riparim të nevojshëm në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektimit përpara lëshimit të deklaratës së përputhshmërisë të avionit (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s);

f) kur lëshon një certifikatë lejimi në shërbim pas një mirëmbajtjeje të tillë, të verifikohet që çdo avion i përfunduar i është nënshtruar mirëmbajtjes së nevojshme dhe është në gjendje për operim të sigurt, përpara lëshimit të certifikatës;

g) merr përsipër detyrimet e një personi fizik ose juridik që lëshon deklaratat e përputhshmërisë (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose certifikatat e autorizuara për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) të nënpjesës A të këtij aneksi;

h) informon AAC-në për ndërprerjen e aktiviteteve të tyre sipas kësaj nënpjesë.

SEKSIONI B PROCEDURAT PËR AUTORITETET KOMPETENTE

NËNPJESA A – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

21L.B.11 Dokumentacioni i mbikëqyrjes

AAC-ja, vë në dispozicion për personelin përkatës aktet ligjore standardet, rregullat, publikimet teknike dhe dokumentet përkatëse për t'i lejuar që të kryejnë detyrat dhe të përmbushin përgjegjësitë e tyre.

21L.B.12 Shkëmbimi i informacionit

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 ndajnë informacionin që kanë në dispozicion nëpërmjet investigimeve të bëra nga ta dhe mbikëqyrjes së kryer në përputhje me këtë seksion, i cili është i rëndësishëm për palën tjetër gjatë certifikimit, mbikëqyrjes ose zbatimit sipas këtij seksioni.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 duhet të koordinojnë një investigim të bazuar te produkti dhe një mbikëqyrje të projektimit dhe prodhimit të produktit dhe pjesëve sipas këtij aneksi, duke përfshirë, ku është e nevojshme, kryerjen e vizitave të përbashkëta mbikëqyrëse.

21L.B.13 Informacioni rreth Agjencisë

a) AAC-ja njofton Agjencinë në rast të ndonjë problemi të rëndësishëm me zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, brenda 30 ditëve nga shfaqja e këtyre problemeve.

b) Pa cenuar urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, AAC-ja i siguron Agjencisë sa më shpejtë të jetë e mundur çdo informacion të rëndësishëm rreth sigurisë që rrjedh nga raportet e ngjarjeve të ruajtura në bazën e të dhënave kombëtare në përputhje me urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë

21L.B.14 Direktivat e vlefshmërisë ajrore të marra nga shtetet joanëtare

Kur AAC merr një direktivë për vlefshmërinë ajrore nga autoriteti kompetent i një shteti joanëtar, AAC merr masa për të njoftuar Agjencinë për atë direktivë.

21L.B.15 Reagimi i menjëhershëm ndaj një problemi sigurie

a) Pa cenuar urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese, AAC-ja vë në zbatim një sistem për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë në mënyrë të përshtatshme informacionin rreth sigurisë.

b) Agjencia vë në zbatim një sistem për të analizuar në mënyrë të përshtatshme çdo informacion të marrë lidhur me sigurinë përkatëse, pa vonesa të panevojshme, i siguron AAC-së dhe Komisionit çdo informacion, duke përfshirë rekomandimet ose veprimet korrigjuese që duhen ndërmarrë, që është e nevojshme për të reaguar në kohën e duhur ndaj një problemi sigurie që përfshin produkte, pjesë, persona ose organizata që i nënshtrohen VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e

kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj.

c) Me marrjen e informacionit të përmendur në paragrafin (a) dhe (b), AAC-ja merr masat e duhura për të adresuar problemin lidhur me sigurinë.

d) Masat e marra sipas paragrafit (c) të pikës 21L.B.15 do t’u njoftohen menjëherë të gjithë personave ose organizatave që duhet të respektojnë ato sipas VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj. AAC-ja duhet gjithashtu t’i njoftojë këto masa Agjencisë dhe kur kërkohet veprim i kombinuar, shteteve të tjera anëtare përkatëse.

21L.B.16 Sistemi i menaxhimit

a) AAC-ja krijon dhe mirëmban një sistem menaxhimi, duke përfshirë të paktën:

1. politikat dhe procedurat e dokumentuara që përshkruajnë strukturën, mjetet dhe metodat për të arritur përputhshmërinë me VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj. Procedurat mbahen të përditësuara dhe shërbejnë si dokumente bazë pune brenda AAC-së për të gjitha detyrat përkatëse;

2. një numër të mjaftueshëm personeli për kryerjen e detyrave dhe përmbushjen e përgjegjësive të tij. Krijimin e një sistemi për të planifikuar disponueshmërinë e personelit me qëllim për të siguruar përfundimin e duhur të gjitha detyrave përkatëse;

3. personel që është i kualifikuar për kryerjen e detyrave të caktuara, që ka njohuritë dhe përvojën e nevojshme, merr trajnim fillestar dhe rifreskuese për të siguruar aftësi të vazhdueshme;

4. ambiente të përshtatshme dhe akomodim në zyrë për kryerjen e detyrave të caktuara;

5. një proces që monitoron përputhshmërinë e sistemit të menaxhimit me kërkesat përkatëse dhe përshtatshmërinë e procedurave, duke përfshirë krijimin e një procesi të auditimit të brendshëm dhe një procesi të menaxhimit të rreziqeve të sigurisë. Funkzioni i monitorimit të përputhshmërisë duhet të përfshijë një sistem reagimi të gjetjeve të auditimit për menaxhimin e nivelit të lartë të AAC-së për të siguruar zbatimin e veprimeve korrigjuese të nevojshme;

6. një person ose grup personash, përgjegjës për menaxhimin e nivelit të lartë të AAC-së për funksionin e monitorimit të përputhshmërisë.

b) AAC-ja duhet për çdo fushë të aktivitetit, të përfshirë në sistemin e menaxhimit, të caktojë një ose më shumë persona me përgjegjësi të përgjithshme për menaxhimin e detyrës(ve) përkatëse.

c) AAC-ja përcakton procedurat për pjesëmarrjen në një shkëmbim të ndërsjellë të gjithë informacionit të nevojshëm me çdo autoritet tjetër kompetent përkatës dhe i ofron atyre ndihmë, qoftë nga Republika e Shqipërisë ose nga Shtetet e tjera, duke përfshirë:

1. të gjitha gjetjet e ngritura dhe çdo veprim të mëtejshëm të ndërmarrë si rezultat i mbikëqyrjes së personave dhe organizatave që kryejnë aktivitete në territorin e Republikës së Shqipërisë, por të certifikuara nga autoriteti kompetent i një Shteti tjetër ose nga Agjencia;

2. çdo informacion që buron nga raportimi i detyrueshëm dhe vullnetar i ndodhive siç kërkohet nga pika 21L.A.3.

d) Një kopje e procedurave lidhur me sistemin e menaxhimit të AAC-së dhe çdo ndryshim tjetër që këto procedura të vendosen në dispozicion të Agjencisë për qëllime standardizimi.

21L.B.17 Caktimi i detyrave për subjektet e kualifikuara

a) AAC-ja mund të caktojë detyra në lidhje me certifikimin fillestar ose me mbikëqyrjen e vazhdueshme të produkteve dhe pjesëve, si dhe të personave fizikë ose juridikë që i nënshtrohen VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”

dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, subjekteve të kualifikuara.

Gjatë caktimit të detyrave, AAC-ja duhet të sigurojë që ka:

1. një sistem për të vlerësuar fillimisht dhe në mënyrë të vazhdueshme që subjekti i kualifikuar vepron në përputhje me aneksin VI të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”. Ky sistem dhe rezultatet e vlerësimeve do të dokumentohen;

2. për të krijuar një marrëveshje të dokumentuar me një subjekt të kualifikuar, të miratuar nga të dyja palët në nivelin e përshtatshëm të menaxhimit, që përcakton:

i) detyrat për t’u kryer;

ii) deklaratat, raportet dhe regjistrimet që do të ofrohen;

iii) kushtet teknike për t’u përmbushur në kryerjen e këtyre detyrave;

iv) mbulimin e përgjegjësive përkatëse;

v) mbrojtjen që jepet për informacionin e marrë gjatë kryerjes së këtyre detyrave.

b) AAC-ja garanton që procesi i auditit të brendshëm dhe procesi i menaxhimit të rreziqeve të sigurisë së kërkuar nga paragrafi (a)(5) e pikës 21L.B.16 mbulon të gjitha detyrat e certifikimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të kryera në emër të subjektit të kualifikuar.

21L.B.18 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit

a) AAC-ja ka një sistem për të identifikuar ndryshimet që prekin aftësinë e tij në kryerjen e detyrave dhe përmbushjen e përgjegjësive siç përcaktohet në VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazën e saj. Ky sistem i mundëson atij të ndërmarrë veprime, sipas rastit, për tu siguruar që sistemi i menaxhimit të mbetet i përshtatshëm dhe efektiv.

b) AAC-ja përditëson sistemin e tij të menaxhimit për të pasqyruar çdo ndryshim në VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj në kohën e duhur, në mënyrë që të sigurohet zbatim efektiv.

c) AAC-ja njofton Agjencinë për çdo ndryshim që prek aftësinë e saj në kryerjen e detyrave dhe përmbushjen e përgjegjësive siç parashikohet në VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të tyre.

21L.B.19 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

AAC krijon një proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda procedurave të tij të dokumentuara.

21L.B.20 Mbajtja i të dhënave

a) AAC krijon një sistem për mbajtjen e të dhënave që lejon ruajtjen e duhur, aksesin dhe gjurmimin e besueshëm të:

1. politikave dhe procedurave të dokumentuara të sistemit të menaxhimit;

2. trajnimeve, kualifikimeve dhe autorizimeve të personelit të tij;

3. caktimit të detyrave që mbulojnë elementët e kërkuar nga pika 21L.B.17, si dhe detajet e detyrave të caktuara;

4. proceseve të certifikimit dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të organizatave të certifikuara dhe të deklaruara që përfshin:

- i) aplikimet për një certifikatë;
- ii) deklaratat e aftësisë;
- iii) deklaratat e përputhshmërisë së projektimit;
- iv) programin e mbikëqyrjes së vazhdueshme të AAC-së, duke përfshirë të gjitha vlerësimet, auditimet dhe të dhënat e inspektimit;
- v) certifikatat e lëshuara, duke përfshirë çdo ndryshim në to;
- vi) një kopje të programit të mbikëqyrjes, duke renditur datat kur janë skeduluar dhe kryer auditimet;
- vii) kopjet e të gjithë dokumentacionit të korrespondencës;
- viii) rekomandime për lëshimin ose vazhdueshmërinë e një certifikate ose vazhdimin e regjistrimit të një deklarate, detajet e gjetjeve dhe veprimet e ndërmarra nga organizatat për mbylljen e tyre, duke përfshirë datën e mbylljes së çdo artikulli, veprimet e zbatueshmërisë dhe rekomandimet;
- ix) çdo raport vlerësimi, auditimi dhe inspektimi të lëshuar nga një autoritet tjetër kompetent.
- x) kopjet e të gjithë manualeve të organizatës, procedurave dhe proceseve ose manualeve dhe ndryshimeve të tyre;
- xi) kopjet e çdo dokumenti tjetër të miratuar nga AAC-ja;

5. deklaratave të përputhshmërisë të avionit (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose certifikatat e autorizuara për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) për motorët, helikat ose pjesët që ai ka inspektuar sipas nënpjesës R të këtij aneksi.

b) AAC-ja përfshin në mbajtjen e të dhënave:

1. vlerësimin dhe njoftimin e Agjencisë për çdo mjet alternativ përputhshmërie të propozuar nga organizatat, dhe vlerësimin e çdo mjeti alternativ përputhshmërie të përdorur nga vetë AAC-ja;

2. informacioni e sigurisë në përputhje me pikën 21L.B.13 dhe masat pasuese;

3. përdorimin e dispozitave të mbrojtjes dhe fleksibilitetit në përputhje me nenin 71(1) dhe nenin 76(4) të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” që transponon rregulloren e (BE) 2018/1139.

c) AAC-ja mban një listë të të gjitha certifikatave që ka lëshuar dhe çdo deklarate që ka regjistruar.

d) Të gjitha regjistrimet e përmendura në pikat (a) dhe (b) dhe (c) mbahen për një periudhë minimale prej 5 vjetësh, në varësi të ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

e) Të gjitha regjistrimet e përmendura në pikat (a) dhe (b) dhe (c) i vihen në dispozicion, sipas kërkesës, një autoriteti kompetent të një Shteti tjetër ose Agjencisë.

21L.B.21 Gjetjet dhe rekomandimet

a) Kur AAC-ja, gjatë investigimit, mbikëqyrjes ose çdo mënyre tjetër, zbulon mospërputhje të kërkesave të zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” që transponon rregulloren e (BE) 2018/1139 dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, të një procedure ose manuali të kërkuar nga ato rregullore, ose të një certifikate ose deklarate të lëshuar në përputhje me ato rregullore, pa cenuar ndonjë veprim shtesë të kërkuar nga ato rregullore, do të ngrejë një gjetje.

b) AAC-ja duhet të ketë një sistem për të analizuar gjetjet sipas rëndësisë që ato kanë për sigurinë.

Një gjetje e nivelit 1 lëshohet nga AAC-ja kur zbulohet ndonjë mospërputhje e rëndësishme që ul sigurinë ose rrezikon seriozisht sigurinë e fluturimit, ose në rastin e organizatave të projektimit mund të çojë në një mospërputhje të pakontrolluar dhe në një rrethanë të mundshme pasigurie sipas pikës 21L.B.23; Gjetjet e nivelit 1 do të përfshijnë gjithashtu, por nuk kufizohen në sa vijon:

1. ndalimi i aksesit të AAC-së në objektet e organizatës ose personit fizik ose juridik, të përcaktuara në pikën 21L.A.10 gjatë orarit normal të punës dhe pas dy kërkesave me shkrim;

2. dhënia e informacionit të gabuar ose falsifikimi i provave shkresore;
3. çdo provë e keqpërdorimit ose përdorimit të rremë të një certifikate, deklarate ose formular të lëshuar në përputhje me këtë Aneks;

4. mungesa e një menaxheri përgjegjës ose drejtuesi të organizatës së projektimit, sipas rastit.

Një gjetje e nivelit 2 lëshohet nga AAC-ja kur zbulohet një mospërputhje me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” që transponon rregulloren e (BE) 2018/1139 dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, me procedurat ose manualet kërkuar nga ato rregullore, ose të një deklarate të lëshuar në përputhje me ato rregullore, e cila nuk klasifikohet si gjetje e nivelit 1.

c) AAC-ja do t’ia komunikojë gjetjen organizatës ose personit fizik ose juridik me shkrim dhe kërkon veprime korrigjuese për të adresuar mospërputhshmërinë/të e identifikuar.

d) Nëse ka ndonjë gjetje të nivelit 1, AAC-ja ndërmerr veprime të menjëhershme dhe të përshtatshme në përputhje me pikën 21L.B.22, përveç rasteve kur gjetja është në një organizatë projektuese e cila ka deklaruar aftësitë e saj të projektimit, rast në të cilin Agjencia së pari i jep organizatës një periudhë zbatimi të veprimeve korrigjuese që është e përshtatshme për natyrën e gjetjes dhe që në çdo rast nuk duhet të jetë më shumë se 21 ditë pune. Periudha fillon që nga data që gjetja i komunikohet me shkrim organizatës që kërkon veprime korrigjuese për të adresuar papajtueshmërinë e identifikuar. Nëse një gjetje e nivelit 1 lidhet drejtpërdrejt me një avion, AAC-ja informon autoritetin kompetent të një Shteti tjetër në të cilin avioni është regjistruar.

e) Për gjetjet e nivelit 2, AAC-ja do t’i japë organizatës ose personit fizik ose juridik një periudhë zbatimi të veprimeve korrigjuese që është e përshtatshme për natyrën e gjetjeve. Periudha fillon që nga data që organizatës ose personit fizik ose juridik, i komunikohet me shkrim gjetja që kërkon veprime korrigjuese për të adresuar mospërputhjen e identifikuar. Në fund të kësaj periudhe, dhe në varësi të natyrës së gjetjes, AAC-ja mund të zgjasë periudhën me kusht që të jetë dakordësuar me organizatën ose personin fizik ose juridik për një plan masash korrigjuese;

AAC-ja vlerëson masat korrigjuese dhe planin e zbatimit të propozuar nga organizata ose personi fizik ose juridik, nëse sipas vlerësimit arrin në përfundimin se janë të mjaftueshme për të zgjidhur mospërputhshmërinë, i miraton ato.

Nëse organizata ose personi fizik ose juridik dështon të paraqesë një plan veprimesh korrigjuese të pranueshëm, ose të kryejë veprimet korrigjuese brenda periudhës kohore të pranuar ose të zgjatuar nga AAC-ja, gjetja ngrihet në nivelin 1 dhe ndërmerren veprime siç parashikohet në pikën (d).

f) AAC-ja mund të lëri vërejtje/rekomandime për rastet e mëposhtme që nuk kërkojnë gjetje të nivelit 1 ose nivelit 2:

1. për çdo artikull, performanca e të cilit është vlerësuar si joefektive;

2. kur është identifikuar se një artikull ka potencialin të shkaktojë një mospërputhje sipas pikave; ose

3. kur sugjerimet ose përmirësimet janë me interes për performancën e përgjithshme të sigurisë të organizatës.

Vëzhgimet e nxjerra sipas kësaj pike do t’i komunikohen organizatës ose personit fizik ose juridik me shkrim dhe regjistrohen nga AAC-ja.

21L.B.22 Masat e zbatueshmërisë

a) AAC-ja:

1. pezullon një certifikatë nëse ai konsideron se ka arsye të përshtatshme që një veprim i tillë është i nevojshëm për të parandaluar një kërcënim të mundshëm për sigurinë në operim të avionit;

2. lëshon një direktivë për vlefshmërinë ajrore sipas kushteve të pikës 21L.B.23;

3. pezullon, revokon ose kufizon një certifikatë nëse një veprim i tillë kërkohet sipas paragrafit (d) të pikës 21L.B.21;

4. pezullon ose revokon një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore kur plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin (b) të pikës 21L.B.163;

5. pezullon ose revokon një certifikatë zhurme ose një certifikatë të kufizuar zhurme kur plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin (b) të pikës 21L.B.173;

6. ndërmerr veprime të menjëhershme dhe të përshtatshme, të nevojshme për të kufizuar ose ndaluar aktivitetet e një organizate ose personi fizik ose juridik nëse AAC-ja konsideron se ka baza të arsyeshme që një veprim i tillë është i nevojshëm për të parandaluar një kërcënim të mundshëm për sigurinë e avionit;

7. kufizon ose ndalon aktivitetet e një organizate ose një personi fizik ose juridik që kanë deklaruar aftësitë e tyre për të projektuar ose prodhuar produkte ose pjesë në përputhje me seksionin A ose që lëshojnë deklarata të përputhshmërisë (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose certifikata të autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së sipas modelit të EASA-s) në përputhje me nënpjesën R të seksionit A të këtij aneksi, duke pasur parasysh paragrafin (d) të pikës 21L.B.21;

8. nuk regjistron një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit për sa kohë që ka gjetje të pazgjidhura nga hetimi fillestar i mbikëqyrjes;

9. çregjistron përkohësisht ose përgjithmonë një deklaratë përputhshmërie të projektimit ose një deklaratë aftësie në përputhje me paragrafin (d) të pikës 21L.B.21;

10. ndërmerr çdo masë të mëtejshme detyruese të nevojshme për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin II të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” që transpozon rregulloren e (BE) 2018/1139 dhe me këtë aneks, dhe, kur është e nevojshme, të korrigjohen pasojat e saj.

b) Pas marrjes së një mase zbatuese në përputhje me paragrafin (a), AAC-ja e njofton adresuesin, të deklarojë arsyet për këtë dhe informon adresuesin për të drejtën e tyre për ankim.

21L.B.23 Direktivat e vlefshmërisë ajrore

a) Një direktivë e vlefshmërisë ajrore nënkupton një dokument të lëshuar ose të miratuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, i cili urdhëron veprimet që duhen kryer në një avion për të rivendosur një nivel të pranueshëm sigurie kur provat tregojnë nivelin e sigurisë së këtij avioni përndryshe mund të rrezikohet. AAC-ja mund të pranojë dhe publikojë edhe direktivat e vlefshmërisë të lëshuara nga Agjencia.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 lëshon një direktivë për vlefshmërinë ajrore kur:

1. një gjendje e pasigurt është përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 se ekziston në një avion si rezultat i një mangësie në avion, ose motor, helikë ose pjesë të instaluar në këtë avion; dhe

2. kjo gjendje ka të ngjarë të ekzistojë ose të ndodhë në avionë të tjerë.

c) Një direktivë e vlefshmërisë ajrore duhet të përmbajë të paktën informacion që identifikon:

1. gjendjen e pasigurt;
2. avionin e prekur;
3. masa(t) e kërkuara;
4. kohën e përputhshmërisë për masa(t) e kërkuara;
5. datën e hyrjes në fuqi.

21L.B.24 Mjetet e përputhshmërisë

a) Agjencia paraqet mjete të pranueshme përputhshmërie (“AMC”) që mund të përdoren për të përcaktuar përputhshmërinë me rregulloren (BE) 2018/1139 transpozuar në Shqipëri me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”. Autoriteti i Aviacionit Civil pranon AMC-në e Agjencisë për të përcaktuar përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e saj të deleguara e zbatuese..

b) Mjetet alternative të përputhshmërisë mund të përdoren për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë Rregullore.

c) Kur është e zbatueshme, AAC-ja informon Agjencinë për çdo mjet alternativ përputhshmërie të përdorur nga personat fizikë ose juridikë nën mbikëqyrjen e tyre ose nga vetë ata për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë Rregullore.

NËNPJESA B – CERTIFIKATAT E TIPIT

21L.B.41 Specifikimet e certifikimit

Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me nenin 76(3) të VKM-s nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, përcakton specifikimet e certifikimit dhe specifikimet e tjera të detajuara, duke përfshirë specifikimet e certifikimit për vlefshmërinë ajrore dhe përputhshmërinë mjedisore që autoritetet kompetente, organizatat dhe personeli mund të përdorin për të dëshmuar përputhshmërinë e produkteve dhe pjesëve me kërkesat thelbësore përkatëse të përcaktuara në anekset II, IV dhe V të asaj rregulloreje, si dhe me ato për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nenin 9(2) dhe me aneksin III të asaj rregulloreje. Specifikime të tilla duhet të jenë mjaftueshëm të detajuara dhe specifike për t’u treguar aplikantëve kushtet në të cilat certifikatat lëshohen, ndryshohen ose plotësohen.

21L.B.42 Hetimi fillestar

a) Pas marrjes së një aplikimi për një certifikatë tipi sipas këtij aneksi, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, verifikon nëse produkti është brenda objektit të përcaktuar në pikën 21L.A.21 dhe nëse aplikanti është i përshtatshëm në përputhje me pikën 21L.A.22, aplikon për një certifikatë tipi për produktin.

b) Kur kushtet e pikës (a) nuk plotësohen, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 e refuzon aplikimin.

21L.B.43 Baza e certifikimit të tipit për një certifikatë tipi

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 vendos bazën e certifikimit të tipit për një certifikatë tip dhe ia njofton atë aplikantit. Baza e certifikimit të tipit përbëhet nga:

1. specifikimet e certifikimit për vlefshmërinë ajrore të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 nga ato të zbatueshme për produktin në datën e aplikimit të asaj certifikate, përveç nëse:

i) aplikanti zgjedh të pajtohet me specifikimet e certifikimit të cilat bëhen të zbatueshme pas datës së aplikimit; nëse një aplikant zgjedh të pajtohet me një specifikim certifikimi i cili u bë i zbatueshëm pas datës së aplikimit, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 përfshin në bazën e certifikimit të tipit çdo specifikim tjetër të certifikimit që lidhet drejtpërdrejt; ose

ii) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 pranon çdo alternativë ndaj një specifikimi të caktuar certifikimi që nuk mund të përmbushet, për të cilin janë gjetur faktorë kompensues që ofrojnë një nivel të barabartë sigurie; ose

iii) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 pranon ose përcakton mjete të tjera që dëshmojnë përputhshmërinë me kërkesat thelbësore të aneksit II të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” që transponon rregulloren e (BE) 2018/1139;

2. çdo kusht të veçantë të përcaktuar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.44(a).

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, ndryshon bazën e certifikimit të tipit në çdo moment përpara lëshimit të certifikatës së tipit nëse ka përcaktuar se përvoja nga produkte të tjera të ngjashme në shërbim, ose produkte që kanë karakteristika të ngjashme projektimi, ka treguar se mund të zhvillohen kushte të pasigurta, dhe baza e certifikimit të tipit që u krijua dhe iu njoftua aplikantit nuk e trajton këtë kusht të pasigurt.

21L.B.44 Kushtet e veçanta

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 përshkruan specifikime të veçanta teknike të detajuara, të quajtura 'kushte të veçanta', për një produkt nëse specifikimet përkatëse të certifikimit nuk përmbajnë standarde të përshtatshme të sigurisë për produktin sepse:

1. produkti ka karakteristika të reja ose të pazakonta projektimi në lidhje me praktikën e projektimit në të cilat bazohen specifikimet e zbatueshme të certifikimit;

2. përdorimi i synuar i produktit është jo i zakonshëm; ose

3. përvoja nga produkte të tjera të ngjashme në shërbim ose produkte që kanë karakteristika të ngjashme projektimi ose rreziqe të identifikuar rishtazi kanë treguar se mund të krijohen kushte të pasigurta.

b) Kushtet e veçanta përmbajnë standarde të tilla sigurie që Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 i konsideron të nevojshme për të vendosur një nivel sigurie të barabartë me atë të specifikimeve e zbatueshme të certifikimit.

21L.B.45 Përcaktimi i kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për një certifikatë tip

Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 cakton dhe njofton aplikantin për një certifikatë tipi për një avion ose për një motor, për kërkesat mjedisore të zbatueshme në përputhje me pikën 21.B.85 të Aneksit I (pjesa 21).

21L.B.46 Investigimi

Me marrjen e një aplikimi për miratimin e një certifikatë tip sipas këtij Aneksi, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2:

a) kryen një rishikim të planit fillestar të dëshmisë të përputhshmërisë dhe çdo përditësim të mëvonshëm të ofruar nga aplikanti për të përcaktuar përmbushjen e planit dhe përputhshmërinë e mjeteve dhe metodave të propozuara për dëshminë e përputhshmërisë me bazën e certifikatës së tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit hartuar dhe caktuar në përputhje me pikën 21L.B.43 dhe me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në përputhje me pikën 21L.B.45; nëse plani i dëshmisë së përputhshmërisë është i paplotë ose mjetet dhe metodat nuk janë të përshtatshme për të arritur dëshminë e përputhshmërisë, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 informon aplikantin dhe kërkon një ndryshim të tij;

b) pasi sigurohet që plani i dëshmisë të përputhshmërisë i ofruar është i përshtatshëm në mënyrë që aplikanti të mund të dëshmojë përputhshmëri, miraton planin e dëshmisë të përputhshmërisë dhe çdo përditësim të mëvonshëm të planit të dëshmisë të përputhshmërisë;

c) pas marrjes së deklaratës së përputhshmërisë në përputhje me paragrafin (f) të pikës 21L.A.25, kryen një inspektim fizik dhe vlerësim të artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin përfundimtar, duke marrë në konsideratë rishikimin kritik të projektimit të kryer në përputhje me paragrafin (a) të pikës 21L.B.242, për të verifikuar përputhjen e produktit me bazën e zbatueshme të certifikatës së tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit; Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 verifikon përputhshmërinë e produktit, duke marrë parasysh mundësinë e një mospërputhjeje të paidentifikuar me bazën e certifikimit të tipit ose kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, dhe ndikimin e mundshëm të kësaj mospërputhjeje në sigurinë e operimit ose pajtueshmërinë e produktit në mjedis;

d) nëse gjatë përcaktimit të bazës së certifikimit të tipit, përcaktimit të kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit ose gjatë rishikimit të planit të dëshmisë të përputhshmërisë, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 përcakton se projektimi i produktit përmban ndonjë element për të cilin një mospërputhje e paidentifikuar me bazën e certifikimit të tipit ose kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit mund të kenë një ndikim negativ në sigurinë ose përputhshmërinë mjedisore të produktit, ky autoritet përcakton se cilat hetime janë të nevojshme përveç atyre të përshkruara në pikën (c) për

të verifikuar dëshminë e përputhshmërisë si dhe njofton aplikantin për çdo hetim shtesë dhe cilët elementë të projektimit do t'i nënshtrohen atyre hetimeve.

21L.B.47 Lëshimi i një certifikate tipi

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 lëshon pa vonesë të panevojshme një certifikatë tip të avionit, motorit ose helikës, me kusht që:

1. aplikanti është në përputhje me pikën 21L.A.27;

2. Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet investigimit të kryer sipas pikës 21L.B.46, nuk ka konstatuar asnjë mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit;

3. nuk ka asnjë çështje të pazgjidhur nga investigimi i kryer sipas paragrafit (c) të pikës 21L.B.46 të atij produkti në konfigurimin përfundimtar;

4. nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

b) Certifikata e tipit përfshin:

1. llojin i projektimit;

2. kufizimet e operimit;

3. udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore;

4. fletën e të dhënave të certifikatës tip për vlefshmërinë ajrore dhe, nëse është e zbatueshme, të dhënat e përputhshmërisë me emetimet e gazrave të motorit;

5. bazën e aplikueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, me të cilat Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 regjistron pajtueshmërinë;

6. nëse është e zbatueshme, fletën e të dhënave të certifikatës tip për zhurmën; dhe

7. çdo kusht ose kufizim tjetër të përshkruar për produktin në bazën e aplikueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

21L.B.48 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore për produktet për të cilat është miratuar një certifikatë tipi

Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet mbikëqyrjes së saj të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore, përfshin raportet e marra në përputhje me pikën 21L.A.3, ose me çdo mjet tjetër zbulon një mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit ose kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, ky autoritet ngre një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21, ose një direktivë të vlefshmërisë ajrore sipas kushteve të pikës 21L.B.23.

21L.B.49 Transferimi i një certifikate tipi

a) Kur Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 merr një aplikim për verifikimin nëse një certifikatë tipi mund të transferohet nga mbajtësi i saj në përputhje me pikën 21L.A.29 ose kur shqyrton një kërkesë për miratimin e një certifikate tipi në përputhje me pikën 21L.A.29, ky Autoritet verifikon që korrespondon me pikat 21L.B.42 dhe 21L.B.46 nëse marrësi ka të drejtë të jetë mbajtës i certifikatës tip në përputhje me pikën 21L.A.22 dhe është në gjendje të marrë përsipër detyrimet e një mbajtësi të një certifikate tipi sipas pikës 21L.A.28.

b) Kur Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 arrin në përfundimin se kushtet e përmendura në pikën (a) plotësohen nga marrësi, ai informon mbajtësin e certifikatës së tipit ose personin fizik ose juridik që kërkon të miratojë një certifikatë tipi që një transferim i certifikatës së tipit tek ai personi fizik ose juridik të pranohet nga ky Autoritet.

NËNPJESA C – DEKLARATAT E PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTIMIT

21L.B.61 Specifikimet teknike të detajuara dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për deklaratat e përputhshmërisë së projektimit të produktit

a) Agjencia, në përputhje me nenin 76(3) të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” që transpozon rregulloren e (BE) 2018/1139, vendos

dhe vë në dispozicion specififikimet teknike të detajuara që personat fizikë dhe juridikë mund të përdorin për të dëshmuar përputhshmërinë me kërkesat thelbësore përkatëse të përcaktuara në aneksin II në atë rregullore kur deklararon përputhshmërinë e projektimit të avionit në përputhje me nënpjesën C të seksionit A të këtij aneksi.

b) Specifikimet teknike të detajuara të përmendura në paragrafin (a) sigurojnë standarde projektimi që pasqyrojnë gjendjen e teknologjisë dhe praktikat më të mira të projektimit, dhe që bazohen në përvojën më të mirë të disponueshme dhe progresin shkencor dhe teknik, si dhe në provat dhe analizat më të mira të disponueshme për projektimin e avionit, për avionët që janë brenda objektit të përcaktuar në pikën 21L.A.41. Këto specifikime teknike të detajuara përfshijnë ose i referohen:

1. specifikimeve të certifikimit të përcaktuara nga Agjencia në përputhje me pikën 21.B.70 të aneksit I (Pjesa 21) për vlefshmërinë ajrore të projektimit të avionit;

2. kushteve të veçanta që janë përcaktuar nga Agjencia në përputhje me pikën 21.B.75 të aneksit I (pjesa 21) ose pikën 21L.B.44 për avionët e tjerë dhe që janë të natyrës së përgjithshme;

3. standardet teknike të detajuara të zhvilluara nga standardizimi dhe organizata e tjera të industrisë.

c) Për qëllime të sigurimit të përputhshmërisë mjedisore të projektimit, Agjencia vendos dhe vë në dispozicion kërkesat e mbrojtjes së mjedisit që do të përdoren si bazë për deklaratën e përputhshmërisë së projektimit, të cilat përfshijnë:

1. kërkesat e mbrojtjes së mjedisit për kategoritë përkatëse të produkteve siç përmbahen në aneksin 16 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, vëllimet I deri në III, në një nivel ndryshimi të përmendur në nenin 9(2) të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” që transpozon rregulloren e (BE) 2018/1139; për këtë qëllim, referencat për:

i) datën e aplikimit për një certifikatë tipi që përmbahet në këto vëllime nënkupton referenca në datën në të cilën deklarata e përputhshmërisë së projektimit është bërë nga deklaruesi; dhe

ii) kërkesat e certifikimit të përfshira në këto vëllime nënkuptohet si kërkesa për deklaratën e përputhshmërisë së projektimit.

2. (rezervë)

21L.B.62 Investigimi fillestar i mbikëqyrjes

a) Me marrjen e një deklarate për përputhshmërinë e projektimit, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 verifikon që avioni është brenda fushëveprimit të nënpjesës C të seksionit A të këtij aneksi dhe se deklarata përmban të gjithë informacionin e specifikuar në pikën 21L.A.43. Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 konfirmon marrjen e deklaratës, duke përfshirë caktimin e një numri referencë të deklaruar individual të përputhshmërisë së projektimit të deklaruesi për konfigurimin e avionit.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 kryen një inspektim fizik dhe vlerësim të artikullit të parë të atij avioni në konfigurimin përfundimtar, duke marrë në konsideratë rishikimin e sigurisë të kryer në përputhje me paragrafin (a)(2) të pikës 21L.B.242. Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 gjen prova, në deklaratë ose nëpërmjet inspektimit fizik dhe vlerësimit të kryer në përputhje me fjalinë e parë, që tregojnë se avioni mund të mos jetë në gjendje për të kryer një fluturim të sigurt ose mund të jetë i papërputhshëm me mjedisin gjatë operimeve në shërbim, ky autoritet ngrë një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21.

21L.B.63 Regjistrimi i një deklarate përputhshmërie projektimi

Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 regjistron një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit për një avion me kusht që:

a) deklaruesi të ketë deklaruar përputhshmërinë sipas pikës (a) të pikës 21L.A.43;

b) deklaruesi të ketë paraqitur në Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2 dokumentet e kërkuara në përputhje me paragrafin (c) të pikës 21L.A.43;

c) deklaruesi të jetë angazhuar që detyrimet në përputhje me pikën 21L.A.47 të përmbushen;

d) nuk ka gjetje të pazgjidhura nga inspektimi fizik dhe vlerësimi i artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin përfundimtar ose ndonjë hetim tjetër i kryer nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me paragrafin (c) dhe (d) të pikës 21L.B.62.

21L.B.64 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore e avionëve për të cilët është deklaruar përputhshmëria me projektimin

Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet mbikëqyrjes së saj të vazhdueshme të vlefshmërisë ajrore, përfshin raportet e marra në përputhje me pikën 21L.A.3, ose me çdo mjet tjetër zbulon një mospërputhje me specifikimet e detajuara teknike të zbatueshme ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 ngre një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21, ose një direktivë të vlefshmërisë ajrore sipas kushteve të pikës 21L.B.23.

NËNPJESA D – NDRYSHIMET NË CERTIFIKATAT E TIPIT

21L.B.81 Baza e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 vendos bazën e certifikimit të tipit për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi dhe ia njofton atë aplikantit.

b) Për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi dhe zonat e prekura nga ndryshimi, baza e certifikimit të tipit përbëhet nga specifikimet e certifikimit e përfshirë me referencë në certifikatën e tipit, përveç nëse:

1. Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 konstaton se specifikimet e certifikimit të referuara në certifikatën e tipit nuk ofrojnë standarde të përshtatshme në lidhje me ndryshimin e propozuar, prandaj ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi do të jenë gjithashtu në përputhje me çdo kusht të veçantë, dhe ndryshimet në ato kushte të veçanta, të përcaktuara nga Agjencia në përputhje me pikën 21L.B.44, për të ofruar një nivel sigurie të barabartë me atë të përcaktuar nga specifikimet e certifikimit të zbatueshme në datën e aplikimit për ndryshim;

2. një aplikant zgjedh të pajtohet me një specifikim certifikimi të përcaktuar në një ndryshim që është i zbatueshëm në datën e aplikimit për ndryshim.

c) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 përcakton kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për ndryshimin e madh të një certifikate tipi në përputhje me pikën 21.B.85 të aneksit I (pjesa 21) dhe ia njofton ato aplikantit.

21L.B.82 Investigimi dhe lëshimi i një miratimi të një ndryshimi të vogël në një certifikatë tipi

a) Me marrjen e një aplikimi për miratimin e një ndryshimi të vogël për një certifikatë tipi sipas këtij Aneksi, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 miraton ndryshimin e vogël kur:

1. aplikanti ka dhënë të dhënat mbështetëse dhe arsyet dhe ka dëshmuar dhe deklaruar përputhshmërinë e ndryshimit me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit ose me specifikimet e certifikimit të zgjedhura në përputhje me pikën 21L.A.67;

2. Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet verifikimit të dëshmisë të përputhshmërisë, duke marrë parasysh veçoritë e projektimit të riparimit, kompleksitetin dhe kritikën e përgjithshme të projektimit ose teknologjisë, si dhe përvojën e mëparshme të aktiviteteve të projektimit me aplikantin, nuk ka gjetur:

i) asnjë mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit ose, kur është e aplikueshme, me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, ose me specifikimet e zgjedhura të certifikimit;

ii) asnjë veçori ose karakteristikë të ndryshimit që mund ta bëjë produktin e ndryshuar të pasigurt për operim ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi;

b) Një miratim të një ndryshimi të vogël që kufizon konfigurimin(et) specifike në certifikatën e tipit me të cilin lidhet ndryshimi.

21L.B.83 Hetimi për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi

Me marrjen e një aplikimi për miratimin e një ndryshimi të madh sipas këtij Aneksi, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2:

a) kryen një rishikim të planit fillestar të dëshmisë të përputhshmërisë dhe çdo përditësim të mëvonshëm të ofruar nga aplikanti për të përcaktuar përmbushjen e planit dhe përputhshmërinë e mjeteve dhe metodave të propozuara për dëshminë e përputhshmërisë me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit hartuar dhe caktuar në përputhje me pikën 21L.B.81; nëse plani i dëshmisë së përputhshmërisë është i paplotë ose mjetet dhe metodat nuk janë të përshtatshme për të arritur dëshminë e përputhshmërisë, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 informon aplikantin dhe kërkon një ndryshim të tij;

b) pasi sigurohet që plani i dëshmisë të përputhshmërisë i ofruar është i përshtatshëm në mënyrë që aplikanti të mund të dëshmojë përputhshmëri, miraton planin e dëshmisë të përputhshmërisë dhe çdo përditësim të mëvonshëm të planit të dëshmisë të përputhshmërisë;

c) identifikon mundësinë e një mospërputhjeje të paidentifikuar të ndryshimit të madh me bazën e certifikatës së tipit ose me kërkesat e zbatueshme të mbrojtjes së mjedisit, dhe ndikimin e mundshëm të kësaj mospërputhjeje në sigurinë ose përputhshmërinë mjedisore të produktit, dhe përcakton në bazë të një inspektimi fizik dhe vlerësimi të artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin përfundimtar të ndryshuar për të verifikuar përputhshmërinë e produktit me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, duke marrë parasysh rishikimin kritik të projektimit nëse kryhet në përputhje me paragrafin (a)(3) të pikës 21L.B.242 nëse është e nevojshëm; Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 njofton aplikantin para kryerjes së këtij inspektimi dhe vlerësimi;

d) nëse gjatë përcaktimit të bazës së certifikimit të tipit, përcaktimit të kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit ose gjatë rishikimit të planit të dëshmisë të përputhshmërisë, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 përcakton nëse projektimi i ndryshimit të madh përmban çdo element për të cilin një mospërputhje e paidentifikuar me bazën e certifikimit të tipit ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit mund të ketë një ndikim negativ në siguri ose përputhshmërinë mjedisore të produktit të ndryshuar, ky autoritet përcakton se cilat hetime janë të nevojshme përveç atyre të pikës (c) për të verifikuar dëshminë e përputhshmërisë; si dhe njofton aplikantin për ato hetime shtesë dhe cilat elemente të projektimit do t'i nënshtrohen hetimit.

21L.B.84 Lëshimi i një miratimi të një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 miraton ndryshimin e madh kur:

1. aplikanti dëshmon se ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi janë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç përcaktohet dhe i njoftohet aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.81;

2. aplikanti ka vërtetuar dhe dëshmuar përputhshmërinë në përputhje me paragrafin(f) të pikës 21L.A.66;

3. Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet verifikimit të dëshmisë së përputhshmërisë, nuk ka gjetur:

i) asnjë mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit, kur është e aplikueshme, ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit;

ii) asnjë veçori ose karakteristikë të ndryshimit që mund ta bëjë produktin e ndryshuar të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi;

b) Një miratim i një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi do të kufizohet në konfigurimin(et) specifike në certifikatën e tipit me të cilin lidhet ndryshimi.

21L.B.85 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të produkteve të ndryshuara për të cilat është lëshuar një certifikatë tipi

Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet mbikëqyrjes së saj të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore, përfshin raportet e marra në përputhje me pikën 21L.A.3, ose me çdo mjet tjetër zbulon një mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të një produkti për të cilin është miratuar një ndryshim në një certifikatë tipi, ky autoritet ngrë një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21, ose një direktivë të vlefshmërisë ajrore sipas kushteve të pikës 21L.B.23.

NËNPJESA E – CERTIFIKATAT PLOTËSUESE TË TIPI

21L.B.101 Baza e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për një certifikatë plotësuese tipi

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 vendos bazën e certifikimit të tipit për një certifikatë plotësuese tipi dhe ia njofton atë aplikantit.

b) Për ndryshime të mëdha në një certifikatë tipi në formën e një certifikate plotësuese tipi, baza e certifikimit të tipit për zonat e prekura nga ndryshimi do të jetë ajo që përfshihet me referencë në certifikatën e tipit, përveç nëse:

1. Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 konstaton se specifikimet e certifikimit të referuara në certifikatën e tipit nuk ofrojnë standarde të përshtatshme në lidhje me ndryshimin e propozuar, prandaj ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi do të jenë gjithashtu në përputhje me çdo kusht të veçantë, dhe ndryshimet në ato kushte të veçanta, të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.44, për të ofruar një nivel sigurie të barabartë me atë të përcaktuar nga specifikimet e aplikueshme të certifikimit në datën e aplikimit për ndryshim;

2. një aplikant zgjedh të veprorë në përputhje me një specifikim certifikimi të përcaktuar në një ndryshim që është i zbatueshëm në datën e aplikimit për ndryshim.

c) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 përcakton kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për ndryshimin e madh të një certifikate tipi në përputhje me pikën 21.A.85 të aneksit I (pjesa 21) dhe ia njofton ato aplikantit.

21L.B.102 Investigimi

Me marrjen e një aplikimi për një certifikatë plotësuese tipi sipas këtij aneksi, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2:

a) kryen një rishikim të planit fillestar të dëshmisë të përputhshmërisë dhe çdo përditësim të mëvonshëm të ofruar nga aplikanti për të përcaktuar përmbushjen e planit dhe përshtatshmërinë e mjeteve dhe metodave të propozuara për dëshminë e përputhshmërisë me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit hartuar dhe caktuar në përputhje me pikën 21L.B.101; nëse plani i dëshmisë së përputhshmërisë është i paplotë ose mjetet dhe metodat nuk janë të përshtatshme për të arritur dëshminë e përputhshmërisë, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 informon aplikantin dhe kërkon një ndryshim të tij;

b) sigurohet që plani i dëshmisë së përputhshmërisë i ofruar është i përshtatshëm në mënyrë që aplikanti të mund të dëshmojë përputhshmëri, miraton planin e dëshmisë të përputhshmërisë dhe çdo përditësim të mëvonshëm të planit të dëshmisë të përputhshmërisë;

c) identifikon mundësinë e një mospërputhjeje të paidentifikuar të ndryshimit të madh me bazën e certifikimit të tipit ose me kërkesat e zbatueshme të mbrojtjes së mjedisit, dhe ndikimin e mundshëm të kësaj mospërputhjeje në sigurinë ose përputhshmërinë mjedisore të produktit, dhe përcakton në bazë të një inspektimi fizik dhe vlerësimi të artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin përfundimtar të ndryshuar për të verifikuar përputhshmërinë e produktit me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, duke marrë parasysh rishikimin kritik të projektimit nëse kryhet në përputhje me paragrafin (a) të pikës 21L.B.242 nëse është e nevojshëm, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 njofton aplikantin para kryerjes së këtij inspektimi dhe vlerësimi;

d) nëse gjatë përcaktimit të bazës të certifikimit të tipit, përcaktimit të kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit ose gjatë rishikimit të planit të dëshmisë të përputhshmërisë, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 përcakton se ndryshimi kryesor në projektim përmban çdo element për të cilin një mospërputhje e paidentifikuar me bazën e certifikimit të tipit ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit mund të ketë një ndikim negativ në siguri ose përputhshmërinë mjedisore të produktit të ndryshuar, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 përcakton se cilat hetime janë të nevojshme përveç atyre të pikës (c) për të verifikuar dëshminë e përputhshmërisë; si dhe njofton aplikantin për ato hetime shtesë dhe cilat elemente të projektimit do t'i nënshtrohen hetimit.

21L.B.103 Lëshimi i një certifikate plotësuese tipi

a) Me marrjen e një aplikimi për një certifikatë plotësuese tipi sipas këtij Aneksi, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 lëshon një certifikatë plotësuese tipi kur::

1. aplikanti dëshmon se ndryshimi dhe zonat e prekura nga ndryshimi janë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç përcaktohet dhe i njoftohet aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.101;

2. aplikanti ka vërtetuar dhe dëshmuar përputhshmërinë në përputhje me paragrafin(f) të pikës 21L.A.85;

3. pronari i të dhënave të certifikatës së tipit, nëse aplikanti ka specifikuar në përputhje me pikën (b)(2) të 21L.A.84 që të dhënat e certifikimit janë dhënë në bazë të një marrëveshjeje me pronarin e të dhënave të certifikatës së tipit, i cili:

i) nuk ka asnjë kundërshtim teknik për informacionin e paraqitur në paragrafin (a)(2) të pikës 21L.B.103; dhe

ii) ka rënë dakord të bashkëpunojë me mbajtësin e miratimit për projektimin e riparimit për të përmbushur të gjitha detyrimet për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të produktit me modelin e riparimit në përputhje me pikën 21L.A.88;

4. Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet verifikimit të dëshmisë së përputhshmërisë, nuk ka gjetur:

i) mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit, kur është e aplikueshme, ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit;

ii) çdo veçori ose karakteristikë e ndryshimit që mund ta bëjë produktin e ndryshuar të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

b) Një certifikatë plotësuese tipi do të kufizohet në konfigurimet specifike në certifikatën e tipit me të cilin lidhet ndryshimi i madh përkatës.

21L.B.104 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore për produktet për të cilat është lëshuar një certifikatë plotësuese tipi

Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet mbikëqyrjes së saj të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore, përfshin raportet e marra në përputhje me pikën 21L.A.3, ose me ndonjë mjet tjetër zbulon një mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit ose kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të një produkti për të cilin është lëshuar një certifikatë plotësuese tipi, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 ngre një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21 ose lëshon një direktivë të vlefshmërisë ajrore sipas kushteve të pikës 21L.B.23.

NËNPJESA F – NDRYSHIMET NË AVIONËT PËR TË CILËT ËSHTË DEKLARUAR PËRPUTHSHMËRIA ME PROJEKTIMIN

21L.B.121 Investigimi fillestar i mbikëqyrjes së një deklarate përputhshmërie projektimi të një ndryshimi të madh në projektimin e një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin

a) Me marrjen e një deklarate për përputhshmërinë e projektimit të një ndryshimi të madh në një avion për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin, Autoriteti kompetent sipas pikës

21L.2 verifikon që ndryshimi është brenda fushëveprimit të pikës 21L.A.101 dhe që deklarata përmban të gjithë informacionin e përcaktuar në pikën 21L.A.107. AAC konfirmon marrjen e deklaratës, duke përfshirë caktimin e një numri referencë të deklaruar individual të përputhshmërisë së projektimit të deklaruesi.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 vlerëson, bazuar në rrezikun e një mospërputhjeje që çon në një projektim që nuk mund të kryejë fluturim të sigurt ose që nuk është i përputhshëm me mjedisin, nëse nevojitet një inspektim fizik dhe vlerësimin për ndryshimin e një produkti, dhe më pas informon deklaruesin nëse për këtë. Ky vlerësim i rrezikut duhet të konsiderojë:

1. kompleksitetin e ndryshimit të madh dhe efektin e përgjithshëm në strukturën e mjetit fluturues, karakteristikat dhe sistemet e fluturimit;

2. përvojën e mëparshme të inspektimeve fizike të avionëve dhe të ndryshimeve të mëdha që janë projektuar nga deklaruesi;

3. përgjigjen e deklaruesit ndaj çdo gjetjeje të mëparshme që është ngritur për mospërputhje të avionit specifik ose avionëve të ngjashëm të projektuar nga deklaruesi që gjithashtu i janë nënshtruar një deklaratë për përputhshmërinë e projektimit.

c) Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 gjen prova, në deklaratë ose nëpërmjet inspektimit fizik dhe vlerësimit të kryer në përputhje me paragrafin(b) të pikës 21L.B.121, që tregojnë që avioni i ndryshuar nuk mund të kryejë fluturim të sigurt ose që nuk është i përputhshëm me mjedisin, gjatë operimeve në shërbim, ky autoritet ngre një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21.

21L.B.122 Regjistrimi i një deklarate përputhshmërie projektimi për një ndryshim të madh në një projektim avioni

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 regjistron deklaratën e projektimit të një ndryshimi të madh për një avion, për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin, me kusht që:

1. deklaruesi të ketë deklaruar përputhshmërinë sipas pikës (a) të pikës 21L.A.107;

2. deklaruesi të ketë dorëzuar në Autoritetin kompetent sipas pikës 21L.2 dokumentet e nevojshme në përputhje me pikën (d) të pikës 21L.A.107;

3. deklaruesi të jetë angazhuar që në përputhje me pikën 21L.A.47 të marrë përsipër detyrimet në lidhje me projektimin e ndryshuar të avionit;

4. të mos ketë asnjë çështje të pazgjidhur nga kontrolli fizik, nëse kryhet në përputhje me pikën (b) të pikës 21L. B.121.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 regjistron një deklaratë për një ndryshim të madh në projektimin e një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit vetëm nëse ajo është e kufizuar në konfigurimin(et) specifike në deklaratën e regjistruar të përputhshmërisë së projektimit me të cilën ka të bëjë ndryshimi.

21L.B.123 Mbikëqyrja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore e avionëve për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit

Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet mbikëqyrjes së saj të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore, përfshin raportet e marra në përputhje me pikën 21L.A.3, ose me çdo mjet tjetër zbulon një mospërputhje me specifikimet e detajuara teknike të zbatueshme ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të një ndryshimi për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit, ky autoritet ngre një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21, ose një direktivë të vlefshmërisë ajrore sipas kushteve të pikës 21L.B.64.

NËNPJESA G – ORGANIZATAT E DEKLARUARA TË PRODHIMIT

21L.B.141 Hetimi fillestar i mbikëqyrjes

a) Pas marrjes së një deklarate nga një organizatë që deklaroi aftësinë e prodhimit, AAC-ja verifikon nëse:

1. deklaruesi ka të drejtë të deklarojë aftësinë e prodhimit në përputhje me pikën 21L. A.122;

2. deklarata përmban të gjithë informacionin e përcaktuar në paragrafin (c) të pikës 21L.A.123; dhe
3. Deklarata nuk përmban informacion që tregon një mospërputhje me kërkesat e nënpjesës G të seksionit A të këtij aneksi.

b) AAC-ja konfirmon marrjen e deklaratës, duke përfshirë caktimin e një numri individual reference për organizatën prodhuese të deklaruar te deklaruesi.

21L.B.142 Regjistrimi i një deklarate të aftësisë prodhuese

AAC-ja regjistron deklaratën e aftësisë së prodhimit në një bazë të dhënash të përshtatshme, duke përfshirë fushëveprimin e deklaruar të punës, me kusht që:

- a) deklaruesi ka shfaqur aftësinë e tij të prodhimit në përputhje me pikën 21L.A.123;
- b) deklaruesi është angazhuar që të marrë përsipër detyrimet në përputhje me pikën 21L.A.127;
- c) nëse nuk ka çështje të pazgjidhura në përputhje me pikën 21L.B.141.

21L.B.143 Mbikëqyrja

a) AAC-ja mbikëqyrë organizatën e dekluar të prodhimit për të verifikuar përputhjen e vazhdueshme të organizatës së dekluar të prodhimit me kërkesat e zbatueshme të seksionit A dhe zbatimin e masave të sigurisë të zbatuara sipas paragrafit (c) dhe (d) të pikës 21L.B. 15.

b) Mbikëqyrja përfshin inspektimin e artikullit të parë të çdo avioni të ri, motori, helike ose projektimi të pjesës që prodhohet për herë të parë dhe, siç përcaktohet nga programi i mbikëqyrjes në përputhje me pikën 21L.B.144, inspektimet e avionëve të prodhuar më tej, motorëve, helikave dhe pjesëve që prodhohen nga organizata prodhuese e dekluar.

21L.B.144 Programi i mbikëqyrjes

a) AAC krijon dhe mirëmban një program mbikëqyrjeje në mënyrë që të sigurohet përputhja me pikën 21L.B.143. Programi i mbikëqyrjes merr parasysh natyrën specifike të organizatës, vështirësinë e aktiviteteve të saj, rezultatet e certifikimit të mëparshëm ose/edhe aktiviteteve të mbikëqyrjes, dhe bazohet në vlerësimin e risqeve shoqëruese. Ky program përfshin, brenda çdo cikli të planifikimit të mbikëqyrjes:

1. vlerësimet, auditimet dhe inspektimet, duke përfshirë, sipas rastit:

- i) vlerësimet e sistemit të menaxhimit dhe auditimet e proceseve;
- ii) auditimet e produktit provë përkatëse të produkteve dhe pjesëve që janë nën objektin e organizatës;
- iii) marrjen e mostrave të punës së kryer; dhe
- iv) inspektimet e paparalajmëruara;

2. takime ndërmjet menaxherit përgjegjës dhe AAC-së për të siguruar që të dyja palët të jenë të informuara për të gjitha çështjet e rëndësishme.

b) Programi i mbikëqyrjes përfshin regjistrimet e datave kur janë caktuar vlerësimet, auditimet, inspektimet dhe takimet, dhe kur janë kryer në mënyrë efektive vlerësimet, auditimet, inspektimet dhe takimet.

c) Zbatimin e një cikli planifikimi mbikëqyrës që nuk i kalon 24 muaj.

d) Pavarësisht nga paragrafi (c), cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të zgjasë deri në 36 muaj nëse AAC ka vërtetuar se gjatë 24 muajve të mëparshëm:

1. organizata ka dëshmuar se mund të identifikojë në mënyrë efektive rreziqet e sigurisë së aviacionit dhe t'i menaxhojë ato;
2. organizata ka dëshmuar vazhdimisht përputhshmërinë me pikën 21L.A.128 dhe se ka kontroll të plotë mbi të gjitha ndryshimet në sistemin e menaxhimit të prodhimit;
3. nuk janë lëshuar gjetje të nivelit 1;
4. të gjitha veprimet korrigjuese janë zbatuar brenda periudhës kohore që është pranuar ose zgjatur nga AAC-ja siç parashikohet në pikën 21L.B.21.

e) Pavarësisht nga paragrafi (c), cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të zgjatet maksimumi deri në 48 muaj nëse, përveç kushteve të parashikuara në pikat (d) (1) deri (4), organizata ka krijuar dhe AAC-ja ka miratuar një sistem efektiv të vazhdueshëm për raportimin tek AAC-ja mbi performancën e sigurisë dhe përputhshmërinë rregullatore të vetë organizatës.

f) Cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të reduktohet nëse ka prova se performanca e sigurisë së organizatës është ulur.

g) Në përfundim të çdo cikli të planifikimit të mbikëqyrjes, AAC-ja nxjerr një raport rekomandimi për vazhdimin e aktiviteteve të kryera nga organizata prodhuese e deklaruar bazuar në deklaratën e saj të aftësisë prodhuese, duke pasqyruar rezultatet e mbikëqyrjes.

21L.B.145 Aktivitetet e mbikëqyrjes

a) Kur AAC-ja verifikon përputhshmërinë e organizatës së deklaruar të prodhimit në përputhje me pikën 21L.B.143 dhe programin e mbikëqyrjes të vendosur në përputhje me pikën 21L.B.144:

1. i siguron personelit përgjegjës për mbikëqyrjen për udhëzime për të kryer funksionet e tyre;

2. kryen vlerësime, auditime, inspektime dhe, nëse është e nevojshme, inspektime të paparalajmëruara;

3. mbledh provat e nevojshme në rast se kërkohet veprim i mëtejshëm, duke përfshirë masat e parashikuara në pikat 21L.B.21 dhe 21L.B.22;

4. informon organizatën e deklaruar të prodhimit për rezultatet e aktiviteteve të mbikëqyrjes.

b) Nëse objektet e organizatës së deklaruar të prodhimit ndodhen në më shumë se një Shtet, Autoriteti kompetent siç përkufizohet në pikën 21L.2 mund të bjerë dakord që detyrat e mbikëqyrjes të kryhen nga autoriteti(et) kompetente të shtetit(eve) anëtarë ku ndodhen objektet, ose kur është e zbatueshme nga Agjencia për objektet që ndodhen jashtë një shteti joanëtar. Çdo organizatë prodhuese që i nënshtrohet një marrëveshjeje të tillë do të informohet për ekzistencën dhe për fushëveprimin e saj.

c) Për çdo aktivitet mbikëqyrës që kryhet në objektet e vendosura në një shtet anëtar dhe organizata ka vendin kryesor të biznesit në Shqipëri, AAC-ja duhet të informojë autoritetin kompetent të atij Shteti Anëtar përpara se të kryhet ndonjë auditim i vendit ose inspektim i objekteve.

d) AAC-ja mbledh dhe përpunon çdo informacion që konsiderohet i nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes.

e) Nëse AAC-ja zbulon një mospërputhje të organizatës së deklaruar të prodhimit me kërkesat e zbatueshme të seksionit A dhe zbatimin e masave të sigurisë të vendosura sipas paragrafit (c) dhe (d) të pikës 21L.B.15, AAC-ja vepron në përputhje me pikat 21L.B.21 dhe 21L.B.22.

21L.B.146 Ndryshimet në deklarime

a) Me marrjen e njoftimit për ndryshimet në përputhje me pikën 21L.A.128, AAC-ja verifikon përmbushjen e njoftimit në përputhje me pikën 21L.B.141.

b) AAC-ja përditëson programin e tij të mbikëqyrjes të krijuar sipas pikës 21L.B.144 verifikon nëse është e nevojshme të krijohen kushte nën të cilat organizata mund të funksionojë gjatë ndryshimit.

c) Kur ndryshimi prek çdo aspekt të deklaratës që është regjistruar në përputhje me pikën 21L.B.142, AAC-ja përditëson regjistrin.

d) Pas përfundimit të aktiviteteve të kërkuara nga paragrafi (a) deri (c), AAC konfirmon marrjen e njoftimit tek organizata prodhuese e deklaruar.

NËNPJESA H – CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

21L.B.161 Hetimi

a) Kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, AAC-ja përgatit procedurat për hetimet, duke mbuluar të paktën elementët e mëposhtëm:

1. vlerësimin për pranimin e aplikantit;

2. vlerësimin e kushteve për aplikim;
3. klasifikimin e certifikatave të vlefshmërisë ajrore;
4. vlerësimin e dokumentacionit të marrë me aplikimin;
5. inspektimin e avionëve;
6. përcaktimin e kushteve të nevojshme, kufizimit ose limitimit të certifikatës.

b) Me marrjen e një kërkesë për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore, kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, AAC-ja verifikon nëse avioni është brenda objektit të përcaktuar në pikën 21L.A.141.

c) Kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, AAC-ja kryen aktivitete të mjaftueshme hetimore për të justifikuar lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose revokimin e certifikatës së vlefshmërisë ajrore ose certifikatës së kufizuar të vlefshmërisë ajrore. Gjatë kryerjes së investigimeve në lidhje me lëshimin e një certifikate të vlefshmërisë ajrore ose një certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore për një avion të sapo prodhuar, kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, AAC-ja vlerëson nevojën për të kryer një inspektim fizik të avionit për të siguruar përputhshmërinë dhe sigurinë e fluturimit të avionit përpara lëshimit të një certifikate të vlefshmërisë ajrore ose një certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore. Ky vlerësim merr parasysh:

1. rezultatet e inspektimit fizik të artikullit të parë të atij produkti në konfigurimin përfundimtar, të kryer në përputhje me pikën (b) të paragrafit 21L.B.143 ose paragrafin (b) të pikës 21L.B.251 nga AAC-ja, në rastet kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, ose nga autoriteti kompetent që mbikëqyr organizatën ose personin fizik ose juridik që ka prodhuar këtë avion, nëse është i ndryshëm;

2. periudhën kohore nga inspektimi i fundit fizik i kryer nga AAC-ja, në rastet kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit të një avioni të prodhuar nga organizata, ose personi fizik ose juridik që e ka prodhuar atë avion;

3. rezultatet e mbikëqyrjes së kryer sipas nënpjesës G të këtij aneksi ose sipas nënpjesës G të seksionit B të aneksit I (pjesa 21) të organizatës që lëshon deklaratën e përputhshmërisë për avionin, ose verifikimin e kryer sipas nënpjesës R të seksionit A të këtij aneksi të deklaratave të tjera të përputhshmërisë (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose certifikatave të autorizuara për përdorim (forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) që janë lëshuar nga i njëjti nënshkrues;

4. periudhën kohore nga mbikëqyrja e fundit e organizatës në përputhje me nënpjesën G të këtij aneksi, ose nënpjesën G të seksionit B të aneksit I (pjesa 21), ose që nga verifikimi i fundit i kryer sipas nënpjesës R të seksionit A të këtij aneksi të një deklaratë përputhshmërie (forma 52B e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) ose certifikata e autorizuar për përdorim (forma 1 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s) e lëshuar nga i njëjti nënshkrues.

21L.B.162 Lëshimi ose ndryshimi i një certifikate të vlefshmërisë ajrore ose një certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore

a) Kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, AAC-ja lëshon ose ndryshon një certifikatë të vlefshmërisë ajrore (forma 25 e RSH-së, sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën VI të aneksit I (Pjesa 21) pa vonesa të panevojshme kur aplikanti ka siguruar dokumentacionin e kërkuar nga pika 21L.A.143 dhe përmbush detyrimet në pikën 21L.A.144, dhe kur përshtatet me:

1. për avionët e rinj, që avioni, motori dhe helika e tij, nëse është e zbatueshme, përputhen me një projektim të miratuar në përputhje me nënpjesën B të këtij aneksi dhe është në gjendje për operim të sigurt;

2. për avionët e përdorur, që:

i) avioni, dhe nëse është e zbatueshme motori dhe helika e tij, përputhen me një model tipi të miratuar në përputhje me nënpjesën B të këtij Aneksi dhe çdo certifikate plotësuese tipi, ndryshim ose riparim të miratuar në përputhje me nënpjesën D, E ose M të këtij aneksi;

ii) janë respektuar direktivat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore; dhe

iii) avioni, dhe nëse është e zbatueshme motori dhe helika e tij, janë inspektuar në përputhje me aneksin I (Pjesa-M) ose aneksin Vb (Pjesa-ML) të rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”.

b) Kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrit, AAC-ja lëshon ose ndryshon një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore (forma 24B e RSH-së sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën I) pa vonesa të panevojshme kur aplikanti ka siguruar dokumentacionin e kërkuar nga pika 21L.A.143 dhe është në përputhje me detyrimet në pikën 21L.A.144, dhe kur përshtatet me:

1. për avionët e rinj: që avioni dhe nëse është e zbatueshme motori dhe helika e tij, përputhen me një model avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin në përputhje me nënpjesën C të seksionit A të këtij aneksi, e cila është regjistruar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me pikën 21L.B.63 në momentin e aplikimit dhe është në gjendje për funksionim të sigurt;

2. për avionët e përdorur, që:

i) avioni, dhe nëse është e zbatueshme motori dhe helika e tij, përputhen me një model avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit në përputhje me nënpjesën C të seksionit A të këtij aneksi dhe që është regjistruar nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, në përputhje me pikën 21L.B.63 në momentin e aplikimit, së bashku me çdo ndryshim të projektimit ose ndryshim të projektimit të riparimit për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit në përputhje me nënpjesën F ose N të seksionit A të këtij aneksi, të cilat janë regjistruar nga Agjencia në përputhje me pikën 21L.B.122 ose pika 21L.B.222, ose nga deklaruesi në përputhje me paragrafin (c) të pikës 21L.A.105;

ii) janë përmbushur direktivat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore; dhe

iii) avioni është inspektuar në përputhje me aneksin I (Pjesa-M) ose aneksin Vb (Pjesa-ML) të rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”.

c) Duke përjashtuar paragrafin (a) dhe (b) të pikës 21L.B.162, për përdorimin e një avioni me origjinë nga një shtet tjetër, autoriteti kompetent i shtetit tjetër të regjistrit, AAC-ja lëshon certifikatën e vlefshmërisë ajrore ose certifikatën e kufizuar të vlefshmërisë ajrore kur aplikanti ka siguruar dokumentacionin e kërkuar nga paragrafi (b) i pikës 21L.A.145 dhe kur është i bindur se aplikanti respekton paragrafin (a) të pikës 21L.A.144.

d) Për avionët e rinj dhe avionët e përdorur me origjinë nga një shtet tjetër, përveç certifikatës së përshtatshme të vlefshmërisë ajrore të përmendur në paragrafin (a) ose (b), AAC, në rastet kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrit, lëshon:

1. për avionët që i nënshtrohen aneksit I (Pjesa-M) të rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, një certifikatë fillestare të rishikimit të vlefshmërisë ajrore (forma 15a e RSH-së sipas modelit të EASA-s, shtojca II);

2. për avionët e rinj që i nënshtrohen aneksit Vb (Pjesa-ML) të rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra” një certifikatë fillestare të rishikimit të vlefshmërisë ajrore (forma 15c e RSH, sipas modelit të EASA-s, shtojca II);

3. për avionët e përdorur me origjinë nga një shtet tjetër dhe që i nënshtrohet aneksit Vb (Pjesa-ML) të rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave të personelit të përfshirë në këto detyra”, një certifikatë fillestare të rishikimit të vlefshmërisë ajrore (forma 15c e RSH-së sipas modelit të EASA-s, shtojca II), kur AAC-ja ka kryer rishikimin e vlefshmërisë ajrore.

e) Një certifikatë e vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore lëshohet për një kohëzgjatje të pacaktuar. Mund të ndryshohet vetëm nga AAC-ja në rastet kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit.

21L.B.163 Mbikëqyrja

a) Pas dëshmisë së shkeljes së ndonjë prej kushteve mbi të cilat është lëshuar certifikata e vlefshmërisë ajrore ose certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore, ose që mbajtësi nuk përmbush kërkesat përkatëse të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të deleguara dhe zbatuese miratuar në bazë të tij ose me modelin e aplikueshëm të tipit ose me të dhënat e aplikueshme të projektimit të një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit, ose me kërkesat e vazhdueshme të vlefshmërisë ajrore, AAC-ja, në rastet kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, nxjerr një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21.

b) Kur certifikata e tipit, në bazë të së cilës është lëshuar certifikata e vlefshmërisë ajrore, pezullohet ose revokohet, ose bëhet e pavlefshme në përputhje me pikën 21L.A.30, ose deklarata e përputhshmërisë së projektimit sipas së cilës është lëshuar certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore nuk regjistrohet më në përputhje me pikën 21L.B.63, AAC, kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, ndërmerr masa në përputhje me pikën 21L.B.22.

NËNPJESA I –CERTIFIKATAT E ZHURMËS

21L.B.171 Hetimi

a) Kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, AAC-ja përgatit procedurat për investigimet e tij, duke mbuluar të paktën elementët e mëposhtëm:

1. vlerësimin për pranueshmërinë e aplikantit;
2. vlerësimin e kushteve për aplikim;
3. vlerësimin e dokumentacionit të marrë me aplikimin;
4. inspektimet e avionit.

b) Me marrjen e një aplikimi për një certifikatë zhurme ose një certifikatë të kufizuar zhurme, kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, AAC-ja verifikon nëse avioni është brenda objektit të përcaktuar në pikën 21L.A.161.

c) Kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, AAC-ja kryen aktivitete të mjaftueshme investiguese për një aplikant ose mbajtës të një certifikate zhurme ose një certifikate të kufizuar zhurme për të justifikuar lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose revokimin e certifikatës.

21L.B.172 Lëshimi ose ndryshimi i certifikatave të zhurme

a) Kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit, AAC-ja lëshon ose ndryshon certifikatat e zhurme (forma 45 e RSH-së sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën VII të aneksit I (Pjesa 21)) dhe certifikatat e kufizuara të zhurme (forma 45B e EASA-s, shih shtojcën II) pa vonesa të panevojshme kur aplikanti ka siguruar dokumentacionin e kërkuar nga pika 21L.A.163 dhe kur është i bindur se avioni është në përputhje me informacionin e zbatueshëm të zhurme të përcaktuar në përputhje me kërkesat e zbatueshme të zhurme.

b) Për avionët e përdorur me origjinë nga një shtet tjetër anëtar, certifikata e zhurme ose certifikata e kufizuar e zhurme lëshohet kundrejt të dhënave përkatëse që ofrohen nga baza e të dhënave të Agjencisë për nivelet e zhurme.

c) Një certifikatë zhurme ose një certifikatë zhurme e kufizuar lëshohet për një kohëzgjatje të pacaktuar. Mund të ndryshohet vetëm nga AAC-ja në rastet kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrimit.

21L.B.173 Mbikëqyrja

a) Pas dëshmisë së shkeljes së ndonjë prej kushteve në të cilat është lëshuar certifikata e zhurme ose certifikata e kufizuar e zhurme, ose që mbajtësi nuk përmbush kërkesat përkatëse të VKM-së nr.

1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” që transponon rregulloren (BE) 2018/1139 dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të tij ose me modelin e tipit të zbatueshëm ose me të dhënat e projektimit të aplikueshëm të një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin, AAC-ja në rastet kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrit lë një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21.

b) Kur certifikata e tipit sipas së cilës është lëshuar certifikata e zhurmës pezullohet ose revokohet, ose bëhet e pavlefshme në përputhje me pikën 21L.A.30, ose deklarata e përputhshmërisë së projektimit sipas së cilës është lëshuar certifikata e kufizuar e zhurmës nuk regjistrohet më në përputhje me pikën 21L.B.63, AAC-ja në rastet kur Republika e Shqipërisë është shteti i regjistrit ndërmerr masa në përputhje me pikën 21L.B.22.

NËNPJESA J – ORGANIZATAT E DEKLARUARA TË PROJEKTIMIT

21L.B.181 Investigimi fillestar i mbikëqyrjes

a) Me marrjen e një deklarate nga një organizatë që deklaronte aftësinë e saj të prodhimit, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 do të verifikojë, që:

1. deklaruesi ka të drejtë të deklarojë aftësinë e tij të prodhimit në përputhje me pikën 21L.A.172.
2. deklarata përmban të gjithë informacionin e përcaktuar në paragrafin (c) të pikës 21L.A.173; dhe
3. deklarata nuk përmban informacion që tregon një mospërputhje me kërkesat e nënpjesës J të seksionit A të këtij aneksi.

b) AAC-ja konfirmon marrjen e deklaratës, duke përfshirë caktimin e një numri referencë të deklaruar individual të organizatës të deklaruesi.

21L.B.182 Regjistrimi i një deklarate për aftësinë e projektimit

Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 e regjistron deklaratën e aftësisë së projektimit në një bazë të dhënash të përshtatshme, duke përfshirë fushëveprimin e deklaruar, me kusht që:

- a) deklaruesi ka deklaruar aftësinë e tij prodhuese në përputhje me pikën 21L.A.173;
- b) deklaruesi është angazhuar që do të marrë përsipër detyrimet në përputhje me pikën 21L.A.177;
- c) nëse nuk ka çështje të pazgjidhura në përputhje me pikën 21L.B.181.

21L.B.183 Mbikëqyrja

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 mbikëqyr organizatën e deklaruar të projektimit në mënyrë që të verifikojë përputhshmërinë e vazhdueshme të organizatës me kërkesat e zbatueshme të seksionit A.

b) Mbikëqyrja përfshin një rishikim kritik të projektimit të produktit ose një inspektim fizik, dhe një inspektim të artikullit të parë të çdo projektimi të ri të organizatës së deklaruar të projektimit.

21L.B.184 Programi i mbikëqyrjes

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 krijon dhe mirëmban një program mbikëqyrjeje në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me pikën 21L.B.183. Programi i mbikëqyrjes merr parasysh natyrën specifike të organizatës, vështirësinë e aktiviteteve të saj, rezultatet e certifikimit të mëparshëm ose aktiviteteve të mbikëqyrjes, ose të dyja, dhe bazohet në vlerësimin e rreziqeve shoqëruese. Ky program përfshin, brenda çdo cikli të planifikimit të mbikëqyrjes:

1. vlerësimet, auditimet dhe inspektimet, duke përfshirë, sipas rastit:
 - i) vlerësimet e sistemit të menaxhimit dhe auditimet e procesit;
 - ii) auditimet e produktit të një mostre përkatëse të projektimit dhe pjesëve që janë nën objektin e organizatës;
 - iii) marrjen e mostrave të punës së kryer;
 - iv) inspektimet e paparalajmëruara;
2. takime të kryera ndërmjet drejtuesit të organizatës së projektimit dhe Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 për të siguruar që të dyja palët të jenë të informuara për çdo çështje të rëndësishme.

b) Programi i mbikëqyrjes përfshin regjistrimet e datave kur janë caktuar vlerësimet, auditimet, inspektimet dhe takimet, dhe kur janë kryer në mënyrë efektive vlerësimet, auditimet, inspektimet dhe takimet.

c) Zbatimin e një cikli të planifikuar mbikëqyrës që nuk i kalon 24 muaj.

d) Pavarësisht nga pika (c), cikli i planifikuar mbikëqyrës mund të zgjasë deri në 36 muaj nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 ka vërtetuar se gjatë 24 muajve të mëparshëm:

1. organizata ka dëshmuar se mund të identifikojë në mënyrë efektive rreziqet e sigurisë së aviacionit dhe t'i menaxhojë ato;

2. organizata ka dëshmuar vazhdimisht respektimin e pikës 21L.A.178 dhe se ka kontroll të plotë mbi të gjitha ndryshimet në sistemin e menaxhimit të projektimit;

3. nuk janë lëshuar gjetje të nivelit 1;

4. të gjitha veprimet korrigjuese janë zbatuar brenda periudhës kohore që është pranuar ose zgjatur nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 siç përcaktohet në pikën 21L.B.21.

e) Pavarësisht nga pika (c), cikli i planifikuar i mbikëqyrjes mund të zgjatet më shumë maksimumi deri në 48 muaj nëse, përveç kushteve të parashikuara në pikën (d), organizata ka krijuar dhe Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 ka miratuar një sistem efektiv të vazhdueshëm për raportimin tek Agjencia mbi performancën e sigurisë dhe përputhshmërinë rregullatore të vetë organizatës.

f) Cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të reduktohet nëse ka prova se performanca e sigurisë e organizatës është ulur.

g) Në përfundim të çdo cikli të planifikuar të mbikëqyrjes, Agjencia nxjerr një raport rekomandimi për vazhdimin e aktiviteteve të kryera nga organizata e deklaruar e projektimit bazuar në deklaratën e saj të aftësisë projektuese, duke pasqyruar rezultatet e mbikëqyrjes.

21L.B.185 Aktivitetet e mbikëqyrjes

a) Kur Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 verifikon përputhshmërinë e organizatës së deklaruar të projektimit në përputhje me pikën 21L.B.183 dhe programin e mbikëqyrjes të vendosur në përputhje me pikën 21L.B.184, ajo do të:

1. pajis personelin përgjegjës për mbikëqyrjen me udhëzime për të kryer funksionet e tyre;

2. kryejë vlerësime, auditime, inspektime dhe, nëse është e nevojshme, inspektime të paparalajmëruara;

3. mbledhë provat e nevojshme në rast se kërkohet veprim i mëtejshëm, duke përfshirë masat e parashikuara në pikat 21L.B.21 dhe 21L.B.22;

4. informojë organizatën e deklaruar të projektimit për rezultatet e aktiviteteve të mbikëqyrjes.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 mbledh dhe përpunon çdo informacion që konsiderohet i nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes.

c) Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 zbulon një mospërputhje të organizatës së deklaruar të projektimit me kërkesat e zbatueshme të seksionit A, me një procedurë ose manual të kërkuar nga seksioni A, ose me deklaratën e paraqitur, ky autoritet vepron në përputhje me pikat 21L.B.21. dhe 21L.B.22.

21L.B.186 Ndryshimet në deklarata

a) Me marrjen e njoftimit për ndryshimet në përputhje me pikën 21L.A.178, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 verifikon përmbushjen e njoftimit në përputhje me pikën 21L.B.181.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, përditëson programin e saj të mbikëqyrjes të krijuar sipas pikës 21L.B.184 dhe do të investigojë nëse është e nevojshme të vendoset ndonjë kusht nën të cilin organizata mund të funksionojë gjatë ndryshimit.

c) Kur ndryshimi prek çdo aspekt të deklaratës që është regjistruar në përputhje me pikën 21L.B.182, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 përditëson regjistrin.

d) Pas përfundimit të aktiviteteve të kërkuara nga pikat (a) deri (c), Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 konfirmon marrjen e njoftimit për organizatën e deklaruar të projektimit.

NËNPJESA K – PJESET

(Rezervë)

NËNPJESA M – PROJEKTIMI I RIPARIMEVE TË PRODUKTEVE ME CERTIFIKATË TIPI

21L.B.201 Baza e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit për miratimin e riparimit të projektimit

Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 cakton çdo ndryshim në bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat mjedisore të zbatueshme të përfshira me referencë, sipas rastit, në certifikatën e tipit ose në certifikatën plotësuese të tipit, të cilat Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 i konsideron të nevojshme për ruajtjen e një niveli të barabartë sigurie dhe përpunshmërie mjedisore ndaj atij të krijuar më parë dhe njofton aplikantin për miratimin e një projektimi për riparim.

21L.B.202 Investigimi dhe dhënia e një miratimi për projektimin e një riparimi të vogël

a) Me marrjen e një aplikimi për miratimin e një projektimi për riparim të vogël për një produkt me certifikatë tipi sipas këtij Aneksi, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 miraton projektimin e riparimit të vogël kur:

1. aplikanti ka siguruar të dhënat mbështetëse dhe arsyet dhe ka dëshmuar dhe deklaruar përpunshmërinë për projektimin e riparimit me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në përputhje me pikën 21L.B.201;

2. Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet verifikimit të dëshmisë së përpunshmërisë, duke marrë parasysh tiparet e projektimit të riparimit, kompleksitetin dhe kritikën e përgjithshme të projektimit të riparimit, si dhe përvojën e mëparshme të aktiviteteve të projektimit me aplikantin, nuk ka gjetur:

i) ndonjë mospërpunhje me bazën e certifikimit të tipit, kur është e aplikueshme, ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit;

ii) asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin të pasigurt ose të papërpunshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

b) Një miratim të një projektimi për riparim të vogël që kufizon konfigurimin(et) specifike në certifikatën e tipit me të cilin lidhet projektimi i riparimit.

21L.B.203 Investigimi i një aplikimi për miratimin e projektimit të një riparimi të madh

Me marrjen e një aplikimi për miratimin e një projektimi riparimi të madh sipas këtij aneksi, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2:

a) kryen një rishikim të planit fillestar të dëshmisë të përpunshmërisë dhe çdo përditësim të mëvonshëm të ofruar nga aplikanti, për të përcaktuar përmbushjen e planit dhe përshtatshmërinë e mjeteve dhe metodave të propozuara për dëshminë e përpunshmërisë me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit hartuar dhe caktuar në përputhje me pikën 21L.B.201; nëse plani i dëshmisë së përpunshmërisë është i paplotë ose mjetet dhe metodat nuk janë të përshtatshme për të arritur dëshminë e përpunshmërisë, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 informon aplikantin dhe kërkon një ndryshim të tij;

b) kur është siguruar që plani i dëshmisë së përpunshmërisë i ofruar është i përshtatshëm në mënyrë që aplikanti të mund të dëshmojë përpunshmëri, miraton planin e dëshmisë të përpunshmërisë dhe çdo përditësim të mëvonshëm të planit të dëshmisë të përpunshmërisë;

c) identifikon mundësinë e një mospërpunhjeje të paidentifikuar të projektimit të riparimit të madh me bazën e certifikimit të tipit ose me kërkesat e zbatueshme të mbrojtjes së mjedisit, dhe ndikimin e mundshëm të kësaj mospërpunhjeje në sigurinë ose përpunshmërinë mjedisore të produktit, dhe përcakton në bazë të një inspektimi fizik dhe vlerësimi të artikullit të parë të atij produkti në

konfigurimin përfundimtar të projektimit të riparimit për të verifikuar përputhshmërinë e produktit me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit nëse është e nevojshëm; Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 njofton aplikantin para kryerjes së këtij inspektimi dhe vlerësimi;

d) nëse, gjatë rishikimit të planit të dëshmisë të përputhshmërisë, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 përcakton nëse projektimi i riparimit të madh përmban ndonjë element për të cilin një mospërputhje e paidentifikuar me bazën e certifikimit të tipit ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit mund të ketë një ndikim negativ në siguri ose përputhshmërinë mjedisore të produktit të ndryshuar, ky autoritet përcakton se cilat investigime janë të nevojshme përveç atyre të pikës (c) për të verifikuar dëshminë e përputhshmërisë; si dhe njofton aplikantin për cilat investigime shtesë dhe cilat elemente të projektimit do t'i nënshtrohen investigimit.

21L.B.204 Lëshimi i miratimit për projektimin e një riparimi të madh

a) Me marrjen e një aplikimi për miratimin e një projektimi për riparim të madh për një produkt me certifikatë tipi sipas këtij aneksi, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 miraton projektimin e riparimit të madh kur:

1. aplikanti dëshmon se projektimi i riparimit dhe zonat e prekura nga projektimi i riparimit janë në përputhje me bazën e certifikimit të tipit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, siç përcaktohet dhe i njoftohet aplikantit nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 në përputhje me pikën 21L.B.201;

2. aplikanti ka dëshmuar dhe deklaruar në përputhje me pikën 21L.A.208;

3. pronari i të dhënave të certifikatës së tipit, nëse aplikanti ka specifikuar në përputhje me pikën 21L.A.205(b)(5) që ka siguruar të dhënat e certifikimit në bazë të një marrëveshje me pronarin e të dhënave të certifikatës së tipit, i cili:

i) nuk ka asnjë kundërshtim teknik për informacionin e paraqitur në paragrafin (a)(2) të pikës 21L.B.204; dhe

ii) ka rënë dakord të bashkëpunojë me mbajtësin e miratimit për projektimin e riparimit për të përmbushur të gjitha detyrimet për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të produktit me modelin e riparimit në përputhje me pikën 21L.A.210;

4. Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet verifikimit të dëshmisë së përputhshmërisë, nuk ka gjetur:

i) mospërputhje me bazën e certifikimit të tipit, kur është e zbatueshme, ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit;

ii) nuk ka gjetur asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë produktin të pasigurt ose të papërputhshëm me mjedisin për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

b) Një miratim i një projekti riparimi të madh do të kufizohet në konfigurimin(et) specifike në certifikatën e tipit me të cilin lidhet projektimi i riparimit.

21L.B.205 Mbikëqyrja e vazhdueshme e vlefshmërisë ajrore për produktet për të cilat është miratuar një projektim riparimi

Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet mbikëqyrjes së saj të vazhdueshme të vlefshmërisë ajrore, përfshirë dhe raportet e marra në përputhje me pikën 21L.A.3, ose me çdo mënyrë tjetër zbulon një mospërputhje të një produkti, për të cilin është miratuar një projektim riparimi, me bazën e certifikimit të tipit ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, ky autoritet ngre një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21, ose një direktivë të vlefshmërisë ajrore sipas kushteve të pikës 21L.B.23.

21L.B.206 Dëmtime të pa riparuar

Një vlerësim i pasojave të vlefshmërisë ajrore do të kryhet nga Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, kur kërkohet të veprkohet sipas pikës 21L. A.211, në rast se një produkt i dëmtuar lihet i pa

riparuar dhe nuk mbulohet nga të dhënat e miratuara më parë. Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 vendos çdo kufizim të nevojshëm për produktin e dëmtuar për të siguruar një fluturim të sigurt.

NËNPJESA N – PROJEKTIMI I RIPARIMEVE TË AVIONËVE PËR TË CILËT ËSHTË DEKLARUAR PËRPUTHSHMËRIA E PROJEKTIMIT

21L.B.221 Investigimi fillestar i mbikëqyrjes së një deklarate përputhshmërie projektimi të një modeli riparimi të madh për një avion, për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin

a) Pas marrjes së një deklarate për përputhshmërinë e projektimit të një riparimi të madh në një avioni për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 verifikon që projektimi i riparimit është brenda objektit të pikës 21L.A.221 dhe që deklarata përmban të gjithë informacionin e përcaktuar në pikën 21L.A.226. AAC konfirmon marrjen e deklaratës, duke përfshirë caktimin e një numri referencë të deklaruar individual të përputhshmërisë së projektimit të deklaruesi.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 vlerëson, bazuar në rrezikun e një mospërputhjeje që çon në një projekt që nuk është i aftë të kryejë fluturim të sigurt ose që nuk është në përputhje me mjedisin, nëse nevojitet një inspektim fizik dhe vlerësim i avionit me projektimin e riparimit të madh, dhe më pas informon deklaruesin nëse është kështu. Ky vlerësim i rrezikut do të marrë në konsideratë:

1. kompleksitetin e projektimit të riparimit të madh dhe efektin e përgjithshëm në strukturat e avionit, karakteristikat dhe sistemet e fluturimit;

2. përvojën e mëparshme të inspektimeve fizike të avionëve dhe projekteve dhe ndryshimeve të riparimeve të mëdha që janë projektuar nga deklaruesi;

3. përgjigjen e deklaruesit ndaj çdo gjetje të mëparshme që është ngritur për mospërputhje të avionit specifik ose avionëve të ngjashëm të projektuar nga deklaruesi që gjithashtu i janë nënshtruar një deklarate për përputhshmërinë e projektimit.

c) Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 gjen prova në deklaratë, ose nëpërmjet inspektimit fizik dhe vlerësimit të kryer në përputhje me paragrafin (b) të pikës 21L.B.221, që tregon se avioni me projekti për riparim të madh mund të mos kryejë fluturim të sigurt ose mund të jetë i papërputhshëm me mjedisin gjatë operimeve në shërbim, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 ngre një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21.

21L.B.222 Regjistrimi i një deklarate të një projektimi riparimi të madh për një avion për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin

a) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 do të regjistrojë deklaratën e projektimit të një riparimi të madh për një avion, për të cilin është deklaruar përputhshmëria me projektimin, me kusht që:

1. deklaruesi të ketë deklaruar përputhshmërinë sipas pikës (a) të pikës 21L.A.226;

2. deklaruesi të ketë dorëzuar në Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 dokumentet e nevojshme në përputhje me pikën (d) të pikës 21L.A.226;

3. deklaruesi të jetë angazhuar që detyrimet në përputhje me pikën 21L.A.228 të merren përsipër;

4. të mos ketë asnjë çështje të pazgjidhur nga kontrolli fizik, nëse kryhet në përputhje me pikën (b) të pikës 21L. B.221.

b) Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 regjistron një deklaratë për një projektim riparimi të madh në një avion për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit nëse ajo është e kufizuar në konfigurimin(et) specifike në deklaratën e regjistruar të përputhshmërisë së projektimit me të cilën lidhet projektimi i riparimit të madh.

21L.B.223 Mbikëqyrja e vazhdueshme e vlefshmërisë ajrore të një projektimi riparimi për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit

Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2, nëpërmjet mbikëqyrjes së saj të vazhdueshme të vlefshmërisë ajrore, duke përfshirë raportet e marra në përputhje me pikën 21L.A.3, ose me ndonjë

mjet tjetër, zbulon një mospërputhje të një modeli riparimi, për të cilin është deklaruar përputhshmëria e projektimit, me specifikimet teknike të detajuara të zbatueshme ose me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit, ky autoritet ngre një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21, ose një direktivë të vlefshmërisë ajrore sipas kushteve të pikës 21L.B.23.

NËNPJESA O – STANDARDI TEKNIK EVROPIAN AUTORIZIMET E POROSISË

(Rezervë)

NËNPJESA P – LEJA E FLUTURIMIT

21L.B.241 Hetimi para lëshimit të lejes për fluturim

a) Pa cenuar nënpjesën P të seksionit B të aneksit I (pjesa 21), kur shqyrton një kërkesë për lëshimin e një leje për fluturimin e një avioni që është brenda objektit të kësaj shtojce, AAC-ja kryen një inspektimi fizik të avionit dhe është i bindur që avioni përputhet me projektimin e përcaktuar në pikën 21.A.708 të pjesës 21 përpara fluturimit kur kërkesa për leje fluturimi ka të bëjë me:

1. dëshminë e aktiviteteve të përputhshmërisë në pikën 21L.A.25 për një avion i cili është, ose synohet të jetë i certifikuar nga tipi;

2. dëshminë e aktiviteteve të përputhshmërisë në pikën 21L.A.44 për një avion për të cilin është ose synohet të deklarohet përputhshmëria e projektimit.

b) Për të gjitha kërkesat e tjera për lëshimin e një lejeje për fluturim për aktivitete dhe avionë brenda objektit të kësaj shtojce, autoriteti kompetent vlerëson, në përputhje me pikën 21.B.520 të pjesës 21, nevojën për një inspektimi fizik.

c) Nëse autoriteti kompetent gjen prova që tregojnë se avioni nuk është në përputhje me modelin e përcaktuar në pikën 21.A.708 të pjesës 21, një gjetje ngrihet në përputhje me pikën 21L.B.21.

21L.B.242 Hetimi përpara nxjerrjes të kushteve të fluturimit

a) Pa cenuar nënpjesën P të seksionit B të pjesës 21, kur shqyrton një kërkesë për miratimin e kushteve të fluturimit për një avion që është brenda objektit të kësaj shtojce, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2:

1. nëse aplikimi për kushtet e fluturimit lidhet me dëshminë e aktiviteteve të përputhshmërisë në pikën 21L.A.25 për një avion i cili është ose synohet të jetë i certifikuar me këtë tip, kryen një rishikim kritik të projektimit dhe një inspektim fizik dhe vlerësim të avionit për të siguruar që avioni është i aftë për fluturim të sigurt dhe se testimi i fluturimit mund të kryhet në mënyrë të sigurt;

2. nëse aplikimi për kushtet e fluturimit lidhet me dëshminë e aktiviteteve të përputhshmërisë në pikën 21L.A.44 për një avion për të cilin është deklaruar ose synon të deklarohet përputhshmëria e projektimit, kryen një inspektim fizik dhe vlerësim të avionit për të siguruar që avioni është i aftë për fluturim të sigurt dhe se testimi i fluturimit mund të kryhet në mënyrë të sigurt;

3. nëse aplikimi për kushtet e fluturimit lidhet me dëshminë e aktiviteteve të përputhshmërisë për një ndryshim të madh në pikën 21L.A.66, një certifikatë e tipit plotësues në pikën 21L.A.85 ose një riparim i madh në pikën 21L.A.206, bazuar në vlerësimin e bërë në pikën 21L.B.83, pika 21L.B.102 dhe pika 21L.B.203, përcakton nevojën për të kryer një inspektim fizik dhe vlerësim të avionit dhe një rishikim kritik të projektimit të dizajnit për të siguruar që avioni është i aftë për fluturim të sigurt dhe se testimi i fluturimit mund të kryhet në mënyrë të sigurt;

4. nëse aplikimi për kushtet e fluturimit lidhet me dëshminë e aktiviteteve të përputhshmërisë për një ndryshim të madh në pikën 21L.A.108 ose një riparim të madh në pikën 21L.A.227, bazuar në vlerësimin e kryer në pikën 21L.B.121 dhe pikën 21L.B.221, përcakton nevojën për të kryer një inspektim fizik dhe vlerësim të avionit për të siguruar që avioni është i aftë për fluturim të sigurt dhe se testimi i fluturimit mund të kryhet në mënyrë të sigurt.

b) Nëse Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 gjen prova që tregojnë se avioni mund të jetë i paaftë për të kryer një fluturim të sigurt, Autoriteti kompetent sipas pikës 21L.2 ngre një gjetje në përputhje me pikën 21L.B.21.

NËNPJESA Q – IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE DHE PJESËVE

NËNPJESA R – DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË PËR AVIONËT DHE CERTIFIKATAT PËR PËRDORIM TË AUTORIZUAR (FORMULARI 1 EASA) PËR MOTORËT DHE HELIKAT, DHE PJESËT E TYRE, QË PËRPUTHEN ME NJË DEKLARATË PËRPUTHSHMËRIE PROJEKTIMI

21L.B.251 Mbikëqyrja

a) AAC-ja kur është Autoriteti kompetent mbikëqyr personin fizik ose juridik që lëshon deklaratat e përputhshmërisë (formulari 52B i RSH-së sipas EASA-s) ose certifikatat për përdorim të autorizuar (formulari 1 EASA) sipas nënpjesës R të seksionit A të kësaj shtojce për verifikimin e përputhshmërisë së vazhdueshme të personit fizik ose juridik me kërkesat e zbatueshme të seksionit A dhe zbatimin e masave të sigurisë në operim të vendosura sipas paragrafit (c) dhe (d) të pikës 21L.B.15.

b) Mbikëqyrja përfshin një inspektim të artikullit të parë të çdo avioni të ri, motor, helikë ose pjesë që prodhohet për herë të parë për të cilin personi fizik ose juridik ka lëshuar një deklaratë përputhshmërie (formulari 52B EASA) ose certifikata për përdorim të autorizuar (formulari 1 EASA), dhe, siç përcaktohet nga programi i mbikëqyrjes në përputhje me pikën 21L.B.252, inspektime të mëtejshme të avionëve, motorëve, helikave dhe pjesëve të prodhuara nga ai person fizik ose juridik.

21L.B.252 Programi i mbikëqyrjes

a) AAC kur është Autoriteti kompetent krijon dhe mirëmban një program mbikëqyrjeje në mënyrë që të sigurohet përputhja me pikën 21L.B.251. Ky program mbikëqyrës merr parasysh natyrën specifike të personit fizik ose juridik, kompleksitetin e aktivitetëve të tyre dhe rezultatet e aktivitetëve të mëparshme të mbikëqyrjes, dhe bazohet në vlerësimin e rreziqeve shoqëruese. Ky program përfshin, brenda çdo cikli të planifikimit të mbikëqyrjes:

1. vlerësimet, auditimet dhe inspektimet, duke përfshirë, sipas rastit:

i) vlerësimet e sistemit të kontrollit të prodhimit dhe auditimet e procesit;

ii) auditimet e produktit të mostrës përkatëse të produkteve dhe pjesëve që janë nën objektin e personit fizik ose juridik;

iii) marrjen e mostrave të punës së kryer, dhe

iv) inspektimet e paparalajmëruara;

2. takime të kryera ndërmjet personit juridik ose fizik dhe autoritetit kompetent për të siguruar që të dyja palët të jenë të informuar për çdo çështje të rëndësishme.

b) Programi i mbikëqyrjes përfshin regjistrimet e datave kur janë caktuar vlerësimet, auditimet, inspektimet dhe takimet, dhe kur janë kryer në mënyrë efektive vlerësimet, auditimet, inspektimet dhe takimet.

c) Zbatimin e një cikli planifikimi mbikëqyrës që nuk i kalon 24 muaj.

d) Pavarësisht nga pika (c), cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të zgjatet në 36 muaj nëse autoriteti kompetent ka vërtetuar se gjatë 24 muajve të mëparshëm:

1. personi fizik ose juridik ka dëshmuar se mund të identifikojë në mënyrë efektive rreziqet e sigurisë së aviacionit dhe të menaxhojë rreziqet shoqëruese;

2. personi fizik ose juridik ka dëshmuar vazhdimisht respektimin e pikës 21L.A.273 dhe se ka kontroll të plotë mbi të gjitha ndryshimet në sistemin e menaxhimit të prodhimit;

3. nuk janë ngritur gjetje të nivelit 1;

4. të gjitha veprimet korrigjuese janë zbatuar brenda periudhës kohore që është pranuar ose zgjatur nga AAC-ja siç përcaktohet në pikën 21L.B.21.

e) Pavarësisht nga pika (c), cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të zgjatet më maksimumi deri në 48 muaj nëse, përveç kushteve të parashikuara në pikat (d) personi fizik ose juridik ka krijuar dhe AAC-ja ka miratuar një sistem të vazhdueshëm për raportimin tek AAC-ja për performancën e sigurisë dhe përputhshmërinë rregullatore të vetë personit fizik ose juridik.

f) Cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të reduktohet nëse ka prova se performanca e sigurisë të personit fizik ose juridik të shërbimit është ulur.

g) Në përfundim të çdo cikli të planifikimit të mbikëqyrjes, autoriteti kompetent nxjerr një raport rekomandimi për vazhdimin e aktiviteteve të kryera nga personi fizik ose juridik, duke pasqyruar rezultatet e mbikëqyrjes.

21L.B.253 Aktivitetet e mbikëqyrjes

a) Kur AAC-ja si autoriteti kompetent verifikon përputhshmërinë e personit fizik ose juridik në përputhje me pikën 21L.B.251 dhe programin e mbikëqyrjes të vendosur në përputhje me pikën 21L.B.252B, ai:

1. siguron personelin përgjegjës për mbikëqyrjen me udhëzime për të kryer funksionet e tyre;
2. kryen vlerësime, auditime, inspektime dhe, nëse është e nevojshme, inspektime të paparalajmëruara;

3. mbledh provat e nevojshme në rast se kërkohet veprim i mëtejshëm, duke përfshirë masat e parashikuara në pikat 21L.B.21 dhe 21L.B.22;

4. informon personin fizik ose juridik për rezultatet e aktiviteteve të mbikëqyrjes.

b) Nëse objektet e personit fizik ose juridik ndodhen në më shumë se një shtet, AAC-ja siç përkufizohet në pikën 21L.2 mund të bjerë dakord që detyrat e mbikëqyrjes të kryhen nga autoriteti(et) kompetente të shtetit(eve) anëtare ku ndodhen objektet, ose nga Agjencia për objektet që ndodhen jashtë një shteti joanëtar. Çdo person fizik ose juridik që i nënshtrohet një marrëveshjeje të tillë do të informohet për ekzistencën dhe për fushëveprimin e saj.

c) Për çdo aktivitet mbikëqyrës që kryhet në objektet e vendosura në një shtet anëtar të ndryshëm nga vendi ku personi fizik ose juridik ka vendin kryesor të biznesit, AAC-ja duhet të informojë autoritetin kompetent të atij shteti anëtar përpara se të kryhet ndonjë auditim i vendit ose inspektim i objekteve.

d) AAC-ja mbledh dhe përpunon çdo informacion që konsiderohet i nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes.

e) Nëse AAC-ja zbulon një mospërputhje të personit fizik ose juridik që lëshon deklaratat e përputhshmërisë (formulari 52B i RSH-së sipas EASA-ës) ose certifikata për përdorim të autorizuar (formulari 1 EASA) me kërkesat e zbatueshme të seksionit A dhe zbatimin e masave të sigurisë në operim të vendosura sipas paragrafit (c) dhe (d) të pikës 21L.B.15, AAC-a vepron në përputhje me pikat 21L.B.21 dhe 21L.B.22

Shtojcat në ANEKSIN Ib (Pjesa 21 Light) FORMULARËT e RSH-së SIPAS EASA

Kur formularët e këtij Aneksi lëshohen në shqip, ato duhet të përfshijnë një përkthim në gjuhën angleze/ When the Forms of this Annex are issued in Albanian, they must include an English translation,

Formularët e RSH-së sipas EASA (“Agjencia e Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian”) të përmendur në shtesat e kësaj pjese do të kenë karakteristikat e mëposhtme të detyrueshme. AAC do të garantojë se Formularët që ai lëshon, njihen dhe do të jetë përgjegjës për printimin e këtyre Formularëve

Shtojca I. Formulari 24B i RSH-së sipas EASA Certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore/Appendix

Shtojca II. Formulari 45B i RSH-së sipas EASA Certifikata e kufizuar e zhurmës/ Appendix II Form

Shtojca III. Formulari 52B i RSH-së sipas EASA Deklarata e përputhshmërisë së avionit/ Appendix

Shtojca IV. Formulari 53B i RSH-së sipas EASA Certifikata e lëshimit në shërbim/ Appendix

Shtojca I

Certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore – Formulari 24B i RSH-së sipas EASA

Restricted certificate of airworthiness- Form 24B of the Republic of Albania according to EASA

Logoja e autoritetit kompetent / *Competent authority logo*

CERTIFIKATA E KUFIZUAR E VLEFSHMËRISË AJRORE (E DEKLARUAR)

RESTRICTED CERTIFICATE OF AIRWORTHINESS (DECLARED)

4	[REPUBLIKA E SHQIPËRISË] [REPUBLIC OF ALBANIA] [AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL] [CIVIL AVIATION AUTHORITY]	4
1. Kombësia dhe markat e regjistrimit/ <i>Nationality and registration marks</i>	2. Prodhuesi dhe përcaktimi i avionit nga prodhuesi/ <i>Manufacturer and manufacturer's designation of aircraft</i>	3. Numri i serisë i avionit/ <i>Aircraft serial number</i>
4. Kategoritë/ <i>Categories</i>		
5. Kjo certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore lëshohet në përputhje me nenin 18(2)(a) të VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 në lidhje me avionin e lartpërmendur, i cili konsiderohet të jetë i vlefshëm për fluturim kur mirëmbahet dhe operon në përputhje me sa më sipër dhe kufizimet përkatëse të operimit. / <i>This restricted certificate of airworthiness is issued pursuant to Article 18(2)(a) of Council of Ministers Decision No. 1095, dated 24.12.2020 in respect of the above-mentioned aircraft which is considered to be airworthy when maintained and operated in accordance with the foregoing and the pertinent operating limitations.</i>		
Përveç sa më sipër, zbatohet kufizimi i mëposhtëm/ <i>In addition to above, the following restriction applies:</i> Kjo certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore lëshohet në bazë të një deklarate të përputhshmërisë së projektimit të hartuar në përputhje me UM nr. ..., datë..... dhe është e vlefshme. Kjo certifikatë nuk përputhet me të gjitha standardet e zbatueshme të aneksit 8 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar dhe për këtë arsye mund të mos jetë e vlefshme për lundrimin ajror ndërkombëtar mbi shtete të tjera, përveç rasteve kur miratohet nga shtetet mbi të cilat fluturohet./ <i>This restricted certificate of airworthiness is issued on the basis of a declaration of design compliance made in accordance with Minister's Order No....., dated..... and is valid. This certificate does not comply with all of the applicable Standards of Annex 8 to the Convention on International Civil Aviation and therefore may not be valid for international air navigation over other States, unless approved by the states being overflown.</i>		
Data e lëshimit/ <i>Date of issue.</i>		Nënshkrimi/ <i>Signature.</i>
6. Kjo certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore është e vlefshme nëse nuk revokohet nga AAC-ja si autoriteti kompetent i shtetit të regjistrimit./ <i>This restricted certificate of airworthiness is valid unless revoked by the CAA as the competent authority of the State of registry.</i>		
Certifikata aktuale e rishikimit të vlefshmërisë ajrore do t'i bashkëngjitet kësaj certifikate/ <i>A current airworthiness review certificate shall be attached to this certificate.</i>		

Formulari 24B i RSH-së sipas EASA – Lëshimi 1

Form 24B of the Republic of Albania according to EASA- Issue 1

Kjo certifikatë do të mbahet në bord gjatë të gjitha fluturimeve/ *This certificate shall be carried on board during all flights.*

Shtojca II

Certifikata e kufizuar e zhurmës – Formulari 45B i RSH-së sipas EASA-s

Restricted noise certificate – Form 45B of the Republic of Albania according to EASA

Për përdorim nga Shteti Anëtar i regjistrimit/ <i>For use by the Member State of registry</i>	1. REPUBLIKA E SHQIPËRISË/ REPUBLIC OF ALBANIA	3. Nr. i Dokumentit/ <i>Document No:</i>
2. CERTIFIKATË E KUFIZUAR ZHURME (E DEKLARUAR) RESTRICTED NOISE CERTIFICATE (DECLARED)		
4. Markat e regjistrimit/ <i>Registration marks:</i>	5. Prodhuesi dhe projektimi i avionit/ <i>Manufacturer and designation of aircraft:</i>	6. Numri serial i avionit/ <i>Aircraft serial No:</i>
7. Projektimi i motorit/ <i>Designation of engine:</i>	8. Projektimi i helikës/ <i>Designation of propeller:</i>	
9. Masa maksimale e ngritjes (kg)/ <i>Maximum take-off mass (kg)</i>		
10. Modifikime shtesë të përfshira me qëllim përputhshmërinë me standardet e zbatueshme të certifikatës së zhurmës/ <i>Additional modifications incorporated for the purpose of compliance with the applicable noise certification standards:</i>		
11. Standardi i certifikatës së zhurmës/ <i>Noise certification standard:</i>	12. Niveli i zhurmës gjatë ngritjes/ <i>Take-off noise level:</i>	
Shënime/ <i>Remarks:</i>		
13. Kjo certifikatë e kufizuar e zhurmës lëshohet sipas nenit 9 të VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, në lidhje me avionin e sipërpërmendur, i cili deklarohet nga deklaruesi i deklaratës së përputhshmërisë së projektimit në përputhje me aneksin Ib (Pjesa 21 Light) të UM r....., datë..... për të respektuar standardin e caktuar të zhurmës kur mirëmbahet dhe operon në përputhje me kërkesat përkatëse dhe kufizimet operacionale/ <i>This restricted noise certificate is issued pursuant to Article 9 of Council of Ministers Decision No. 1095, dated 24.12.2020, in respect of the above-mentioned aircraft, which is declared by the declarant of a declaration of design compliance in accordance with Annex Ib (Part 21 Light) to Minister's order No.....,dated.... to comply with the indicated noise standard when maintained and operated in accordance with the relevant requirements and operating limitation.</i>		
14. Data e lëshimit/ <i>Date of issue</i> 15. Nënshkrimi/ <i>Signature</i>		

Formulari 45B i RSH-së sipas i EASA – Lëshimi 1

Form 45B of the Republic of Albania according to EASA – Issue 1

Shtojca III

Deklarata e përputhshmërisë së avionit – Formulari 52B i RSH sipas EASA

Aircraft statement of conformity – Form 52B of the Republic of Albania according to EASA

DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË SË AVIONIT AIRCRAFT STATEMENT OF CONFORMITY		
1. Vendi i prodhimit/ <i>State of manufacture</i>	2. REPUBLIKA E SHQIPËRISË/ REPUBLIC OF ALBANIA	3. Nr. i Ref. së Deklaratës/ <i>Statement</i>

		Ref. No:
4. Organizimi/ Organisation		
5. Tipi i avionit/ <i>Aircraft type</i>	6. Lloji i certifikatës/Referenca e deklaratës së përputhshmërisë së projektimit/ <i>Type certificate/ Declaration of design compliance refs:</i>	
7. Regjistrimi ose marka e avionit/ <i>Aircraft registration or mark</i>	8. Nr. i identifikimit të organizatës prodhuese/ <i>Production organisation identification No</i>	
9. Të dhënat e motorit/helikës (5)/ <i>Engine/propeller details (5)</i>		
10. Ndryshimet dhe/ose buletinet e shërbimit1/ <i>Modifications and/ or service bulletins1</i>		
11. Direktivat e vlefshmërisë ajrore/ <i>Airworthiness directives</i>		
12. Koncesionet/ <i>Concessions</i>		
13. Përjashtimet, heqjet dorë ose derogimet1/ <i>Exemptions, waivers or derogations1</i>		
14. Shënime/ <i>Remarks:</i>		
15. Certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore/ <i>Restricted/certificate of airworthiness</i>		
16. Kërkesat shtesë/ <i>Additional requirements</i>		
17. Deklarata e përputhshmërisë/ <i>Statement of conformity:</i> Me anë të këtij dokumenti vërtetohet se ky avion përputhet plotësisht me/ <i>It is hereby certified that this aircraft conforms fully to the.</i> <input type="checkbox"/> Projektimin e tipit të certifikuar/ <i>type-certified design; ose/ or</i> <input type="checkbox"/> Të dhënat e projektimit të deklaruar/ <i>declared design data</i> Dhe artikujt e mësipërm në kutitë 9, 10, 11, 12 dhe 13/ <i>and to the items above in boxes 9, 10, 11, 12 and 13.</i> Avioni është në gjendje për operim të sigurt/ <i>The aircraft is in a condition for safe operation.</i> Avioni është testuar në mënyrë të kënaqshme në fluturim/ <i>The aircraft has been satisfactorily tested in flight.</i>		
18. Nënshkruar/ <i>Signed</i>	19. Emri/ <i>Name</i>	20. Data (d/m/v)/ <i>Date (d/m/y)</i>
21. Referenca e deklaruar ose e miratuar e organizatës prodhuese (nëse është e zbatueshme)/ <i>Declared or approved production organisation reference (if applicable)</i>		

Formulari 52B i RSH-s sipas EASA – Lëshimi 1

Form 52B of the Republic of Albania according to EASA-Issue 1

5) Përfshije ose fshije sipas rastit

Udhëzime për përdorimin e “Deklaratës së përputhshmërisë së avionit – formulari 52B i RSH-së sipas EASA”

1. QËLLIMI DHE OBJEKTI

1.1. Qëllimi i deklaratës së përputhshmërisë së avionit (formulari 52B i RSH-së sipas EASA) të lëshuar sipas nënpjesës G ose nënpjesës R të seksionit A të shtojcës Ib (Pjesa 21 Light) ose sipas nënpjesës G të seksionit A të shtojcës I (pjesa 21) është të mundësojë organizatën prodhuese të aplikojë për marrjen e një certifikate individuale të vlefshmërisë ajrore ose certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore nga autoriteti kompetent i shtetit të regjistrimit.

2. TË PËRGJITHSHME

2.1 Deklarata e përputhshmërisë duhet të jetë në përputhje me formatin e modelit duke përfshirë numrat e bllokut dhe vendndodhjen e secilit bllok. Sidoqoftë, madhësia e secilit bllok mund të ndryshojë për t’iu përshtatur aplikimit individual, por jo në atë masë që të mos njihet deklarata e përputhshmërisë. Në rast dyshimesh, konsultohet AAC.

2.2 Deklarata e përputhshmërisë mund të jetë ose e printuar paraprakisht ose e gjeneruar nga

kompjuteri, por në secilin rast printimi i rreshtave dhe karaktereve duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm. Formulimi i printuar paraprakisht lejohet në përputhje me modelin e bashkangjitur, por nuk lejohen deklaratat e tjera certifikimi.

2.3 Plotësimi i deklaratës mund të jetë ose i printuar me makineri/kompjuter ose i shkruar me dorë, duke përdorur shkronja kapitale për një lexim më të lehtë. Gjuha angleze, dhe shqip si gjuha zyrtare e shtetit që lëshon deklaratën, janë të pranueshme.

2.4 Një kopje e deklaratës dhe të gjitha dokumentet e bashkëngjitura të përmendura duhet të ruhen nga organizata prodhuese e miratuar.

3. PLOTËSIMI I DEKLARATËS SË PËRPUTHSHMËRISË NGA HARTUESI

3.1 Duhet të ketë pika në të gjitha blloqet për ta kthyer dokumentin një deklaratë të vlefshme.

3.2 Deklarata e përputhshmërisë nuk mund t'i lëshohet autoritetit kompetent të shtetit anëtar të regjistrimit, përveç nëse janë miratuar projektimi i avionit dhe produktet e tij të instaluar ose nëse është regjistruar deklarata e përputhshmërisë së projektimit në Autoritetin përgjegjës.

3.3 Informacioni i nevojshëm në blloqet 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 mund të përmendet për të ndarë dokumente të identifikuar të mbajtura në dosje nga organizata prodhuese, përveç nëse autoriteti kompetent bie dakord ndryshe.

3.4 Kjo deklaratë përputhshmërie nuk synon të përfshijë ato artikuj të pajisjeve që mund të nevojitet të montohen për të respektuar rregullat e zbatueshme të operimit. Megjithatë, disa nga këto artikuj individualë mund të përfshihen në bllokun 10 ose në projektimin e tipit të licencuar ose në projektimin e deklaruar të avionit. Prandaj, operatorëve iu rikujtohet përgjegjësia e tyre për të garantuar përputhshmërinë me rregullat e zbatueshme operationale për operimet e tyre të veçanta.

Bloku 1. Shkruani emrin e shtetit prodhues.

Bloku 2. Autoriteti kompetent që lëshon deklaratën e përputhshmërisë nën autoritetin e tij.

Bloku 3. Një numër serial unik duhet të printohet paraprakisht në këtë bllok për qëllime të kontrollit të deklaratës dhe gjurmimit. Bëhet përjashtim në rastin e një dokumenti të gjeneruar nga kompjuteri: numri nuk ka nevojë të printohet paraprakisht kur kompjuteri është programuar për të prodhuar dhe printuar një numër unik.

Bloku 4. Emri i plotë dhe adresa e vendndodhjes së organizatës që lëshon deklaratën. Ky bllok mund të printohet paraprakisht. Logot etj., lejohen nëse blloku mund ta përmbajë logon etj.

Bloku 5. Lloji i avionit në tërësi siç parashikohet në certifikatën tip dhe fletën e të dhënave përkatëse të tij ose projektimin e deklaruar të avionit siç është regjistruar nga Autoriteti kompetent.

Bloku 6. Numrat e referencës dhe lëshimi i certifikatës së tipit për avionin në fjalë ose numri i regjistrimit të deklaratës së përputhshmërisë së projektimit

Bloku 7. Nëse avioni është i regjistruar, atëherë kjo markë do të jetë marka e regjistrimit. Nëse avioni nuk është i regjistruar, atëherë kjo do të jetë marka që pranohet AAC-ja dhe, nëse është e zbatueshme, nga autoriteti kompetent i një vendi të tretë.

Bloku 8. Numri i identifikimit i caktuar nga organizata prodhuese për kontrollin, gjurmimin dhe mbështetjen e produktit. Ndonjëherë ky quhet “numri i serisë së organizatës prodhuese” ose “numri i ndërtuesit”.

Bloku 9. Lloji i motorit dhe lloji i helikës plotësisht siç parashikohet në certifikatën përkatëse të tipit dhe në fletën e të dhënave të lidhura me të ose në deklaratën e regjistruar të përputhshmërisë së projektimit. Duhet të përcaktohet gjithashtu numri i identifikimit/referencës së organizatës së tyre prodhuese dhe vendndodhja përkatëse.

Bloku 10. Ndryshime të miratuara ose të deklaruara të projektimit në përkufizimin e avionit.

Bloku 11. Një listë e të gjitha direktivave të zbatueshme të vlefshmërisë ajrore (ose ekuivalente) dhe një deklaratë përputhshmërie me direktivat e vlefshmërisë ajrore, së bashku me përshkrimin e metodës së përputhshmërisë të avionit individual në fjalë, duke përfshirë produktet dhe pjesët,

aparaturat dhe pajisjet e instaluara. Duhet të deklarohet çdo afat i ardhshëm i kërkesës për përputhshmëri.

Bloku 12. Devijimet e paqëllimshme të miratuara ose të deklaruara nga projektimi i tipit të licencuar ose projektimi i deklaruar, ndonjëherë të referuara, si: “koncesione”, “divergjenca” ose “mospërputhmëri”.

Bloku 13. Këtu mund të përfshihen vetëm përjashtimet, heqjet dorë ose derogimet e dakordësuara ose të deklaruara.

Bloku 14. Vërejtjet. Çdo deklaratë, informacion, e dhënë e veçantë ose kufizim që mund të ndikojë te vlefshmëria ajrore e avionit në fjalë. Nëse nuk ka asnjë informacion apo të dhënë të tillë, shënoni “ASNJË”.

Bloku 15. Shkruani “certifikata e vlefshmërisë ajrore” ose “certifikata e kufizuar të vlefshmërisë ajrore”, siç kërkohet nga certifikata e vlefshmërisë ajrore.

Bloku 16. Kërkesat shtesë si ato të njoftuara nga një vend importues duhet të shënohen në këtë bllok.

Bloku 17. Vlefshmëria e deklaratës së përputhshmërisë i nënshtrohet plotësimit të plotë të të gjitha blloqeve në formular. Një kopje e raportit të testimit të fluturimit, së bashku me çdo defekt të regjistruar dhe detajet e korigjimit, duhet të mbahet në dosje nga organizata prodhuese. Raporti duhet të nënshkruhet si i pranueshëm nga stafi përkatës certifikues dhe një anëtar i ekuipazhit të fluturimit, p.sh. piloti testues ose inxhinieri i testimit të fluturimit.

Testimet e kryera të fluturimit janë ato të përcaktuara nën kontrollin e elementit të menaxhimit të cilësisë së sistemit të prodhimit, siç parashikohet nga:

1. pika (b) e pikës 21L.A.124; ose

2. pika (f) e pikës 21L.A.273, për të garantuar se avioni është në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe është në gjendje për funksionim të sigurt.

Lista e artikujve të ofruar (ose të vënë në dispozicion) për të përmbushur aspektet e kësaj deklarate që lidhen me operimin e sigurt të avionit duhet të mbahet në dosje nga organizata prodhuese.

Bloku 18 Deklarata e përputhshmërisë mund të nënshkruhet nga personi që është i autorizuar për ta bërë këtë gjë nga organizata prodhuese në përputhje me pikën (d) të pikës 21L.A.125 ose pikën (b) të pikës 21L.A.273. Nuk duhet të nënshkruar me vulë gome.

Bloku 19 Emri i personit që nënshkruan deklaratën duhet të shkruhet ose printohet në një formë të lexueshme.

Bloku 20 Duhet të përcaktohet data në të cilën është nënshkruar deklarata e përputhshmërisë.

Bloku 21 Referenca e licencimit nga autoriteti kompetent duhet të citohet.

SHTOJCA IV

CERTIFIKATA E LEJIMIT NË SHËRBIM – FORMULARI 53B I RSH-së SIPAS EASA

Certificate of release to service – Form 53B of the Republic of Albania according to EASA

CERTIFIKATA E LEJIMIT NË SHËRBIM
CERTIFICATE OF RELEASE TO SERVICE

[EMRI I ORGANIZATËS PRODHUESE]/ [PRODUCTION ORGANISATION NAME]

Referenca e organizatës prodhuese/ Production organisation reference:

Certifikata e lejimit në shërbim në përputhje me 21L.A.126(e) ose 21L.A.273(8) të aneksit Ib (Pjesa 21 Light) të UM nr..., datë ... (fshihet sipas rastit)/ *Certificate of release to service in accordance with 21L.A.126(e) or 21L.A.273(8) of Annex Ib (Part 21 Light) to Minister's Order No....., dated..... (delete as appropriate).*

Avioni/ *Aircraft*::.....Lloji/ *Type*::..... Nr. i Regjistrimit të ndërtuesit/ *Constructor No/Registration*::.....

është mirëmbajtur siç specifikohet në urdhrin e punës/ *has been maintained as specified in work order*::.....

Përshkrim i shkurtër i punës së kryer/ *Brief description of work performed*:

Vërteton se puna e specifikuar është kryer në përputhje me 21L.A.126(e) ose 21L.A.273(8) të aneksit Ib (Pjesa 21 Light) të UM nr ..., datë/..... (fshihet sipas rastit) dhe në lidhje me atë punë avioni konsiderohet i gatshëm për lejim në shërbim dhe për këtë arsye është në gjendje për operim të sigurt/ *Certifies that the work specified was carried out in accordance with 21L.A.126(e) or 21L.A.273(8) of Annex Ib (Part 21 Light) to Minister's Order No....., dated..... (delete as appropriate) and in respect to that work the aircraft is considered ready for release to service and therefore is in a condition for safe operation.*

Stafi certifikues (emri)/ *Certifying staff*

(name):

(nënshkrimi)/ *(signature)*:Vendndodhja

/ *Location*:

Data/ *Date*... -... (ditë/muaj/vit)/ *(day, month, year)*

Formulari 53B i RSH-së sipas EASA – Lëshimi 1

Form 53B of the Republic of Albania according to EASA-Issue

UDHËZIME PLOTËSUESE

Bloku PËRSHKRIM I SHKURTËR I PUNËS SË KRYER që paraqitet në FORMULARIN 53B i RSH-së sipas EASA duhet të përfshijë një referencë për të dhënat e miratuara të përdorura për të kryer punën.

VENDNDODHJA e bllokut që shfaqet në FORMULARIN 53B i RSH-së sipas EASA i referohet vendndodhjes ku është kryer mirëmbajtja, jo vendndodhjes së objekteve të organizatës (nëse janë të ndryshme).